




QASJE




Libri i Punimeve

QASJE I

Kongresi i Parë Ndërkombëtar i Shkencave Juridike dhe Ekonomike

29-30 Tetor 2016

Prishtinë, Republika e Kosovës



QASJE

1

**Kongresi i Parë Ndërkombtar i Shkencave
Juridike dhe Ekonomike**

Libri i Punimeve

Procedura e zgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Kosovës

Adrianit Ibrahim
Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Republika e Kosovës

Abstrakti

Qëllimi i këtij punimi konsiston në hulumtimin e procesit të zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Më konkretisht hipoteza që kam dashur të vërtetoj ka të bëjë me atë se procesi i zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese manifestohet me implikime të caktuara politike. Me fjalë tjera ky proces sipas mendimit tim nuk është tërësisht objektiv dhe në asnjë rast nuk është thjesht një procedurë juridiko administrative. Kjo për arsye se komisioni i posaçëm për shqyrtimin e aplikacioneve të kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës ndër të tjera përbëhet nga Kryetari i Kuvendit, Udhëheqësit e secilit grup parlamentar, Avokati i Popullit, Kryetari i Këshillit Gjyqësor, etj. Paradoksi këtu qëndron në faktin se këta anëtarë të këtij komisioni mund të paraqiten në procedurë kushtetuese qoftë si paditës qoftë si shkelës të supozuar të Kushtetutës. Në këtë pikë natyrshëm lindin dyshime në objektivitetin e atyre gjyqtarëve për arsye se në njërin apo tjetren formë duhet të gjykojnë ata persona të cilët e kanë votuar atë si gjyqtar/e. Sidoqoftë komisioni vetëm i propozon kuvendit kandidatët ndërsa Kuvendi i voton ose jo ata dhe tutje (ata që marrin votat e mjaftueshme) i propozon tek presidenti për dekretim. Mirpo pikërisht këtu kjo procedurë bëhet edhe më e dyshimit sepse kjo po i bie që Kryetari i Kuvendit dhe Shefat e grupeve parlamentare si anëtarë të komisionit përzgjedhës po i seleksionojnë

kandidatët dhe po i'a dërgojnë vetes për votim. Andaj nëse e trajtojmë situatën nga ky këndvështrim atëherë ku po mbetet kuptimi i funksionit të komisionit?

Sa i përket metodologjisë së punës duhet theksuar që trajtimi i temës fillon me një vështrim të shkurtër historik por konsideroj të domosdoshëm për të kaluar tek organizimi, funksionet dhe kompetencat e këtij institucioni. Më tutje hulumtimi përqëndrohet kryesisht në mënyrën e zgjedhjes së gjyqtarëve, bazën juridike të këtij procesi, kriteret për gjyqtarë si dhe zbatimin e këtyre kriterëve respektivisht këtyre normave juridike kompetente. Natyrisht që janë bërë edhe disa krahasime mjaft interesante lidhur me mënyrën e zgjedhjes së gjyqtarëve në vende të ndryshme të botës për të përmbyllur punimin me të disa konstatime si rezultate të hulumtimit.

Fjalë të rëndësishme: Gjykata Kushtetuese, procesi i zgjedhjes së gjyqtarëve, implikimet politike

Hyrja

“Veprën më të shkëlqyer që mund të ketë nxjerrë ndonjëherë mendja dhe vendosmëria njerëzore është kushtetuta. Në një botë ndryshimesh dhe trazirash, populli amerikan nuk ka asgjë më të vlefshme se këtë dokument të madh” William E. Gladstone

Mendoj që thënia e cituar më lart mjaft mirë e pasqyron rëndësinë e kushtetutës si akti më i lartë juridiko-politik, e pse jo edhe akti më i shenjtë i një vendi. Duke e pasur parasysh këtë fakt, kjo ka qenë arsye e mjaftueshme për mua që të hulumtoj më shumë rreth Gjykatës Kushtetuese respektivisht organit i cili është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe kontrollin e kushtetutshmërisë.

Sidoqoftë qëllimi i këtij punimi konsiston në hulumtimin e procesit të zgjedhjes së gjyqëtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Më konkretisht hipoteza që kam dashur të vërtetoj ka të bëjë me atë se procesi i zgjedhjes së gjyqëtarëve të Gjykatës Kushtetuese manifestohet me implikime të caktuara politike. Me fjalë tjera ky proces sipas mendimit tim nuk është tërësisht objektiv dhe në asnjë rast nuk është thjesht një procedurë juridiko administrative. Kjo për arsye se komisioni i posaçëm për shqyrtimin e aplikacioneve të kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës ndër të tjera përbëhet nga Kryetari i Kuvendit, Udhëheqësit e secilit grup parlamentar, Avokati i Popullit, Kryetari i Këshillit Gjyqësor, etj. Paradoksi këtu qëndron në faktin se këta anëtarë të këtij komisioni mund të paraqiten në procedurë kushtetuese qoftë si paditës qoftë si shkelës të supozuar të Kushtetutës. Në këtë pikë natyrshëm lindin dyshime në objektivitetin e atyre gjyqëtarëve për arsye se në një tërësi apo tjetër formë duhet të gjykojnë ata persona të cilët e kanë votuar atë si gjyqtar/e. Sidoqoftë komisioni vetëm i propozon kuvendit kandidatët ndërsa Kuvendi i voton ose jo ata dhe tutje (ata që marrin votat e mjaftueshme) i propozon tek presidenti për dekretim. Mirpo pikërisht këtu kjo procedurë bëhet edhe më e dyshimit sepse kjo po i bie që Kryetari i Kuvendit dhe Shefat e grupeve parlamentare si anëtarë të komisionit përzgjedhës po i seleksionojnë kandidatët dhe po i'a dërgojnë vetes për votim. Andaj nëse e trajtojmë situatën nga ky këndvështrim atëherë ku po mbetet kuptimi i funksionit të komisionit?

Pra në vija më të trasha qëllimi i punimit është ky që u elaborua më sipër. Ndërsa sa i përket metodologjisë së punës duhet theksuar që trajtimi i temës fillon me një vështrim të shkurtër historik por konsideroj të domosdoshëm për të kaluar tek organizimi, funksionet dhe kompetencat e këtij institucioni. Më tutje hulumtimi përqëndrohet kryesisht në mënyrën e zgjedhjes së gjyqëtarëve, bazën juridike të këtij procesi, kriteret për gjyqtarë si dhe zbatimin e këtyre kriterëve respektivisht këtyre normave juridike kompetente. Natyrisht që janë bërë edhe disa krahasime mjaft interesante lidhur me mënyrën e zgjedhjes së gjyqëtarëve në vende të ndryshme të botës.

Personalisht mendoj që Gjykata Kushtetuese është institucion i domosdoshëm për të gjitha shtetet që synojnë demokraci dhe kushtetutshmëri të plotë si dhe respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kjo është me interes të

veçantë sidomos për Kosovën si një shtet i ri dhe me shumë sfida gjatë tranzicionit.

Historik i shkurtër për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës

Në aspektin e përgjithshëm Gjykata Kushtetuese si institucion i karakterit që e ka sot, për herë tëparë është paraqitur në Austri ne vitin 1920 dhe aktualisht funksionon në një numër të madh të shteteve si mekanizëm kryesor për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë ¹.

Ndërsa sa i përket Kosovës mendoj që Kosova në përgjithësi nuk ka traditë të gjatë të kontrollit kushtetues.² Fillet e para të drejtësisë kushtetuese në Kosovë pasuan me reformat kushtetuese të vitit 1971 të cilat avancuan pozitën kushtetuese të Kosovës në kuadër të ish- Federatës Jugosllave. Kjo situatë i mundësoi Kosovës të bëjë riorganizimin e saj në fusha të caktuara politiko juridike, përfshirë këtu edhe fushën e mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së saj.

Tutje më 1972 miratohet amendamenti dhjetë (10) në Ligjin Kushtetues të Kosovës i cili themeloi Gjykatën Kushtetuese të Kosovës. Ky hap bëri që Dega Gjyqësore Kushtetuese (e cila deri atëherë gjendej në kuadrin e Gjykatës Supreme) të transformohet në Gjykatë Kushtetuese. Institucioni i Gjykatës Kushtetuese u ruajt edhe në kuadër të arkitekturës së re kushtetuese të vitit 1974. Gjykata Kushtetuese e Kosovës si mekanizëm për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë ishte funksionale deri më 1990 ku përmes masave anti - kushtetuese pasoi heqja e autonomisë kushtetuese të Kosovës.

Suprimimi kundërkushtetues i autonomisë së Kosovës dhe shkëputja për rreth 19 vite deri më 2009, shkaktoj një vakuum në zhvillimin e gjyqësisë

¹ Arsim Bajrami, "Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës", Prishtinë 2012, faqe 333.

² Po aty, faqe 334.

kushtetuese.³ Megjithëse edhe gjatë kësaj periudhe pati disa përpjekje si p.sh me Kushtetutën e Kaçanikut (7 shtator 1990) apo Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme të Kosovës (15 maj 2001), ku ishte paraparë që në kuadër të Gjykatës Supreme të Kosovës të themelohet një Kolegj i veçantë për mbrojtjen e Kornizës Kushtetuese (i cili Kolegj ishte pasiv për gjatë gjithë kohës).

Sidoqoftë duhet theksuar që megjithëse rrethanat e krijimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ishin specifike, ky proces nga shumica e autorëve të kësaj lëmie përmbledhet në tri faza kryesore:

Faza e parë: themelimi dhe krijimi i bazës ligjore për funksionimin e këtij organi;

Faza e dytë: mbylljen e procesit tranzicional të këtij organi sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Statusin e Kosovës të 26 marsit 2007 të propozuar nga Presidenti Ahtisari që ndërlihet me përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur;

Faza e tretë: fillimi i procesit të pavarur të funksionimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Nga themelimi në shkurt të vitit 2009 deri tani, kjo gjykatë ndër tjerash pati dy raste mjaft sfiduese lidhur me vlerësimin e ushtrimit të funksionit kushtetues të dy presidentëve Pacolli dhe Sejdiu që e bënë këtë Gjykatë mjaft të sfiduar qysh në fillet e saj.

Kompetencat e Gjykatës Kushtetuese dhe natyra juridike e vendimeve të saj

Gjykata Kushtetuese duhet të garantoj stabilitetin e sistemit juridik dhe institucional. Autoritetin e nevojshëm për këtë ky institucion e merr nga kushtetuta. Me fjalë të tjera stabiliteti jo vetëm juridiko-politik por edhe ai shoqëror në tërësi është i garantuar vetëm atëherë kur Gjykata Kushtetuese në mënyrë të drejtë dhe rigoroze e bën interpretimin përfundimtar të kushtetutës.

³<http://www.gjk-ks.org/?cid=1.2>, web-faqja e Gjykatës Kushtetuese së Kosovës, sektori Për Gjykatën, Historiku, qasur më 23 Dhjetor 2014.

Në aspektin e përgjithshëm kompetencat e gjykatave kushtetuese mund të ndahen në tri fusha kryesore:⁴

- 1. Kontrolli i kushtetutshmërisë dhe vlerësimi i ekzistimit të pajtueshmërisë së akteve juridike me kushtetutën dhe ligjin;*
- 2. Kontrolli i ekzistimit të shkeljeve, cenimit ose mosrespektimit të kushtetutës nga organet dhe institucionet shtetërore, përfshirë këtu edhe shkarkimin e zyrtarëve të lartë shtetëror;*
- 3. Kontrolli i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së zgjedhjeve, referendumeve dhe akteve tjera juridike e politike.*

Pra mund të përfundojmë se Gjykatat Kushtetuese kanë autorizime mjaft të gjëra në mbrojtjen e Kushtetutës. Ato bëjnë kontrollin e përgjithshëm të sistemit juridik nga aspekti i pajtueshmërisë të akteve dhe veprimeve me Kushtetutën. Në rast të vlerësimit të ekzistimit të papajtueshmërisë së akteve juridike me kushtetutën, Gjykata Kushtetuese ka kompetencën ti anulojë apo ti shfuqizojë ato. Marrim si shembull organin ligjdhënës i cili njëkohësisht është edhe organi që miraton vetë kushtetutën. Në rast të miratimit të një ligji, në qoftë se Gjykata Kushtetuese këtë të fundit e vlerëson si jo kushtetuese, ajo mund të anuloj apo shfuqizoj aktin përkatës juridik, qoftë në tërësi apo vetëm pjesë të caktuara të tij.

Gjithashtu, gjykatat kushtetuese vlerësojnë shkeljen e kushtetutës edhe nga ana e institucioneve shtetërore dhe konstatojnë plotësimin e kushteve për shkarkimin dhe largimin nga detyra të zyrtarëve të lartë shtetëror, që nga presidenti e gjerë tek zyrtaret e niveleve të ndryshme. Në theks të veçantë për këtë është kontrollimi i kushtetutshmërisë nga ana e presidentit, sidomos kur bëhet fjalë për tradhëtinë ndaj vendit, keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo shkelje tjera të rënda të kushtetutës.

Pra në përgjithësi mund të thuhet se për nga natyra juridike vendimet e Gjykatës Kushtetuese mund të ndahen në katër(4) grupe kryesore:⁵

⁴ Arsim Bajrami & Xhavit Shala, “Sistemi Kushtetues dhe organizimi i jurisprudencës”, OSBE, Prishtinë, 2010, faqe 25.

⁵ Po aty, faqe 30.

a) Vendimet me të cilat anulohet legjislacioni ose akti tjetër juridik (anulimi nënkupton gjithashtu edhe anulimin e pasojave juridike të krijuara nga akti juridik në fjalë).

b) Vendimi me të cilin bëhet shfuqizimi i një ligji ose akti juridik (shfuqizimi është një masë më e butë e shkeljes së kushtetutës për arsye se ajo nuk nënkupton edhe anulimin e pasojave juridike krijuara nga akti juridik në fjalë).

c) Vendimi me të cilin konstatohet shkelja e kushtetutës nga autoriteti zyrtar si dhe plotësimi i kushteve për shkarkimin e tij.

d) Vendimi me të cilin konstatohet jo kushtetutshmëria ose kundërligjshmëria e një procesi elektorale, referendumi ose të ndonjë procesi tjetër për zgjedhjen apo shkarkimin e ndonjë titullari të lartë shtetërorë.

Sa i përmet mënyrës së marrjes së vendimeve duhet cekur se vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren me shumicën e votave të anëtarëve të saj, me përjashtim të rasteve kur kërkohet shumica e kualifikuar prej 2/3 të votave të anëtarëve të saj si p.sh me rastin e vlerësimit të ekzistimit të shkeljeve kushtetuese nga shefi i shtetit dhe shkarkimit kushtetues të tij. Për dallim nga procedurat gjyqësore vendimi i gjykatës kushtetuese nuk kumtohet publikisht në séance të gjykatës por i dërgohet palëve në kontestin kushtetues. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës shpallen në gazetën zyrtare. Përndryshe ato janë të formës së prerë, të zbatueshme që nga moment i marrjes si dhe të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.⁶ Gjithashtu duhet të theksohet që gjyqësia kushtetuese vepron vetëm në një instancë dhe ndaj vendimeve të saj nuk mund të apelohej asnjë ankesë ose mjet tjetër juridik të rregullt apo të jashtëzakonshëm.

Nëse i referohemi statistikave të Raportit Final Statistikor të Gjykatës Kushtetuese (2009-2014)⁷ atëherë gjatë periudhës 02.02.2009 – 31.10.2014, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur 2 seanca publike dëgjimore (në rastet KI 187/13 dhe KO 119/14) dhe 36 seanca plenare. Në 163 kolegje shqyrtuese, të mbajtura gjatë kësaj periudhe, janë marrë 168 vendime (duke përfshirë aktvendimet, aktgjykimet, vendimet për masë të përkohshme, vendimet për

⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 116, paragrafi 1.

⁷ Shih Pasqyrë e përgjithshme e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, 2014.

heqje nga lista të kërkesave dhe vendimet për refuzim të kërkesës për masë të përkohshme).

Subjektet që mund të fillojnë procedure para gjykatës kushtetuese

Çështja e parë që parashtrohet te Gjykata Kushtetuese ka të bëjë me përcaktimin e subjekteve që kanë të drejtë të fillojnë procedurë para kësaj gjykate.⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës autorizon dy subjekte me të drejtën e ngritjes së një procedure para gjykatës kushtetuese:

1. *Propozuesit e autorizuar*-organet shtetërore⁹(Shefi i shtetit,Qeveria, Parlamenti përmes numrit të caktuar të deputetëve, Gjykata Supreme, Prokurori publik, Ombduspersoni, Agjensionet e Pavarura si dhe subjektet tjera të përcaktuara me Kushtetutë);
2. *Iniciativa kushtetuese*- qytetarët dhe subjektet tjera joqeveritare.

Lidhur me çështjen se a kanë mundësi qytetarët të iniciojnë një rast para Gjykatës Kushtetuese në përgjithësi ekzistojnë dy koncepte teorike. Në rastin e parë Gjykata Kushtetuese nuk merret me shkeljet individuale të të drejtave dhe lirive të qytetarëve, por vetëm me kontrollin e akteve të përgjithshme juridike. Në lidhje me këtë autori i veprës “Kontrolli Kushtetues” Prof.Sokol Sadushi, thekson se mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individëve e bëjnë gjykatat e rregullta dhe organet administrative.¹⁰ Mirëpo në anën tjetër të medaljes dihet se të drejtat dhe liritë e qytetarëve janë kategori kushtetuese dhe duhet të gëzojnë mbrojtjen përkatëse.¹¹ Në këtë drejtim pajtohet edhe Prof. Kurtesh Saliu, i cili citon se “njëra ndër prerogativat që hyn në kuadër të juridiksionit kushtetues të një Gjykate Kushtetuese është edhe mbrojtja e lirive dhe të drejtave të qytetarit”.¹²

Për këtë arsye në Kushtetutën e Republikës së Kosovës në kuadër të palëve të autorizuarra për të ngritur çështje para Gjykatës Kushtetuese përfshihen edhe

⁸ Arsim Bajrami, Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës, Prishtinë 2012, faqe 335.

⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 113.

¹⁰ Sokol Sadushi, “Kontrolli Kushtetues”,Tiranë 2004, fq. 186.

¹¹ Doracak për pregaditjen e provimit të jurisprudencës,Botimi III, Prishtinë 2008

¹² Kurtesh Saliu “E Drejta Kushtetuese” Prishtinë 2004, fq 179-180

individët, por me kusht që kjo të bëhet vetëm pasi të jenë shteruar mjetet e rregullta juridike si dhe shkelësi i pretenduar të jetë një autoritet publik.¹³ Lidhur me këtë në ligjin për Gjykatën Kushtetuese saktësisht përcaktohen kushtet të cilat duhet të plotësoj një ankimim individual. Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.¹⁴ Sa i përket afatit të parashtrimit të kërkesës, kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve, që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në rastet tjera afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht apo kur ligji ka hyrë në fuqi.¹⁵ Në rastet kur parashtruesi pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, Gjykata Kushtetuese ka për detyrë që në bazë të kërkesës së parashtruesit ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme (*restitutio in integrum*).

Lidhur me ankimimin individual, për fund mendoj që ankimimi individual si kategori kushtetuese pa dyshim se është në përputhje me frymën e standardeve moderne evropiane dhe aquis komunitare. Mirëpo rritja e popullaritetit të ankimimit individual mbase do të vë në pikëpyetje edhe funksionalitetin dhe rrezikun potencial që Gjykata Kushtetuese të shndërrohet në një gjykatë të zakonshme faktike, sepse të tilla do të krijoheshin edhe perceptcionet! Prandaj për të ruajtur kredibilitetin e gjykatës kjo rritje pa dyshim kërkon efikasitet më të madh të gjyqtarëve seleksionues në filtrimin e lëndëve jo potenciale.¹⁶ P.sh Në Spanjë dhe Gjermani afër 97-98 % e lëndëve nuk pranohen, apo hidhen poshtë nga komisionet filtruese. Në Shqipëri, brenda një viti janë sjellë në gjykatë 243 lëndë prej të cilave janë pranuar vetëm 18 apo 7.4 %.¹⁷

Në rastin e Republikës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese ka ndërtuar tashmë një traditë dhe një standard sa i përket kësaj prerogative kushtetuese. Ky standard

¹³ Kushtetua e Republikës së Kosovës, 2008, neni 113 paragrafi 7.

¹⁴ Ligji nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese neni 48.

¹⁵ Po aty, neni 49.

¹⁶ Gjyqtarë seleksionues janë gjyqtarët që bëjnë filtrimin e kërkesave dhe zakonisht janë komisione treshe.

¹⁷ Buletini i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë 2002

vërehet në aspektin procedural të pranimi të lëndëve por edhe atë vendimmarrës. Mirëpo nuk duhet harruar se një problematikë e madhe dhe sfidë për Gjykatën Kushtetuese, padyshim mbetet mungesa e komunikimit të mjaftueshëm me Gjykatën Evropiane të Drejtësisë. Fjala është për komunikimin zyrtarë, dhe përderisa kjo e fundit të mos ketë në tryezë një rast të pretendimit të shkeljes kushtetuese për të cilin Gjykata Kushtetuese ka dhënë interpretimin e saj, do të jetë e vështirë të konfirmojmë nëse interpretimi i kushtetutës është apo nuk është konform standardeve evropiane dhe ndërkombëtare.

Përbërja dhe organizimi i Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar që interpreton dhe përcakton përputhshmërinë e ligjeve, akteve nën-ligjore dhe veprimeve ose mos veprimeve të autoriteteve publike me Kushtetutën Republikës së Kosovës. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës është themeluar me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese Nr. 03/L-121. Ky Ligj rregullon aspektet organizative dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Gjykata Kushtetuese ka simbolin dhe vulën e vet të përcaktuar me rregulloren e punës. Selia e saj është në Prishtinë ku edhe zhvillon seancat e saja, përveç në rastet kur ajo vetë merr vendim ndryshe.

Sa i përket buxhetit, Gjykata Kushtetuese financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës. Ajo përgatit propozimin vjetor të buxhetit dhe e dërgon në Kuvend për miratim. Propozimin si të tillë nuk ka të drejtë të ndryshohet apo modifikohet në çfarëdo mënyre. Edhe menaxhimi i buxhetit bëhet në mënyrë të pavarur nga gjykata, megjithëse i nënshtrohet auditimit të brendshëm dhe të jashtëm nga Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës. Sa i përket ndërtimit të brendshëm, Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë (9) gjyqtarë me mandat nëntë (9) vjeçar pa të drejtë rizgjedhje. Në kuadër të gjyqtarëve të gjykatës, zgjidhet me votim të fshehtë Kryetari dhe Zv/Kryetari, me mandat tre (3) vjeçar në kuadër të mandatit të përgjithshëm. Detyrat e të cilëve janë të përcaktuara në ligjin për Gjykatën Kushtetuese.

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga detyra për vendimet e marra, mendimet e shprehura

dhe veprimet e bëra brenda fushës së përgjegjësive si gjykatës i Gjykatës Kushtetuese. Përndryshe në nenin 118 të kushtetutës së Republikës së Kosovës parashihen dy raste në të cilat Presidenti mund të shkarkoj gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. Në rastin e parë kemi të bëjmë me mospërfillje të rëndë të detyrave, me ç'rast duhet që 2/3 e gjyqtarëve (nga nëntë sa janë gjithsej) të propozojnë shkarkimin e gjyqtarit në fjalë tek Presidenti. Ndërsa në rastin e dytë kemi të bëjmë me kryerjen e krimeve të rënda. Kuptohet që në këtë rast nevojitet një bazë e besueshme gjyqësore që vërteton se gjyqtari kushtetues ka kryer një krim të rëndë sipas legjislacionit penal. Me fjalë të tjera mund të thuhet se neni 118 i Kushtetutës i mbron nga shkarkimi nga një institucion i jashtëm duke garantuar kështu imunitetin e tyre. Kjo konfirmon edhe njëherë që Gjykata Kushtetuese është një institucion plotësisht i pavarur dhe nuk është i obliguar të përgjigjet para asnjë institucioni, përveç në rastet kur nxjerr raportin vjetor të punës mirëpo edhe kjo bëhet vetëm me qëllim të informimit të publikut të gjerë.¹⁸

Procesi i zgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese

Ligji nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në nenin 4 përcakton kushtet për emërimin e gjyqtarëve, si: *të jenë shtetas të Republikës së Kosovës; jurist të shquar me reputacion të shkëlqyeshëm profesional me jo më pak se dhjetë (10) vjet përvojë pune, individ me reputacion të shkëlqyeshëm moral, të cilët kanë aftësi të plotë veprimi dhe të cilët nuk janë dënuar për vepër penale.*

Së këndejmi neni 6 i ligjit në fjalë përcakton procedurën për zgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht hap i parë është themelimi i Komisionit për shqyrtimin e kandidaturave, i cili Komision zhvillon tërë procedurën deri në votimin në Kuvend për zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues.

¹⁸ Enver Hasani & Ivan Čukalović, Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Botimi I, Prishtinë 2013, faqe 605.

Përndryshe komisioni i posaçëm për shqyrtimin e aplikacioneve të kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese ka këtë përbërje: **1. Kryetari i Kuvendit; 2. Udhëheqësit e secilit grup parlamentar; 3. Kryetari i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës; 4. Avokati i Popullit; 5. Përfaqësuesi i Këshillit Konsultativ për Komunitete; si dhe 6. Përfaqësuesi i Gjykatës Kushtetuese.**

Komisioni zhvillon intervistë me secilin kandidat, shqyrton të gjitha kandidaturat duke i veçuar ato që i plotësojnë të gjitha kushtet për tu zgjedhur gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese. Në këtë mënyrë komisioni krahas listës së gjithë kandidatëve formon edhe listën e ngushtë, për t'i dërguar si të tilla të dy listat në Kuvend për votim së bashku me një arsyetim pse disa kandidatë janë të favorizuar më shumë se tjerët. Realisht kjo çështje¹⁹ lë shumë hapsirë të interpretimit të lloj-llojshëm. Kjo për arsye se krijohen dy mundësi të vendosjes (për listën e ngushtë dhe për listën e të gjithë kandidatëve që plotësojnë kushtet) gjë që nënkupton se ata që janë në listë të ngushtë kanë ndonjë përparësi dhe të tjerët mund mos merren fare parasysh nga Kuvendi!

Në fund, me propozimin e Kuvendit Gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, për një mandat nëntëvjeçar, pa mundësi vazhdimi.²⁰ Pyetje me rëndësi në këtë kontekst është nëse Presidenti i Republikës mund të refuzojë një propozim të Kuvendit? Kushtetuta nuk jep ndonjë përgjigje të qartë për këtë, megjithatë mendoj që për aq kohë sa Presidenti i Republikës vishet me të drejtën e emërimit, natyrshëm që mund edhe ta ushtroj të drejtën e refuzimit të një propozimi të Kuvendit.²¹ Mirëpo megjithatë Presidenti duhet të arsyetojë që një apo disa nga kushtet e kërkuara nuk janë plotësuar. Në të kundërtën kuptohet që presidenti duhet që të bëjë emërimin e gjyqtarëve të propozuar nga Kuvendi.

Në dorën tjetër vërejmë kushtet që duhet të plotësojnë gjyqtarët kushtetues. Së këndejmi duhet të theksojmë se historia e gjyqësisë kushtetuese të ish vendeve komuniste ka treguar se suksesi më i madh i është arritur në ato raste kur gjykatat kushtetuese kanë qenë të përbëra jo nga gjyqtarë të rregullt, avokatë

¹⁹ Pika 11 e nenit 6 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

²⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 114, paragrafi 2.

²¹ Komentari ligjor i Kushtetutës, faqe 603.

dhe juristë tjerë teknik por nga personalitetet e jetës akademike dhe të papërvojë dogmatike në punët e gjyqësorit të rregullt.²² Në këtë drejtim mendoj që edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës është një shembull mjaft i mirë.²³

Neni 114.1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës parasheh tri kushte themelore sa i përket kandidatëve për pozitën e gjyqtarit kushtetues të cilat janë: 1. Të jetë jurist i shquar; 2. Të ketë personalitet të lartë; si dhe 3. Të ketë jo më pak se 10 vite përvojë pune. Gjithashtu theksohet se “Kualifikimet e tjera përkatëse janë të rregulluara me ligj”.²⁴ Së këndejmi nëse i referohemi nenit 4 në paragrafin 1.2 të ligjit nr. 03/L-121 Për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës vërejmë se ndër të tjera gjyqtari kushtetues duhet të plotësojë këto kriteret: “të ketë jo më pak se dhjetë (10) vjet përvojë pune profesionale veçanërisht në fushën e së drejtës publike dhe kushtetuese të dëshmuar, mes tjerash, përmes punës profesionale si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, shërbyes civil ose mësimdhënës universitar dhe punë tjera të rëndësishme të natyrës juridike”. Pra fillimisht nuk specifikohet se cila përvojë profesionale juridike konkretisht është e nevojshme për të qenë gjyqtarë i Gjykatës Kushtetuese. Në këtë drejtim ka mundësi që kandidati për gjyqtarë të përmbushë kriterin e kërkuar duke e kryer një punë administrativo juridike e cila siç theksohet në ligj është punë e rëndësishme e natyrës juridike ngjashëm sikur përvoja profesionale e kandidatit tjetër i cili marrim si shembull ka shërbyer më se dhjetë vite si profesor i së drejtës kushtetuese. Ndërsa në anën tjetër koncepti “jurist i shquar” i shfrytëzuar në nenin 114 të kushtetutës së Kosovës dallon thelbësisht nga karakteristika e juristit që kërkohet të ushtrojë profesionin e gjyqtarit të rregullt dhe se kjo ngërthen në vete një pamje shumëfish më komplekse të shkencës juridike dhe filozofisë së të drejtës.²⁵ Rasti gjerman i gjyqësisë kushtetuese është shembull shumë i mirë në të cilën më shumë se 75% e gjyqtarëve janë profesorë/akademik të fushës së tillë, jashtë rrethit të rregullt gjyqësor.

²² Po aty, faqe 602.

²³ <http://www.gjk-ks.org/?cid=1,41>, qasur më 23 Dhjetor 2014.

²⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 114, paragrafi 1.

²⁵ Më gjerësisht shih: Osman Ismaili, “Kushtetuta e Republikës së Kosovës pas tetë viteve”, Revista Global Challenge, Vol. Nr. 1, Tiranë, 2016, faqe 36.

Ndërsa sa i përket kushtit të tretë ku kërkohet që kandidati duhet të ketë së paku dhjetë (10) vite përvojë pune profesionale, duhet të theksojë që rastet e ngritura e ngritura pranë këtij institucioni rëndom janë çështje mjaft delikate dhe shumë të rëndësishme për shtetin dhe shoqërinë. Duke e pasur parasysh këtë më duhet të theksoj se gjyqtarët kushtetues përveç që duhet patjetër të jenë jurist të shquar do të duhej të kishin edhe një nivel mjaft të theksuar të përvojës profesionale. Rëndom preferohet që gjyqtarët të jenë persona në përfundim e sipër të karrierës së tyre profesionale, kjo për faktin se supozohet që pikërisht në atë fazë ata janë në kulminacionin e karrierës së tyre. “*Erfahrung vor Jugend*” është një fjalë e urtë gjermane që nënkupton se përvoja shpeshherë është më e nevojshme se vullneti dhe energjia për punë. Pra me fjalë të tjera mendoj që nuk do të ishte e tepërt në qoftë se në të ardhmen në ndryshimin eventual të ligjit për Gjykatën Kushtetuese në nenin 4 ndër të tjera të parashihet që kandidatët për gjyqtarë kushtetues të kenë 15 (pesëmbëdhjetë) apo edhe më shumë vite përvojë pune profesionale në fushën e së drejtës kushtetuese.

Disa kushtetuta përveç dy subjekteve kryesore (propozuesit e autorizuar dhe iniciativës kushtetuese) përcaktojnë edhe një mënyrë tjetër të fillimit të procedurës para Gjykatës Kushtetuese. Në këto raste në rast të dyshimit për shkeljen e Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese fillon vetë procedurën ex-officio (sipas detyrës zyrtare).²⁶ Kuptohet se në këto raste gjykata kushtetuese përfundimisht e konfirmon pushtetin e vet për mbrojtjen e kushtetutës dhe bëhet i barabartë me tri pushtetet tradicionale. Besoj që edhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës së shpejti do të transformohet edhe në këtë aspekt për t’ia dhënë vullën e fundit Republikës së Kosovës si një **shtet kushtetues dhe demokratik**.

Procesi i zgjedhjes të gjyqtarëve kushtetues në disa vende të botës

Mënyra e zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, koha e qëndrimit në detyrë, mosha e zgjedhjes së gjyqtarit nuk trajtohen në të njëjtën mënyrë në të gjitha kushtetutat me kontrollim centralist.

Në shumicën e rasteve në zgjedhjen e gjyqtarëve marrin pjesë parlamenti, ekzekutivi dhe presidenti. Në disa kushtetuta si në atë të: **Hungarisë, Polonisë, Sllovakisë, Gjermanisë, Letonisë** etj, rolin parësor në zgjedhjen e gjyqtarëve

²⁶ Arsim Bajrami, Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës, Prishtinë 2012, faqe 335

kushtetues e ka parlamenti. Kështu p.sh në **Gjermani** gjysma e gjyqtarëve zgjidhët nga Bundestagu (dhoma e ultë) dhe gjysma nga Bundesrati (dhoma e lartë). Ndërsa në sistemet tjera gjyqtarët kushtetues caktohen nga organet ekzekutive pa ndërhyrjen e organeve përfaqësuese. Por ka edhe sisteme *mikste (të përziëra)* në të cilat kërkohet një lloj bashkëveprimi ndërmjet organeve përfaqësuese dhe organeve ekzekutive si p.sh: Austria, Armenia, Franca, Rumania etj.

Tek sistemet mikste (të përziëra) të përzgjedhjes së gjyqtarëve dallojmë dy forma të bashkëveprimit të institucioneve. Forma e parë: kur procedura fillon me përzgjedhjen e kandidatëve nga organi legjislativ dhe përfundon me dekretim tek presidenti apo kryeministri. Forma e dytë: përmes bashkëveprimit Presidenti, Kuvendi dhe autoritetet gjyqësore zgjedhin nga një numër të caktuar gjyqtarësh

Kështu p.sh gjyqtarët kushtetues të **Spanjës** emërohen nga Mbreti, ndërsa katër (4) prej tyre propozohen nga parlamenti, katër (4) të tjerë propozohen nga senati, dy (2) nga qeveria dhe dy (2) nga Këshilli i Përgjithshëm Gjyqësor. Në **Itali** 15 gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese zgjedhën sipas një shpërndarje të ekuilibruar ndërmjet disa institucioneve kushtetuese. Një e treta (1/3) e gjyqtarëve caktohen nga organet e larta të drejtësisë së zakonshme dhe administrative (Gjykata e Kasacionit, Këshilli i Shtetit dhe Gjykata e Llogarive), një e treta (1/3) nga Presidenti i Republikës dhe një e treta (1/3) nga parlamenti në seancë të përbashkët.²⁷

Sa i përket **Francës** duhet theksuar që ekziston një shpërndarje e ekuilibruar me ç'rast nga nëntë anëtarët e Këshillit Kushtetues, tre i propozon presidenti, tre Kryetari i Asamblesë Kombëtare dhe tre senati. Krahas kësaj, neni 56 i kushtetutës së Francës ka përcaktuar një privilegj të veçantë për ish presidentët duke u njohur atyre të drejtën automatike për të qenë anëtarë të Këshillit Kushtetues.²⁸ Megjithatë roli i tyre është më tepër konsultativ, meqenëse ata nuk gëzojnë të drejtë vote.

²⁷ Kushtetuta e Republikës Italiane, neni 135, Romë, 1947.

²⁸ Arsim Bajrami, *Parlamentarizmi (Aspekte Krahasuese)*, Prishtinë 2010, fq. 317.

Gjykata Kushtetuese e **Republikës së Shqipërisë** që nga themelimi i saj ka kaluar nëpër disa sisteme të përzgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.²⁹ Një prej tyre është sistemi ku secili organ është kompetent për zgjedhjen e një pjese të gjyqtarëve kushtetues, pa qenë i ndërruar nga organi tjetër. Më vonë, me “Ligjin për dispozitat kryesore kushtetuese” 4 gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese nga Presidenti ndërsa 5 nga Kuvendi. Ndërsa sipas nenit 125 të kushtetutës së vitit 1998, formula e zgjedhjes së gjyqtarëve u përqendrua në bashkëpunimin e dy institucioneve të larta të shtetit: Presidentit të Republikës dhe Kuvendit. Në bazë të kësaj formule, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese konsiderohet i zgjedhur kur akti i emërimit të Presidentit të Republikës e merr pëlqimin në Kuvend.

Konkludime

Sa i përket konkludimeve të dala nga ky hulumtim theks të veçantë do t'i kushtoj procesit të zgjedhjes së gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese, si një segment shumë i rëndësishëm madje do të thosha shtyllë kurrizore e vet Gjykatës Kushtetuese. Në këtë drejtim duhet cekur se Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës si një gjykatë e krijuar rishtazi natyrisht që kërkon shumë punë për të zhvilluar kredibilitetin e saj dhe për të ndërtuar standarde të qëndrueshme në sistemin juridik të vendit. Ndërsa njëri ndër segmentet më së shumti në nevojë mendoj që është pikërisht procesi i zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues.

*Shikuar në kuptimin e përgjithshëm, gjyqtarët kushtetues kërkohet që të votohen nga një shumicë e kualifikuar parlamentare, e cila natyrisht që është shumëfish më e lartë se sa shumica që bart zakonisht një qeveri e koalicionit. Propozimi meqë duhet të arrij shkallën prej 2/3 të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, është i prirë të jetë konsensual në kuptimin e asaj që asnjë parti politike (apo as koalicioni që kontrollon qeveria) të mos mund ta votojë e vetme. Në këtë kuptim, propozimi për emërimin e gjyqtarëve kushtetues duhet të jetë konsensual dhe si i tillë ky vendim konsiderohet si juridikisht neutral dhe i pakontrollueshëm nga një parti e vetme apo koalicioni i vetëm.

²⁹ http://www.gjk.gov.al/web/Perberja_90_1.php , web-faqja e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, qasur më 23 Dhjetor 2014.

*Megjithatë nëse i referohemi komisionit për shqyrtimin e kandidaturave dhe analizojmë përbërjen e tij (e cila është si vijon: Kryetari i Kuvendit, shefat e grupeve parlamentare, Avokati i Popullit, etj), atëherë mund të japim dy supozime: 1. deputetët e kuvendit dhe udhëheqësit e grupeve parlamentare, pavarësisht faktit që mund të jenë politikanë dhe njohës të proceseve të ndryshme sidomos politike në vend mund të mos jenë njohës profesional të çështjeve kushtetuese dhe juridike sidomos ato që hyjnë nën juridiksionin e Gjykatës kushtetuese. Ndërsa nën 2 në aspektin profesional nuk është edhe shumë e pranueshme duke pasur parasysh se të njëjtit deputet i propozojnë për votim kandidatët, e më pas i votojnë vetë.

*Ngjajshëm qëndron situata edhe me Ombudspersonin (anëtarë i komisionit) i cili vetë zgjidhet nga Kuvendi dhe së bashku deputetët janë subjekte potenciale për të iniciuar procedura pranë Gjykatës Kushtetuese. Natyrisht se kjo krijon hapësirë të mendohet edhe rreth interesave personale si dhe implikimeve subjektive duke siguruar në këtë mënyrë ndikim të madh tek kandidatët dhe duke ndikuar në anshmërinë e gjyqtarit në të ardhmen. Prandaj do të ishte shumë i pranueshëm një ndryshim i ligjit aktual për Gjykatën Kushtetuese lidhur me dispozitat për themelimin e komisionit, duke përfshirë kësaj radhe anëtarë më kompetent lidhur shkencat juridike dhe më profesional në aspektin e implikimeve politike, si p.sh (Përfaqësues nga Akademia e Shkencave, nga Fakultetet Juridike të Universiteteve Publike, nga Oda e Avokatëve, Këshilli Prokurorial, Këshilli Gjyqësor e pse jo edhe shoqërisë civile, etj).

*Mundësi të ngjashme keqintepretimi krijohen edhe në nenin 6, paragrafi 2.11 ku mbi bazën e kësaj dispozite Kuvendit i dërgohen për votim nga Komisioni dy lloje kandidaturash, një me listë të ngushtë dhe një me listë që i plotësojnë kushtet. Në këtë rast anshmëria që tregon komisioni mund të ndikojë që kandidatët jashtë listës së ngushtë të mos merren fare parasysh.

Literatura

1. Buletini i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, 2002.
2. Doracak për pregaditjen e provimit të jurisprudencës, Prishtinë 2008, Botimi III.

3. Kurtesh Saliu, E Drejta Kushtetuese, Prishtinë 2004.
4. Osman Ismaili, “Kushtetuta e Republikës së Kosovës pas tetë viteve”, Revista Global Challenge, Vol. Nr. 1, Tiranë, 2016.
5. Kushtetua e Republikës së Kosovës, 2008.
6. Kushtetuta e Republikës Italiane, Romë, 1947.
7. Sokol Sadushi, Kontrolli Kushtetues, Tiranë 2004.
8. Enver Hasani & Ivan Čukalović, Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Botimi I, Prishtinë 2013.
9. Pasqyrë e përgjithshme e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, 2014.
10. Arsim Bajrami, Parlamentarizmi (Aspekte Krahasuese), Prishtinë 2010.
11. Arsim Bajrami, Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës, Prishtinë 2012.
12. Arsim Bajrami & Xhavit Shala, Sistemi Kushtetues dhe organizimi i jurisprudencës, OSBE, Prishtinë, 2010.
13. Ligji nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.
14. <http://www.gjk-ks.org/?cid=1,2> , web-faqja e Gjykatës Kushtetuese së Kosovës, qasur më 23 Dhjetor 2014.
15. http://www.gjk.gov.al/web/Perberja_90_1.php , web-faqja e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, qasur më 23 Dhjetor 2014.

**Administrimi kolektiv i të drejtës së autorit dhe të drejtave të përfaqësuara si
mënyrë e mbrojtjes nga keqpërdorimi dhe keqshfrytëzimi- Republika e
Maqedonisë si rast studimi**

Meriton Arslani,

Universiteti Shën Kirili dhe Metodi Shkup,
Fakulteti Juridik Justinijani i Parë,
Shkup-Maqedoni,

Abstrakti

E drejta e mbrojtjes së pronësisë intelektuale është një nga të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Deklaratën univërsale për të drejtat e njeriut, Paktin ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, por edhe me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, e cila i garanton të drejtat që dalin nga krijimtaria shkencore e artistike. Autorët dhe bartësit e të drejtave të përfaqësuara kanë të drejtë që të drejtat e tyre t'i realizojnë individualisht, por këtë mund ta bëjnë edhe në mënyrë kolektive, përmes organizatave (shoqatave) për administrim kolektiv të të drejtës së autorit dhe të drejtave tjera të përfaqësuara. Çështja e administrimit kolektiv me të gjitha problematikat e saj është aktualizuar me zhvillimin tekniko-teknologjik e sidomos atë informatik, ku mundësohet qasje më e gjërë e individëve deri te veprat e ndryshme autoriale, andaj bëhet e pamundur që bartësit e të drejtave të ushtrojnë kontroll mbi gamën e gjerë të shfrytëzimit të veprave autoriale, si veprat e shkruara, muzikore dhe ato audio-vizuale. Për këtë shkak, përveç harmonizimit të legjislacionit me aktet ndërkombëtare, nevojitet punë më intenzive me qëllim njohjeje dhe aplikim të rregullave për mbrojtje nga keqpërdorimet, duke pasur parasysh mundësitë dhe rrethanat me të cilat ballafaqohemi.

Fjalë e rëndësishme: Administrimi kolektiv, E drejta e autorit dhe të drejtat e përfaqësuara, Administrimi kolektiv ne R.e Maqedonisë.

Hyrje

Jemi dëshmitarë të faktit se të drejtat e pronësisë intelektuale, ku bëjnë pjesë edhe e drejta e autorit dhe të drejtat e përafërta janë pre e sulmeve të vazhdueshme dhe mbrotja e tyre përbën një nga sfidat më të mëdha të kohës në sistemet juridike. Duke marrë parasysh zhvillimin e shpejtë teknologjik, sidomos zhvillimin e teknologjisë informatike, qasja deri te veprat e ndryshme të autorëve lehtësohet dhe kështu rritet rreziku për keqpërdorim eventual të të drejtave nga ana e shfrytëzuesve të ndryshëm.

Mbrojtja e të drejtave materiale dhe morale që dalin nga krijimtaria shkencore, letrare e artistike kanë gjetur vend në një morri aktesh ndërkombëtare (UNDH 1948, article 27; ICESCR 1966, article 15; TRIPS)³⁰, si dhe disa direktiva dhe rregullore të Unionit European. E gjitha kjo me të vetmin qëllim të mbrotjes sa më efikase nga falsifikimi dhe pirateria. Këto akte dhe legjislacionet pozitive të shteteve, përbëjnë mekanizmin e mbrotjes dhe ndëshkimit të çdo lloj keqpërdorimi dhe keqshfrytëzimi të veprave.

Për të pasur një sistem më të sofistikuar të mbrotjes dhe parandalimit nga keqpërdorimet, duke qenë të vetëdijshëm për faktin që për vepra të caktuara është e pamundur kontrolli individual i përdorimit të tyre, me dispozita të ndryshme është paraparë edhe mundësia e administrimit kolektiv me të drejtat që burojnë nga to.

Praktika e tillë është e njohur edhe në R. e Maqedonisë, për të cilën do të bëhet fjalë në pjesën e tretë të këtij punimi.

2.Rëndësia e administrimit kolektiv të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta

Në periudhën antike, në kohën e Greqisë antike dhe Perandorisë Romake nuk ka ekzistuar e drejta e pronësisë intelektuale dhe nuk është vlerësuar krijimtaria e mendjes e materializuar (regjistruar) në letër.

Në atë periudhë veprat letrare janë shkruar për shpërblim, i cili është paguar nga ana e organizuesve të lojërave të cilët kanë dashur t'i shfrytëzojnë të njejtat. Njëherit, e drejta e botimit të veprave të shkruara ka qenë e njësuar me të

³⁰ Konventa e Bernës për mbrotje të të drejtave mbi veprat letrare dhe artistike; Marrëveshja për regjistrim ndërkombëtar të veprave audiovizuale; Konventa ndërkombëtare për mbrotjen e performuesve, prodhuesve të fonogramëve dhe organizatave radiodifuzive.

drejtën e pronësisë mbi shkrimin, prandaj me botimin e veprave janë marrë tregtarët e librave, të cilët e kanë organizuar procesin e riprodhimit të veprave të shkruara.

Nga kjo, mund të arrihet në përfundim që e drejta e botimit dhe e drejta e shfaqjes publike të veprës ka qenë e inkorporuar në të drejtën e pronësisë mbi sendin në të cilin vepra ka qenë e fiksuar. (Henneberg 1996, 9)

Në periudhën e mëvonshme kur arrihet një nivel më i lartë i zhvillimit dhe vjen deri te zbulimi i makinës së shtypit nga Johanes Gutenbergu në shek.XV, raportet në mes të autorëve të veprave të shkruara dhe botuesve fillojnë të ndryshojnë. Kjo periudhë njihet edhe si periudha e privilegjëve të autorëve dhe botuesve, ku botuesve dhe autorëve të ndryshëm ju janë dhënë privilegje të caktuara për veprat e shkruara dhe të botuara.

Në fillimin e shekulli të XVIII fillon kalimi nga faza e privilegjeve të autorëve dhe botuesve në fazën e regullimit ligjor të sferës së drejtës së autorit. Ligji i parë për mbrojtjen e të drejtës së autorit është sjellur në Angli në vitin 1709 në kohën e sundimit të mbretëreshës Ana dhe kështu ligji njihet me emrin *Statute of Anne*. (Daboviq-Anastasovska dhe Pepeljugoski 2012, 28) Ky ligj i ka njohur autorit të drejtën ekskluzive që veprën e vetë ta shfrytëzojë duke e riprodhuar për periudhë kohore 14 (katërmbëdhjetë) vjeçare, e cila e drejtë ka mundur të vazhdohet.

Pas sjelljes së Statute of Anne vazhdon edhe sjellja e ligjeve që mbrojnë të drejtat e autorëve edhe në shtete tjera dhe këtu fillon edhe periudha e zhvillimit modern në këtë sferë. Statute of Anne është ligji i parë i cili i njohu autorit të drejtën e tij ekskluzive të shfrytëzimit të veprës pa mos e humbur të drejtën e pronësisë mbi të.

Në kohën në të cilën jetojmë e drejta e autorit dhe të drejtat e përafërta janë në një nivel mjaft të lartë të zhvillimit të tyre. Por, paralelisht me zhvillimin riten edhe mundësitë e keqpërdorimit të ketyre të drejtave, ose, thënë më mirë, pengimin dhe pamundësimin e titullarit të së drejtës që të realizojë përfitimet materiale që burojnë nga këto të drejta.

Duke qenë koshient për shkeljet e mëdha që ju bëhen të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, duke mos shkuar më larg, por duke marrë shembuj nga jeta e përditshme si kopjimi i programeve kompjuterike, kopjimi i veprave audiovizuale (filmave), kopjimi i pjesëve të librave, shfaqja e pautorizuar e veprave skenike, vënien në dispozicion të publikut veprat e fiksuara dhe të ngjashme, duhet të jemi të shqetësuar për këtë realitet. Gjithsesi, këtu nuk bën

pjesë ajo që në literaturën bashkëkohore perëndimore njihet si *Fair use*.³¹ *Fair use* gjithashtu nuk përfshihet në dispozitat për regullimin e administrimit kolektiv të të drejtave, sepse në një situatë *fair use* nuk parashihet leje nga autori apo edhe kompenzim ndaj tij. *Fair use* paraqet një mundësi, ose sipas avokatit amerikan Richard Stim, ajo paraqet më shumë një mbrojtje, se sa një e drejtë e njohur/e garantuar. (Stim 2010, 200)

Prandaj, si nevojë e mbrojtjes nga keqpërdorimet, shkenca juridike ka paraparë disa mënyra të mbrojtjes dhe njëra nga to konsiston në administrimin kolektiv të këtyre të drejtave.

Në sistemet juridike si fille të para të zhvillimit të organizatave për administrim kolektiv të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, paraqiten *ndërmjetësuesit* në formë të shoqërive të autorëve. Në Francë, paraqitet Shoqëria e autorëve të veprave të shkruara (shkrimtarëve), ndërsa në vitin 1850 edhe Shoqëria e autorëve e kompozitorëve. (Stim 2010, 199) Ndërsa, si organizatë e parë për administrim kolektiv të të drejtave paraqitet Shoqëria franceze SACEM në vitin 1850.

Në kohën e sotme të gjitha shoqatat nacionale janë të anëtarësuara në Konfederatën ndërkombëtare të shoqërisë së autorëve dhe kompozitorëve (CISAC)³², kurse në kuadër të shteteve anëtare të Unionit European, Norvegjisë dhe Zvicrës është themeluar GESAK³³ në vitin 1990. Gjithashtu, në vitin 1985 është formuar edhe Asociacioni ndërkombëtar i autorëve të veprave audiovizuale me seli në Bruksel (AIDAA). (Daboviq-Anastasovska dhe Pepeljugoski 2012, 202)

2.1. Regullimi juridik i administrimit kolektiv të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta

Regullimi juridik i shfrytëzimit të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta është mjaft kompleks, sidomos duke u mbështetur në dallimet që ekzistojnë në të drejtën kontinentale dhe atë anglo-saksone. Këto dallime në regullimin juridik të shteteve, janë si pasojë e faktit që kjo fushë është lënë në dispozicion të vetë shteteve, vetëm duke dhënë udhëzime për mënyrën se si këto çështje të trajtohen.

Në çështjet e regullimit juridik të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta me rëndësi të veçantë paraqiten disa akte ndërkombëtare si Marrëveshja për aspektet afariste të të drejtave të pronësisë intelektuale (TRIPS), Marrëveshja për regjistrim ndërkombëtar të veprave audiovizuale,

³¹ Nënkupton përdorimin e veprave të autorit pa leje paraprake dhe përdorim (shfrytëzim) pa pagesë të kompenzimit, për shkaqe dhe nevoja të caktuara.

³² <http://www.cisac.org/>.

³³ <http://www.authorsocieties.eu/>.

Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e performuesve, prodhuesve të fonogramëve dhe organizatave radiodifuzive (Konventa e Romës), si dhe direktivat e Unionit European për zbatim 2004/48/E3, për radiodifuzionin satelitor dhe ritransmetimit kabllovik 93/83/EEC, Direktiva për administrim kolektiv të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përfaqëta dhe licencimit multi-territorial të të drejtave mbi veprat muzikore për përdorim online (në rrjet) në tregut e brendshëm 2014/26/EU etj. Në plan nacional, regullimi i administrimit kolektiv të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përfaqëta paraqitet në fund të shek.XX, si shembull mund të përmendet Mbretëria e Bashkuar, ku që nga viti 1988 parashihet që "e drejta e performuesit për vënie të veprës së dispozicion të publikut nuk mund të realizohet vetëm se nëpërmjet të shoqërisë (organizatës) për administrim kolektiv të të drejtave". (Copyright, Designs and Patents Act 1988, MacQueen et al. 2011, 234)

Në rrethana të zhvillimit të lartë teknologjik është e pamundur të kontrollohet shfrytëzimi i veprave të ndryshme sidomos duke pasur parasysh transmetimin dhe ritransmetimin kabllovik të veprave të autorëve si ato skenike, muzikore dhe audiovizuale.

Prandaj, në këtë frymë Direktiva e Unionit European për administrim kolektiv të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përfaqëta, dhe licencimit multi-territorial të të drejtave mbi veprat muzikore për përdorim online (në rrjet) në tregut e brendshëm 2014/26/EU, parasheh dhe regullon mundësinë e administrimit kolektiv të të drejtave. Me këtë direktivë, organizata për administrim kolektiv definohet si organizatë e autorizuar për administrim të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përfaqëta, në dobi të vetë titullarëve e cila themelohet dhe kontrollohet nga vetë ata dhe ka karakter jofitimprurës. (2014/26/EU, neni 3)

Direktiva e Unionit European për radiodifuzionin satelitor dhe ritransmetimit kabllovik 93/83/EEC, në nenin 9 parasheh që vendet anëtare janë të obliguara të sigurohen që të drejtat e titullarëve (autorëve dhe bartësve të të drejtave të përfaqëta), për të lejuar dhe refuzuar autorizimin e operatorëve kabllovikë për ritransmetim kabllovik të realizohen vetëm përmes organizatës (shoqatës) për administrim kolektiv. (93/83/EEC, neni 9) Kjo zgjidhje ia pamundëson titullarit të së drejtës, që në mënyrë individuale të realizojë të drejtat që dalin për të, duke e cilësuar këtë të drejtë, si e drejtë e cila ekskluzivisht realizohet përmes organizatës për administrim kolektiv.

Gjithashtu, në drejtim të realizimit kolektiv të të drejtave të cilat mund të realizohen edhe individualisht, e njejtja direktivë (93/83/EEC) në nenin 10 parasheh obligim që shtetet anëtare të sigurojnë se realizimi kolektiv sipas nenit 9 të theksuar më lartë, nuk do të zbatohet për të drejtat të cilat i gëzon organizata radiodifuzive në lidhje me transmetimin, pa marrë parasysh nëse të drejtat janë të sajat ose janë bartur. Me këtë, ligdhënësi i Unionit European ju

jep liri të zgjedhjes organizatave radiodifuzive për të përcaktuar nëse të drejtat e tyre do t'i realizojnë përmes organizatës për administrim kolektiv ose jo, duket mos i përfshirë këto të drejta në grupin e të drejtave që realizohen ekskluzivisht në mënyrë kolektive.

Veç kësaj, Direktiva e Unionit European për zbatim të të drejtave të pronësisë intelektuale, në nenin 4 i parasheh organizatat kolektive si të autorizuar për të paraqitur kërkesë për mbrojtje juridike të të drejtave, duke i barazuar me vetë titullarët e të drejtave dhe subjekteve të tjerë të autorizuar për shfrytëzim të të drejtave të pronësisë intelektuale. Kështu, organizatat për administrim kolektiv të të drejtave mund të paraqiten në rolin e të autorizuarit (përfaqësuesit) për mbrojtje të të drejtave të titullarëve, por vetëm nëse kjo është e përcaktuar edhe sipas dispozitave të së drejtës pozitive. (2004/48/EC, neni 4)

Në anën tjetër, përveç legjislacionit të Unionit European administrimi kolektiv është çështje regullimi edhe në akte të tjera ndërkombëtare. Këtu mund të përmendet Marrëveshja për aspektet afariste të të drejtave të pronësisë intelektuale (TRIPS), e cila i jep mundësi titullarit të së drejtës të mbrohet nga keqpërdorimi i mundshëm nga organizata për administrim kolektiv të të drejtave. Marrëveshja i obligon shtetet anëtare që të parashohin procedura dhe mjete juridike për pengim të shkeljeve, procedura këto, që do evitojnë krijimin e pengesave për tregtim dhe njëherit do sigurojnë masa mbrojtëse kundër keqpërdorimit të të drejtave. (TRIPS, neni 41)

3. Administrimi kolektiv i të drejtës së autorit dhe të drejtave të përfaqësuara në Republikën e Maqedonisë

Një nga të drejtat dhe liritë themelore është e drejta e pronësisë intelektuale. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë në nenin 47 përcakton se të drejtat që dalin nga krijimtaria shkencore, artistike dhe llojet e tjera të krijimtarisë janë të garantuara. Republika e Maqedonisë nxit, ndihmon dhe mbron zhvillimin teknologjik dhe shkencor. Fusha e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përfaqësuara në Republikën e Maqedonisë, rregullohet me Ligjin për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përfaqësuara³⁴ i sjellë në vitin 2010, i cili përveç mënyrave tjera të realizimit të të drejtave e parasheh edhe realizimin (administrimin) kolektiv.

Administrimi kolektiv në Republikën e Maqedonisë bëhet përmes organizatave për administrim kolektiv, të cilat kanë statusin e personit juridik me karakter jofitimprurës, që në emër të vet dhe për llogari të titullarëve të të drejtave ndërmarrin veprime të caktuara të përcaktuara me ligj.

³⁴ "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.115/10, 140/10, 51/11, 147/13 dhe 154/15.

Organizata për administrim të të drejtave është kompetente për lidhjen e punëve juridike me shfrytëzuesit e të drejtave, mbledhjen dhe shpërndarjen e kompenzimit nga shfrytëzimi, si dhe mbrojtjen e titullarëve të të drejtave përpara organeve shtetërore dhe subjekteve të tjera. Për kryerjen e veprimtarisë së tillë, organizata siguron leje (licencë) nga Ministria e Kulturës. Ligjdhënësi në mënyrë shprehimore i përcakton të drejtat dhe detyrimet e organizatës.

Në administrimin kolektiv përfshihet kalimi joekskluziv i të drejtave të caktuara nga titullari i të drejtës në organizatën për administrim kolektiv. Është me rëndësi të theksohet se në Republikën e Maqedonisë, ligjdhënësi bën dallimin në mes të drejtave që mund të realizohen nga vetë titullari i të drejtës (qoftë *personalisht, individualisht apo përmes përfaqësuesit të autorizuar*), si dhe të drejtave të cilat realizohen vetëm përmes organizatave për administrim kolektiv të të drejtave, kështu duke i ndjekur praktikat bashkëkohore dhe direktivat e Unionit Europian. Gjithashtu, ligjdhënësi në mënyrë të detajuar përcakton edhe përmbajtjen e statutit të organizatës, autorizimet e saj, kontrollin e brendshëm dhe të jashtëm të saj e sidomos mënyrën e finasimit dhe ndarjen e përfitimeve të realizuara nga shfrytëzimi i veprave, duke përcaktuar përqindjet nga shumata e fituara.

Sa i përket çështjes së përcaktimit të vlerës së kompenzimit për shfrytëzimin e veprës, ligjdhënësi në Republikën e Maqedonisë përcakton 3 (tre) mënyra të cilat e plotësojnë njëra tjetrën, edhe atë: **kontratën e veçantë inter partes** të lidhur ndërmjet organizatës dhe shfrytëzuesit konkret; **kontratën e përgjithshme** të lidhur ndërmjet organizatës dhe shoqatave të kategorive të caktuara të shfrytëzuesve dhe **aktin e përgjithshëm (tarifën)** të organizatës për përcaktimin e kompenzimit për shfrytëzim të veprës.

Me Ligjin për ndryshim dhe plotësim të ligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta³⁵ të vitit 2013, me qëllim të ndjekjes dhe kontrollit mbi transmetimin publik të veprave të mbrojtura, organizata për administrim kolektiv të të drejtave obligohet që në organizatat radio-televizive (radio-televizione) të sigurojë dhe instalojë sistem të evidentimit elektronik.

Mirëpo, edhe përkundër regullimit të detajuar të pothuajse të gjitha çështjeve që i përkasin administrimit kolektiv të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, në aspektin praktik shumë pak gjejnë zbatim të njëjtat, kjo si pasojë e faktit që shoqëria shumë pak është e njohur me këtë sferë. Në Maqedoni, si organizata për administrim kolektiv të të drejtave janë të regjistruara: Shoqata për mbrojtjen e të drejtave të veprave muzikore³⁶ e cila është anëtare e regullit e Konfederatës ndërkombëtare të shoqërisë së autorëve

³⁵ "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.147/13.

³⁶ <http://www.zamp.com.mk/>.

dhe kompozitorëve (CISAC)³⁷ dhe deri më sot numëron 1493 anëtarë, si dhe Industria muzikore maqedone e cila ndërpreu së funksionuari më 1 (një) janar të vitit 2016 për arsye të marrjes së licencës nga ana e Ministrisë për kulturë.³⁸

4. Përfundimet

Në rrethana të zhvillimit të lartë teknologjik është e pamundur të kontrollohet shfrytëzimi i veprave të ndryshme, sidomos duke pasur parasysh transmetimin dhe ritransmetimin kabllorik të veprave të autorëve, si ato skenike, muzikore dhe audiovizuale. Prandaj, në akte të ndryshme ndërkombëtare si dhe me dispozita të brendshme të shteteve tentohet që këto çështje të rregullohen dhe të arrihet një mbrotje më efikase përmes administrimi kolektiv të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta nga ana e organizatave jofitimprurëse, të themeluara nga vetë autorët.

Në Republikën e Maqedonisë në mënyrë të detajuar ligjdhënësi i rregullon çështjet që i përkasin administrimit kolektiv të të drejtave me anë të Ligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta të vitit 2010, mirëpo, edhe përkundër kësaj, vërehet mungesa e interesimit për themelim të organizatave për mbrotje kolektive të të drejtave, edhe pse, jemi dëshmitarë të shkeljes së vazhdueshme që çdo ditë ju bëhet këtyre të drejtave.

Prandaj, mendoj që nuk është e mjaftueshme vetëm inkorporim i dispozitave të konventave dhe akteve të tjera ndërkombëtare në të drejtën pozitive si dhe harmonizim të legjislacionit në përputhshmëri me direktivat e Unionit European, sikurse Maqedonia në rastin konkret, por nevojitet edhe njohje dhe familjarizim i subjekteve të së drejtës, sidomos, shfrytëzuesve të veprave të ndryshme të autorëve me këto dispozita, me qëllim që të arrihet një nivel më i lartë i zhvillimit dhe një siguri më e madhe nga keqpërdorimi dhe keqshfrytëzimi.

³⁷ [http://www.cisac.org/Cisac-Home/Our-Members/Members-Directory/\(society\)/74](http://www.cisac.org/Cisac-Home/Our-Members/Members-Directory/(society)/74).

³⁸ <http://www.mmi.mk/>.

Referencat

Libra

1. Daboviq-Anastasovska, Jadranka, dhe Pepeljugoski, Valentin. *E drejta e pronësisë intelektuale*. Shkup:Akademik, 2012;
2. Henneberg, Ivan. *Autorsko pravo*. Zagreb:Informator, 1996;
3. MacQueen, Hector, Waelde, Charlotte, Laurie, Graeme, Brown, Abbe, *Contemporary Intellectual Property Law and Policy, Second Edition*, New York:Oxford University Press, 2011;
4. Stim, Richard. *Patent, Copyright & Trademark*. Berkeley-California:Nolo, 2010.

Akte normative

1. Deklarata universale për të drejtat e njeriut (Universal Declaration of Human Rights UNGA Res 217 A(III) UDHR) <<http://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights/>>;
2. Direktiva e Unionit European për administrim kolektiv të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, dhe licencimit multi-territorial të të drejtave mbi veprat muzikore për përdorim online (në rrjet) në tregut e brendshëm (Directive of the European Union on collective management of copyright and related rights and multi-territorial licensing of rights in musical works for online use in the internal market 2014/26/EU) <<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32014L0026&from=EN>>;
3. Direktiva e Unionit European për radiodifuzionin satelitor dhe ritransmetimit kabllorik (Directive of the European Union on the coordination of certain rules concerning copyright and rights related to copyright applicable to satellite broadcasting and cable retransmission 93/83/EEC) <<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:31993L0083&from=EN>>;
4. Direktiva e Unionit European për zbatim të të drejtave të pronësisë intelektuale (Directive of European Union on the enforcement of intellectual property rights 2004/48/EC) <<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2004:195:0016:0025:en:PDF>>;

5. Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e performuesve, prodhuesve të fonogramëve dhe organizatave radiodifuzive (International Convention for the Protection of Performers, Producers of Phonograms and Broadcasting Organisations) <http://www.wipo.int/treaties/en/text.jsp?file_id=289757>;
6. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 52/91, 1/92, 31/98, 91/01, 84/03, 107/05, 3/09 dhe 49/11.
7. Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përfaqësuara në Republikën e Maqedonisë "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.115/10, 140/10, 51/11, 147/13 dhe 154/15";
8. Ligji për ndryshim dhe plotësim të ligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përfaqësuara në Republikën e Maqedonisë "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.147/13;
9. Marrëveshja për aspektet afariste të të drejtave të pronësisë intelektuale (Agreement on trade-related aspects of Intellectual property rights - TRIPS) <http://www.wipo.int/treaties/en/text.jsp?file_id=305907>;
10. Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights 993 UNTS (ICESCR) <<http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CESCR.aspx>>.

Linqe

1. <http://www.authorsocieties.eu/>;
2. <http://www.cisac.org/>;
3. [http://www.cisac.org/Cisac-Home/Our-Members/Members-Directory/\(society\)/74](http://www.cisac.org/Cisac-Home/Our-Members/Members-Directory/(society)/74);
4. <http://www.mmi.mk/>;
5. <http://www.zamp.com.mk/>;

Servitutet Sendore sipas legjislacionit ne fuqi, menytrat e fitimit dhe te shuarjes te se drejtes sendore

JEHONA SHALA

Universiteti “Hasan Prishtina”, Prishtinë,

Abstrakti

Servitutet sendore, konsistojnë në radhë të parë, në një të drejtë sendore, e cila e bën të mundëshme që në dobi të një sendi të paluajtshëm të përdoret e shfrytëzohet një send tjetër i paluajtshëm. Servituti pat një origjinë të pavarur, të cilën e shoqëroi edhe gjatë fazave të mëvonëshme të zhvillimit të saj.

Literatura juridike, Ligjet, Kodet civile të shtetëve të ndryshme përdorën për servitutet sendore nocione të ndryshme. Këto koncepte juridike të ndryshme për servitutet sendore sigurisht që gjejnë trajtimin e tyre doktrinar në këtë punim. Servituti sendor përbën të drejtën e pronarit të një pasurie të paluajtshme që për nevojat e kësaj pasurie të paluajtshme të kryejnë veprime të caktuara në pasurinë e paluajtshme të pronarit tjetër. Nisur nga rëndësia që servitutet sendore paraqesin për të drejtën, por edhe nga ana e vështërsive që ai mbartë në vetë vete, jemi përpjekur që në këtë punim të trajtojmë përkufizimin, nocionin e servituteve sendore, elementet e rëndësishme të tij siç janë objekti dhe subjekti i servituteve sendore, duke vazhduar me llojet e servituteve sendore deri tek mënyrat e fitimit dhe të shuarjes së servituteve sendore.

Fusha e studimit: *E drejta Pronësore, Servitutet Sendore*

Fjalë kyçe: *servitut, send dominant, sendi shërbyes, paluajtshmëri, ndërtim, vendim gjyqësor, parashkrim, libri i tokave, intabulacionet, titulli juridik, ushtrim i së drejtës etj.*

HYRJE

Servitutet si një institutë me rëndësi në të drejtën civile, paraqesin një interes të posaqëm që lidhet ngushtë më të drejtën e pronësisë. Nisur nga rëndësia të cilën e kanë servitutet për të drejtën, ligjëvënësi i ka garantuar asaj përveq mbrojtjes së posaqme me anë të padive të ndryshme, edhe një sërë efektesh tjera juridike. Servitutet sendore, në vetëvete përbëjnë një institutë i cili paraqet një laramani në dhënien e nocionëve dhe koncepteve që e karakterizojnë atë. Në frymën e

interpretimit bashkëkohorë, në këtë punim shkencor instituti i servituteve sendore konform rregullimit ligjor në fuqi, interpretohet në një ndërthurje të dy elementëve përbërëse të tij, fitimit dhe humbjes. Në këtë vështrim, këtij instituti i mundësohet interpretimi shkencor bashkëkohorë, duke kapërcyer kështu edhe pengesat ideologjike të vrejtura në interpretimin e këtij instituti gjatë kohës së lindjes dhe zhvillimit të tij.

E drejta e servituteve është një e drejtë reale që nënkupton të drejtën e një personi, që në përmasë dhe në mënyrë të caktuar, të shfrytëzon sendin pronar i të cilit është personi tjetër. Në këtë aspekt koha dhe mënyra në të cilën u krijuan servitutet sendore mbetet ende vështirë të përcaktohet. Ndër servitutet e para, hasim ato servitutet të cilat ishin të domosdoshme për zhvillimin e jetës normale, e ato ishin servitutet e rrugës dhe servituti i ujit. Si mënyra për shuarje e servitutit sendor përmenden këto: veprimi juridik, heqja dorë, kalimi i kohës, me shkatërrimin e sendit, me vendim të organit gjyqësor, me bashkim etj.

HISTORIKU DHE NOCIONI I SERVITUTEVE

Me emrin e përbashkët **iura in re aliena** quhen të gjitha të drejtat të cilat kanë efekt juridiko civil, ndërsa nuk janë pronë. Të gjitha këto të drejta janë grumbulluar në tri grupe: servitutet (**servitudes**), disa forma të qirasë (**qesimit**) afatgjatë të tokës me efekt juridikosendor (**superficies, ius in agro vectigali dhe emphyteusis**) dhe e drejta e pengut (**fiducia, pignus dhe hypotheca**).

Institutet juridike të përfshira me këtë emer të përbashkët janë të ndryshme për nga përmbajtja dhe janë paraqitur në kohë të ndryshme, prandaj është shumë vështirë që të nxirren disa karakteristika të përbashkëta që nga to kishin për ta bërë tërësinë. Koha dhe mënyra e krijimit të disa servituteve është shumë e vështirë të vërtetohet. Ligji i XII tabelave nuk i ka njohur servitutet si marrëdhënie e veçantë juridike, megjithëse i ka rregulluar disa marrëdhënie të cilat më vonë janë renditur në mes të servituteve tokësore (**servitudes praediorum**). Servitutet e para të cilat i hasim, janë ato të cilat janë të domosdoshme për të shfrytëzimin e fushave-servitutet e rrugës dhe të ujit. Më

vonë kanë ardhë të tjerat: servitutet e nxerrjes së rërës, gëlqerës, kullotjes së bagëtisë etj.³⁹

Përpjekjet për të përkufizuar servitutit sendor janë të shumënumërta dhe të llojlojta, si në teori ashtu edhe në legjislacione. Përkufizimi më i shkurtër i servitutit sendor, me gjasë, do të mund të bëhet në këtë mënyrë. Servituti sendor është një e drejtë sendore, e cila bën të mundshme (ose, në bazë të së cilës bëhet e mundëshme) që në dobi të një sendi të paluajtshëm të përdoret e shfrytëzohet një send tjetër i paluajtshëm. Mirëpo, nga ato që dimë për servitutit, e edhe për servitutit sendor, ky përkufizim nuk është i plotë. Nga përkufizimi i përmendur del e qartë se fjala është për një të drejtë, bile për një të drejtë sendore, e cila është e lidhur për sendet e paluajtshme, në bazë të së cilës shfrytëzohet ekonomisht njëri send, duke e shfrytëzuar ose përdorur një send tjetër.⁴⁰

Në vazhdim po japim definicionin ligjor ku thuhet, " Servituti sendor është e drejta e pronarit përkatës të një paluajtshmërie (paluajtshmëria dominuese) që një paluajtshmeri tjetër (paluajtshmëria shërbyese) në një mënyrë të caktuar ta shfrytëzojë apo të ndalojë kryerjen e veprimi të caktuar ose të përjashtojë ushtrimin e së drejtës së caktuar, të cila rrjedhin nga e drejta e pronësisë në paluajtshmerinë shërbyese."

"Servituti sendor duhet t'i sigurojë ndonjë dobi titullarit të servitutit, përndryshe servituti është i palejuar."

"Një servitut sendor nuk mund ta detyrojë pronarin e paluajtshmërisë shërbyese për një veprim."⁴¹

Nga aspekti i autorizimeve të titullarëve të së drejtës së servitutit, servituti ishte e drejtë reale mbi sendet e huaja, e cila e autorizonte titullarin e së drejtës së servitutit që në një masë të caktuar të vepronte përherë në sendin e huaj ose që prej zotëruesit të pasurisë shërbyese të kërkonte që objektin e servitutit të mos e përdorte në një mënyrë të caktuar.⁴²

Në literaturën juridike, servitute sendore konsiderohen ato servitute në bazë të të cilave pronari i një sendi të paluajtshëm duhet të durojë që pronari i një sendi tjetër të paluajtshëm të shfrytëzojë sendin e tij të paluajtshëm për nevojat e

³⁹ Bilalli Asllan, Bahtiri Bedri, "E drejta Romake", faqe 328-330, Prishtinë 2015

⁴⁰ Statovci Ejup, "E drejta e servituteve-Aspekte komperative", faqe 99, Prishtinë 2009

⁴¹ Ligji Nr.03/L-154, Për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, neni 252, <http://www/gazetazyrtare.com>

⁴² Ivo Puhani, "E drejta Romake", faqe 262, Shkup, 1988

sendit të vet ose pronari të mos shërbehet në interesin e këtij pronari të dytë me sendin e vet të paluajtshëm, për shkak se ekziston servituti sendor. Servituti sendor (real) ka për objekt gjithmonë sendet e paluajtshme dhe në këtë mënyrë, parimisht, krijon lidhje të përhershme midis dy sendeve të paluajtshme.⁴³

Regjistrimi i servitutit - Servitutet do të regjistrohen në regjistër për të dy pjesët shërbyese dhe dominuese (sunduese) të njësisë së pronës së paluajtshme. Regjistrimi i servituteve do të përfshijë llojet e servituteve dhe kohën e servituteve, nëse janë me kohëzgjatje të caktuar.⁴⁴

1.3 USHTRIMI I SË DREJTËS SË SERVITUTEVE SENDORE

Legjislacioni jonë në fuqi pra Ligji për Pronësin dhe të drejtat tjera sendore, në lidhje me ushtrimin e së drejtës së servitutit sendor përcakton se:

1. Titullari i të drejtës së servitutit sendor duhet ta ushtrojë servitutin në atë mënyrë, që pasurisë së paluajtshme shërbyese t'i paraqesë ngarkesën më të vogël të mundshme.

2. Gjatë ushtrimit të një servituti, titullari i servitutit i ruan në mënyrë adekuate edhe interesat e pronarit të paluajtshmërisë së ngarkuar, derisa nuk cenohet ushtrimi i servitutit.

Meqenëse servituti është një raport i caktuar juridik, atëherë nga ky raport me rastin e ushtrimit të servitutit dalin pozita e anës aktive dhe pozita e anës pasive e pronarit dominant dhe e pronarit shërbyes. Të drejtat dhe detyrimet e pronarit të sendit dominant lidhur me ushtrimin e servitutit dalin varësisht nga origjina e të drejtës së servitutit.⁴⁵

“E drejta e servitutit duhet të ushtrohet në kohën dhe në mënyrën që sjell më pak vështirësi e shqetësime për pronarin e pronës shërbyese.”⁴⁶

1.2 OBJEKTI DHE SUBJEKTET E SERVITUTEVE SENDORE

Servitutet sendore për objekt kanë sendin. Sendi është gjithmonë i paluajtshëm. Kjo paluajtshmëri, që është shërbyese, mund të jetë në pronësi të çdokujt. E drejta e servitutit sendor konstituohet në favor të paluajtshmërisë, me qëllim që

⁴³ Games Andrija, “Bazat e të drejtës reale”, faqe 145, Prishtinë 1978

⁴⁴ Meha Murat, Steiwer Fredrik, Bublaku Hajzer, “Procedurat për regjistrimin e pronës dhe shërbimet komunale”, Faqe 12, Prishtinë 2011.

⁴⁵ Ligji Nr. 03/L-154, Ligji për Pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, neni 254, <http://www.gazetazyrtare.com>

⁴⁶ Kodi Civil i Shqipërisë, neni 285-291

sendi i paluajtshëm, për të cilin është konstituuar servituti të shfrytëzohet në mënyrë të plotë, ose në mënyrë komode. Sendet në bazë të legjislacionit në fuqi përkufizohen në këtë mënyrë: “Sende konsiderohen sendet e luajtshme, paluajtshmeritë dhe të drejtat jotrupore.

Sendi i luajtshëm “ Sendet e luajtshme janë objektet trupore të pavarura, që nuk janë në mënyrë të përhershme të lidhura me tokën ose pjesët e tokës dhe që në përgjithësi mund të lëvizin”

Paluajtshmëria- Paluajtshmëria është një pjesë e caktuar e sipërfaqes tokësore, e cila është e kufizuar ose mund të kufizohet.

Subjektet e servituteve sendore përcaktohen në bazë të faktit se kush është i autorizuar i të drejtës së servitutit sendor i autorizuar është gjithmonë pronari i paluajtshmërisë dominuse.

Kur paluajtshmëria dominuse është objekt i më shumë subjekteve, atëherë të autorizuar janë të gjithë bashkë pronarët, gjegjësisht pronarët e përbashkët.⁴⁷

Në termet ligjore servitutet janë “mjete juridike private”, që krijojnë interesa rreth përdorimit të tokës. Të gjitha këto terma përfshinë në thelb të drejta reale pronësore në pasurin apo pronën e dikujt tjetër.⁴⁸

2.1 FITIMI I SERVITUTEVE SENDORE

Në shekujt e parë të histories romake, praktika ka njohur vetëm disa raste të shfrytëzimit të tokës së huaj. Mirëpo, ky shfrytëzim nuk është konsideruar si e drejtë e veçantë, por pjesë përbërse e të së mirë së privilegjuar,

përkatësisht të drejta të cilat dalin nga fakti i posedimit të së mirë së privilegjuar.⁴⁹

Me ligji shprehimisht thuhet se,“Servituti sendor krijohet në bazë të një punë juridike, një vendimi të organit shtetëror ose një ligji.

Për krijimin e një servituti sendor sipas punës juridike është e nevojshme një kontratë dhe

⁴⁷ Aliu Abdulla,“E drejta sendore” faqe160-161,Prishtinë 2004,

⁴⁸ Antony Dnes And Dean Lueck ,”Asymmetric Information and the Structure of Servitude Law”,faqe 1

⁴⁹ Bilalli Asllan,Bahtiri Bedri,vepër e cituar,faqe 335

regjistrimi në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëritë. Me kontratë palët duhet të merren vesh,
për krijimin dhe përmbajtjen e servitutit.

Dispozitat në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni do të zbatohen në të gjitha rastet përveç nëse me vendim administrativ ose me ligj të veçantë parashihet ndryshe.”⁵⁰

Nga kjo nënkuptohet se servituti mund të fitohet me anë të tri bazave juridike: së pari më punë juridike që në të shumtën e rasteve janë kontratat: së dyti me vendim të organit shtetëror, në bazë të së cilit titulli juridik shërben për fitimin e të drejtës së servitutit: dhe së treti si bazë për fitimi e të drejtës së servitutit është ligji. Servitutet sendore mund të krijohen edhe për një periudhë të caktuar kohore siç është rasti i servituteve sezonale, të cilat krijohen për një periudhë të shkurtër kohore, ky lloj i servitutit është i përmendur në ligjin për tokën bujqësore të Kosovës.

Fitimi i servitutit në bazë të veprimit juridik është fitimi më i rëndont, më i shpeshti që ka një rëndësi të madhe. Shprehjet veprim juridik ose titull si përdoren në një pjesë të kodeve dhe të literaturës, përdoren në një kuptim të përgjithshëm, i cili në vetëvete përmban edhe kontratat edhe testamentin. Servituti mund të krijohet inter vivos në bazë të kontratës dhe mortis cause në bazë të testamentit.⁵¹

Regjistrimi i servitutit sendor bëhet në librin e tokave, bëhet në librat e tapive-librat e intabulacionit. Por nëse nuk ekziston as librat e tokave, as ato të tapive, regjistrimi i servitutit bëhet në regjistrat publikë. Në Kosovë nuk ka pasur dhe nuk ka libra të tokës.⁵²

Fitimi i servitutit në bazë të vendimeve gjyqësore ose të organëve shtetërore. Një mënyrë të tillë të fitimit të servituteve sendorë e ka paraparë edhe Ligji jonë bazë, Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore. Nga ligjëvënësit ky emërtim i përcaktuar në vetëvetë përmban vendimin e gjyqit ose të organit administrativë, që d.m.th, mënyrën e fitimit të servitutit me vendim gjyqësor dhe me vendim të një organit tjetër administrativë.⁵³

Fitimi i servitutit sendor me parashkrim fitues. Ky është një fitim original i të drejtës së servitutit në sendin e huja, duke e ushtruar përmbajtjen e tij (posedimi) mbi sendin shërbyes në dobi e interest ë pronarit të sendit dominant

⁵⁰ Nr. 03/L-154,Ligji për Pronësinë dhe të drejtat tjera sendore,neni neni 253,<http://www.gazetazyrtare.com>

⁵¹ Statovci Ejup,vepër e cituar,faqe 182

⁵² Më hollësisht:E.Statovci,Marrëdhëniet pronësore-juridike në sendet e paluajtshme në KSA të Kosovës,Prishtinë 1977

⁵³ Më hollësisht shih Ligji Nr. 03/L-154,Ligji për Pronësinë dhe të drejtat tjera sendore,neni

për një kohë të caktuar. Disa sisteme juridike kërkojnë që ky ushtrimi servitutit mbi sendin e tjetrit gjatë një kohe të caktuar të mos jetë kundërshtuar nga pronari i sendit shërbyes.⁵⁴ Në lidhje me procedurën e regjistrimit dhe përmbajtjes së saj, legjislacione për pasuritë e paluajtshme na jep këtë përfundim: “Pronari i një pasurie të paluajtshme regjistron një servitut duke i paraqitur regjistruesit aktin e krijimit të servitudit në formën e kërkuar nga ligji; ai duhet të përmbajë:

- a) natyrën e servitutit, periudhën për të cilën ka efekt ky servitut, si dhe ndonjë konditë apo kufizim që ka efekt mbi të; dhe
- b) pasurinë e paluajtshme ose pjesën e saj, që preket nga ky servitut.⁵⁵

2.2 SHUARJA E SERVITUTIT SENDOR

Deri në këtë pjesë, pamë fitimin e servituteve sendore, formimin dhe zhvillimin e tij nëpër periudha të ndryshme kohore, tani na mbetet të shohim edhe rastet e përfundimit apo të shuarjes së servitutit sendor. Me ligj, shprehimishtë është trajtuar çështja e shuarjes së servitutit sendor në këtë mënyrë:

“Për shuarjen e servitutit sendor janë të nevojshme deklarata e pronarit të paluajtshmërisë dominuese për heqjen dorë nga servituti sendor dhe regjistrimi në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëritë.”⁵⁶

Shuarja e servitutit me anë të veprimit juridik. Servituti, sikurse është thënë, fitohet me anë të veprimit juridik. Por, servituti edhe shuhet me anë të veprimit juridik. Këtu mbi të gjitha dhe para së gjithash mendohet në shuarjen e servitutit me anë të kontratës. Pronari aktual i sendit shërbyes dhe pronari aktual i sendit dominant, mund të merren vesh, që servituti të shuhet në bazë të kontratës. Në qoftëse në anën aktive ekziston bashkëpronësia, për shuarjen e servitutit kërkohet pëlqimi i të gjithë bashkëpronarëve. Me rastin e shuarjes së servitutit kërkohet edhe pëlqimi i një personi të tretë kur ky ka ndonjë interes në sendin dominant, siç është hipoteka, usufructi etj. Në lidhje me formën e duhur të kontratës është e paraparë që kontrata të jetë e lidhur me shkrim.

⁵⁴ Statovci Ejup, vepër e cituar, faqe 214-215

⁵⁵ Përmbledhje legjislacione për pasuritë e paluajtshme, neni 42

⁵⁶ Ligji Nr. 03/L-154, Ligji për Pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, neni 260, <http://www.gazetazyrtare.com>

Shuarja e servitutit me anë të renoncimit. Mënyra tjetër e shuarjes së servitutit është renoncimi, heqja dorë nga servituti me shprehje të një anshme të vullnetit të titullarit të servitutit. Për shuarjen e servitutit me renoncim nuk kërkohet pëlqimi i pronarit aktual të sendit shërbyes. Kur servituti është i papjestueshëm, një bashkëpronar me renoncim nuk mund të shuaj servitutin pa pëlqimin e bashkëpronarëve tjerë. Edhe kur sendi dominant është i ngarkuar me barrë në dobi të personave të tretë, si hipoteka, servituti nuk mund të shuhet me renoncim, nëse më atë rast u shkaktohet atyre ndonjë dëm.⁵⁷

Shuarja e servitutit me kalimin e kohës. Servituti sendore mund të shuhet më kalimin e kohës, në ato raste kur ai është lidhur për një periudh të caktuar kohore. Në rastet kur servituti është i lidhur për ndonjë kusht të caktuar, atëherë në momentin e plotësimit të atij kushti shuhet edhe e drejta e servitutit.

Shuarja e servitutit sendor me shkatërrimin (humbjen) e sendit. E drejta e servitutit, mund të shuhet më veprimin e ngjarjeve natyrore ose me vullnetin e të autorizuarve juridik, ose për arsyet të disa rrethanave që kishin si pasojë shuarjen e të drejtave ekzistuese: p.sh, servitutet shuheshin me veprimin e ngjarjeve natyrore ose kur zhdukej objekti, kur sendi ndryshonte esencialisht, kur bëhej i pamundur ushtrimi i mëtutjeshëm i së drejtës.⁵⁸

Shuarja e servitutit sendor me vendim të organit shtetëror. Servituti sendor siç mund të fitohet me vendim të organit shtetëror ashtu edhe mund të shuhet. Në rastet e përpjestimit të pronësisë, me anë të vendimit gjyqësor, mund të krijohet një servitut dhe të shuhet një tjetër dhe anasjelltas.

Shuarja e servitutit sendor me anë të bashkimit (konsolidim). Servituti është e drejtë sendore mbi sendin e huaj, në rastet kur bëhet bashkimi në atë mënyrë që personi i njejtë të bëhet edhe pronar i sendi dominant edhe pronari i sendit shërbyes, në të tilla raste ndodh shuarja e servitutit sendore sipas parimit nemini res sua servit.

Shuarja e servitutit me mosushtrimin e tij. Servituti sendor me mosushtrim shuhet në dy raste. Nëse shuarja është rezultati i mosushtrimit të zakonshëm të servitutit, afati për shuarjen e servitutit është më i gjatë. Ndërkaq, kur ushtrimin e servitutit sendor e kundërshton pronari i sendit shërbyes, afati për shuarje e servitutit është më i shkurtër.⁵⁹

⁵⁷ Statovci Ejup, vepër e cituar, faqe 253-254

⁵⁸ Mandro Arta, "E drejta Romake", faqe 226, Tiranë 2004

⁵⁹ Statovci Ejup, vepër e cituar, faqe 263-264

PËRFUNDIMI

Servitutet sendore, janë të drejta sendore në bazë të cilave arrihet, që në dobi të sendit të paluajtshëm, të përdore ose të shfrytëzohet një send tjetër i paluajtshëm. Përpyekjet për të kufizuar servitutet sendore, kanë qenë të shumëta dhe të llojëllojshme, që nga moment i krijimit e deri në formimin dhe zhvillimin e mirëfilltë të tyre. Instituti i servituteve, është një institut me një rëndësi të veçantë për të drejtën civile, dhe këtë më së miri na e dëshmon dhënia e përkufizimeve për servitutet në shumicën e Kodëve Civile edhe Ligjeve të shumë shtetëve të ndryshme. Koha por edhe mënyra e krijimit të servituteve është e vështirë që të përcaktohet. Ligji i XII tabelave, nuk i ka njohur servitutet si marrëdhënie e veçantë juridike, megjithatë se më vonë ky Ligj i ka rregulluar disa marrëdhënie të cilat më vonë kanë qenë pjesë e servituteve. Servituti vërtet ka origjinë të përbashkët me pronësinë, buron nga e njejta substancë, por origjina e servitutit dhe formimi gradual i tij është i pavarur nga pronësia.

Në të drejtën tonë zakonore e drejta e servituteve ka qenë e paraparë në Kanunin e Lek Dukagjinit, Kanuni i Idriz Sulit, në këto kanune kanë qenë të parapara edhe shumë veçori të ndryshme për servitutet dhe llojet e servituteve sendore.

Rëndësia që kanë servitutet, kanë bërë që secili shtet në legjislacionin e tyre, të parashohin krijimin e këtij institut të veçantë juridik, format e fitimit, shuarjes si dhe mbrojtjen juridike në rast të cënimit apo pengimit të realizimit të kësaj të drejte. Edhe legjislacioni jonë parasheh Ligjin mbi Pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, ku në kuadër të këtij ligji është i paraparë edhe instituti i servituteve në përgjithësi por edhe servitutet sendore në veçanti, në kapitullin e III, nenet 252-260.

Sa i përket fitimit të servituteve sendore kjo çështje duhet të shikohet në një kontekst të caktuar historik, të marrëdhënieve shoqërore si dhe në nivel të caktuar të prodhimit dhe zhvillimit social. Megjithatë mënyrat e fitimit të servituteve sendore kanë ndryshuar me kalimin e kohës si dhe me zhvillimin e vet institutit të servituteve sendore.

Servitutet sendore përveç fillimit e kanë momentin edhe të shuarjes së tyre, ku me anë të kësaj paraqesin edhe specifikat e nje servituti si e drejtë sendore. Arsyet për këtë shuarje mund të jenë të ndryshme, ndërsa ligji jonë bazë nuk i ka të parapara shprehimishtë të gjitha ato mundësi për shuarjen e servitutit sendore, mirëpo këtë çështje e ka trajtuar në mënyrë me specifike.

Zhvillimit aktual të vendit tonë, i nevojitet një legjislacion civil më i modernizuar, ku si model do të mund të merrëshin vendet e zhvilluara perendimore. Në këtë mënyrë do të mund të arrihej plotësimi i aspiratës tonë, për një zhvillim më të madhë ekonomik, duke mundësuar kështu forma dhe kushte më të lehta për fitimin dhe gëzimin e të mirave materiale.

Bazuar në përkufizimet e mësipërme të dhënat për servitutet, shtjellohen në këtë punim në mënyrë të detajuar të gjitha elementet dhe llojet e servituteve sendore, konsekuenca ligjore, mënyrat e fitimit dhe të humbjes së tij dhe padyshim edhe mbrojtja që e drejta i garanton këtij instituti të veçantë në mënyrë të posaçme.

LITERATURA

- I.** Aliu Abdulla, “E Drejta Sendore”, Prishtinë 2004
- II.** Aliu Abdulla, “E Drejta Civile -Pjesa e Përgjithshme”, Prishtinë 2013
- III.** Antony Dnes And Dean Lueck ,”Asymmetric Information and the Structure of Servitude Law”, University of Arizona, USA, 2007
- IV.** Bilalli Asllan, Bahiri Bedri,“E Drejta Romake”,Prishtinë 2015
- V.** Statovci Ejup,“E Drejta e Servituteve-Aspekte komperative”, Prishtinë 2009
- VI.** Statovci Ejup,“Marrëdhëniet Pronësore Juridike në sendet e paluajtshme në KSA të Kosovës”, Prishtinë,1977
- VII.** Games Andria ,“Baza e të drejtës reale”, Prishtinë 1978
- VIII.** Meha Murat, Steiwer Fredrik, Bublaku Hajzer,”Procedurat për regjistrimin e pronës dhe shërbimet komunale”, Prishtinë 2011
- IX.** Metzger Ernest,”Adam Smith and Roman Servitudes” Roman Law Resources,University of Aberdeen, 2003
- X.** Mandro Arta,“E drejta Romake”, Tiranë 2004
- XI.** Puhan Ivo,“E drejta Romake”, Shkup 1988
- XII.** Presented by Meumann White Attorneys, “Servitudes over immovable property and implications”

- XIII. Shehu Avni, "Pronësia", Tiranë, 2000
- XIV. Tutulani-Semini Mariana, "Korniza ligjore e regjistrimit të pasurive në Shqipëri dhe e drejta e pronësisë", Tiranë 2001

LEGJISLACIONE

- I. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë. Miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994; ndryshuar me ligjet nr.8536, datë 18.10.1999; nr.8781, Datë 3/5/2001 dhe nr.17/2012, datë 16/02/2012;121/2013, datë 18/04/2013
- II. Ligji për Pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, Prishtinë, Nr. 03/L-154, Datë 25/06/2009
- III. Ligji për tokën Bujqësore Nr 02/L-26, Datë 01/06/2007
- IV. Ligji për Themelimin e Regjistrimit për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme i Kosovës. Prishtinë, Nr. 2002/5
- V. Përmbledhje Legjislacioni për Paluajtshmëritë, Nëntorë 2008

PROCEDURAT ALTERNATIVE SIPAS KPPK-SË, NË VËSHTRIM TË VEÇANTË NEGOCIMI I MARRËVESHJES PËR PRANIMIN E FAJËSISË

Llegum magister: Edona Morina, Kosovë

ABSTRAKT

Ky punim është nxitur me ndryshimet që solli Kodi i ri i cili hyri në fuqi me 1 janar 2013, i cili karakterizohet me një mori ndryshime dhe plotësime si dhe zgjedhje të reja që mbështesin tendencën për mbrojtje të të drejtave të njeriut e njëkohësisht edhe efikasitet të procedurave penale. Në vazhden e ndryshimeve materiale dhe procedurale, Kodi i ri i procedurës penale i dha një rëndësi të posaçme zgjidhjes së çështjeve penale me anë të aplikimit të procedurave alternative.

Procedurat penale alternative gjithnjë e më shumë vijnë në shprehje. Si rezultat i zgjedhjes së një numri enorm të çështjeve penale vendet janë gjithnjë në kërkim të proceseve alternative për të trajtuar rastet penale përtej gjykimeve tradicionale formale. Marrëveshja për pranimin e fajësisë është konsideruar shpesh si një zgjidhje e mundshme për problemet e grumbullimit të lëndëve, periudhave të gjata të paraburgimit dhe për të ndihmuar për të adresuar abuzimet serioze të të drejtave të njeriut që rezultojnë nga një keqfunksionim i sistemit të drejtësisë penale.

Punimi është i përqëndruar kryesisht në shpjegimin teorik dhe praktik të procedurave alternative të zgjidhjes së çështjeve penale në vështrim të veçantë të institutit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, mbështetur edhe nga shembuj praktik që korrespondojnë me pjesën teorike, me theks dhe vështrim të veçantë në aspektin procedural.

Në këtë studim është bërë përpjekje që të pasqyrohen dhe të shtjellohen të gjitha elementet e rëndësishme që kanë të bëjnë me temën në fjalë. Punimi përveç objektit dhe qëllimit të studimit përmban nocionin, format, karakteristikat, avantazhet, disavantazhet, si dhe kritikën drejtuar këtij instituti juridik. Punimi përmban edhe vështrimin krahasues të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, bazën juridike sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, rolin e

pjesëmarrësve, rrjedhën e procedurës dhe marrjen e aktgjykimit në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, arsyet, rreziqet dhe vështirësit praktike në zbatim.

Si shtojcë punimi përmban formularët për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë për çdo fazë të procedurës si dhe përfundimin dhe literaturën e cila është përdorur për realizimin e këtij punimi.

Fjalët kyçe: KPPK, procedurat alternative, marreveshja mbi pranimin e fajësisë, efikasiteti i procedurës penale.

1. Hyrje

Sistemet e drejtësisë penale në mbarë botën përballen me numra të enorm të çështjeve gjyqësore të pazgjidhura. Presioni që ky numër i lëndëve të pazgjidhura te rritet mund të jetë edhe më serioz në vendet post-konfliktuale, që përballen me probleme të tjera të tilla si burimet e kufizuara dhe mjedis politik i brishtë. Në sistemet e drejtësisë të mbingarkuara me raste kriminale mund të jetë e vështirë, në mos e pamundur, të mbahen gjyqet në mënyrë të duhur dhe në kohë, për çdo person të akuzuar.

Marreveshja për pranimin e fajësisë dhe procedurat alternative të zgjedhjes së çështjeve penale gjyqësore mund të ndihmojë për të lehtësuar disa nga këto probleme. Megjithatë, në vendet që nuk e kanë përdorur më parë negociimin e marreveshjes së pranimit të fajit, ky lloj i reformës është një ndryshim serioz në sistemin ligjor dhe duhet të trajtohet me kujdes në kontekstin e përgjithshëm të sistemit ekzistues të drejtësisë penale.

Edhe Republika e Kosovës në mesin e vendeve postkonfliktuale ballafaqohet me një numër të madh të lëndëve të pazgjidhura të cilat mbeten të grumbulluara në sirtarët dhe shkrimoret e gjykatave dhe prokurorive. Kjo rrjedh si rezultat i një numri të faktorëve me të cilët kryesisht ballafaqohen vendet në tranzicion, siç janë baza joadekuata dhe e pamjaftueshme ligjore, joefikasiteti, mungesa e llogaridhënies, numri i vogël i gjyqtarëve e prokurorëve dhe mungesa e burimeve të mjaftueshme materiale.

2. Teksti kryesor

Në sistemet e mëparshme shqyrtimi kryesor ishte rezultati i pritshëm i çfarëdo hetimi apo aktakuze. Mirëpo, ekzistojnë disa arsye përse prokurori i shtetit apo i pandehuri kërkojnë alternativa, dhe gjykata duhet t'i mbështesë ato alternativa.

Arsyeja e parë përse prokurori i shtetit kërkon alternativa është avancimi i hetimeve, pasi që marrëveshjet për pranimin e fajësisë mund të rezultojnë në atë që i pandehuri të bëhet dëshmitar bashkëpunues.

Në këtë mënyrë, i pandehuri mund të sigurojë prova shtesë kundër personave tjerë të cilët kanë kryer vepra penale dhe në këtë mënyrë të avancojë në hetimet e tij/saj. Ky është mjet i rëndësishëm për hetimet e ndërlikuara, veçanërisht për krimin e organizuar dhe korrupsionin. Një arsye tjetër për të kërkuar alternativa tjera është mbrojtja e viktimës nga ripërjetimi i asaj nëpër të cilën ka kaluar në gjykatë, gjë që mund të jetë përvojë traumatike dhe e vështirë. Alternativat gjithashtu mund të sigurohen nëse i pandehuri kërkon trajtim në vend të dënimit. Shumë raste mund të përfitojnë nga efikasiteti i gjyqësorit.

Përkundër reformave të bëra në sistemin gjyqësor dhe atë prokurorial pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës në vitin 2008, si dhe reformave në fushën penale në vitin 2013 numri i lëndëve të pazgjidhura kallëzimeve penale vazhdon të jetë në rritje e sipër.

Në përpjekje për të adresuar këtë problem, Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 6 nëntor 2008 miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Kosovës dhe Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, i cili është bërë pjesë e KPP dhe u rregullua çështja e negociimit të kushteve për pranimin e fajësisë si dhe favorët që mund t'i realizojë i akuzuari në rast të arritjes së marrëveshjes së tillë, natyra dhe përmbajtja dhe efektet e marrëveshjes për pranimin e fajësisë si dhe procedura e cila duhet ndjekur nga palët e përfshira në këtë proces. Natyrisht, marrëveshja për pranimin e fajësisë u rregullua detajisht në 16 paragrafë të veçantë të nenit 308 A të KPP të këtij Kodi. Në vazhdimësi të reformimit të sistemit tonë të drejtësisë me 1 janar 2013 hyri në fuqi Kodi i Ri i Procedurës penale të Kosovës, i cili karakterizohet me një mori të ndryshmeve dhe plotësimeve si edhe të zgjedhjeve të reja të cilat mbështesin fuqishëm tendencën për mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe efikasitetin e procedurës penale. Kodi i ri i vitit 2013 solli ndryshime thelbësore të cilat përshkojnë gjithë procedurën penale, e edhe procedurat alternative, të cilat udhëzojnë prokurorin e shtetit që t'i marrë parasysh dhe t'i shfrytëzojë gjykimet alternative në të gjitha ato raste kur një gjë e tillë është e përshtatshme dhe kur është në interes të përgjithshëm. Gjithashtu, prokurori i shtetit dhe gjykata duhet t'i marrin parasysh të drejtat e të pandehurit dhe palës së dëmtuar gjatë këtyre gjykimeve alternativave, dhe duhet ta përfshijnë kompensimin dhe konfiskimin e pasurive në rastet kur është nevojshme. Këto gjykime alternative janë të rëndësishme për krijimin e një sistemi të drejtësisë penale që garanton një gjykim të drejtë të rasteve penale, por që e bënë atë me shpejtësinë e duhur për ruajtjen e të drejtave të të gjitha palëve.

Këto alternativa përfshijnë diversionin sipas nenit 148, pezullimin e përkohshëm të procedurës sipas nenit 230, dhe negocimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë sipas nenit 233.

Në vendet me sistem juridik kontinental, marrëveshja për pranimin e fajësisë është relativisht një risi dhe disa vende ende nuk e njohin këtë institut. Literatura juridike e këtyre vendeve është mjaft e kufizuar në këtë drejtim, duke pasur parasysh kohën relativisht të shkurtë prej kur ky institut parashihet në legjislacionet e tyre përkatëse apo prej fillimit të zbatimit të tij. Kohëve të fundit, vërehet qartë tendenca e shumë vendeve për të instaluar në sistemet e tyre juridiko-penale marrëveshjen për pranimin e fajësisë, ashtu siç kishin bërë më parë Italia, Franca, Serbia, Bosnja e Hercegovina, etj.

Për dallim nga vendet me sistem kontinental, në vendet anglosaksone marrëveshja për pranimin e fajësisë ka një traditë mjaft të gjatë dhe funksionimi i sistemit juridik në këto vende nuk mund të paramendohet pa zbatimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, një prej vendeve më të zhvilluara të botës që ka burime jashtëzakonisht të mëdha për hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e rasteve penale dhe kryerësve të tyre, mbi nëntëdhjetë përqind të rasteve penale zgjidhen me marrëveshje për pranim. Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara në vendimet e saj disa herë ka potencuar domosdoshmërinë e zgjidhjes së rasteve përmes marrëveshjes, meqë në të kundërtën sistemi juridik i vendit do të binte në kolaps.

Edhe pse ky institut ka përejardhje nga e drejta anglosaksone nocionin e tij do ta jap sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Negocimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë, rregullohet me nenin 233 të Kodit të Procedurës penale në fuqi, i cili ka hyrë në fuqi me 1 janar 2013, i cili me përmbajtjen e vet i përgjigjet nenit 308 A të Kodit të përkohshëm të procedurës penale të vitit 2008, që rregullonte këtë institut.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë sipas nenit 233 paragrafi 1 dhe 2 nënkupton negocimin e kushteve të marrëveshjes me shkrim për pranimin e fajësisë nëpërmjet prokurorit të shtetit dhe të pandehurit, në bazë të së cilës i pandehuri dhe prokurori i shtetit pajtohen për akuzat e përfshira në aktakuzë, ndërkaq i pandehuri pajtohet të pranojë fajësinë në shkëmbim për pajtimin e prokurorit të shtetit që ti rekomandojë gjykatës dënim më të butë, ashtu siç parashihet me ligj ose të marrë parasysh konsiderime të tjera në interes të drejtësisë.

2.2 Format e formave të marrëveshjes për pranim të fajit

Është evidente ekzistenca e disa formave të marrëveshjes për pranim të fajit, të cilat nuk përjashtojnë njëra-tjetrën dhe mund të kombinohen:

- **Charge bargaining** – marrëveshje për përmbajtjen e aktit të prokurorit sa i përket përshkrimit dhe kualifikimit juridik të veprave penale, ku prokuroria pajtohet të heqë një akuzë më të rëndë në këmbim për fajësinë për një shkelje më të vogël.
- **Fact bargaining** – pajtueshmëri apo ujdi për prezantimin e një verzioni më të favorshëm të fakteve të pretenduara në këmbim të pranimit të fajit.
- **Nolo contendere pleas** – sanksioni pranohet pa dhënie të deklaratës për pranim të fajit në mënyrë të qartë; ka disa përparësi për të akuzuarin, e në fakt i shmanget krijimit të obligimeve për kompensim të dëmit e cila do të mund të ndërli dhej në procedurë civile, që do të pasonte pas përfundimit të procedurës penale në të cilën i akuzuari është deklaruar si fajtor⁶⁰
- **Alford pleas** – paraqet rastin kur i akuzuari nuk e pranon fajin, por deklarohet se prokuroria ka dëshmi të mjaftueshme për të përcaktuar fajin jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.⁶¹

⁶⁰ I akuzuari as e pranon e as nuk e konteston akuzën; në shumë legjisllacione nuk parashihet si e drejtë e të akuzuarit; shërben si alternativë e deklaratës për pranim të fajit dhe shfrytëzohet gjatë procedurës së marrëveshjes për pranim të fajit. Deklarata sipas së cilës i akuzuari nuk i konteston faktet e rastit, mirëpo thotë se assesi nuk ka kryer vepër penale, mund të kuptohet se i akuzuari nuk i kupton akuzat ndaj tij. Kjo deklaratë futet në procesverbal me pëlqim të gjykatësit (në raste të veçanta të prokurorit) dhe ka dy përparësi: a) i akuzuari të thotë se në aspektin formal nuk ka aktgjykim ndëshkues edhe pse është shqiptuar dënimi, dhe b) kjo deklaratë pamundëson që ndaj të akuzuarit të ngritet padi civile për kompensim, R.A. Carp/R.Stidham, fq. 165.

⁶¹ Emrin e ka marrë sipas rastit në Gjyqin Suprem të SHBA-ve, North Carolina v. Alford, 400 U.S. 25 (1970). *“Henri Alford në dhjetor të vitit 1963, është akuzuar për vrasje të shkallës së parë, për të cilën mund të shqiptohet denim me vdekje. Të pandehurin e kanë ngarkuar deklaratimet e dy deshmitarëve të cilët kanë vertetur se kanë qenë prezent kur ai doli nga banesa, ka marrë revolen dhe tha se do të “lajë llogarit me dike” dhe pas kohe kur u kthi tha se “kreva punën”. Alford u muar vesh me prokurorin ashtu që do të pranon fajsinë në ndërrim që akuza të kualifikoj veprën në vrasje të shkallës së dytë e cila nuk mund të tërheq denimin me vdekje. Gjykatësi aprovoi pranimin dhe shqiptoi denimin më të lartë të mundshëm për veprën e ricilësuar 30 vite burgim. I pandehuri u ankuar se pranimi i fajsisë së tij ishte rezultat i presionit dhe frikës nga denimi me vdekje, që në të vertet është i pafajshëm. “Kam pranuar fajsinë vetëm për atë se me thanë se ka prova të forta dhe të mjaftueshme kundër meje...Nuk kam vrarë askend dhe po pësoj nga veprimet e tjetrit...Pranova fajsinë më që më thanë në të kunderten, kur prokurori bind provon porotës që jam fajtor, do të përfundoj në karrikën*

- **Sentence bargaining** – pranimi i fajit çon në drejtim të zvogëlimit apo zbutjes së dënimit, gjegjësisht në drejtim të përcaktimit të dënimit me kohëzgjatje më të shkurtër sesa që supozohet se do ta caktojë gjyqi, në rast se do të organizohej procedurë e rregullt gjyqësore.

2.3 Karakteristikat themelore të Marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Një ujdj apo marrëveshje për pranimin e fajësisë është çdo marrëveshje në një çështje penale në mes të prokurorit dhe të pandehurit të cilin i akuzuari pranon fajësinë për një akuzë të veçantë në këmbim të një koncesioni nga prokurori. Kjo mund të thotë se i pandehuri do të pranojë fajësinë për një akuzë më pak serioze, ose një nga disa akuza, në këmbim për shkarkimin e detyrimeve të tjera; ose ai mund të thotë se i pandehuri do të pranojë fajësinë për akuzën origjinale penale në këmbim të një dënim më të butë.⁶²

Marrëveshjet për pranimin e fajësisë në fakt përfshijnë tri fusha të negociatave:

- 1. Negocimi mbi objektin e akuzës (Charge Bargaining):** Kjo është një formë e zakonshme për të njohur gjerësisht e marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Ajo përfshin një negociimin e akuzave të veçanta (akuza) ose krime me të cilat i pandehuri do të përballet në gjyq. Zakonisht, në këmbim të marrëveshjes për tu shpallur "fajtor" për një sanksion më të vogël, një prokuror do të shkarkojë akuzat më të rënda ose akuzat tjera që i ngarkohen të pandehurit . Për shembull, në këmbim për shkarkimin nga akuza për vrasje të shkallës së parë, një prokuror mund të pranojë një marrëveshje për pranimin e fajësisë vetëm për vrasje, i cili duhet të jetë subjekt i miratimit të gjykatës.
- 2. Negocimi mbi deklaratën e pranimin të fajësisë (Sentence Bargaining):** Negocimi mbi deklaratën e pranimin të fajësisë përfshin negociimin për fajësinë, për akuzën e deklaruar, në këmbim për një dënim më të lehtë.

elektrike. "Megjithatë gjykata refuzoi ankesën duke theksuar që pranimi paraqet faktin e zgjedhjes së vullnetshme të tij, andaj nuk ka arsye që gjykata të mos respektoj zgjedhjen e tij. Duke u ballafaquar me dy alternativa, i pandehuri e zgjodhi atë që në atë moment i bëhëj më më e pranueshme. Kjo që të pandehurit, siç thekson ai ka pranuar fajësinë vetëm që ti shmangët dënimin me vdekje, nuk do të thotë që pranimi i tij nuk ka qenë zgjedhje e tij e vetëdijshme dhe e arsyeshme"

⁶² Garner, Bryan A., ed. (2000). Black's law dictionary (7th ed. ed.). St. Paul, Minn.: West Group. p. 1173. ISBN 0-314-24077-2.

3. Kjo kursen prokurorin që jo domosdoshmërisht duhet zgjidhur çështja përmes gjykimit për tu provuar e vërteta. Ai siguron të pandehurin me një mundësi për një dënim të lehtë.
4. **Negocimi mbi faktet** (Fact Bargaining): Negocimi dhe marrëveshja mes prokurorit dhe të pandehurit mund të bëhet edhe në pranimin e fakteve të caktuara në çështjen konkrete penale, duke eliminuar nevojën që prokurori ka për t'i provuar ato, në këmbim për një marrëveshje për të mos i futur disa fakte të tjera në prova.

Vlefshmëria e një ujdje si marrëveshja mes prokurorit dhe të pandehurit për pranimin e fajësisë varet nga tri komponente themelore:⁶³ a) Njohja mbi heqjen e të drejtave të tyre; b) Dokumenti i heqjes dorë vullnetare; c) Bazë faktike për të mbështetur akuzat për të cilat i akuzuari pranon fajin.

2.3 Rëndësia e Marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Duke e pranuar qëndrimin në drejtësi penale efikase, pjesërisht, mund të sigurohet edhe nëpërmjet veprimeve të cilat mundësojnë dekriminalizim, depenalizim, forma alternative të ndjekjes penale dhe thjeshtësim të procedurës penale, duhet të bëhet dallimi në mes të marrëveshjes për pranimitë fajit, si raport në mes të autorit të veprës (në cilësinë e të dyshuarit apo të akuzuarit dhe detyrimisht mbrojtësit të tij dhe prokurorit publik, si paditës zyrtar, si alternativë e procedurës gjyqësore, nga negocimi me qëllim të kompensimit që mund të zhvillohen në mes të autorit të veprës dhe të dëmtuarit, të cilat i udhëheq personi i tretë i papërfshirë në rast (mediatori) dhe ka karakter të alternativës së ndjekjes.⁶⁴

Shtrohet pyetja se cila është rëndësia e kësaj marrëveshje dhe pse është ky institut kaq i përhapur? Përgjigja do të ishte se marrëveshja për pranimin e fajësisë është një mjet shumë i dobishëm për zgjidhjen e shpejtë dhe efektive të rasteve penale, në përpjekje që:

- a) Të lejojë sistemin e drejtësisë penale të funksionojë në mënyrë më efikase;
- b) Të lejojë prokurorët dhe hetuesit të hetojnë rastet tjera;

⁶³Shih më shumë në vegëzen:

<http://criminal.findlaw.com/criminal-procedure/plea-bargaining-areas-of-negotiation.html#sthash.xyk17wKT.dpuf>

⁶⁴ Udhëzues për marrëveshjen për pranimin e fajësisë- Doracak për Profesionistët, fq 115 të verzionit 3 gjuhësh, viti 2011. Përgatitur nga Prof. Dr. Gordana Buzharovska në bashkëpunim me Prof. Dr. Gordan Kalajxhiev.

c) Të lejojë prokurorët dhe hetuesit të zhvillojnë rastet kundër kryerësve të veprave më të rënda;

d) Të ruaj kapacitete të vlefshme gjyqësore.

Lidhur me çështjen e shtrirjes dhe përhapjes së vazhdueshme të marrëveshjes për pranimin e fajësisë edhe në sistemet kontinentale dhe për arsyet që shpiejnë deri tek nevoja për zbatimin e këtij instituti, ndoshta përgjigja më e drejtë në këtë pyetje jepet nga Shoqata e Juristëve Amerikanë (American Bar Association), ku në një komentari lidhur me këtë çështje thuhet:

“Marrëveshja për pranimin e fajësisë është prevalente për shumë arsye praktike, sic janë: të pandehurit shmangin koston e përfaqësimit të tyre në gjykim, rrezikun e dënimit të ashpër dhe publicitetin që mund të zgjojë një gjykim i hapur; prokurori kursen kohën dhe shpenzimet e një shqyrtimi të gjatë; dhe sistemi i gjykatave nuk ngarkohet me barrën e mbajtjes së gjykimeve dhe administrimin e provave për secilin rast dhe secilën vepër penale e cila paraqitet pranë gjykatës”.⁶⁵

Ka faktorë shtesë të cilët bëjnë edhe më të rëndësishëm zbatimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, si:

a) Me hyrjen në marrëveshje për praninë, **të pandehurit** i garantohet e drejta në gjykim brenda një kohe të arsyeshme. Përveç kësaj, me hyrjen në marrëveshje i pandehuri në masë të konsiderueshme shmang pasigurinë lidhur me përfundimet që do të nxjerr gjykata dhe sanksionin penal që do t’ia shqiptojë. Njëkohësisht, ai siguron zbatimin me kohë të sanksionit penale të shqiptuar ndaj tij.

b) Qëllimi i shqiptimit të dënimeve nga **gjykata** ndaj kryerësve të veprave penale nuk është vetëm punitiv. Me zhvillimin dhe evolvimin e të drejtës penale dhe drejtësisë penale, në sistemet juridike bashkëkohore si qëllim shumë i rëndësishëm i dënimit është edhe rehabilitimi i kryerësve të veprave penale. Hapi i parë dhe ndoshta më i rëndësishmi në procesin e rehabilitimit është pranimi i fajit nga kryerësi dhe gatishmëria e tij për të bartur përgjegjësinë për veprimet kriminale. Pranimi i fajësisë, si pjesë integrale e procesit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, paraqet një hap të rëndësishëm në procesin e rehabilitimit të kryerësit të veprës penale.

c) Lëshimet e bëra nga prokurori dhe i pandehuri mundësojnë aplikimin e masave korrektuese të cilat janë më të përshtatshme për të pandehurin se masat që

⁶⁵ American Bar Association, Commentary on Plea Bargaining, SHBA, 1968

gjykata mund të kishte shqiptuar në mënyrë të njëanshme. Si rezultat i kësaj, dënimi i caktuar mund të shërbejë më mirë për arritjen e objektivit të rehabilitimit dhe parandalimit të kryerjes së veprave penale në të ardhmen.

d) Bashkëpunimi i të pandehurit me organin e hetuesisë dhe atë të ndjekjes, kur një gjë e tillë është pjesë e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, paraqet ndihmesë shumë të madhe për këto organe në zbulimin dhe ndjekjen e kryerësve tjerë të veprës së njejtë apo më të rëndë penale.

Përkundër faktit se marrëveshja për pranimin e fajësisë është kritikuar nga disa juristë e akademikë të shquar, në SHBA dhe në disa vende tjera mbi nëntëdhjetë përqind e rasteve penale zgjidhen me anë të marrëveshjeve për pranim.

Nga kjo që u tha mund të themi se janë tre avantazhe të mëdha për arritjen marrëveshjes për pranimin e fajësisë:

- ajo mund të lehtësojë mbipopullimin e çështjeve penale nëpër gjykata për të mos pritur rradhën për gjykim dhe rastet e ngecjeve dhe parashkrimit të lëndëve;
- ajo është një mjet i dobishëm për ndjekje penale komplekse; dhe
- ajo mundëson shqiptimin e dënimeve më krijuese, individuale dhe ndoshta dënimeve të pa mbikqyruara (noncustodial).

2.4 Arsyet e zbatimit në favor të marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe prespektiva e marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Marrëveshja për pranimin e fajësisë në Evropën Lindore, por edhe në Kosovë përkundër të gjitha reformave të gjëra ligjore në fushën e drejtësisë penale, ende nuk ka gjetur zbatim të kënaqshëm sa për t'i liruar gjykatat nga numri i madh i çështjeve gjyqësore.

Perderisa dimë që nga praktika gjyqësore e SHBA nga 90 deri 95 % të rasteve i zgjidh më negocimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, dhe kjo funksionon edhe në shumë vende tjera të Evropës perendimore dhe të botës në përgjithësi, e ardhmja dhe instiucionalizimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë në Kosovë ka potencial për një sistem më efikas ligjor në të ardhmen.

Hapi i menjëhershëm në drejtëm të realizimit të suksesshëm të sistemit të bisedimeve për pranimin e fajësisë, përveç infrastrukturës së sistemit juridik të Kosovës, duhet të përfshijë krijimin e mekanizmave të kontrollit për të siguruar funksionimin e duhur të sistemit në të ardhmen.

Megjithatë, mospërputhjet potencialisht problematike që ekzistojnë në mes të institucionit të negocimimeve dhe marrëveshjes për pranimin e fajësisë, që rrjedhin nga tradita kundërshtuese e SHBA-së dhe tradita inkuizitore që ndiqet në Kosovë, numri i çështjeve penale që arrijnë marrëveshje për pranimin e fajësisë, që nga inkorporimi i këtij instiuti në legjislacionin tonë është në rritje e sipër.

Andaj arsyet dhe përgjigja në pyetjen se” Çka pritet nga marrëveshja për pranim të fajit?” janë përmbledhur si në vijim:

- Shkarkim të gjyqeve nga një pjesë e lëndëve ku palët do të arrijnë të merren vesh
- Për shkak se nuk ekziston kufizim sa i përket natyrës dhe peshës së veprave penale për të cilat është e lejuar marrëveshja për pranim të fajit, palët mund ta zbatojnë marrëveshjen për pranim të fajit çdoherë kur të vlerësojnë se ajo është në dobi të të dyja palëve;
- Gjykatësit do të kenë më shumë kohë t’u kushtojnë lëndëve komplekse penale me gjendje faktike të komplikuar, numër të madh dëshmish dhe autorësh e të ngjashme;
- Zvogëlim të shpenzimeve të procedurave gjyqësore për shkak se zvogëlohet në masë të konsiderueshme kohëzgjatja prej fillimit të procedurës penale deri në sjelljen e aktgjykimit;
- Rol proaktiv të palëve;
- Përfundim të procedurës në fazë më të hershme me sjellje të vendimit meritor;
- Rezultat të qartë përfundimtar i cili mbështetet mbi konsultime, biseda dhe kompromise në mes të palëve dhe mbrojtësit të cilat rezultojnë me nënshkrim të propozim- marrëveshjes për pranim të fajit;
- Aftësi të mbrojtësit për të vlerësuar se sa është e volitshme për klientin e tij që të shprehë gatishmëri për pranim të fajit, gjegjësisht të bëjë pranim të krimit para gjyqit, përkundrejt rezultatit përfundimtar të procedurës të cilën e përbëjnë veprimet e zakonshme procedurale nëpër statet e saja të ndryshme.

2.5 Rreziqet e mundëshme respektivisht vështirësitë praktike

Rreziqet e mundshme gjatë implementimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë në kornizën tonë ligjore dhe zbatimi i tij mund të na sjell:

- Korniza të gjera të sanksioneve të parapara në KP-së;

- Politika ndëshkuese e cila sillet rreth minimumit ligjor të paraparë të sanksioneve;
- Nevoja për ndryshime në KP sa i përket zbutjes së dënimeve në rast të procedurës për marrëveshje për pranim të fajit, gjegjësisht dhënies së deklaratës për pranim të krimit;
- Vështirësi për palët që të vlerësojnë nëse më shumë u konvenon marrëveshja për pranim të fajit apo procedura e rregullt penale;
- Praktika e pabarabartë gjyqësore në shqiptimin e sanksioneve penale për vepra të njëjta apo të ngjashme penale;
- Mosekzistimi i sanksionit të llogaritur mesatar për vepra të ndryshme kriminale sipas praktikës gjyqësore gjatë disa viteve të kaluara etj.

3. PËRFUNDIMET

Marrëveshjet për pranimin e fajësisë mund të ndihmoj vendet pas konfliktit për të menaxhuar më mirë sistemet e tyre të drejtësisë penale, duke evituar shtyrjen e çështjeve gjyqësore dhe në rënien e numrit të njerëzve në paraburgim.

- ❖ Megjithatë, politikëbërësit, avokatët, ligjvënësit dhe ofruesit e ndihmës ligjore duhet të kuptojnë se negociimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë është një ndryshim potencialisht kompleks i sistemit të drejtësisë penale dhe mund të kërkojë ndërrime serioze në kulturën ligjore.
- ❖ Marrëveshjet për pranimin e fajësisë mund t'i ngrisin problemet ekzistuese në sistemin e drejtësisë penale, të tilla si mungesa e qasjes në avokatët mbrojtës, korrupsion apo gjyqësor të politizuar. Për këtë arsye, negociimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk është një proces që të nxitojmë për ta miratuar, por është një reformë që duhet trajtuar kujdesshëm. Ky kujdes duhet të perqëndrohet në vlerësimin, qëllimet pas miratimit të bisedimeve për pranimin e fajësisë dhe gjendjen aktuale të kriminalitetit në sistemin konkret të drejtësisë.

- ❖ Shoqëria nuk është në gjendje të pranojë se individët të cilët janë të lidhur me krimet e rënda të tilla si terrorizmi të shpëtojnë me dënime më të lehta vetëm sepse kanë pranuar fajin për akuzat e vënë përpara.⁶⁶
- ❖ Hartuesit e politikave duhet gjithashtu të vlerësojnë qëndrimet e publikut ndaj sistemit të drejtësisë penale dhe si negocimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë mund të kontribuojë në ndërtimin e besimit në sistemin formal të drejtësisë.
- ❖ Në përfundim deklarimin e fajësisë shihet nga publiku i gjerë si promovimin e padrejtësisë sepse dënimi nuk është matur sipas seriozitetit të veprës penale – krimin por sipas aftësisë të kryerësit , që të jetë në gjendje për të negociuar dhe për të siguruar një dënim më të vogël me prokurorinë (Herzog, 2004).
- ❖ Shoqëria percepton Marrëveshjen për pranimin e fajësisë si sakrificë e kualitetit për kuantitetin dhe drejtësisë për efektivitetin administrativ.
- ❖ Në fund të fundit, marrëveshjet për pranimin e fajësisë mund të kontribuojnë në një sistem të fortë të drejtësisë penale dhe qasje më të mirë për drejtësi.

I. REFERENCAT

A. Libra, artikuj dhe punime të tjera

- Abraham Blumberg, “The Practice of Law as Confidence Game: Organizational Cooptation of a Profession”, 1 Law and Society Review 15, (1967).
- American Bar Association, Commentary on Plea Bargaining, SHBA,1968
- Andrew, Ashworth, Mike Redmayne, The Criminal Process, 2005, 3rd edition, Oxford University Press, kapitulli XII, theksuar sipas N. Garoupa/F.H. Stephen
- Bazuar në shkrimet e Profesorit Herrman, marrë nga Gunter Widmaier “Der strafprozessuale Vergleich”, (1982).
- Bennett L. Gershman, “Prosecutorial Ethics and Victims' Rights: The Prosecutor's Duty of Neutrality”, Pace Law Faculty Publications,(2005).

⁶⁶ <http://www.lawteacher.net/free-law-essays/judicial-law/what-is-plea-bargaining-purpose-it-serves-justice-problems-law-essay.php>

- Braha, Brulinda “Te drejtat themelore të të akuzuarit në legjislacionin penal shqipëtar dhe përçasja e tyre me parimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”; punim për mbrojtjete gradës shkencore Doktor, Tiranë, 2013.
- Buzharovska, Nanev, Misoski, Hulumtim krahasues i zgjidhjeve për përsheptim dhe thjeshtësim të procedurës penale, RMDPK, nr. 1/2008
- David A. Starkweather, “The Retributive Theory of "Just Desserts" and Victim Participation in Plea Bargaining”, *Indiana Law Journal*, Vol. 67, (1992).
- Erik Luna, “Bargaining in the shadow of the law-the relationship between plea bargaining and criminal code structure”, *Marquis Law Review*, (2007).
- F. Andrew Hessick III, Reshma M. Saujani, “Plea Bargaining and Convicting the Innocent: the Role of the Prosecutor, the Defense Counsel, and the Judge”, *B.Y.U. Journal of Public Law*, fq. 197 (2001-2002).
- Frank , Easterbrook, Criminal Procedure as a Market System, *Journal of Legal Studies*, 1983, 12, ctp. 289-332; Steven Shavell, *Foundation of Economic Analysis of Law*, Harvard University Press, 2004; Thomas Miceli, *The Economic Approach to Law*, Stanford University Press, 2004. N. Garoupa, F.H. Stephen
- G.M. Grossman, M.L. Katz, “Plea bargaining and social welfare”, *The American Economic Review* 73
- George Fisher, “Plea Bargaining’s Triumph: A History of Plea Bargaining in America”, *Stanford University Press* (2003).
- George Fisher, “Plea Bargaining’s Triumph: A History of Plea Bargaining in America”, *Stanford University Press*, (2003).
- Gordana, Buzharovska, Gordan, Kalajxhiev; Udhëzues për marrëveshjen për pranimin e fajësisë- Doracak për Profesionistët, fq 115 të verzionit 3 gjuhësh, viti 2011.
- Gjeçovi, Shtjefën, “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, Prishtinë, 2001.
- Hajdari, Azem “E drejta e procedurës penale”, Prishtinë, 2010.
- Hajdari, Azem “Efikasiteti procedural dhe të drejtat e njeriut në procedurën penale”, Prishtinë, 2011.
- Hajdari, Azem “Procedura penale-Komentar”, Prishtinë, 2010.
- Hajdari, Azem “Sistemi i drejtësisë për të mitur-Komentar”, Prishtinë, 2010.
- Hyseni, Bashkim, Shala, Afrim “Mbrojtja e detyruar me avokat në procedurën penale të Republikës së Kosovës”.

- Josephine Gittler, “Expanding the Role of the Victim in a Criminal Action: An Overview of Issues and Problems”, 11 Pepperdine Law Review (1984).
- Komentari i marrëveshjes për pranimin e fajësisë, Law Journal, SHBA. Komentari mund të gjendet në faqen e internetit: <http://www.jstor.org>
- Maloku, Etrur “Marrëveshja për pranimin e fajësisë”; punim diplome master, 2011, Prishtinë
- Mandro, Arta “Relativizmi” i lirisë së profesioneve të lira në funksion të një shërbimi “absolutisht” në të mirë të qytetarëve dhe në përputhje me ligjin: Zgjidhjet alternative të mosmarrëveshjeve: Ndërmjetësimi dhe Arbitrazhi”, Tiranë, Shqipëri, 2008.
- Mario Chiavario, “La riforma del processo penale”, (1990).
- Murati, Rexhep “Disa çështje mbi imunitetin penalo-procedural”, Revista “Përparimi” Prishtinë, 1991.
- Murati, Rexhep “Efikasiteti i procedurës penale dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të të pandehurit në procedurë penale”, 1996, nr 3, Prishtinë.
- Murati, Rexhep “Judicial criminal system in Kosovo and the protection of human rights and fundamental freedoms”, 8/12/2011.
- Murati, Rexhep “Main Characteristics of the Judicial Criminal System in Kosovo” Deccenium Moztanicense, Rijeka, 2008.
- Murati, Rexhep “Protection of Human Rights Under Kososvo’s Criminal Code and Criminal Procedure Code”, Chicago-Kent Law Review, Volume 80, Number 1, 2005.
- Murati, Rexhep “Rishikimi i procedurës penale për shkak të fakteve dhe provave të reja”, Universiteti i Prishtinës- Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2006, fq. 350.
- Murati, Rexhep “Some aspects of Human Rights and Freedoms Protection in Criminal Proceedings”, Prishtina, 2008.
- Murati, Rexhep, Sahiti, Ejup, Elshani, Xhevdet Komenntari Kodit të Procedurës Penale i Republikës së Kosovës”, Prishtinë, 2014.
- Nova, Koço “Procedura penale – Pjesa e përgjithshme, Tiranë 1966.
- Sahiti, Ejup “ Të drejtat dhe liritë e njeriut të vështruara nga aspekti procedural”, 1998.
- Sahiti, Ejup “Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurën penale”, Prishtinë, 1993.
- Sahiti, Ejup “E drejta e procedurës penale”, Prishtinë, 1984, 1988; 2005.
- Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep “E drejta e procedurës penale”, Prishtinë,

2013.

- Stephen J. Schulhofer, Plea Bargaining as Disaster, Yale Law Journal, 1992, 101, стр. 1979- 2009. Russell Christopher, The Prosecutors's Dilemma: Bargains and Punishment, Fordham Law Review, 2003
- Tim H. Arendt, "Human condition", (1958).
- Tulkens van de Kerchove, La Justice Pénale, во European Criminal Procedures, (ed. Delmans-Marty/Spencer), Cambridge University Press, 2002

B. Akte juridike dhe tekste ligjore

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila hyri në fuqi me 15 qershor 2008.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 28 nëntor 1998.
- Kodi Penal i Kosovës, Kodi nr. 04/L-082, G.Z., Nr.19/2012, dhe Nr. 30/2012.
- Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Kodi nr. 04/L-123, G.Z., Nr.37/2012.
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, LIGJ Nr.7895, datë 27.1.1995, i përditësuar.
- Kodi i Procedurës Penale të Shqipërisë, LIGJ Nr.7905, datë 21.3.1995, i përditësuar në tetor 2004.
- Udhëzues i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Prishtinë, 2013.
- Kodi i Drejtësisë për të mitur, Kodi nr. 03/L-193, G.Z. Nr. 78/2010.
- "Udhëzimet mbi marrëveshjet për pranimin e fajësisë", Zyra e kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës dhe Zyra e kryeprokurorit të EULEX-it.
- Ligji për Prokurorinë e shtetit, Ligji Nr.03/L-223, G.Z. Nr.83/2010.
- Ligji nr.03/L-003 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, nr.2003/26, i datës 06.11.2008.
- Ligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale. Ligji nr. 04/L-31.
- Ligji për Ndërmjetësim i Republikës së Kosovës, ligji nr. 03/L-057.
- Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve. Ligji nr. 04/L- 015.
- " Kodi I Procedures Penale të Republikës së Shqipërisë", ligji nr.7905, date 21.03.1995
- Ligji nr. 8813, datë 13.06.2002 "Për disa shtesa dhe ndryshime me ligjin nr.7905, date 21.03.1995

- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Serbisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë, Ligji No. 46/2006, Beograd 2006
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Serbisë, Beograd 2011
- Ligji i Procedurës Penale të Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare No. 15/2005 dhe Ndryshimet nga viti 2008 dhe 2009, Shkup 2009
- Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Neni III, Paragrafi 2[3].
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës Federale të Gjermanisë, Gazeta Zyrtare Federale e Republikës Federale të Gjermanisë, Berlin 2009
- Kushtetuta e Italisë
- Kodit të Procedurës Penale të Italisë të vitit 1988
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Francës, Seksioni VIII, Neni 495-7.
- Les chiffres-clés de la Justice, Ministria e Drejtësisë e Francës, Tetor 2006.
- Kodi i Procedurës Penale të Tajvanit, nenet 455-2 deri 11.
- Margaret K. Lewis “Sistemi i Ri Kundërshtues i Tajvanit dhe Sfida e Neglizhuar për Reforma Drejtuar Efikasiteti” 49 Zhurnali i Virgjinitas për Ligjin Ndërkombëtar 651 (2008-2009).
- JE Ross (2006), "The Entrenched Position of Plea Bargaining in United States Legal Practice", The American Journal of Comparative Law (The American Journal of Comparative Law) 54: 717–732, JSTOR 20454559.
- Marco Fabri, “Theory Versus Practice of Italian Criminal Justice Reform”, 77 Judicature 211, 213 n.4 (1994).
- Timothy Sandefur, In Defence of Plea Bargaining, Regulation, 2003, Vol. 26, No. 3, pp. 28-31.
6 Recommendation No. R (87) 18 concerning the simplification of criminal justice.
- Timothy Lynch, The Case Against Plea Bargaining, Regulation, 2003, Vol. 26, No. 3, fq. 24-27.
- Abraham S. Goldstein, “Converging Criminal Justice Systems: Guilty Pleas and the Public Interest”, 31 Israeli Law Review, (1997).
- Joachim Herrman, “Bargaining Justice - A Bargain for German Criminal Justice?”, 53 University of Pittsburgh Law Review, (1991-1992)
- Joachim Herrman, “The Rule of Compulsory Prosecution and the Scope of Prosecutorial Discretion in Germany”, 41 University of Chicago Law Review, (1974).

C. Dokumente ndërkombëtare

- Deklarata e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut e vitit 1948 (*Universal Declaration on Human Rights, G.A.res 217 A(III), U.N. Doc A/810 at 71*).
- Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut e vitit 1950, me protokollet shtesë (*European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms, (ETS No. 5), 213 U.N.S. 222, entered into force Sept. 3.1953, as amended by Protocols No 3,5,8, i 11 wick entered into force on 21 September 1970, 20 December 1971, 1 January 1990, and 1 November 1998 respectively*).
- Karta e gjelbër – Mbrojtja e të dyshuarve dhe e të pandehurve në procedurat penale të Bashkimit Europian (*Green Paper from the Commission: Procedural Safeguards for Suspects and Defendants in Criminal Proceedings throughout the European Union, Brussels, 19. II. 2003 COM (2003)75 final*).
- Propozimi i Garancive të Përbashkëta Minimale Procedurale (*Proposal for A Council Framework Decision on Certain Procedural Rights in Criminal Proceedings throughout the European Union, COM (2004) 328 final*).

D. Burime nga interneti

- http://en.wikipedia.org/wiki/Plea_bargain
- http://en.wikipedia.org/wiki/Plea_bargaining_in_the_United_States#History_and_constitutionality.
- <http://legal-dictionary.thefreedictionary.com/Plea+Bargaining>
- http://www.americanbar.org/groups/public_education/resources/law_related_education_network/how_courts_work/pleabargaining.html
- http://chicagounbound.uchicago.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1987&context=journal_articleshttps://www.bja.gov/Publications/PleaBargainingResearchSummary.pdf
- <http://monderlaw.com/guilty-plea/>
- <http://criminal.findlaw.com/criminal-procedure/plea-bargain.html>
- <http://criminal.findlaw.com/criminal-procedure/plea-bargaining-areas-of-negotiation.html#sthash.xyk17ëKT.dpuf>
- <http://www.jstor.org>

Krahasimi i ligjeve per azil kerkim ne Shqiperi dhe Kosove.

Eldisa Cirogu
La Sapienza , phd ne Studime Politike
Rome,
Itali,
Rigert Cirogu ,
La Sapienza , Rome, Itali,

Abstrakti:

Migrimi është një proces dhe fenomen që fillon dhe ka përcaktuar më së shumti historinë e njerëzimit dhe mënyrën e zhvillimit të tij. Fenomeni i migrimit është sot e kësaj dite në programet politike të pjesës dërrmuese të forcave e lëvizjeve politike në të gjitha vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim . Legjislacioni ndërkombëtar mbi migrimin dhe azilin përbën në ditët tona një nga fushat më të zhvilluara të së drejtës ndërkombëtare.

Për të arritur këto standarte Shqipëria ka bërë shumë hapa përpara. Një listë veprimesh e aktesh që duheshin ndërmarrë, është filluar me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me BE të vitit 2003. Në këtë marrëveshje parashikohen 8 prioritete (fusha me përparësi) e një nga këto është edhe azili dhe migrimi.

Ky punim ka pikerisht si synim te analizoje se si Shqiperia dhe Kosova jane përshatur nga ana legjislative, normativave te Bashkimit European per te ofruar një tutelë sipas standarteve ndërkombëtare.

Fjalët e rëndësishme: migrimi, azil kerkues, risia legjislative, Kosove, Shqiperi,

1. Hyrja

Migrimi si proces i përhershëm i lëvizjes së njerëzve si dhe rritja e vazhdueshme e numrit të migrantëve dhe problemet që ndërlidhen me këtë, ka ndikuar që migrimi të gjendet në qendër të vëmendjes në shumë shtete të botës. Pothuajse të gjitha vendet, pa dallim, ballafaqohen me sfida që ndërlidhen me migrimin, qofshin si vende të origjinës, transitit apo vende të destinacionit përfundimtar. Kjo bëhet edhe më aktuale në ditët e sotme, posaçërisht duke pasur parasysh faktin se përafërsisht, vlerësohet se në ditët e sotme jetojnë diku rreth 214 milion njerëz jashtë vendit të vendlindjes së tyre ose 3% e numrit të përgjithshëm të njerëzimit, dhe se ky numër ka pësuar rritje enorme, veçanërisht në 20 vitet e fundit. Gjatë periudhës së viteve 1965-1990, numri i migrantëve, ndërkombëtarisht është rritur për 45 milion, me një shkallë rritje prej 2.1% për vit, përderisa shkalla e tanishme e rritjes është 2.9% në vit. Po ashtu, numri i përgjithshëm i migrantëve në nivel global, ka pësuar rritje këto vitet e fundit, nga diku rreth 150 milion në vitin 2000, në 214 milion në kohët e sotme, që i bie se çdo i 33 njeri sot është migrant (përderisa në vitin 2000, ka qenë çdo i 35)

E drejta e migracionit në vendin tonë, në formë të shkruar, daton që me Statutet e Shkodrës, të përditësuara deri në vitin 1469 e pikërisht me nenin 1, të këtyre Statuteve, ku parashikohet barazia e të huajve me qytetarët e komunës së Shkodrës⁶⁷.

Lidhja e fortë e kësaj të drejte me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, janë të shprehura e të rrënjësura në zakonet e popullit shqiptar shumë më përpara se sa të shfaqeshin në dokumentet e njohura ndërkombëtarisht si fillesat e të drejtave të njeriut.

Migrimi përmban si element largimin, i cili është një term i përgjithshëm që përfshin çdo lloj forme lëvizjeje për çfarëdolloj shkak. Disa njerëz largohen nga vendi i tyre si migrantë jovullnetarë, sepse janë viktimat e politikës – përfshirë këtu dhunimin e të drejtave të njeriut, luftërave ose katastrofave në shkallë të gjerë. Këta janë refugjatë. Mund të them pra që çdo refugjat është një migrant, por jo çdo migrant është një refugjat.

⁶⁷ Aty thuhet:

“Mbi lirinë e të huajve për të ardhur dhe për t’u vendosur në qytetin tonë

Nëse ndokush do të dëshironte të vendosej në qytetin tonë, qoftë ky njeri i Mbretit apo i ndonjë fisniku, ai duhet t’i shërbejë vetëm Komunës sonë dhe askujt tjetër. Qytetari ynë, apo sllavi ose arbëreshi, që do të përpiqeshin ta kapnin e ta bënë pronë të tyre, do të detyroheshin t’i paguanin 50 perperë mbretit, ndërsa robin duhet ta lenë të lirë. Çdo qytetar i Komunës sonë duhet ta mbrojë atë me çdo kusht.”

Refugjatët largohen nga vendi i tyre, nuk kanë më mbrojtjen e këtij vendi dhe si rrjedhim përftojnë mbrojtjen e bashkësisë ndërkombëtare të ushtruar në territorin e vendit ku njihen si refugjatë.

2. Hipoteza

Historikisht, shtetet kanë vendosur vetë ose në marrëveshje mes tyre për trajtimin e refugjatëve në shkallë të gjerë. Aktet e para ndërkombëtare në këtë fushë i përkasin fillimit të viteve 30 të shekullit të kaluar, mbi të gjitha me Kushtetutën e Organizatës Ndërkombëtare të Refugjatëve. Pas Luftës së Dytë Botërore, akti kryesor universal për refugjatët njihet si Konventa e vitit 1981 në lidhje me Statusin e Refugjatëve. Republika e Shqipërisë e ka ratifikuar këtë Konventë në vitin 1992.⁶⁸

Standartet në trajtimin e refugjatëve njohën një nivel të ri pas krijimit të Bashkimit European, bashkim i cili ka synuar dhe synon krijimin e një hapësire me standartet më të larta në fushën e mbrojtjes dhe realizimit të të drejtave të njeriut.

Me ndryshimin e sistemit Shqipëria hyri në rrugën e përpjekjeve të përshtatur, arritur dhe zbatuar standartet ndërkombëtare në shumë fusha, përfshirë këtu atë të ofrimit të mbrojtjes ndërkombëtare dhe trajtimit të refugjatëve. Pas nënshkrimit të Konventës së Refugjatëve, Shqipëria zhvilloi një kuadër ligjor dhe një sistem azili për këtë qëllim.

Ky studim synon të vertetojë që Shqipëria ka bërë hapa përpara në fushën e azilit dhe migrimit, pavarësisht se është një vend në zhvillim, ndërgjegjësimi për rritjen e rolit të Shqipërisë si vend që jo vetëm prodhon por edhe pret migrantët anëmbanë botës, duke përfshirë edhe refugjatët mestyre, është një plus shumë i rëndësishëm për arritjen e synimeve të Shqipërisë në rrugën e saj të integritimit.

⁶⁸ Ashtu si shumica e akteve të tjera ndërkombëtare, kjo Konventë ka përcaktuar standartet minimale për trajtimin e tyre duke lënë të hapur mundësinë për një trajtim më të favorshëm nga shtetet që e kanë këtë mundësi.

3. Metodologjia

Si hap i parë metodologjik shqyrtimi i legjislacionit në këtë fushë, i cili ka qenë i bollshëm dhe lëhtësisht i gjetshëm.

Si hap i dytë, ka qenë shqyrtimi i pjesës tjetër të literaturës së studiuar me qëllim nxjerrjen edhe të opinioneve të ndryshme të aktorëve të përfshirë në këtë fushë qoftë nga Shteti Shqiptar qoftë nga organizatat ndërkombëtare, veçanërisht UNHCR, si edhe dokumenteve të BE për këtë qëllim.

Po kështu, si një hap i tretë metodologjik ka qenë kontakti me organizata si UNHCR, IOM, RMSA, si edhe kontakti me zyrtarët e policisë kufitare

4. Historiku i Legjislacionit ndërkombëtar mbi azilin dhe migrimin

Legjislacioni ndërkombëtar mbi migrimin dhe azilin përbën në ditët tona një nga fushat më të zhvilluara të së drejtës ndërkombëtare. Kjo ka ardhur si rezultat i pranimit të fenomenit të migrimit si një fenomen i pashmangshëm, që ndodh për arsye nga më të ndryshmet por mbetet gjithsesi tipar i sjelljes njerëzore.

Rregullimi ndërkombëtar i procesit të migrimit, ka nisur me traktate e marrëveshje dypalëshe mes shteteve për të arritur sot në një tërësi konventash ndërkombëtare⁶⁹.

-mbi refugjatët

- a. Konventa e vitit 1951 në lidhje me statusin e refugjatëve.
- b. Protokollin e vitit 1967 ndaj Konventës së vitit 1951 në lidhje me statusin e refugjatëve.
- c. Statuti i UNHCR (Zyrës së Komisionerit të Lartë të OKB për Refugjatët).
- d. Parimet udhëheqëse mbi personat e shpërngulur brenda vendit.
- e. (pjesërisht) Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore e vitit 1950.
- f. Deklarata Universale e të drejtave të Njeriut.
- g. (pjesërisht) Pakti Ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike, 1966.

⁶⁹ Glossary on Migration (Fjalorth mbi Migrimin), IOM (Organizata Ndërkombëtare për Migrimin),

- h. (pjesërisht) Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore.
- i. (pjesërisht) Konventa e OKB mbi të Drejtat e fëmijës, 1989

-mbi emigrantët

- a. Konventa Ndërkombëtare për mbrojtjen e të Drejtave të Punonjësve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre, 1990.
- b. Protokollin e OKB kundër Kontrabandimit të Migrantëve nga deti, toka dhe ajri, që shton Konventën e OKB kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, 2000.
- c. (pjesërisht) Pakti Ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike, 1966.
- d. (pjesërisht) Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore.

Në regjimin ndërkombëtar të mbrojtjes së refugjatëve, pozicionin qendror e ka Konventa⁷⁰ e vitit 1951 dhe Protokollin e saj i vitit 1967⁷¹. Konventa e vitit 1951 ka karakter gati "kushtetues". Ajo formulon rregulla me vlefshmëri objektive, të shoqëruara nga detyrime të pandashme.

Konventa e vitit 1951 dhe Protokollin e saj i vitit 1967 janë të vetmet dokumenta universale dhe shprehja më e qartë e solidaritetit ndërkombëtar për mbrojtjen e refugjatëve. Dispozitat e Konventës mbeten standarti që përdoret për të gjykuar çdo masë për mbrojtjen dhe trajtimin e refugjatëve. Dispozita e saj më e rëndësishme, parimi i moskthimit mbrapsht i parashikuar në Nenin 33, është guri themeltar i regjimit ndërkombëtar të mbrojtjes së refugjatëve.

Në vendet që nuk kanë pranuar asnjë dokument ndërkombëtar për refugjatët, baza më e paktë e mbrojtjes së refugjatëve është Statuti i UNHCR-së në mënyrën që ai është zhvilluar me kalimin e kohës. Si agjenci e OKB e ngarkuar me zbatimin apo mbikëqyrjen e zbatimit të Konventës së vitit 1951 dhe në përgjithësi të të drejtave të refugjatëve, UNHCR ka ndërmarrë një numër veprimtarish për të përcaktuar dhe për të forcuar lidhjet midis të drejtës ndërkombëtare për refugjatët dhe të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në mënyrë që secila të mund të përdoret më mirë për mbrojtjen e refugjatëve.

⁷⁰ Konventa është një dokument shumëpalësh i përvijimit të standarteve me një zbatim gati të përgjithshëm, që krijon një regjim të veçantë ligjor ndërkombëtar për personat që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare. Ai është një dokument me karakter të përgjithshëm që, nga vetë natyra e tij, kërkon zbatimin e dispozitave të tij në tërësinë e tyre midis të gjitha palëve kontraktuese. Ky në të vërtetë është një kusht thelbësor që secila palë të japë pëlqimin që traktati të jetë detyrues për ta.

⁷¹ Objekti dhe qëllimi kryesor i Konventës së vitit 1951 së bashku me Protokollin e saj të vitit 1967 ishte në fakt krijimi i një regjimi për mbrojtjen e refugjatëve në bazë të së drejtës ndërkombëtare, që ishte universal në zbatueshmërinë e tij dhe jodiskriminues në zbatimin e tij.

Një burim tjetër i legjislacionit janë normat dhe parimet e të drejtës ndërkombëtare të zbatueshme në lidhje me refugjatët të cilët u drejtohen të gjitha shteteve, pavarësisht nga pranimi i dokumenteve ndërkombëtare⁷².

5. Nocione të rëndësishme

- Refugjati

Sipas Konventës së vitit 1951 në lidhje me statusin e refugjatëve, refugjat është çdo person që për shkak të një frike të bazuar se mos përndiqet për shkak të racës, fesë, shtetësisë, përkatësisë në një grup të caktuar shoqëror apo mendimit politik, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së tij/saj dhe nuk është në gjendje, ose për shkak të kësaj frike, nuk dëshiron të përfitojë nga mbrojtja e atij vend

Këto elementë i quajmë elementë të përfshirjes:

1. frika e bazuar
2. përndjekja (se mos përndiqet)
3. arsyet e dhëna në përkufizimin e konventës (për shkak të racës, fesë, shtetësisë, përkatësisë në një grup të caktuar shoqëror apo mendimit politik),
4. qenia jashtë vendit të origjinës (ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së tij/saj;
5. mungesa e mbrojtjes shtetërore (nuk është në gjendje, ose për shkak të kësaj frike, nuk dëshiron të përfitojë nga mbrojtja e atij vendi).

-Azilkërkuesit⁷³

Nënkategoria e azilkërkuesve është përdorur nga Asambleja e Përgjithshme që nga viti 1981 në rezoluta të përgjithshme, që lidhen me UNCHR. Termi mund t'i referohet ose një individi statusi prej refugjati i të cilit nuk është përcaktuar ende nga autoritetet, por kërkesa e të cilit për strehim i jep atij/asaj të drejtë të gëzojë njëfarë statusi mbrojtës në bazë të asaj se ai/ajo mund të jetë refugjat/refugjate, ose mund t'u referohet dyndjeve masive grupesh të përziera në një situatë kur përcaktimi individual i statusit të refugjatit është jopraktik. Rastet mund të jenë :

⁷² Për shembull, normat e të drejtës zakonore ndërkombëtare në lidhje për mbrojtjen e refugjatëve siç është parimi i non-refoulement (moskthimit mbrapsht). Parimi i moskthimit i ndalon shtetet që të kthejnë mbrapa, të dëbojnë ose ekstradojnë një person të caktuar në territoret ose shtetet ku ka dyshime të bazuara se atij i kërcënohet seriozisht jeta ose liria, për shkak të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose për shkak të bindjeve të tij politike.

⁷³ Historikisht ky koncept ka qenë i lidhur ngushtë me Përfundimin nr. 22 të Komitetit Ekzekutiv, miratuar nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 36/125

6. Analizë e kuadrit ligjor në Shqipëri

Sistemi shqiptar i azilit i ka fillimet e veta që me nënshkrimin dhe ratifikimin e Konventës së vitit 1951 nga Republika e Shqipërisë në vitin 1992. disa dispozita paraprake që hapën rrugën për zhvillimin e mëvonshëm të këtij sistemi u parashikuar edhe në Ligjin për Migracionin të vitit 1995. Zhvillimet e mëvonshme në Ballkan – veçanërisht lufta në ish Jugosllavi, pozita gjeografike e Shqipërisë si një pikë e rëndësishme për kalimin tranzit të të huajve për në vendet e Bashkimit Europian dhe nevojat e ngritjes dhe zgjerimit të legjislacionit shqiptar në nivelet e kërkuara nga BE bënë që në bashkëpunim me UNHCR, Shqipëria të miratonte të 14 dhjetor 1998 një ligj të posaçëm për azilin⁷⁴.

Veprimtria konkrete me refugjatët dhe vënia në jetë dhe në provë e këtij ligji, patën kulmin e vet nga pranvera e vitit 1999 kur Shqipëria hapi dyert për afro gjysëm milion njerëz të larguar nga Kosova si pasojë e genocidit serb. Me largimin e shumicës së refugjatëve nga Kosova, vëmendja u drejtua tek procesi i integritit të refugjatëve dhe personave të tjerë që gëzonin azil në R. Sh. çka solli edhe nevojën e rregullimeve të mëtejshme ligjore në këtë fushë. Bashkë me marrjen përsipër të më shumë kompetencave dhe detyrave në këtë fushë nga Qeveria Shqiptare, u arrit ndërtimi i kapaciteve administrative, akomoduese dhe shërbimeve të tjera në këtë kuadër, bazuar edhe në ligjin nr. 9098, miratuar në vitin 2003, për Integrimin dhe bashkimin Familjar të personave që kanë përfituar azil në R. Sh.

Modifikimi i fundit bërë në këtë sektor daton me Ligjin Nr. 121/2014” PËR AZILIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”.

Ligji ka për qëllim parashikimin e kushteve e të procedurave për dhenien dhe heqjen e azilit në Republikën e Shqipërisë të drejtat dhe detyrimet e refugjatëve dhe të personave në mbrojtje të perkohshme e plotësuese përmbajtjen e statusit të refugjatit të drejtën e tyre për bashkim familjar si dhe parashikimin e kushteve për integrimin e refugjatëve e të personave në mbrojtje plotësuese në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu ndër risite e projektligjit është edhe Perjashtimi nga moskthimi në rastet kur ka arsye për ta konsideruar si një rrezik për sigurinë e Republikës së Shqipërisë ose është denuar me një vendim të formës së prera për kryerjen e një

⁷⁴ Ligji Nr. 8432, dt. 14. 12.1998, ndryshuar me Ligjin Nr. 10060 të vitit 2009

krimi te rende per te cilin parashikohet nje denim minimal prej 7 vjetesh me heqje lirie.

Një përmbledhje të akteve ligjore që veprojnë në R. Sh dhe kanë impaktin e tyre në fushën e azilit:

- a) Kushtetuta e RSH. Neni 40 parashikon se të huajt kanë të drejtën e strehimit në RSH sipas ligjit.
- b) Ligji për Azilin i vitit 1998, i ndryshuar në vitin 2009 dhe ne 2014
- c) Ligji për Integrimin dhe Bashkimin Familjar të personave që kanë përfituar azil në R. Sh.
- d) Ligji për të Huajt (miratuar në vitin 1999 dhe ndryshuar apo kaluar si ligj i ri në vitin 2008 dhe 2013).
- e) VKM për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në RSH;

dhe një sërë aktesh të tjera ligjore e administrative.

Nga ana e zbatimit praktik dhe arritjeve konkrete,

- a) ka nën administrimin e vet që prej vitit 2004 një qendër pritje për azilkërkuesit në nivelin e kërkuar të standarteve ndërkombëtare;
 - b) vendosjen e një sistemi të përzgjedhjes të zbatuar nga policia kufitare e RSH;
 - c) miratimin e VKM përkatëse dhe përfshirjen e gjithë të huajve që kërkojnë apo përfitojnë azil në RSH në skemën e sigurimeve shëndetësore dhe të ofrimit të shërbimeve shëndetësore si për shtetasit shqiptarë.caktuar, qoftë edhe nëse ardhja e tyre ka qenë spontane apo e ndihmuar nga një program evakuimi.
- Më poshtë jepen në mënyrë skematike kërkesat apo elementët që duhet të përmbushen që të jepet statusi i refugjatit krahasuar me ato që duhet të përmbushen që të jepet mbrojtje plotësuese.

Ligji ngre Komisionin Kombetar per azilin dhe refugjatet si autoritet i vetem kompetente vendimmarres mbi ankimimet kunder vendimeve te institucioneve qe japin azil Ai ploteson statusin e mbrojtjes plotesuese i cili eshte pothuaj i barabarte me ate te refugjatit ,zgjeron statusin e mbrojtjes se perkohshme duke percaktuar afatet procedurat Ai parashikon detyrimin per regjistrim te shtetasve ne regjistrin e Gjendjes civile, parashikon perjashtimin nga moskthimi kur shtetasi perben rrezik per Republikën e Shqiperise ose kur eshte denuar 7 vjet minimalisht.

Ligji parashikon gjithashtu statusin e mbrojtjes plotesuese i cili eshte status pothuajse i barabarte me ate te refugjatit Nga ana tjetër ligji zgjeron trajtimin e mbrojtjes se perkohshme duke percaktuar afatin e kesaj mbrojtjeje rrethanat per refuzimin perfundimin si dhe kufizimin e saj ne kushte te caktuara, ligji percakton edhe rrethanat ose kriteret perjashtimin e personit ne mbrojtje te perkohshme nga ushtrimi i te drejtes se azilkerkuesit gjate kohes kur ky ka aplikuar per azil dhe gjithashtu parashikon detyrimin per regjistrim ne regjistrin kombetar te gjendjes civile dhe regjistrin e administruar nga autoriteti pergjegjes per azilin dhe refugjatet azilkerkuesve refugjateve dhe personave ne mbrojtje.

Ligji parashikon perjashtimin nga parimi nderkombetar i moskthimit ne rastet kur konsiderohet rrezik per sigurine e Republikes se Shqiperise ose kur personi eshte i denuar me nje vendim te formes se prere per vepra penale minimumi i denimit per te cilat eshte 7 vjet. Gjithashtu ligji per te garantuar siguri dhe regjim te ngurte per personat qe perfitojne status parashikon kufizimin e lirise se levizjes se azilkerkuesit ne territorin e Republikes se Shqiperise Dhe gjithashtu trajton ne menyre te detajuar praktiken dokumentare dhe proceduren qe con Republika e Shqiperise per azilkerkuesit refugjatet dhe personat ne mbrojtje. Ne pligj jane futur per here te pare nocione te reja si vendi i trete i sigurt azilkerkues i mitur i pashoqeruar e keshtu me radhe.

Dhe sigurisht praktika tashme e konsoliduar nderkombetare per refuzimin e azilit si rrjedhoje e ardhjes se shtetasit nga nje vend i trete i sigurt duke perfshire edhe trajtimin e vecante te te miturve te pashoqeruar qe kerkojne azil dhe zbatimin e parimit te interesit me te larte te femijes. Keto pak a shume jane aspektet kryesore te ligjit te ri per azilin ne Republiken e Shqiperise.

7. Analizë e kuadrit ligjor në Kosovë

Kuadrit ligjor në Kosovë në sektorin e azilit eshte rrjedhoje e misionit të “STRATEGJISE SHTETËRORE PËR MIGRIM DHE PLANI I VEPRIMIT 2013-2018”, me te cilin synohet :

- parandalimi dhe luftimi i migrimit të parregullt;
- përmirësimi i menaxhimit të migrimit ligjor dhe qarkullues;
- transformimi dhe zhvillimi i migracionit në faktor pozitiv ekonomik

Numri i përgjithshëm i migrantëve në nivel global ka pësuar rritje këto vitet e fundit.

Kjo rritje është ndjerë edhe në Ballkanin Perëndimorë dhe Republikën e Kosovës si pjesë e Ballkanit Perëndimor, ku ka pasur rritje të konsiderueshme të migrantëve të parregullt, dhe atë kryesisht nga vendet si: Afganistani, Pakistani, Bangladeshi, Algjeria, Maroku, Kongo, Siria, etj. Kjo rritje sipas këtij raporti vjen kryesisht përmes Turqisë në Greqi dhe pastaj nga Greqia në Shqipëri apo Maqedoni ku vazhdohet për në vendet tjera, duke përfshirë edhe Republikën e Kosovës.

Bazuar në të gjitha këto, Republika e Kosovës ka ndërmarrë një varg masash me qëllim të menaxhimit sa më efikas të migrimit si dhe zvogëlimit dhe parandalimit të efekteve negative që burojnë posaçërisht nga migrimi i parregullt. Në këtë aspekt, Republika e Kosovës ka hartuar dhe miratuar një varg ligjesh dhe akte nënligjore, dokumente strategjike dhe dokumente tjera. Në mesin e këtyre vlen të veçohen, Ligji për Azilin, Ligji për të Huajt, Ligji për Kontrollin e Kufirit, Ligji për Shtetësinë e Kosovës, Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, Strategjinë për Luftimin e Trafikimit me Njerëz, si dhe janë plotësuar dhe ndryshuar një numër i ligjeve përfshirë këto që u përmendën më lartë, si dhe disa ligjeve të reja, ku vlen të përmendet Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit.

Po le te ndalemi tek Ligji për Azil :

Ky ligj rregullon dhënien e azilit dhe njohjen e statusit të refugjatit, dhënien e statusit të mbrojtjes plotësuese apo të përkohshme, personave që kanë nevojë si dhe kthimin e tyre në vendin e origjinës, të prejardhjes ose në një vend të tretë.

Miratimi i procedurave të qarta për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave për azil është vendimtare për menaxhimin efektiv të flukseve migratore të përziera. Në këtë aspekt, Kosova siguron qasje në procedurat e drejta të azilit për të huajt që kërkojnë mbrojtje në territorin e saj, në përputhje me standardet ndërkombëtare të vendosura nga Konventa e Gjenevës 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve dhe Protokollit të saj të vitit 1967, si dhe direktivat përkatëse të BE-së.

Sipas legjislacionit vendor për azil, statusi refugjatit i jepet përmes procedurës së përcaktimit individual, e cila përbëhet nga një vlerësim i plotë në bazë të meritave të kërkesës. Ligji gjithashtu parashikon mbrojtje të përkohshme që do të jepet për grupet e njerëzve në rastet e flukseve masive të huajve të cilët janë të detyruar të largohen nga vendet e tyre të origjinës. Në mënyrë të ngjashme, mbrojtja plotësuese duhet të jepet personave të cilët nuk i plotësojnë kriteret për statusin e refugjatit, por për të cilët kthimi në vendin e origjinës nuk është i

mundur pasi ata mund të jenë të ekspozuar ndaj torturës apo trajtime të tjera jo-njerëzore dhe degraduese.

Qendra për Azilkërkues është funksionale, me kapacitet për të akomoduar deri në 50 azilkërkues. Qendra për Azilkërkues organizon akomodimin, kontrollin mjekësor, ndihmën mjekësore dhe sociale të personave të cilët kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare. Qendra është e tipit të hapur që nënkupton se azilkërkuesit e akomoduar janë të lirë të lëvizin duke respektuar rregullat e brendshme të Qendrës.

8. Konkluzioni

Risite kryesore të ketyre ligjeve kanë si synim përafrimit të legjislacionit të Kosovë dhe Shqipërisë me legjislacionin e BE-se. Keto dy shtete janë te vendosura për zhvillimin dhe fuqizimin e politikave dhe praktikave të azilit lidhur me përcaktimin e statusit të refugjatit dhe mbrojtjen e personave në nevojë, në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe të drejtën ndërkombëtare. Për rrjedhojë, koordinimi ndërmjet institucioneve që merren me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të të huajve që kërkojnë mbrojtje në Kosovë është esencial.

Kosova dhe Shqipëria kanë bërë harmonizimin e legjislacionit të azilit me legjislacionin e BE-së. Përbushja e kriterëve lidhet pikërisht me forcimin e bashkëpunimit me Zyrën Evropiane për Mbështetje të Azilit (EASO). Në këtë kuadër të dyja shtetet kanë filluar bashkëpunimi me EASO-në duke shkëmbyer pyetësorin standard për gjendjen e migrimit dhe azilit.

Bibliografi

1-Konventa e Gjenevës” Mbi statusin e Refugjatit”, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 28 korrik e vitit 1951, hyrë në fuqi më 22 prill 1954 dhe Protokollit të New York-ut, 4 tetor 1967, miratuar me Dekretin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, nr. 200, datë 03.06.1992

2- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

3-Ligji nr. 8432, datë 14.12.1998” Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 10060, datë 26.01.2009” Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8432, datë 14.12.1998,” Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

4- Ligji nr. 8942, datë 19.09.2002” Për ratifikimin e Konventës Europiane për Shtetësinë”

5-Glossary on Migration (Fjalorth mbi Migrimin), IOM (Organizata Ndërkombëtare për Migrimin).

6- Manuali i UNHCR për procedurat e përcaktimit të Statusit të refugjatit, botim i vitit 1992.

7- LIGI Nr. 121/2014 “PËR AZILIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

8- LIGJI NR. 04/L-217 PËR AZIL NE REPUBLIKËN E KOSOVËS / Nr. 32 / 30 GUSHT 2013, PRISHTINË

SISTEMI I DREJTËSISË PËR TË MITUR NË KOSOVË

Rastet e paraqitura të delikuencës së të miturve, me një vështrim të posaçëm në Qendrën Korrektuese në Lipjan, gjatë viteve 2010 – 2015

Egzona Morina (LLM)
Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Republika e Kosovës,

Abstrakt

Punimi “Sistemi i Drejtësisë për të Mitur në Kosovë - Rastet e paraqitura të delikuencës së të miturve, me një vështrim të posaçëm në Qendrën Korrektuese në Lipjan, gjatë viteve 2010 – 2015”, në vijim do të trajtoj konceptin e Drejtësisë për të Mitur, karakteristikat, rolin dhe rëndësinë e saj. Po ashtu, me anë të këtij punimi, në koordinim me institucionet përgjegjëse, ligjet dhe rregullativën tjetër juridike do të sjellë një këndvështrim më ndryshe mbi Sistemin e Drejtësisë për të Mitur në Republikën e Kosovës, duke ofruar statistika të sakta lidhur me rastet e paraqitura të delikuencës së të miturve me një vështrim të posaçëm në Qendrën Korrektuese në Lipjan, ku do të pasqyrohet prezenca reale e të miturve në këtë Qendër. Interesimi im drejtuar mbi këtë çështje është një përpjekje për ta analizuar situatën aktuale të të miturve në konflikt me ligjin, me anë të statistikave të sakta, sipas evidencave të këtij institucioni për periudhën kohore 2010 – 2015, me qëllim, krijimin e një tabloje të qartë të kriminalitetit të të miturve në vend. Gjithashtu, përmes këtij punimi do të ofroj më shumë informacione për trajtimin, të drejtat, obligimet, procesin e riedukimit, risocializimit, riintegrimin dhe mënyrën e jetesës së të miturve me një vështrim të posaçëm në Qendrën Korrektuese në Lipjan.

Fjalët kyçe: Sistem, i mitur, qendër korrektuese, burgim, të drejta, obligime, riedukim, risocializim, riintegrim.

HYRJA

Sistemi i Drejtësisë për të Mitur në Republikën e Kosovës, ka për qëllim që të miturit, si kryes të veprës penale t’i ofrojë mbrojtje për shkak të specifikave, respektivisht aftësisë për ta kuptuar realitetin duke pasur parasysh faktet e

pjekurisë – zhvillimin shpirtëror emocional, mendor dhe intelektual të të miturit.⁷⁵ Sistemi i Drejtësisë për të Mitur synon t'i japë drejtësi të merituar shtresës me të ndjeshme në shoqëri, më konkretisht - të miturve.⁷⁶ Ky sistem, synon mirëqenien e të miturit dhe siguron që çdo reagim ndaj kryesve të mitur të jetë në proporcion me rrethanat e kryesit dhe veprës penale.⁷⁷

Sistemi i Drejtësisë për të Mitur është ndërtuar mbi parimet themelore dhe mundëson mbrojtjen efektive të të miturve në të gjitha rastet në procedurë gjyqësore si dhe në fazën e riedukimit, risocializimit dhe riintegritit të tyre. Sistemi i drejtësisë për të mitur, mbron të drejtat dhe sigurinë e të miturve, si dhe mirëqenien e tyre fizike dhe mendore. Përderisa, burgimin e të miturve e parasheh vetëm si masë të fundit.⁷⁸

Sistemi i drejtësisë për të mitur përbëhet nga ligjet, politikat, udhëzuesit, normat zakonore, sistemet, profesionistët, institucionet për trajtim të posaçëm për fëmijët në konflikt me ligjin⁷⁹ dhe parasheh që procedura gjyqësore, pjesë e së cilës është i mituri, të jetë sa më konfidenciale.⁸⁰

SISTEMI I DREJTËSISË PËR TË MITUR NË KOSOVË

Të kuptuarit e nocioneve “Drejtësi për të mitur” dhe “Delikuencë”

Drejtësia për të mitur konceptohet si pjesë integrale e procesit të zhvillimit për secilin vend, brenda një kuadri të zgjeruar drejtësie sociale për të gjithë të miturit duke kontribuar në mbrojtjen e të rinjve dhe në ruajtjen e një rendi paqeje në shoqëri.⁸¹

⁷⁵Sipas, udhëzuesit të IGJK për mësim në distance “Drejtësia për Fëmijë në aspektin penal; https://igjk.rks-gov.net/Uploahhttps://igjk.rks-gov.net/Uploads/Documents/elpt2016_.pdfs/Documents/elpt2016_.pdf

⁷⁶ Sipas Kodi Penal të Kosovës, **i mitur** konsiderohet personi ndërmjet moshës katërmëdhjetë (14) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet.⁷⁶ Të miturit ndahen në “të mitur të rinj” nga (14-16 vjet) dhe të “të mitur të rritur” nga (16-18 vjet) dhe në Rekomandimin CM/Rec (2008) 11 të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për Rregullat Evropiane për shkelësit e ligjit me moshë të re, subjekte të sanksioneve ose masave, 5 Nëntor 2008.

⁷⁷Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve, të cilëve u është hequr liria- Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 45/113, datë 14 dhjetor 1990 II – Qëllimi dhe zbatimi i rregullave parag. 11, nën (a).

⁷⁸Neni 3 parag.1- Parimet udhëzuese “Kodi Penal për të Mitur” po citoj: Privimi i lirisë do të shqiptohet vetëm si mjet i fundit dhe do të kufizohet në afatin sa me të shkurtër të mundshëm. Gjatë privimit të lirisë të shqiptuar si dënim, kryerësit të mitur i ofrohet edukim, ndihmë psikologjike, e sipas nevojës edhe ndihmë mjekësore për të lehtësuar rehabilitimin e tij dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e Të Miturve, të cilëve u është hequr liria, Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 45/113, datë 14 dhjetor 1990 “ I-Perspektivat themelore” parag. 1 dhe 2 dhe Standardet ndërkombëtare Rregullat e Pekinit (Neni 13).

⁷⁹Treguesit e Drejtësisë për Fëmijë, faqe 50 – “ Gjendja në Kontestin Global” Prishtinë, 2013, faqe 9.

⁸⁰Hajdari, Azem: “ E drejta e procedurës penale e të miturve”, Prishtinë, 2005, – Parimi i gjykimit me dyer të mbyllura.

⁸¹ Rregullat standard e minimale të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të mitur (“Rregullat e Pekinit”) Miratuar nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 40/33 e datës 29 nëntor 1985, “Dispozitat e përgjithshme”.

Drejtësia për të mitur përbëhet nga normat juridike, me anë të të cilave behet mbrojtja e të drejtave të të miturve. Qëllimi i drejtësisë për të mitur është të siguroj se fëmijët⁸² janë shërbyer në mënyrën më të mirë të mundshme dhe mbrohen nga sistemet e drejtësisë.⁸³ Ajo në mënyrë specifike synon të sigurojë zbatimin e normave dhe standardeve ndërkombëtare për të gjithë fëmijët, të cilët vijnë në kontakt me sistemin e drejtësisë si viktimat, dëshmitarë dhe të dyshuar për një veprë penale, apo për arsye tjera, ku ndërhyrja gjyqësore është e nevojshme, për shembull lidhur me kujdesin e tyre, privimin e lirisë ose për mbrojtjen e tyre.⁸⁴

Drejtësia për të miturit, nuk mbulon vetëm situatat në të cilat është shfaqur një konflikt me legjislacionin penal. Ajo përfshin edhe çështje të tilla si; parandalimi i delinkuencës, zbatimi i ligjit, gjykimi dhe rehabilitimi.⁸⁵ “Personat e mitur që janë në konflikt me ligjin njihen si **delikuent**, ndërsa, “veprimet e caktuara negative të manifestuara nga ana e tyre, që janë në kundërshtim me normat shoqërore dhe rendin juridik paraqesin **delikuencën e të miturve**.⁸⁶

“Termi **Delikuencë** (devijim) rrjedh nga fjala latine “*deliquare*”, që nënkupton përgjithësisht shprehjet, sjelljet dhe veprimet e përsëritura të të miturve që bien ndesh me moralin, zakonet dhe ligjet e mjedisit ku jetojnë. Shikuar historikisht, delikuenca e të miturve është e vjetër sa edhe vetë njeriu dhe shoqëria. Delikuent është ai individ i cili me veprimet e veta jo vetëm që shkel normat e mjedisit, por edhe cenon të drejtat dhe liritë e tjetrit dhe bie direkt në konflikt me të tjerët⁸⁷. Pra, delikuent quhet ai që ka sjellje të përsëritura devijuese, që bën vepra kriminale, duke shkelur kështu normat ligjore në fuqi.⁸⁸

Delikuencën e të miturve e kuptojmë si shprehje të tërësishme e të gjitha sjelljeve të të miturve, që nuk janë në pajtim me normat e shkruara dhe të pashkruara të sjelljeve shoqërore (juridike e morale).⁸⁹

⁸² Shëndeti Mendor dhe të Drejtat e Njeriut vol.9 (2010) Nr.2. Drejtësia për të Mitur dhe disa prej parimeve të saj të rëndësishme, faqe 23.

⁸³ UN ‘Common Approach to Justice for Children’, Mars 2008

⁸⁴ Shëndeti Mendor dhe të Drejtat e Njeriut vol. 9 (2010) Nr. 2. Drejtësia për të Mitur dhe disa prej parimeve të saj të rëndësishme, faqe 23.

⁸⁵ Sufaj, Femi – Sota, Marinela – Gjoka, Rasim: “Manual Trajnimi për Profesionistët që punojnë me fëmijët në Sistemin Penitenciar”, 2012, faqe 6.

⁸⁶ Mendim personal; LL.M. Egzona Morina.

⁸⁷ Broshurë - Dhuna në mes të bashkëmoshatarëve dhe delikuenca e të miturve

<http://www.kosovopoliice.com/repository/docs/2. Dhuna ne mes te bashkemoshatareve dhe delikuenca e te miturve.pdf>

⁸⁸ Delikuenca e të miturve në Kosovë në periudhën 2003 - 2006 “ Nociioni i Delikuencës” – Përkufizimi i objektit të studimit, faqe 6.

⁸⁹ Latifi, Vesel: “Kriminalistika e Delikuencës së të Miturve”, Prishtinë, 1982, “Botëkuptimet e ndryshme rreth delikuencës së të miturve”, faqe 21-22.

Atë, gjithashtu, mund ta konsiderojmë si shenjë të falimentimit të një procesi psikik normal të socializimit. Shkurt, gjithçka që do të vërë në punë mekanizmin e të mësuarit të tolerancës së frustracionit dhe identifikimit, rrezikon të jetë me origjinë të sjelljeve antisociale.⁹⁰

“Në kuptimin juridik, sjellja delinkuente është ajo sjellje që bie në kundërshtim me ligjin. Në kuptimin sociologjik, sjellja delinkuente përbën një devijim nga një normë sociale, dhe në kuptimin moral, kjo sjellje konsiderohet e tillë, nëse nga individi thyhet një normë morale e shoqërisë, ku vetë ai bën pjesë.⁹¹ Delikuenca e të miturve shprehet nëpërmjet kryerjes së veprave penale nga ana e të miturve, si: vrasje, lëndime të rënda trupore, lëndime të lehta trupore, pjesëmarrje në rrahje, rrezikim të sigurisë, delikte seksuale, vjedhje, grabitje etj. Personat e mitur mund të jenë; kryes, bashkë kryes, nxitës apo ndihmës të veprës penale.⁹²

Si shkaqe që ndikojnë në formimin e një të mituri delikuent, dhe në përgjithësi në formimin e grupeve asociale përmenden: varfëria, probleme me drogën apo alkoolin, mospërshtatshmëria sociale, pasiguria e të rinjve në ardhmërinë e tyre, brengat e përditshme për sigurimin e ekzistencës, nevoja për afirmimin e personalitetit, disavantazhi në shkollim, revolta kundër familjes (mungesa e mbështetjes së familjes) dhe shoqërisë etj.⁹³

LEGJISLACIONI VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR

Instrumentet vendore dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të miturve

Në legjislacionin e secilit shtet janë përfshirë dispozita të caktuara lidhur me mbrojtjen e të drejtave të të miturve dhe ekzekutimin e sanksioneve penale në rastet kur të miturit bien në konflikt me ligjin. Duke marr parasysh se “zhvillimi i gjithanshëm fizik e psikik i personave të mitur dallon nga zhvillimi i personave të rritur,⁹⁴ shtetet në mbarë botën kanë shtuar kujdesin më të madh ndaj kësaj kategorie shoqërore. “Për ketë arsye në rastin kur të miturit kryejnë

⁹⁰ Beqo, Ani – Doci, Blerta: “Të miturit në konflikt me ligjin” Analizë e faktorëve të riskut që ndikojnë në kriminalitetin e të miturve, faqe 29.

⁹¹ Gjoka, Rasim – Zenelaga, Brunilda: “Komunikimi mes të miturve në institucionet e vuajtjes së dënimit”, (Karakteristika psiko-sociale tek të miturit që kryejnë sjellje delinkuente (kriminale)), faqe 3.

⁹² Statistikat e Jurisprudencës për Persona të mitur – 2015, “Shpjegime për shfrytëzuesit”, faqe 39.

⁹³ Latifi, Vesel: “Kriminalistika e Delikuencës së të Miturve”, Prishtinë, 1982 “ Botëkuptimet e ndryshme rreth delikuencës së të miturve, faqe 23.

⁹⁴ Sahiti, Ejup – Murati, Rexhep: “E drejta e Procedurës Penale”, Prishtinë, 2013, “Procedura ndaj të Miturve, faqe 425

vepra penale, të drejtat bashkëkohore parashohin rregullim të posaçëm për trajtimin e tyre.⁹⁵ Qëllimi i trajtimit specifik të të miturve kryerës të veprave penale, pikësëpari është që i mituri të risocializohet dhe të kompensohet ajo që në edukimin e tij është lëshuar, në mënyrë që të kthehet si anëtar i dobishëm i shoqërisë.⁹⁶ Kjo, arsyetohet edhe me faktin se, duke e pasur parasysh moshën e tyre të re, ka më shumë shpresë për përmirësim, në anën tjetër nëse nuk ndërmerren masa adekuate për përmirësimin e tyre, mendohet se ata edhe për një kohë të gjatë do t'i shkaktojnë dëm shoqërisë.⁹⁷ Standardet e drejtësisë për të mitur janë zhvilluar në nivel rajonal dhe global. Andaj, normat e një spektri juridik të ndryshëm (p.sh.: dispozitat normative, procedurale apo penitenciare)⁹⁸ për mbrojtjen e të miturve janë specifikuar në;

Instrumentet vendore, si:

1. Kushtetutën e Kosovës,⁹⁹
2. Kodin Penal,
3. Kodin e Procedurës Penale,
4. Kodin Penal për të Mitur,
5. Ligjin mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale etj.

Instrumentet ndërkombëtare, si:

1. Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut¹⁰⁰
2. Konventën për të Drejtat e Fëmijëve¹⁰¹
3. Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut¹⁰²
4. Direktivat e OKB-së për parandalimin e delikucencës së të miturve (Direktivat e Riadit, 1990)¹⁰³
5. Rregullat Minimum Standard të OKB-së për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit” (Rregullat e Pekinit), 1985¹⁰⁴
6. Rregullorja e OKB-së për Mbrojtjen e të Miturve të Deprivuar nga Liria e tyre (Rregullat e Havanës), 1996¹⁰⁵

⁹⁵ Po aty.

⁹⁶ Po aty.

⁹⁷ Po aty.

⁹⁸ Sqarim: mbi bazën e të cilave është vendosur çështja.

⁹⁹ Të Drejtat dhe Liritë Themelore: Neni 23 -“Dinjiteti i njeriut”, neni 26- “E Drejta e Integritetit Personal”, neni 27- “Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruës”, neni 50- “Të Drejtat e Fëmijës” parag. 1,3,4,5 etj.

¹⁰⁰ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, u miratua më 10 dhjetor të vitit 1948, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara – disa nga nenet e Deklaratës, si: neni 5, 8, 9, 10, 11 etj.

¹⁰¹ Konventa për të Drejtat e Fëmijës është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 20 nëntor 1989.

¹⁰² Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut është miratuar Këshilli i Evropës, më 04.11.1950 në Romë.

¹⁰³ Direktivat e Riadit janë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 14 Dhjetor 1990

¹⁰⁴ Rregullat e Pekinit janë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 29 Nëntor 1985.

¹⁰⁵ Rregullat e Havanës janë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 14 dhjetor 1990.

7. Rregullat Standard Minimum të Kombeve të Bashkuara lidhur me Masat e Mosarrestimit (Rregullat e Tokios),1990.¹⁰⁶
8. Rregulloren e Këshillit të Evropës për masat dhe sanksionet (Rregulloren Evropiane) ¹⁰⁷
9. Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria¹⁰⁸
10. Paktin Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike¹⁰⁹
11. Konventën kundër torturës dhe vuajtjeve të tjera ose trajtimit mizor, jonjerëzor apo degradues etj.

MASAT DHE DËNIMET E ZBATUESHME NDAJ TË MITURVE

(Sipas Kodit Penal për të Mitur)

Në rastet kur të miturit kryejnë vepra penale (tiparet e të cilave janë të përcaktuara me ligj), janë paraparë sanksione penale ose masa të trajtimit të detyrueshëm. Procedurën e shqiptimit të këtyre sanksioneve dhe masave ndaj të miturve e rregullon Kodi i Drejtësisë për të Mitur. Sipas këtij Kodi “masat që mund të shqiptohen ndaj të miturve janë: masat e diversitetit dhe masat edukative.¹¹⁰

Masat edukative që mund të shqiptohen ndaj të miturve janë: masat disiplinore, masat e mbikëqyrjes së shtuar dhe masat institucionale. Për dallim nga masat, ndaj të miturve mund të shqiptohen edhe dënime, si; gjoha, urdhri për punë në dobi të përgjithshme dhe burgimi për të mitur.¹¹¹ Sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur “ndaj të miturve të rinj të grup - moshës nga (14-16 vjeç) mund të shqiptohen vetëm masa edukative.¹¹² Parimisht, edhe ndaj të miturve të rritur të grup-moshës nga (16-18 vjeç) shqiptohen masa edukative, por në rastet e caktuara me ligj mund të shqiptohet masa e dënimit me burg për të mitur .¹¹³

¹⁰⁶ Një sërë parimesh që kanë për qëllim promovimin e masave të tjera të sigurisë përveç arrestit në burg, si edhe disa standarde minimale lidhur me personat të cilët janë në kushtet e vuajtjes së alternativave të dënimit me burgim.

¹⁰⁷ Rregullorja Evropiane, u miratua nga Këshilli i Evropës në vitin 2008. Gjithashtu, sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë edhe standardet dhe rekomandimet tjera evropiane.

¹⁰⁸ Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 45/113, të datës 14 dhjetor 1990.

¹⁰⁹ Miratuar dhe hapur për nënshkrim, ratifikim dhe aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI), të datës 16 dhjetor 1966.

¹¹⁰ Neni 7 paragrafi 1: “Masat dhe dënimet e zbatueshme ndaj të miturve” - Kodi i Drejtësisë për të Mitur, Nr. 03/L-193

¹¹¹ Po aty.

¹¹² Seria 5: Statistikat Sociale Statistikat e Jurisprudencës për Persona të mitur – 2015, faqe 39.

¹¹³ Po aty

Qëllimi i burgimit për të mitur është që të kontribuohet në rehabilitimin dhe në zhvillimin e kryerësit të mitur, veçanërisht në edukimin e të miturit, edukimin e specializuar, aftësitë profesionale dhe në zhvillimin e duhur personal. Përveç kësaj, burgimi për të mitur duhet të ndikojë pozitivisht në të miturin përmes mbrojtjes, ndihmës dhe mbikëqyrjes për ta parandaluar recidivizmin.¹¹⁴ Ekzekutimi i dënimit me burgim për të mitur mbahet në institucionin korrektues për të mitur.¹¹⁵ Në Kosovë ekzekutimi i dënimit me burgim për të mitur bëhet në Qendrën Korrektuese në Lipjan.

QENDRA KORREKTUESE NË LIPJAN

(Vështrim i Përgjithshëm)

“Qendra Korrektuese në Lipjan është ndërtuar në vitin 1978, si institucion korrektues për të mitur dhe femra.¹¹⁶ Në fillim është populluar vetëm me të mitur ndërsa nga viti 1981 ka filluar edhe popullimi me femra. Si institucion i tillë ka vepruar deri në vitin 1989 për të startuar pastaj, në vitin 2000. Gjatë periudhës 1998 - 1999, destinimi i kësaj qendre ka qenë jashtë menaxhimit institucional.¹¹⁷ Objekti i Qendrës Korrektuese gjendet në anën e djathtë të rrugës magjistrale Lipjan – Magurë, në kilometrin e parë të kësaj rruge, e cila në veri kufizohet me lumin Sitnica, në Jug me rrugën për Magurë, ndërsa në perëndim me Qendrën e Paraburgimit në Lipjan.¹¹⁸ Të miturit janë të sistemuar në objekte apo kate të veçanta ndërsa femrat e mitura, në mungesë të hapësirave janë të vendosura së bashku me madhorët. “Kapaciteti total i Qendrës Korrektuese në Lipjan është 145 vende dhe posedon 6 lokale të veçanta. Pjesa e jashtme përbëhet nga objekti i administratës, ndërsa pjesa e brendshme përbëhet nga objekte të banimit dhe ato përcjellëse, si p.sh. qendra ambulatore (ku merren shërbimet adekuate mjekësore), shkolla, shtëpia e nënave (ku janë të vendosura femrat që kanë fëmijë – deri kur fëmija të mbushë moshën 8 muajshe). Përveç objekteve të banimit ka edhe 12 objekte tjera përcjellëse.¹¹⁹ Të burgosurit në këtë Institucion mund të vendosen nga 6 persona në një dhomë (kjo vlen për të miturit), ku secila dhomë posedon TV, tavolina me karrige si

¹¹⁴ Neni 32: “Qëllimi i burgimit për të mitur” - Kodi i Drejtësisë për të Mitur, Nr. 03/L-193

¹¹⁵ Neni 136: “Ekzekutimi i burgut për të mitur” - Kodi i Drejtësisë për të Mitur Nr. 03/L-193

¹¹⁶ Portali zyrtar: Ministria e Drejtësisë <http://www.md-ks.net/?page=1,71>

¹¹⁷ 1998 – 1999 (në rrethana lufte)

¹¹⁸ Po aty

¹¹⁹ Të dhëna të siguruara drejtpërdrejtë nga Qendra Korrektuese në Lipjan.

dhe mobilitet për vendosjen e gardërobës, po ashtu banjat dhe tualetet janë ndaras nga dhomat, ku kanë qasje në ujë të ngrohtë gjatë tërë kohës.¹²⁰ Sa i përket kushteve higjienike, secilit të mitur i sigurohen mjete të mjaftueshme për higjienën personale dhe hapësirave ku ata jetojnë dhe punojnë. Furnizimi me gjëra higjienike të nevojshme bëhet sipas orarit të përcaktuar nga ana e Institucionit.¹²¹ Qendra Korrektuese në Lipjan është specifike për sa i përket kategorisë së të burgosurve për arsye se është e vetmja Qendër në Republikën e Kosovës që akomodon të mitur, si;

1. Femra të mitura të dënuara,
2. Femra të mitura me masë edukative korrektuese,
3. Femra të mitura të paraburgosura,
4. Të mitur të dënuar,
5. Të mitur me masa edukuese korrektuese,
6. Të mitur në paraburgim.

Të gjitha këto kategori të të burgosurve janë të ndarë ndërmjet veti dhe nuk kanë qasje me njëri-tjetrin nëpër pavijone.¹²²

Aktivitetet e Qendrës Korrektuese në Lipjan që lidhen me riedukimin, risocializimin dhe riintegrimin e të miturve

Në Qendrën Korrektuese në Lipjan punohet sipas rutinës. Qendra Korrektuese organizon aktivitete të ndryshme që kanë për qëllim ri-edukimin, ri-socializimin dhe ri-integrimin e të miturve. Të gjitha aktivitetet që zhvillohen në Qendër, si; koha e qëndrimit në shkollë, në bibliotekë, në trajnime, në shëtitje, në program, në koncert, në shfaqje, në sallën e sportit – aktivitete sportive, në fushën e futbollit dhe aktivitete të tjera

¹²⁰ Po aty

¹²¹ Po aty – sqarim: Mënyra e funksionimit të Qendrës Korrektuese në Lipjan është - konform Rregullave të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria - Të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 45/113, të datës 14 dhjetor 1990.

¹²² Të dhëna të siguruar drejtpërdrejtë nga Qendra Korrektuese në Lipjan.

kulturore, përcaktohet nga drejtoria.¹²³ Gjithashtu, Qendra Korrektuese siguron edhe mbajtjen e orëve të veçanta me psikolog dhe punëtorë profesional-social. Qendra Korrektuese në Lipjan ofron një atmosferë risocializuese për të gjithë banoret e saj. Ekziston dhe funksionon edhe arsimiti shkollor për të mitur në kuadër të shkollave të Komunës së Lipjanit ku ka profesor të lëmive të ndryshme mësimore. Të miturit i marrin dëftesat në kuadër të dy shkollave të qytetit, asaj fillore dhe të mesme. Dëftesat, diplomat dhe certifikatat e kurseve apo trajnimeve janë të njëjta me ato të kurseve jashtë burgut dhe në to nuk specifikohet se i mituri ka qenë i institucionalizuar.¹²⁴

Tabela 1. Numri i nxënësve që kanë ndjekur shkollimin në periudhën 2011-2015 në QKL.

Viti	Numri i nxënësve të regjistruar gjatë viteve 2010 - 2015		
	M	F	Gjithsej:
2011	90	-	90
2012	91	-	91
2013	65	2	67
2014	76	-	76
2015	87	02	89

Burimi: Të dhëna nga Qendra Korrektuese në Lipjan.

Qendra Korrektuese në Lipjan organizon edhe trajnimet profesionale për të mitur në disa drejtime, siç janë:

1. elektroinstalues,
2. hidroinstalues
3. ndërtimtari dhe
4. makineri.¹²⁵

Të miturit të cilët tregohen të suksesshëm gjatë mbajtjes se këtyre trajnimeve certifikohen nga Ministria e Mirëqenies Sociale, dhe në certifikatat e tyre nuk figuron askund Qendra Korrektuese, me qëllim që personat e mitur të mos paragjykojnë në të ardhmen.¹²⁶

¹²³ Të dhëna të siguruara drejtpërdrejtë nga Qendra Korrektuese në Lipjan.

¹²⁴ Po aty - sqarim: konform Rregullave të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria - Të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 45/113, të datës 14 dhjetor 1990 "Arsimimi, trajnimet profesionale dhe puna, paragrafi 40, faqe 7.

¹²⁵ Po aty.

Po ashtu, në Qendrën Korrektuese në Lipjan organizohen trajnime edhe në lëmin e informatikës. Qendra posedon kabinetin i cili është donacion nga UNICEF-i, ku kryesisht merren hapat e parë mbi përdorimin e kompjuterëve dhe profesionalizimin e punës me kompjuter. Përveç trajnimeve në informatikë, femrat mund të ndjekin edhe kurse të tjera, si në; rrobaqepësi, floktari, bukëpjekje dhe aftësim profesional për kuzhinë.¹²⁷

Tabela 2. Të dhënat statistikore për periudhën 2013 – 2015, lidhur me angazhimin e të miturve në aftësimin profesional në QKL.

	2013	2014	2015
Elektroinstalues	03	03	06
Ndërtimtari	01	01	08
Hidroinstalues	03	05	09

Burimi: Të dhëna nga Qendra Korrektuese në Lipjan.

Shërbimet kryesore në Qendrën Korrektuese në Lipjan

Në kuadër të Qendrës Korrektuese në Lipjan lidhur me; mbarëvajtjen e punëve në këtë Institucion, ekzekutimin e ligjshëm të dënimit me burgim për të mitur dhe realizimin e procesit të risocializimit dhe riedukimit të të miturve ekzistojnë disa shërbime profesionale ku secili prej tyre ushtron detyra dhe punë të caktuara gjithmonë duke u bazuar në ligj, akte nënligjore udhëzime dhe rregullore, si dhe duke i respektuar parimet themelore të lirive dhe të drejtave të njeriut.

Si shërbime kryesore në këtë Institucion janë:¹²⁸

1. Shërbimi Juridik – Administrativ,
2. Shërbimi i Sigurimit,
3. Shërbimi i Risocializimit - Riedukimit,
4. Shërbimi Shëndetësor dhe
5. Shërbimi Ekonomik – Financiar.¹²⁹

¹²⁶ Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e Të Miturve, të cilëve u është hequr liria / Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 45/113, datë 14 dhjetor 1990 - Arsimimi, trajnimi profesional dhe puna, paragrafi 41, 42.

¹²⁷ Po aty.

¹²⁸ Të dhëna të siguruara drejtpërdrejtë nga Qendra Korrektuese në Lipjan.

¹²⁹ Po aty.

Të drejtat e avokatit në raport me të miturit

Në Qendrën Korrektuese në Lipjan, të miturit kanë të drejtën e këshillimit ligjor dhe u krijohet mundësia që në çdo rast të kërkojnë ndihmë ligjore. Avokatët mund t'i kontaktojnë të miturit çdo ditë (përfshirë edhe ditën e shtunë), brenda orarit të punës. Prezenca e avokatit është e detyrueshme edhe gjatë intervistimeve të ndryshme të të miturve. Avokatët në emër të të miturve mund t'u parashtrijnë kërkesa organeve të ndryshme, si p.sh. Gjykatave të Apelit për lirim me kusht etj.¹³⁰ I mituri ka të drejtë që në çdo kohë të ketë kontakte dhe komunikim të papenguar me mbrojtësin dhe familjen.¹³¹

Të drejtat e familjareve në raport me të miturit

Në Qendrën Korrektuese në Lipjan, të miturve u lejohen vizitat çdo javë (të dielave), nga një deri në dy orë. Përveç kësaj, ky institucion ofron edhe mundësinë e vizitës-shtesë (ekstra) të cilën mund ta kërkojë secili i mitur, kur ka: rast vdekje, raste sëmundjesh apo lëndimesh të rënda në familje, kur familjarët vijnë nga shtetet tjera, në ndonjë përvjetorë apo ngjarje tjetër të veçantë, edhe nëse vizitat e rregullta i ka të kryera (shfrytëzuara), e që janë në pajtim me ligjin dhe rregulloret e aplikueshme në Shërbimin Korrektues të Kosovës.¹³² Njëherit, familja ka të drejtë të jetë që në çdo kohë e informuar lidhur me procesin nëpër të cilin do të kalojë i mituri, si; drejtpërdrejtë, me telefon, me anë të korrespondencës etj.¹³³

Rastet e paraqitura të delikuencës së të miturve, me një vështrim të posaçëm në Qendrën Korrektuese në Lipjan gjatë viteve 2010 – 2015

Me një vështrim të posaçëm, në vijim do të prezantohen statistikat mbi gjendjen reale të prezencës së të miturve në Qendrën Korrektuese në Lipjan. Në këtë kuadër është e domosdoshme të qartësohet se të dhënat e prezantuara në formë tabelare janë siguruar nga evidencat e sakta të këtij Institucioni.

¹³⁰ Po aty – konform Rregullave të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria - Të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 45/113, të datës 14 dhjetor 1990 - (a) Të miturit duhet të ketë të drejtën në mbrojtje juridike dhe të jenë të aftë për të kërkuar falas ndihmë juridike, kur ndihma e tillë është e disponueshme, dhe të komunikojë rregullisht me mbrojtësit ligjorë. Privatësia dhe konfidencialiteti i komunikimeve të tilla duhet të garantohen;

¹³¹ Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria - Të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 45/113, të datës 14 dhjetor 1990, paragrafi 60, faqe 9.

¹³² Të dhëna të siguruar drejtpërdrejtë nga Qendra Korrektuese në Lipjan.

¹³³ Po aty.

Tabela 3. Numri i rasteve të të miturve prezent në QKL, gjatë viteve 2010 – 2015.

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Të mitur prezent	127	76	87	94	74	104	127

Burimi: Të dhënat e siguruar drejtpërdrejtë nga Qendra Korrektuese në Lipjan

Tabela e mësipërme na lejon të krijojmë një ide, se numri i të miturve në konflikt me ligjin vazhdon të mbetet shqetësues. Siç edhe mund të kuptohet nga shifrat e lartcekura, përderisa nga viti 2010 deri në vitin 2013 kemi pasur një ulje të lehtë të numrit të të miturve prezent në Qendër, ky numër përgjatë dy viteve të fundit prapë ka shënuar rritje.

Studimi i këtyre të dhënave dhe krahasimi i tyre na ndihmon të kuptojmë (numrin real të të miturve në konflikt me ligjin të përfshire në vepra penale). Gjithashtu, pasqyrimi i të dhënave në mënyrë statistikore është një indikator i dobishëm nxitës dhe na ndihmon që të ndërmarrim alternativa parandaluese. Në Qendrën Korrektuese në Lipjan, mosha mesatare e të miturve prezent në Qendër, gjatë viteve 2010 - 2015 sillet rreth 16 - 17 vjeçar/e, ndërsa koha e qëndrimit në këtë Institucion sillet prej 1 deri në 10 vite.

Tabela 4. Numri i të miturve prezent në Qendrën Korrektuese në Lipjan, gjatë vitit 2016.

Statusi	Numri i të miturve prezent në QKL – Viti 2016
Të mitur të paraburgosur	7
Të mitur të dënuar	9
Të mitur me Masë Edukative	34
Femra të mitura të paraburgosura	0
Femra të mitura të dënuara	2
Femra me Masë Edukative Korrektuese	1

Burimi: Të dhëna nga Qendra Korrektuese në Lipjan

Në funksion të analizës sa më konkrete, sipas të dhënave të siguruara nga Qendra Korrektuese, në fund paraqesim statistikat që lidhen me recidivizmin (përsëritësit e veprave penale), veçanërisht për periudhën kohore 2010 - 2015. Nga tabela në vijim vërejmë se, “fenomeni i përsëritjes së veprave penale i njohur si “Recidivizëm” është shumë më i shfaqur tek gjinia mashkullore.

Tabela 5. Recidivizmi (përsëritja e veprave penale) tek meshkujt dhe femrat në periudhën 2010-2015.

Recidivist:	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Meshkuj	10	11	16	17	24	20
Femra	/	/	/	2	/	/

Burimi: Të dhëna nga Qendra Korrektuese në Lipjan.

Ndihma post-penale

Qendra Korrektuese në Lipjan, ofron shërbime të ndryshme me qëllim asistimin e të miturve në rivendosjen e tyre në shoqëri pas mbajtjes së dënimit. Qendra Korrektuese në Lipjan, posedon programin “Menaxhimi i rastit pas lirimit”. Qëllimi i këtij programi individual është që të punohet me secilin të mitur, gjatë kohës së qëndrimit të tyre në Qendrën Korrektuese në Lipjan, në mënyrë që të miturit të përgatiten për kushtet e punës dhe jetës normale kur të lirohen pas dënimit. Me anë të këtij programi, punohet me çdo të mitur në mënyrë individuale. Në këtë program marrin pjesë edhe prindërit e të miturve, zyrtari sprovues i rastit, si dhe ekipi multi-profesional i Qendrës Korrektuese në Lipjan, që punon me të mitur gjatë gjithë kohës së qëndrimit të tyre në Qendër. Ky program synon që të përgatisë të miturit, që në të ardhmen të jenë të dobishëm për shoqërinë, familjen dhe të kyçen në ndonjë zanat apo punë për të cilën ata trajnohen në Qendrën Korrektuese në Lipjan.

PËRFUNDIMI

Duke u bazuar në atë që u trajtua më lartë, mund të konkludojmë, se Kosova në fushën e drejtësisë për të mitur ka shënuar progres të madh. Me diferencimin e sistemit penal për të mitur nga ai për të rritur, Kosova ka arritur të krijoj një bazë të mirë ligjore, lidhur me sistemin e drejtësisë për të mitur në përputhje me standardet e kërkuara nga instrumentet ndërkombëtare. Me hyrjen në fuqi të Kodit Penal për të Mitur, me pranimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve në Kushtetutën e Kosovës dhe me miratimin e shumë ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore janë krijuar mundësi të mira për të miturit që me efikasitet dhe efektshmëri t'i realizojnë të drejtat e tyre.

Duke e pasur parasysh se, kriminaliteti i të miturve efektson në cilësinë e ardhshme të jetës dhe nuk është një problem i thjeshtë, gjatë gjithë këtyre viteve të tranzicionit, në Kosovë janë bërë hapa të rëndësishëm, në mënyrë që sistemi i drejtësisë për të mitur, në çdo fazë t'i përgjigjet sa më mirë, sa më shpejt, me kosto sa më të ulët kërkesave të të miturve që janë në konflikt me ligjin.

Duke e ditur se, drejtësia për të mitur është një parakusht i rëndësishëm për barazinë dhe zhvillimin e shoqërisë, në Kosovë është punuar shumë në këtë drejtim. Një shembull i mirë, për të cilin Kosova është vlerësuar pozitivisht, është Institucioni Korrektues i Lipjanit. Institucioni Korrektues në Lipjan si institucion i vetëm korrektues për të mitur është i fokusuar në zhvillimin e personalitetit të fëmijëve, rehabilitimin pozitiv, dhe përgatitjen e tyre për rikthim-riintegrim në shoqëri pas mbajtjes së dënimit, në mënyrë që ata të jetojnë në harmoni me normat ligjore dhe shoqërore.

Përmes këtij studimi kam analizuar, arritjet në sistemin e drejtësisë për të mitur, pasurimin e kornizës ligjore në Kosovë - që ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave të të miturve, si dhe përmes statistikave të sakta, kam sjellë edhe një tablo të qartë të numrit të të miturve të dënuar në vendin tonë.

Në fund studimi mbyllet me, statistikën mbi gjendjen reale të recidivizmit dhe ndihmën post-penale, që ka të bëjë me "Menaxhimin e rasteve pas lirim", program ky që synon të përgatisë të miturit, që në të ardhmen të jenë të dobishëm për familjen dhe shoqërinë.

Llojlojshmëria e Servituteve Sendore

Arjana Shala

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Prishtinë- Kosovë,

Arbër Shala

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Prishtinë- Kosovë,

Abstrakti

Servitutet në përgjithësi me theks të posaçëm servitutet sendore në shkencën juridike por edhe në praktikë konsiderohen si lloji më i vjetër i servituteve. Këto të drejta sendore në sendet e huaja janë të një rëndësie të posaçme në jetën shoqërore përgjithësisht, andaj edhe në normimin e tyre juridik sigurohet edhe mbrojtja e tyre.

Çfarë trajtimi kanë servitutet sendore me Ligjin për Pronësi dhe të Drejta tjera Sendore të Republikës së Kosovës si dhe krahasimi i tyre me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë, do të vë në pah ky punim.

Shikuar nga aspekti dyanësor, njëri në të drejtën që i takon personit mbi sendin e huaj, dhe tjetrin mbi kufizimin në të drejtën që ka pronari mbi atë send. Përmes këtij shqyrtimi empirik dhe normativ punimi mëton të sigurojë një vizion të qartë të llojlojshmërisë së servituteve sendore, krijimin dhe mbrojtjen pasi që sistemi juridik i vendit tonë mbron me efikasitet dhe i garanton këto të drejta mbi sendet e huaja.

Fjalët e rëndësishme: servitute sendore, llojlojshmëria, rregullimi juridik.

Hyrja

E drejta e servituteve sendore e njohur dhe e zbatuar në të drejtën romake, edhe sot bazamentin e saj e ka nga e drejta romake, por e modifikuar me ndryshimet e kohës dhe e normuar me dispozitat e Ligjit për Pronësi dhe të Drejta tjera Sendore të Republikës së Kosovës. Gjithashtu në vendet e tjera të rajonit fokus kryesor i kanë llojet e servituteve sendore.

Kur merret parasysh fakti se servitutet sendore ndahen në dy grupe ato tokësore dhe urbane, medoemos që një trajtim i detajuar shpehet përmes këtij punimi. Këto lloje të servituteve trajtohen në aspektin e doktrinës juridike si dhe trajtimin normativ të Ligjit për pronësi dhe të drejta tjera sendore.

Ndryshimet në legjislacion në mes të vendeve të rajonit kanë rezultuar edhe me rregullimin e të drejtës së servituteve sendore dhe llojeve të tyre në mënyra të ndryshme, e kjo çështje, përkatësisht aspektet krahasuese në mes të Kosovës dhe vendeve të rajonit duke i dhënë theks të veçant trajtimin normativ në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Maqedonisë, të cilat paraqiten në pjesën e fundit të punimit.

1. Në përgjithsi për servitutet

Doktrina juridike shumë qartë ka përcaktuar nocionin e servituteve, e cila e drejtë buron nga e drejta e pronësisë. Përderisa “*E drejta e pronësisë është e drejtë subjektive e karakterit absolut e cila titullarit të saj i bën të mundur që sendin e caktuar ta përdor, ta shfrytëzoj dhe ta disponoj në mënyrën më absolute të mundshme*”,¹³⁴ e drejtë e pronësisë konsiderohet edhe e drejta mbi sendin përkatësisht e drejta e një titullari mbi sendin e tij. Megjithatë në të drejtën pronësore ka kufizime, dhe ato kanë qenë të njohura që nga e drejta romake, më konkretisht në Ligjin e XII tabelave, ku janë përfshirë edhe në formë të shkruar disa kufizime konkrete të të drejtave pronësore, e të tilla kufizime paraesin të drejtën e servituteve.

Historiku i servituteve është shumë i hershëm, fillimisht në të drejtën romake ishin të vetmet *iura in re aliena*.¹³⁵ Ndryshe nga posedimi me mirëbesim “*bonae fidei possession*” çdo *iura re aliena* është një e drejtë absolute në dispozicion kundër gjithë botës, madje edhe kundër pronarit.¹³⁶ Pasi që pasuria e mbajtësit të servitutit specifikohej, atij i ipej e drejta e caktuar e veprimtimit në

¹³⁴ Abdullahu, Prof. Dr. Aliu, *E Drejta Civile*, Prishtinë, 2013, Fq. 302.

¹³⁵ Statovci, Ejup, *E Drejta e Servituteve*, Prishtinë, 2009, Fq. 17.

¹³⁶ Grveber, Dr. Jur. Erwin, *The Roman law of damage to property : being a commentary on the title of the digest Ad legem aquiliam (IX. 2) : with an introduction to the study of the Corpus juris civilis*, Clark, New Jersey, 2004, Fq. 243.

token e tjetrit sikur te ishte e tija, pavarësisht nga fakti se nuk kishe te drejta pronësore mbi atë pronësi.¹³⁷

Ashtu siç ka qenë i njohur dhe përkufizuar servituti siaps të drejtës romake, pra që servituti ishte e drejta mbi sendin e tjetrit, gjegjësisht kufizim për pronarin në shfrytëzimin e sendit të vet në mënyrën më absolute të mundshme, ashtu është edhe në drejtat positive.

2. E drejta e servituteve

Në Republikën e Kosovës të drejtat sendore janë taksativisht të numëruara me Ligjin për Pronësi dhe të Drejta tjera Sendore të Republikës së Kosovës, (në vazhdim LPDTS), e drejta e servituteve hynë në grupin e të drejtave sendore që përcaktohet me të këtij ligji.

Definimi i të drejtës së servituteve ka ekzistuar qysh herët, e sot në doktrinën juridike mund të hasim definime të ndryshme, por të cilat esencialisht janë të njejta.

Në terminologjinë juridike me servitut nënkuptohet barra që i ngarkohet një prone për përdorimin dhe dobinë e një prone fqinjë të një pronari tjetër.¹³⁸

Një definim tjetër përcakton që servituti është një e drejtë reale e kufizuar, ku një barrë vendoset në një pasuri të paluajtshme duke kufizuar të drejtat, kompetencat ose liritë e pronarit të paluajtshmërisë për një pjesë të madhe ose vogël të paluajtshmërisë në favor të një personi, ose pronari të një paluajtshmërie tjetër.¹³⁹

3. Llojet e servituteve

Qysh në kohën e Justinianit është bërë ndarja e servituteve, përkatësisht koha e Justinianit që ajo kur përfundoi ndarja sistematike e servituteve në dy grupe të mëdha: Në servitute reale dhe në ato personale.¹⁴⁰

Servitutet reale ose sic i përcakton LPDTS-ja servitute sendore i përkitnin përherë tokave dhe sit ë tilla u emërtuan *jura praediorum*.

Parimisht servitutet krijohen për sendet e paluajtshme, mirëpo nuk përjashtohet mundësia e servituteve për sendet e luajtshme, por realisht në praktikë këto raste janë të pakta

¹³⁷ Noyes, C.Reinold, *The institution of property*, Clark, New Jersey, 2007, Fq.184.

¹³⁸ Gojani, Skender, *Fjalori i terminologjisë juridike*, Prishtinë 2013. Fq.244.

¹³⁹ file:///C:/uploads-documents-2011-08-Servitudes_over_immovable_property_and_their_implications.pdf

¹⁴⁰ Puhan, Dr.Ivo, *E Drejta Romake*, Prishtinë, Fq.264.

Servitutet edhe pse janë të klasifikuara në dy grupe, ekzistojnë edhe ndarje brenda këtyre dy grupeve.

Kriter për ndarjen e servituteve në servitute sendore respektivisht servitute personale, merret fakti se, servituti a është krijuar në dobi të pronarit të përhershëm të një paluajtshmërie apo në dobi të një personi të caktuar. Në qoftë se servituti është konstituuar në dobi të pronarit të përhershëm të një paluajtshmërie quhet servituti sendor(real). Ndërsa, nëse konstituohet në dobi të një personi të caktuar, ky servituti quhet servituti personal.¹⁴¹

3.1. Servitutet sendore

LPDTS-ja duke filluar në nenin 252 deri në nenin 264 trajton servitutet në përgjithësi. Rrjedhimisht në nenin 252 përcakton nocioni e servituteve sendore: Servituti sendor është e drejta e pronarit përkatës të një paluajtshmërie (paluajtshmëria dominuese) që një paluajtshmëri tjetër (paluajtshmëria shërbyese) në një mënyrë të caktuar ta shfrytëzojë apo të ndalojë kryerjen e veprimi të caktuar ose të përjashtoj ushtrimin e së drejtës së caktuar, të cilat rrjedhin nga e drejta e pronësisë në paluajtshmerin shërbyese.¹⁴²

Distanca e paluajtshmerisë nuk është me rëndësi, çka nënkuptohet që nuk kërkohet të jetë një paluajtshmëria fqinje apo shumë afër.

Servituti duhet të shërbejë për një qëllim të caktuar, kjo është e paraparë shprehimisht me LPDTS-në ku përcaktohet që: Servituti sendor duhet t'i sigurojë ndonjë dobi titullarit të servitutit, përndryshe servituti është i palejuar.¹⁴³

4. Llojet e servituteve sendore

Përpos ndarjes kryesore të servituteve në sendore dhe personale, ekzistojnë edhe nëngrupe të këtyre llojeve të servituteve.

Për dallim nga doktrina juridike, ligji në Kosovë nuk e trajton fare, përkatësisht në asnjë dispozitë nuk trajtohen nënlojet e servituteve sendore.

Ndarja tradicionale e servituteve sendore ndanë këto në:

- Servitute Tokësore ose Fushore, dhe

- Servitute Shtëpiake.

¹⁴¹ Abdullahu, Prof. Dr. Aliu, *E Drejta Sendore*, Prishtinë, 2014, fq. 247.

¹⁴² LIGJI NR.03/L-154 PËR PRONËSINË DHE TË DREJTAT TJERA SENDORE, Prishtinë 2009, neni 252, para. 1.

¹⁴³ LIGJI NR.03/L-154 PËR PRONËSINË DHE TË DREJTAT TJERA SENDORE, Prishtinë 2009 neni 252, para. 2.

4.1. Servitutet Tokësore ose Fushore

Janë servitute mjaft të lashta, e si servituti më i vjetër është servituti tokësor fshatar.

Servitutet tokësore ishin të drejta reale të konstituuar në tokën e huaj në favor të pronarit të përcaktuar individualisht të tokës tjetër. Më servitute tokësore ishin të ngarkuar pronarët e pasurive shërbyese, ndërsa të favorizuar ishin pronarët e pasurive sunduese.¹⁴⁴

Servitutet tokësore ekzistojnë gjithmonë midis dy tokave. Servituti tokësor është një e drejtë sendore në sendin e huaj e cila krijohet në dobi të pronarit aktual të tokës dominante duke e ngarkuar pronarin aktual të tokës shërbyese. Me qëllim të shfrytëzimit sa më të mirë ekonomik, si dhe të shtimit të vlerës së tokës dominante.¹⁴⁵

Në të drejtën romake servitutet tokësore (fushore) ishin servitutet tokësore fshatare dhe të qytetit. Realisht të bëhet një ndarje e servituteve tokësore, ose të bëhet numërimi i tyre taksativ është shume e vështir për arsye që janë të shumta në numër dhe mjaft të ndryshueshme.

Si servitutet tokësore më të rëndësishme janë:

- Servituti i rrugës;
- Servituti i nxjerrjes së ujit;
- Servituti i rrugës së domosdoshme;

Servituti i rrugës (Right of Way): Ky lloj i servitutit ka të bëjë me të drejtën e ecjes në pronën e dikujt tjetër, kalimi me bagëti ose vozitja e makinës nëpër pronë. Rruga në të cilën ekziston e drejta e servitutit mund të përcaktohet specifikisht ose në terma të përgjithshëm, varësisht me qëllimin e palëve të përfshira në krijimin e servitutit.¹⁴⁶

Servituti i rrugës së domosdoshme (Way of necessity): Pëlqimi i pronarit të pronës e cila është objekt i nënshtimit këtij lloji të servitutit nuk është i nevojshme dhe ky lloj i servitutit mund të konsiderohet si e drejtë nga ana e pronarit të tokës e cila është e rrethuar nga toka tjetër në atë masë sa që ai ose ajo nuk ka qasje të drejtpërdrejtë ose të mjaftueshme në rrugën publike dhe si rezultat i kësaj është i/e detyruar të kalojë në tokën fqinjë që është në pronësi privatë.¹⁴⁷

Servituti i rrugës së somosdoshme mund të trajtohet edhe në pikpamje më të gjerë apo e drejta e ndjekjes së kafshëve, ku kuptohet përpos të drejtës së

¹⁴⁴ Puhan, Dr. Ivo, *E Drejta Romake*, Prishtinë, Fq. 264.

¹⁴⁵ Abdullahu, Prof. Dr. Aliu, *E Drejta Sendore*, Prishtinë, 2014, Fq. 252.

¹⁴⁶ file:///C:/uploads-documents-2011-08-Servitudes_over_immovable_property_and_their_implications.pdf

¹⁴⁷ file:///C:/uploads-documents-2011-08-Servitudes_over_immovable_property_and_their_implications.pdf

kalimit sic u trajtua pronari I servitutit gëzon të drejtën e ndjekjes së kafshëve shtëpiake.

Servituti i nxjerrjes së ujit (Weater Servitudes): Në përgjithësi ky lloj i servitutit i jepet personit i cili e mbanë të drejtën reale për nxjerrje të ujit nga prona mbi të cilën servituti është dhënë. Po ashtu mund të japë të drejtën e udhëheqjes së ujit nëpër pronë nëpërmes tubave dhe brazdakeve, dhe të ruaj ujin e tepërt.¹⁴⁸

4.2.Servitutet Shtëpiake ose Urbane

As sa i përket servituteve urbane ligji nuk parasheh ndonjë dispozitë.Në literaturën juridike, servituti shtëpiak më së shpeshti definohet se është një e drejtë sendore në sendin e huaj, i cili krijohet në dobi të pronarit ose poseduesit aktual të sendit dominant dhe në ngarkim të pronarit ose të poseduesit aktual të sendit shërbyes, me qëllim të përdorimit të shtëpisë(ndërtesës dhe tokës ndërtimore).¹⁴⁹

Servitutet shtëpiake(urbane) për tu dalluar nga e drejta fqinjësore ato duhet të jenë të regjistruara në librat publik,ose të fituara me parashkrim fitues.¹⁵⁰

Numri i këtyre është shumë i madh, dhe njëlloj si tek servitutet tokësore nuk bëhet ndonjë përcaktim i tyre, madje është pothuajse e pamundur të numrohen të gjitha servitutet urbane.

Disa nga servitutet shtëpiake ose urbane janë:

- Drita, pamja;
- Mbështetja e murit;
- Servituti ujit;
- Detyrimet kushtëzuese;
- Kalimi i tymit;
- Ndërtimi i shtëpisë në lartësi të caktuar;
- Kalimi i ujrave; etj.

Si lloj i Servitutit Urban pra është edhe mbështjetja e murit.

E drejta që ta mbështes ndërtesën e vet në murin e shtëpisë së huaj është një lloj servituti shtëpiak mjaft i shpeshtë.Ushtrimi I këtij servituti duhet të bëhet në mënyrë të kujdesshme. Në disa raste, jo vetëm që ekziston e drejta e mbështjetjes së murit, por ekziston edhe mundësia që disa pjesë të ndërtesës së tij të shtrihen mbi sipërfaqen e oborrit.¹⁵¹Detyrimet kushtëzuese konsiderohen

¹⁴⁸ Po aty.

¹⁴⁹ Statovci, Ejup,*E Drejta e Servituteve*, Prishtinë,2009,Fq.177-....

¹⁵⁰ Abdullahu,Prof.Dr.Aliu,*E Drejta Sendore*,Prishtinë, 2014,Fq.257.

¹⁵¹ Abdullahu,Prof.Dr.Aliu,*E Drejta Sendore*,Prishtinë ,2014,Fq.257.

si servitutet urbane më të rëndësishme, dhe të tilla në doktrinën juridikë janë shumë.

Përpos ndarjes tradicionale të servituteve, në doktrinën juridike ekzistojnë edhe ndarje të tjera të llojeve të ndryshme të servituteve si ato servitute pozitive dhe negative, servitutet të dukshme dhe padukshme etj.

5.Mbrojtja e servituteve sendore

Servitutet trajtoheshin si të drejta të pandashme dhe unike,¹⁵² e të njëjtave ju sigurohej mbrojtje juridike. Është e drejtë e pamohueshme e titullarit të së drejtës së servitutit sendor të kërkoj mbrojtje, nëse i cenohet kjo e drejtë.

LPDTS përcakton shprehimisht të drejtën e mbrojtjes duke përcaktuar: Nëse cenohet një servitut sendor, titullarit i takojnë të drejtat për pushimin e cenimit sipas nenit 102 të këtij ligji.¹⁵³ E neni 102 në paragrafin e parë përcakton që : Nëse pronësia cenohet përmes largimit ose marrjes së posedimit të sendit, pronari mund të kërkoj ndërprerjen e mëtejme të cenimit. Nëse priten cenime të mëtejme, pronari mund të ngritë padi për cenimet e tilla.

Padia për mbrojtjen e servitutit sendor është padi e veçantë juridiko-sendore dhe emërtohet me emrin Padi Konfessore (*Actio Confesoria*).Këtë padi ka të drejtë ta paraqes personi, i cili ka të drejtën e servitutit ndaj çdo personi të tretë, si dhe ndaj pronarit të paluajtshmërisë shërbyese¹⁵⁴.

LPDTS po ashtu përcakton që në qoftë se poseduesi i një paluajtshmërie dominuese pengohet në ushtrimin e një servituti sendor të regjistruar në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri, atëherë poseduesi përshtatshmërisht e gëzon të njëjtën mbrojtje të posedimit sikurse pronari.¹⁵⁵

6.Llojet e servitutet sendore në Shqipëri dhe Maqedoni

Servitutet përkatësisht servitutet sendore në Shqipëri rregullohen nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë. Për dallim nga LPDTS-ja servitutet sendore në Shqipëri emërtohen si servitute detyruese dhe trajtimi i tyre në kod bëhet prej nenit 265 deri tek neni 280.

Një hapë para në trajtimin e llojeve të servituteve sendore është Shqipëria.

Kodi Civil i Shqipërisë parashih disa lloje të servituteve detyruese.

- “ servitutet e rrjedhjes së ujërave” (në Kod njihen me termin “ rrjedhja e ujërave”).Këto servitute normohen nga nenet 266-271;

¹⁵² Puhan,Dr.Ivo, *E Drejta tomake*, Prishtinë, Fq.263.

¹⁵³ LIGJI NR.03/L-154 PËR PRONËSINË DHE TË DREJTAT TJERA SENDORE, Prishtinë 2009, neni 258.

¹⁵⁴ Abdullahu,Prof.Dr.Aliu,*E Drejta Sendore*,Prishtinë,2014,Fq.265-266.

¹⁵⁵ Po aty, neni 259.

- “servitutet e ndërtimeve” (në Kod njihen me termin “servitutet që rrjedhin nga ndërtimet”). Këto normohen nga neni 272;
- “servitutet e marrjes së ujit” (në Kod këto njihen me termin “servitutet që rrjedhin nga marrja e ujit”). Këto servitute normohen nga nenet 273-276;
- “servitutet e kalimit” që normohen nga nenet 277-279; dhe
- “servitutet e vendosjes së gypave, kabllove e telave” të normuara nga neni 280.¹⁵⁶

Sikurse LPDTS-ja i Kosovës edhe KCSH ka paraparë dispozita të veçanta për mbrojtjen e të drejtës së servituteve, në rastin tonë servitutet detyruese. Neni 292 “Mbrojtja e servitutit” përcakton që: “Personi që ushtron një servitut, ka të drejtë të kërkojë gjyqësisht nga kushdo që kundërshton këtë të drejtë, duke kërkuar sipas rastit rivendosjen e plotë të saj, pushimin e cenimit që i bëhet si edhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar”. Pra neni 292 përcakton të drejtën e titullarit të servitutit për ngritjen e padisë.

Sa i përket fitimit të servituteve detyruese KCSH parasheh dispozita të veçanta për krijimin e servituteve në përgjithësi.

KCSH përcakton që: Pronari i një prone që, në bazë të ligjit, ka të drejtë të kërkojë nga pronari i një prone tjetër krijimin e një servituti, në mungesë të një marrëveshjeje, mund t’i drejtohet gjykatës. Servituti detyruar mund të krijohet edhe me akt të organit shtetëror, në rastet e parashikuara me ligj. Vendimi duhet të përcaktojë rregullat e ushtrimit të servitutit dhe shpërblimin e dëmit përkatës.¹⁵⁷

Për dallim nga RSH në Maqedoni servitutet sendore emërtohen në të njëjtën mënyrë si në Kosovë.

LPDTS-ja i RM përcakton edhe llojet e servituteve sendore (ligji i Kosovës nuk parashihte ndonjë lloj të veçantë, në anën tjetër ai i RSH përcakton 5 lloje të veçanta të servituteve detyruese).

Llojet e servituteve sendore në RM janë:

- Servitutet sendore fushore;
- Servitutet shtëpiake;
- Servitutet tekniko-komunale;

LPDTS i RM-së, lidhur me mbrojtjen e servituteve nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë që përcakton mbrojtjen e tyre siç ishte rasti me RSH dhe RKS, por për trajtimin e çështjes së mbrojtjes së servituteve sendore në mënyrë analoge zbatohen dispozitat e mbrojtjes së të drejtës së pronësisë. Mbrojtjen e bënë gjykata, dhe inicimi i procedurës për mbrojtje e bënë titullari i të drejtës së servitutit me paraqitjen e padisë.

¹⁵⁶ Skrame, Olti, *Komentari i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë-Vëllimi i parë, Tiranë, 2011, Fq.358.*

¹⁵⁷ KODI CIVIL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, Tiranë, 2014, neni 265.

Për fitimin e të drejtës së servituteve sendore në RM ligji përcakton disa baza juridike dhe atë: në bazë të punës juridike,parashkrim fitues dhe vendim të organit shtetërorë.¹⁵⁸

Përfundimi

Servitutet si institucion u paraqitën qysh në kohën e të drejtës romake, si një kufizim në të drejtën e pronësisë së pronarit, dhe e drejtë e të autorizuarit të së drejtës së servitutit. Që atëherë por edhe sot servitutet u trajtuan dhe u përcaktuan me norma juridike, duke u klasifikuar në lloje të ndryshme.

Servitutet sendore të përcaktuara në legjislacionin e Kosovës, por edhe të vendeve të tjera paraqesin të drejtën e pronarit përkatës të një paluajtshmërie “paluajtshmëria dominuese”, që një paluajtshmëri tjetër “paluajtshmëria shërbyese”, në një mënyrë të caktuar ta shfrytëzojë apo të ndaloj kryerjen e veprimi të caktuar ose të përjashtoj ushtrimin e së drejtës së caktuar, të cila rrjedhin nga e drejta e pronësisë në paluajtshmërin shërbyese.

Punimi ka nxjerr në pah se në mënyrë të ngjashme servitutet rregullohen edhe Në legjislacionin e Shqipërisë dhe Maqedonisë.

Referencat

- I. Abdullahu,Prof.Dr.Aliu,E Drejta Civile, Prishtinë,2013;
- II. Abdullahu,Prof.Dr.Aliu,E Drejta Sendore,Prishtinë 2014;
- III. file:///C:/uploads-documents-2011-08-Servitudes_over_immovable_property_and_their_implications.pdf ;
- IV. Gojani,Skender,Fjalori i terminologjisë juridike,Prishtinë 2013;
- V. Grveber,Dr.Jur. Erwin,The Roman law of damage to property: being a commentary on the title of the digest Ad legem aquiliam (IX. 2) : with an introduction to the study of the Corpus juris civilis, Clark,New Jersey,2004;
- VI. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Dhjetor 2014
- VII. Ligji per Pronësi dhe të Drejta tjera Sendore, NR.03/L-154,Prishtinë, 2009;
- VIII. Ligji për Pronësi dhe të Drejta tjera Sendore,Maqedoni,2001;

¹⁵⁸ Më detaisht shih- LPDTS i RM, neni 199-200.

- IX. Noyes, C.Reinold,The institution of property,Clark,Neë Jersey,2007;
- X. Puhan,Dr.Ivo, E Drejta Romake, Prishtinë;
- XI. Skrame,Olti,Komentari i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë-Vëllimi i parë,Tiranë,2011;
- XII. Statovci, Ejup, E Drejta e Servituteve, Prishtinë,2009.

Regjistrimi i së Drejtës së Pronësisë sipas Kornizës Ligjore në Fuqi

Blerta
Rudi

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Republika e Kosovës

Abstrakti:

Duke u nisur nga fakti se në Kosovë fusha e të drejtave pronësore meriton një studim shumë të hollësishëm për shkak të kompleksitetit të saj nëpër vite, në këtë punim shkencor do të trajtohet Pronësia si e drejta më absolute e drejtës sendore, dhe regjistrimi saj në Regjistrin e të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme, me qëllim mbrojtjen e së drejtës së pronarit dhe ofrimin e sigurisë juridike.

Definimi i së drejtës së pronësisë dhe mbrojtja e saj ka qenë dhe mbetet qëllimi kryesor i rregullimit ligjor. Rregullimi i të drejtave pronësore dhe regjistrimi i tyre haset në të gjitha shtetet evropiane, i bazuar në një kornizë ligjore dhe institucionale që i përshatet rrethanave të kohës.

Meqenëse në Kosovë ndryshimi i regjimeve ka ndikuar që gjendja në fushën e drejtave pronësore në aspektin ligjor të jetë komplekse dhe njëherit e komplikuar, nëpërmjet këtij punimi jemi munduar të paraqesim sistemin e regjistrimit të drejtave pronësore, si dhe krahasimin e tij me vendet e ndryshme evropiane në bazë të metodave përshkruese dhe krahasuese, të cilat do ta ndihmojnë lexuesin që të kuptoj pikat e përbashkëta apo dallimet që e karakterizojnë me sistemet e shteteve tjera.

Regjistrimi i të drejtave pronësore është element kyç i cili ofron bazë të sigurt për të fituar, shfrytëzuar dhe disponuar me të drejtat mbi tokën. Krahas

pikëpamjes ligjore, efekti dhe rëndësia e regjistrimit të së drejtës mbi pronën mund të vlerësohet po ashtu edhe me rëndësi për ekonominë e vendit, pasi që sigurimi i të drejtave mbi pronën paraqet siguri për investime afatgjate, dhe që ekonomia e një shteti të ketë rritje.

Si përfundim, rezultatet e pritura nga ky punim kanë për qëllim të pasqyrojnë se trajtimi i institutit të regjistrimit të pronësisë është mjaft i rëndësishëm dhe i veçantë në sistemin juridik dhe ekonomik të vendit.

Fjalët e rëndësishme: E drejta e pronësisë, Legjislacioni, Regjistrimi i të drejtave pronësore, Regjistri, Kadastra.

Hyrja

Definimi i të drejtës së Pronësisë dhe mbrojtja e saj ka qenë dhe mbetet qëllimi kryesor i rregullimit ligjor. Në Kosovë ndryshimi i regjimeve ka ndikuar që në fushën e të drejtave pronësore të mbesin gjurmët e modeleve ligjore të trashëguara nga ngjarje të kaluara. Sistem i trashëguar ishte edhe sistemi i tapive, ku nëpërmjet tapisë mundësohej bartja e pronësisë. Ky sistem në mungesë të librave të tokës, kishte rëndësi të pakontestueshme sa i përket regjistrimit të drejtave të pronësisë, pasi që kështu krijoheshin bazat e para të një lloj kadastrë, mirëpo kishte mangësi të shumta.

Në raportet dhe studimet e ndryshme të përpiluar nga juristë, trajtimi i regjistrimit të pronësisë mbi pronën e paluajtshme është i rrallë. Vërehet një mungesë literature e theksuar në këtë drejtim, pasi që edhe në kuadër të librave të të drejtave sendore, regjistrimi përfshin një pjesë shumë të vogël të trajtimit, duke i pamundësuar si studentëve të Fakultetit juridik ashtu dhe të gjithë të interesuarve të tjerë që të dinë më shumë rreth këtij institucioni të rëndësishëm juridik.

Po e cilësoj si institut të rëndësishëm juridik duke u bazuar në efektin konstituiv që i jep fitimit të drejtës së pronësisë, parimit të ligjshmërisë dhe publicitetit në

mbrojtjen e të drejtave pronësore të titullarit dhe si formë nëpërmjet të cilit mundësohet administrimi më efektiv i tokës.

Kështu që, duke u nisur nga roli i regjistrimit të drejtës së pronësisë si në aspektin juridik ashtu edhe ekonomik, shpresoj po ashtu se trajtimi i kësaj teme do të kontribuoj sado pak në shqyrtimin juridik të tij.

1.Korniza ligjore në fushën e të drejtave pronësore dhe regjistrimit të tyre

Situata e krijuar në Kosovë në vitet e pasluftës, kishte nevojë për ndërhyrje në aspektin ligjor, pasi që administrata e UNMIK-ut me nxjerrjen e vendimeve dhe udhëzimeve të reja, si dhe mos definimi se cilat aktet ligjore kishin mbetur në fuqi nga e kaluara, kishin ndikuar që si rezultat të kishim një grumbull ligjesh, rregulloresh, vendime të cilat bënin situatën edhe më të komplikuar pasi krijonin konfuzitet se cili ligj është i aplikueshëm në rastin e caktuar.

Për zgjidhjen e kësaj situatë u konsiderua e nevojshme krijimi i një strategjie për përmirësimin e gjendjes, ku me përkushtim të madh juristët e vendit dhe ndërkombëtar filluan punën në hartimin e legjislacionit të ri në fushën e të drejtave pronësore. Perpjekjet për rregullimin ligjor të fushës së drejtave pronësore u konkretizuan në vitin 2009, pasi që korniza ligjore mbi të drejtat pronësore u kompletua me nxjerrjen e ligjit: "Për pronësinë dhe të drejtat sendore" nr. 03/L -154, i cili është ligji themelor për të gjitha drejtat sendore, përfshirë këtu të drejtën e pronësisë dhe regjistrimin e saj, përkatësisht nenet 115- 124 përcaktojnë qartë ligjet që rregullojnë regjistrimin dhe shtjellojnë parimet mbi të cilat funksionon instituti i regjistrimit të drejtave të pronë paluajtshme, me një theks të veçantë në trajtimin e parimit të përparësisë së regjistrimit. Deri me miratimin e këtij ligji, në Kosovë si ligj në fuqi ishte Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore-Juridike i RSFJ-së, i vitit 1980.

Me miratimin dhe amendamentimin e mëvonshëm të tij "Ligji për themelimin e regjistrimit mbi të drejtat e pronës së paluajtshme" si dhe e ligjit mbi Kadastrën, nr 2003/5, u mundësua të hidhen bazat e sistemit të ri kadastral në Kosovë

Ligji për themelimin e regjistrimit mbi të drejtat e pronës së paluajtshme është ligj relativisht i shkurtër me gjithsej 10 nene. Pjesa e parë përmban sqarime për fushëveprimin e ligjit, pastaj përcaktohen organet përgjegjëse të përfshira në regjistrim, të drejtat reale që mund të regjistrohen, baza ligjore për regjistrim, efektet e regjistrimit, dhe më tutje shtjellohet procedura e regjistrimit.

Regjistri i të drejtave mbi pronën e paluajtshme (RDPP), si regjistër publik njih dhe zbaton vlefshmërinë e të drejtave të pronës së paluajtshme në Kosovë sipas ligjeve në fuqi¹⁵⁹ duke shërbyer si një bazë e saktë e të gjitha transaksioneve pronësore të regjistruara, qoftë të së drejtës pronësisë apo drejtave tjera sendore. Regjistri për regjistrimin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme kryen funksionin e librave të tokës dhe si bazë të regjistrimit ka aktin juridik të fitimit të pronësisë mbi pronën e paluajtshme e caktuar e cila është e përcaktuar në bazë të matjeve kadastrale.

Ligji për Regjistrin solli shumë ndryshime në aspektin e regjistrimit dhe forcimit sigurisë juridike të të drejtave të pronarit mbi pronën, pasi themelimi i Regjistrimit të drejtave mbi pronën e paluajtshme (RDPP), do të kishte karakter publik dhe qytetarët do të kishin qasje më të lehtë për njohjen dhe verifikimin e drejtave pronësore, që nënkupton mundësi për realizimin e parimit të publicitetit dhe në të njëjtën kohë qarkullim më efikas dhe i sigurtë i të drejtave mbi paluajtshmëritë.

Gjithashtu, ligji është në përputhshmëri të plotë me legjislacionin e BE – së dhe mundëson zbatimin e direktivës së Komisionit Evropian të vitit 2007 lidhur me të dhënat hapësinore për secilin shtet. Ligji nuk ka implikime buxhetore por krijon bazë për gjenerim të ardhurash dhe mjedis të favorshëm afarist për biznese.¹⁶⁰

Në bazë të ligjit mbi themelimin e Regjistrimit të të drejtave mbi pronën e paluajtshme Pronësia si instituti juridik më i rëndësishëm i drejtës civile në

¹⁵⁹ Ligji për themelimin e Regjistrimit të të drejtave të pronës së paluajtshme.

¹⁶⁰ Transkript i mbledhjes plenare të kuvendit të republikës së Kosovës, të mbajtur më 12 maj 2011, fq.28, e publikuar në: http://www.assemblykosova.org/common/docs/proc/trans_s_2011_05_12_10_al.pdf (11.10.2016)

përgjithësi, e i së drejtës sendore në veqanti¹⁶¹ së bashku me të drejtat tjera sendore, përcaktohen si të drejta mbi pronën e paluajtshme.

2. Pronësia si koncept juridik

Të drejtat sendore e veçanërisht pronësia janë instituti më i lashtë i drejtës civile dhe konsideroj se është instituti më i rëndësishëm i sistemit juridik të një vendi.

E drejta e pronësisë ndaj një sendi nuk përfaqëson vetëm të drejtën mbi atë send por, si marrëdhënie juridike, përfaqëson edhe marrëdhënien themelore, më të rëndësishme juridike pronësore.¹⁶²

Legjislacioni ynë jep përkufizimin mbi pronësinë duke u mbështetur në Ligjin mbi pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, nr. 03/L -154, neni 18 thekson:“Pronësia është e drejta e tërësishme në një send. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t’i përjashtoj nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti”.

Një përkufizim i tillë absolut haset edhe ne Kodin civil gjerman i cili i jep të drejtë pronarit të sillet si të dojë me objektin e pronësisë së tij, gjithmonë në kornizat e përcaktuara me ligj, por duke i përjashtuar të tjerët. *(neni 903)*

E drejta e pronësisë është e rregulluar dhe e mbrojtur me dispozita ligjore dhe kushtetuese, është një e drejtë e transferueshme, dhe si e tillë kërkon rregullim të veçantë lidhur me vëllimin e të drejtës që bartet dhe titullarin kujt i bartet.

Në këtë mënyrë, regjistrimi i saj në regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme është i domosdoshëm dhe ka si qëllim mbrojtjen e së drejtës së pronarit dhe ofrimit të sigurisë juridike.

¹⁶¹ Aliu, A., E drejta sendore (Pronësia), Prishtinë, 2004, faqe 47.

¹⁶² Doracaku për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, 2008, fq.396.

Neni 2.1 i ligjit mbi Regjistrin e drejtave mbi pronën e paluajtshme përcakton vetëm të drejtat më të rëndësishme sendore të regjistrueshme duke e lënë në mënyrë të përgjithësuar se të drejtat e pronave të paluajtshme që mund të regjistrohen janë të drejtat që i takojnë tokës, ndërtesave dhe banesave dhe si të tilla kjo kategori përfshinë :

1. Pronësinë;
2. Hipotekat;
3. Servitutet,
4. Të drejtat e shfrytëzimit të pronave komunale, publike, shoqërore dhe pronave shtetërore dhe
5. Barrat dhe ngarkesat pronësore.¹⁶³

Mirëpo, në ligjin në fuqi nuk përcaktohen cilat forma të pronësisë mund të regjistrohen në regjistrin mbi të drejtat mbi pronën e paluajtshme, duke lënë të hapur interpretimin sipas gjykimit individual. Por edhe pse nuk përcaktohet qartë, ky formulim i nenit duhet të kuptohet se në Regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme mund të regjistrohen të gjitha format në të cilat mund të shprehet pronësia.

3. Regjistrimi i drejtës së pronësisë

Regjistrimi si koncept i përdorur në terminologjinë juridike është mjaft i hershëm.

Si koncept juridik regjistrimi do të thotë : regjistrimi zyrtar i interesave të njohura ligjërish në tokë dhe të cilat zakonisht janë pjesë e një sistemi kadastral.¹⁶⁴

Qëllimi i regjistrimit të së drejtës së pronësisë është që të krijohet një pamje e gjerë lidhur me kufijtë e asaj toke, pronarin dhe të drejtat mbi të. Të regjistrosh drejtën e pronësisë nënkupton krijim të pasojave juridike dhe përgjegjësi për të gjithë personat e tretë që të respektohet e drejta e pronësisë tjetrit.

¹⁶³ Ligji Nr. 04/L-009 “Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2002/ 5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme”.

¹⁶⁴ Ciparisse, G., Multilingual thesaurus on land tenure: English version, fq.89.

Regjistrimi si akt juridik i vërtetimit të drejtës pronësisë krahas nenit 7 të ligjit “Për themelimin e regjistrimit mbi të drejtat e pronës së paluajtshme” parashihet edhe me ligjin: ”Për pronësinë dhe të drejtat sendore” nr.03/L -154, ku aty shprehimisht në nenin 115 theksohet që për fitimin, ndryshimin e përmbajtjes, bartjen, shuarjen e pronësisë është e nevojshme një punë juridike e vlefshme si bazë juridike ndërmjet titullarit dhe një pale tjetër, si dhe është i nevojshëm regjistrimi i qdo ndryshimi juridik në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëritë, mirëpo aty nuk është dhënë ndonjë sqarim më i qartë se çfarë është regjistrimi, më shumë janë përqendruar në pasojat juridike që sjell akti i regjistrimit.

Poashtu, duke u ndërlidhur këtu me nenin 124 të po këtij ligji, përcaktohet qartë prezumimi ligjor se një e drejtë sendore i takon vetëm atij titullari tek i cili është i regjistruar e drejta sendore në Regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme.

Në këtë mënyrë regjistrimi paraqitet si institut i rëndësishëm për arsye të efektit konstituiv në fitimin e së drejtës së pronësisë, parimit të ligjshmërisë dhe publicitetit në mbrojtjen e të drejtave pronësore të titullarit dhe si formë nëpërmjet të cilit mundësohet administrimi më efektiv i tokës.

Regjistrimi kryhet nëpërmjet një procedure rigoroze ligjore e bazuar në kriteret e domosdoshme siç janë: dokumentet juridike të verifikuara nga noteri, ose vendimi i organi administrativ apo gjyqësor, dokument letërnjoftimi, certifikatën e vjetër (me përjashtim të fitimit të pronësisë me vendim gjyqësor) dhe një formular aplikim.

Të gjitha këto dokumente shërbejnë për regjistrimin e drejtës së pronësisë në regjistër dhe mungesa e ndonjërit prej kushteve të lartëpërmendura sjell pavlefshmërinë.

Vlefshmëria e aktit me të cilin regjistrohet pronësia është kriter i rëndësishëm i procedurës së regjistrimit, andaj parimi i ligjshmërisë konsiderohet një nga parimet bazë të regjistrimit të pronësisë.

Sipas ligjit mbi pronësinë, kushtet kryesore të fitimit të drejtës së pronësisë janë puna juridike dhe dorëzimi i sendit (modus aquirendi).

Tek sendet e paluajtshme, mënyrë e dorëzimit konsiderohet regjistrimi i saj në regjistrin e pronave, si element thelbësor i vlefshmërisë së veprimit juridik.¹⁶⁵

Sistemi i cili e kërkon regjistrimin për efekt të fitimit të pronësisë ose të drejtave tjera reale i bazuar në matjet gjeodezike dhe harta kadastrale quhet sistem kadastral, lloj ky i cili është i zbatueshëm edhe në Kosovë. Andaj, sipas sistemit tonë kadastral regjistrimi ka efekt konstituiv në momentin e regjistrimit të së drejtës në Regjistër dhe jo para regjistrimit.

Nëse bejmë vështrim krahasues në shtetet evropiane vërejmë se regjistrimi si efekt konstituiv aplikohet edhe në Qipro¹⁶⁶, Skoci, Austria, Kroacia, Republika e Çekisë, Anglia, Estonia, Hungaria, Slovakia, Slovenia, Gjermani.¹⁶⁷

Në këtë punim do të shtjellojmë shkurtimisht vetëm regjistrimin e të drejtës së pronësisë mbi sendet e paluajtshme.

Paluajtshmëria sipas legjislacionit në Kosovë definohet në këtë mënyrë: paluajtshmëria shtrihet në hapësirën mbi sipërfaqen e tokës dhe në hapësirën nën sipërfaqen e tokës, duke përfshirë pasuritë natyrore nëntokësore, bimët me rrënjë nën tokësore dhe objektet tjera të lidhura me bazament tokësor duke përfshirë një ndërtesë, e cila është në pronësi të një personi tjetër për dallim nga pronari i paluajtshmërisë, mbi të cilën është ndërtuar ndërtesa; pronësia në njësi të ndërtesës, drejta e ndërtimit dhe drejta e qirasë sendore sipas dispozitave përkatëse mbi qiranë.¹⁶⁸

Format e pronësisë të cilat mund të regjistrohen në Regjistër nuk janë të përcaktuara shprehimisht mirëpo nga ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore trajtohen veq e veq format e pronësisë që mund të regjistrohen e të cilat janë:

- a) pronësia individuale;
- b) bashkëpronësia;
- c) pronësia etazhe apo në njësi të ndërtesës.

¹⁶⁵ Shehu, A., "Pronësia", Tiranë, 2006, fq.107.

¹⁶⁶ Ligji mbi pronën e paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Qipros, (26.09.2016).

[http://www.moi.gov.cy/moi/DLS/dls.nsf/All/E76E80BF8616912CC2256FF9002C69B9/\\$file/Cap224_low_res.pdf](http://www.moi.gov.cy/moi/DLS/dls.nsf/All/E76E80BF8616912CC2256FF9002C69B9/$file/Cap224_low_res.pdf)

¹⁶⁷ Kodi Civil Gjerman , neni 873 , <http://www.fd.ul.pt/LinkClick.aspx?fileticket=KrijHyaFOkmw%3D&tabid=505e> (29.09.2016).

¹⁶⁸ Ligji mbi pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, neni 10.

3.1 Bashkëpronësia, prona e përbashkët dhe prona në etazhe

Duke qenë që prona e paluajtshme mund të jetë objekt i pronësisë i një individi por edhe i shumë personave, në rastet e këtilla është e nevojshme që të bëhet ndarja e vëllimit të së drejtës së pronësië për secilin pronar në masën që iu takon.

Ligji për pronësinë dhe të drejtat sendore nuk trajton rastin e regjistrimit të bashkëpronësisë, por duke marrë parasysh që bashkëpronësia është formë e pronësisë konsideroj se vlejné të njëjtat rregulla dhe procedura njëjtë si në rastin e regjistrimit të pronësisë individuale, me të vetmin dallim se zyrën kadastrale komunale në certifikaten e pronësisë tek bashkëpronësia shkruhen emrat dhe pjesët e caktuara që janë në pronësi të secilit person fizik apo juridik.

Kodi Civil i Shqipërisë specifikon edhe formën e njoftimit që duhet bërë nga ana e bashkëpronarit kur ai dëshiron të shesë pjesën e tij, forma njoftimit duhet të jetë me shkrim¹⁶⁹.

Pronësia etazhe apo pronësia në njësi të ndërtesës është pronësi e veçantë në një banesë, një hapësirë (lokal) afariste ose një vend parkim garazhi së bashku me pjesën e bashkëpronësisë në paluajtshmëri në të cilën ndodhet pjesa e ndërtesës¹⁷⁰

Pjesa e bashkëpronësisë në paluajtshmëri nuk mund të ndahet nga pronësia e veçantë në njësi të ndërtesës sepse Pronësia e përbashkët ekziston në paluajtshmëri (toka) mbi të cilën qëndron ndërtesa dhe kjo vlen edhe për të gjitha pjesët, instalimet dhe pajisjet, të cilat nuk janë në pronësi të veçantë ose në pronësi të një personi të tretë.

Sipas ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore të Republikës së Kosovës, titullari i pronësisë në njësi të ndërtesës ka të drejtë nëpërmjet deklaramit në zyrën kadastrale komunale të ndajë pronësinë e tij në pjesë edhe më të vogla, pra të krijojë bashkëpronarë në atë mënyrë, që së bashku në secilën pjesë të bashkëpronësisë pjesa e veçantë e pronësisë është themeluar mbi një banesë të caktuar ose një hapësirë të një ndërtese që është ndërtuar ose do të ndërtohet në atë paluajtshmëri.

¹⁶⁹ Kodi Civil i Shqipërisë, neni 204, e publikuar në: http://justice.gov.al/UserFiles/File/Legjislacioni_Brendshem_Web/Kodi_Civil.pdf (25.09.2016).

¹⁷⁰ Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore , neni 57 pika .1

Pjesa e veçantë e pronësisë janë hapësirat e caktuara si dhe pjesët përbërëse të ndërtesës që i takojnë këtyre hapësirave, të cilat mund të ndryshohen, mënjahohen ose plotësohen, pa u cenuar pronësia e përbashkët ose pronësia e veçantë e personave të tretë përtej masës së lejuar ose pa u cenuar pamja e jashtme e ndërtesës¹⁷¹, ndërsa çdo pronari i takon pjesa e cila është në përpjesëtim me vlerën e katit ose të pjesëve të katit që i përkasin atij.

Karakteristikë e këtij lloji të pronësisë është se nuk mund të tjetërsohet apo të ngarkohet pa pjesën tjetër të bashkëpronësisë, andaj është e nevojshme marrëveshja kontraktuese në situatën në të cilën ndodh ndryshimi juridik i tjetërsimit apo i ngarkimit me hipotekë dhe domodoshmërisht regjistrimi i saj në

Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëritë. Regjistrimi duhet të bëhet në pëlqim me bashkëpronarin.

Të gjitha vendimet të cilat mirren nga bashkëpronarët në njësi të ndërtesës duhet të jenë me shumicë votash, dhe të gjitha kufizimet në rast të tjetërsimit duhet të regjistrohen në Regjistër, njëjtë sikur shuarja apo fitimi i pronësisë në njësi të ndërtesës.

Rregullimi ligjor i pronësisë në njësi të ndërtesës sipas legjislacionit të Republikën Kosovës i përshtatet modelit të fundit që përfshin kombinimin e pronësisë së veçantë të banesës dhe të tokës së bashku me strukturat e përbashkëta.

4. Titullarët të cilët mund të regjistrojnë të drejtën e pronësisë

Marëdhënia juridike e drejtës së pronësisë si njëra nga të drejtave sendore kryesore është marrëdhënie e cila krijohet mes njerëzve lidhur me sendet. Legjislacioni në vendin tonë ka përcaktuar se titullar i të drejtave sendore, respektivisht në rastin tonë i të drejtës së pronësisë mund të jetë çdo person duke përfshirë këtu si personat fizik dhe personat juridik të regjistruar, nëse me ligj nuk parashihet ndryshe, shteti – komunat si dhe personat e huaj

Ligji për themelimin e Regjistrimit mbi të drejtat e paluajtshme dhe ligji i amandamentuar më vonë nuk e trajtojnë fare rregullimin se kush ka të drejtë të regjistrojë drejtën e pronësisë në Regjistër, pasi që ligji mbi pronësinë dhe të

¹⁷¹ Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, neni 60.

drejtat tjera sendore ka përcaktuar se titullar i drejtës sendore mund të jetë çdo person. Andaj, në mënyrë indirekte prezumohet se të gjithë titullarët e drejtës së pronësisë kanë të drejtë të regjistrojnë pronën e paluajtshme.

Në Kosovë aplikohet sistemi i regjistrimit të aktit juridik të vlefshëm, me regjistrimin të cilit njëkohësisht në certifikatën e pronësisë regjistrohet edhe emri i pronarit përkatës. Në rastin kur regjistrohet bashkëpronësia atëherë si titullarë regjistrohen të gjithë pronarët sipas pjesës që posedojnë.

4. Përfundimet

Deri në vitin 2000, në Kosovë u aplikua sistemi i tapive si sistem i trashëguar. Juridikisht u quajt kështu pasi TAPIA ishte dokumenti publik që dëshmonte të drejtën e pronësisë mbi një paluajtshmëri .

Në vitet 2000 filloi një etapë e re në Kosovë, por e cila shoqërohej me kaosin e ligjeve të trashëguara, udhëzimeve, rregulloreve të reja që u nxorrën nga administrata e Unmik-ut me qëllim të zgjidhjes së situatës së krijuar, dhe të gjitha së bashku krijonin konfuzitet se cili ligj është i aplikueshëm në rastin e caktuar, dhe si rrjedhim bën që gjendja e ndërlikuar legjislative praktikisht të vazhdojë.

Aktualisht, Kosova karakterizohet me sistem kadastral të regjistrimit të tokës i cili në vete përfshin edhe Regjistrin për të drejtat mbi pronën e paluajtshme. Funkcionalizimi i sistemit të regjistrimit të drejtës së pronësisë në regjistër është i bazuar në Ligjin e Pronësisë dhe të Drejtave tjera Sendore, si dhe në Ligjin për themelimin e Regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme, ligj ky i cili u amendamentua dy herë me qëllim të rregullimit më të detajuar të regjistrimit të drejtave mbi pronën e paluajtshme.

Në Kosovë aplikohet sistemi i regjistrimit i të drejtës së pronësisë sipas llojit të regjistrimit të dokumenteve-veprimeve juridike dhe efekti i regjistrimit i të drejtës së pronësisë në Regjistër ka karakter konstituiv, si element thelbësor i vlefshmërisë së veprimit juridik.

Format e pronësisë të cilat mund të regjistrohen nuk janë të përcaktuara shprehimisht mirëpo në Ligjin për Pronësisë trajtohen këto forma të pronësisë:

1. pronësia individuale; 2. bashkëpronësia; 3. pronësia etazhe apo në njësi të ndërtesës.

Sikur Kosova të zbatonte kohë më parë një sistem efikas të regjistrimit të tokës konsideroj se do të zvogëlonte mosmarrëveshjet dhe kontestet e shumta mbi pronat, ku si pasojë edhe gjykatat janë tej mase të mbingarkuara.

Si përfundim, trajtimit të kësaj teme do i shoqëroj disa rekomandime të cilat konsideroj se do ti ndihmojnë zhvillimit të sistemit të regjistrimit të së drejtës së pronësisë.

Rekomandime

- Zhvillimi i fushatave sensibilizuese dhe futja në planprogramet mësimore të Fakultetit Juridik si lëndë obligative: “Regjistrimi i Paluajtshmërive” në mënyrë që të kemi vetëdijësim më të madh që të rritet numri i regjistrimeve të së drejtës së pronësisë
- Për shkak të rëndësisë së jashtëzakonshme së këtij instituti juridik, shteti Kosovës duhet të përgatisë strategjitë dhe politikat e zhvillimit me qëllim të përsosjes së sistemit të regjistrimit të tokës dhe të drejtave mbi të, për të krijuar një ambient të favorshëm për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Referencat

1. Aliu, A., E drejta sendore (Pronësia), Prishtinë, 2004,
2. Ciparisse, G., Multilingual thesaurus on land tenure: English version,
3. Doracaku për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, 2008,
4. Kodi Civil i Shqipërisë
5. Kodi Civil Gjerman
6. Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore,
7. Ligji Nr. 04/L-009 “Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2002/ 5 për themelimin e regjistrimit të të drejtave të pronës së paluajtshme”
8. Ligji mbi pronën e paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Qipros

[http://www.moi.gov.cy/moi/DLS/dls.nsf/All/E76E80BF8616912CC2256F9002C69B9/\\$file/Cap224_low_res.pdf](http://www.moi.gov.cy/moi/DLS/dls.nsf/All/E76E80BF8616912CC2256F9002C69B9/$file/Cap224_low_res.pdf)

9. Shehu, A., “Pronësia”, Tiranë, 2006, fq.107.
10. Transkript i mbledhjes plenare të kuvendit të republikës së kosovës, të mbajtur më 12 Maj 2011, e publikuar në:
http://www.assemblykosova.org/common/docs/proc/trans_s_2011_05_12_10_al.pdf

Sfidat e femrave në biznese – Studim praktik në Shqipëri

Msc. Joana Lleshi
Universiteti i Tiranës, Republika e Shqipërisë,

Msc. Rigerta Memoçi
Universiteti i Tiranës, Republika e Shqipërisë,

Abstrakti:

Qëllimi i këtij studimi është paraqitja e sfidave dhe barrierave të cilat prekin femrat dhe që ndikojnë në mundësinë e rritjes së tyre në profesion. Këto sfida janë të lidhura kryesisht me barrierat që krijojnë diferencime në gjini dhe me krijimin e asaj që prej shumë studiuesve është quajtur “tavani i qelqtë”.

Metodologjia e përdorur në këtë studim është e mbështetur në mbledhjen e të dhënave në praktikë nëpërmjet instrumentit kërkimor intervistë. Mostra e marrë në shqyrtim është e përbërë prej 32 femrave të cilat i përkasin moshave të ndryshme, pozicioneve specialiste dhe menaxhere dhe të cilat punojnë kryesisht në kompani me aktivitet tregtar dhe shërbimi.

Nëpërmjet këtij studimi u arrit të identifikohen dy kategori barrierash që pengojnë femrat në Shqipëri për rritjen e tyre në karrierë; barrierat sociale dhe barrierat strukturore. Rezultatet e studimit tregojnë që akoma në Shqipëri “tavani i qelqtë” po ndikon në promovimin dhe rritjes së mundësisë së femrave për tu zhvilluar më shumë profesionalisht.

Fjalët e rëndësishme: femra, menaxherë, biznese, tavani i qelqtë, gjini, barriera sociale, barriera strukturore

1. Hyrja

Edhe pse janë realizuar shumë zhvillime në aspektin e karrierës, mundësia e femrave për t'u zhilluar në nivele të larta profesionale vazhdon të jetë në nivele jo të konsiderueshme. Egly (2003), Hymowitz & Schellhardt(1986) si dhe Stone (2013) nëpërmjet punës së tyre kanë treguar se ekzistojnë një sërë barrierash që pengojnë femrat që të jenë në pozicione të larta drejtuese në organizatë qofshin këto psikologjike, sociale apo organizative.

Nga ana tjetër qëndrojnë edhe raportet ndërkombëtare si ato të FTSE të cilat tregojnë që numri i femrave në pozicione të tilla drejtuese po rritet gjithnjë e më shumë. (Sealy & Vinnicombe, The Female FTSE Board Report, 2012). Bazuar në këto studime ky punim synon të analizojë se cilat janë barrierat e femrave në Shqipëri në rritjen e tyre në karrierë; A është arritur që të thuhet “tavani i qelqtë”? Për të bërë një analizë më të mirë të problemit janë realizuar 32 intervista me femra në pozicione të caktuara pune.

Pjesa e parë e studimit është e përbërë nga rishikimi i literaturës e cila tregon pikpamjet dhe studimet e kryera në këtë fushë. Në pjesën e dytë do të tregohet një përshkrim i metodologjisë së përdorur. Në pjesën e fundit do të paraqiten rezultatet dhe përfundimet e arritura nga ky studim.

2. Rishikim Literature

Në 2012, rritja e numrit të aktiviteteve të ndryshme të biznesit ka ndikuar edhe në rritjen e numrit të femrave në bordet drejtuese në tërë botën. Ekziston një rritje me rreth 15% të femrave në bordin dejtues të FSTE100, si dhe një rritje me rreth 6.6% në bordin ekzekutiv. Dhjetë firma të tjera kanë femra në bordin e tyre drejtues dhe më shumë se 50% të kompanive tashmë kanë më shumë se një grua në bord, gjë që demonstron që po lëvizim larg asaj që quhet

tokenizem.¹⁷²(Sealy & Vinnicombe, The Female FTSE Board Report2012, 2012).

Hulumtimet nga Corporate Citizenship dhe ICCSR kanë analizuar iniciativat e biznesit në fuqizimin e femrave dhe ndikimin që kanë ato në zhvillimin e tregjeve. Kjo tregon se bizneset po i shohin femrat si konsumatore potenciale, punonjëse, furnizuese dhe mbështetëse. Bizneset shohin një numër përfitimesh nga investimi në fuqizimin e grave.

Së pari, investimi tek femrat shpërndan mundësi ekonomike duke krijuar një komunitet më të fortë dhe si rezultat një bazë të gjerë punonjësish dhe konsumatorësh potencial. Së dyti, duke rritur numrin e grave në gjithë zinxhirin e vlerës dhe duke investuar në nivelin e trajnimit dhe edukimit të tyre një kompani mund të arrijë nivele të larta produktiviteti. Së fundi, angazhimi i grave në rrjetin shpërndarës në tregjet në zhvillim dhe targetimi i tyre si një grup potencial konsumatorësh mund ta ndihmojë kompaninë të rrisë shitjet. (Citizenship, 2012).

Organizatrat që dëshirojnë të maksimizojnë mundësitë që vijnë nga diversiteti i gjinive në menaxhimin e lartë, duhet të sigurojnë që sjelljet e femrave lider janë perceptuar ashtu siç duhet dhe përkrahen për vlerat e tyre të vërteta. Ata duhet të përditësojnë procesin e tyre menaxherial si: zhvillimi i lidërsip-it, kompetencat e lidërsip-it dhe mënyra e vlerësimit të tyre.(Vanderbroeck, 2010)

Megjithatë, edhe pse kohët kanë ndryshuar vazhdojmë të kemi një dominim të meshkujve në pozicionet më të larta hierakike në biznese, në administatën publike apo edhe në fushën politike.

Femrat duken se janë të predispozuara për të mos qënë pjesë e ketyrë niveleve. Përpara tyre shfaqen një sërë problemesh, shpesheherë të pakuptueshme. Për të treguar këtë fenomen përdoret termi i “tavanit të qelqtë”. Ky term i referohet barrierave me të cilat përballen femrat për të kaluar në pozicione të larta në organizatë. (Hymowitz & Schellhardt, 1986).

Sipas (Browne, 2003), “tavani i qelqtë” i referohet barrierave anësore që frenojnë individin për të levizuar apo zhvilluar në karrierën e tyre duke krijuar kështu ndarje të punës sipas gjinive apo racës.

¹⁷²Do të thotë të jesh pjesë e një grupi të vogël, ose minoriteti, pra dhe përbën pjesë të vogël të popullatës, më pak se 15%. Në problemet e gjinisë ajo shfaqet si një fenomen i cili vjen si rezultati i një posti të punës që nuk mund të kryhet nga femrat.

Barrierat kryesore që pengojnë femrat në zhvillimin e tyre në sektorin privat janë: barrierat sociale, që janë jashtë vendimeve dhe kontrollit të bizneseve (barriera këto që kanë të bëjnë me mundësitë e arsimimit dhe të zhillimit sipas gjinisë); barrierat strukturore, që janë në kontrollin e bizneseve (praktikat e rekrutimit, klima

në orgnizatë, trajnimet, standarte speciale ose të ndryshme etj); dhe barrierat qeveritare (ligjet mbrojtëse etj). (Commision, 1995).

Paula Stone në studimin e saj tregon që barrierat më të mëdha që femrat kanë për tu rritur profesionalisht janë barrierat të cilat krijohen më shumë si rezultat i stereotipeve të shumta që kanë për femrat, stereotipe që janë të bazuara në traditën e të parit femrën shtëpiake dhe jo profesionale. Pavarësisht kësaj ajo mbështet faktin që femrat e kanë më të vështirë që të arrijnë shpërndarjen e duhur të kohës midis familjes dhe punës. Ajo tregon që 90% e femrave largohen nga vendi i punës pasi bëhen nëna për shkak të kushteve jo të favorshme që bizneset ofrojnë për të arritur një balancim më të mirë të kohës midis punës dhe familjes. (Stone, 2013)

Pavarësisht se si grupohen këto lloje barrierash, i rëndësishëm është fakti që duhet të identifikohen dhe të shmangen në çdo organizatë. Gjithashtu sipas studimeve tregohet që mënyra efektive se si një individ udhëheq, nuk është e lidhur me aspektin biologjik, pra e ndarë midis gjinive, por vjen si rezultat i procesit të socializimit (Eagly A., 1994).

Sipas (Eagly, 2003), nuk është “tavani i qelqtë” ai që ndikon që femrat të mos jenë pjesë e bordeve menaxhuese, por një sërë pengesash që hasin ato gjatë rrugëtimit të tyre drejt këtij destinacioni. Sipas tyre disa nga pengesat për zhvillimin e femrave në biznes janë: paragjykimet, çështjet e lidhshme me lideritetin, përgjegjësia e familjes, mosinvestimi aq sa duhet në ndërlidhjet shoqërore (ose kapitalin social), si dhe diskriminimi (mendësitë) ndaj lideritetit të grave. Një metaforë më e mirë për të përshkruar këtë gjendje mund të jetë labirinti. Për fermat të cilat aspirojnë drejt top leadership-it, ekzistojnë rrugë por që janë me shumë kthesa, me shumë të papritura dhe të pritura.

Pavarësisht këtyre studimi i realizuar nga (Barsh, 2012) tregon faktin që femrat do të dëshironin të ishin pjesë e bordeve drejtuese, por në krahasim me meshkujt aspiratat e tyre për pozicion të tillë janë më të ulëta në përqindje.

Një tjetër studiuës tregon raportin që ekziston ndërmjet pagës mesatare të meshkujve dhe atyre të femrave për të njëjtën pozicion pune. Nga studimi i tij rezulton që femrat fitojnë rreth 75% të asaj që fitojnë meshkujt. (Valle, 2004)

3. Metodologjia

Në mënyrë që të kuptohet situata e femrave në organizatë, mënyra se si ato trajtohen, barazia gjinore dhe ekzistenca ose jo e barrierave për zhvillimin dhe rritjen e tyre në organizatë, u realizua një përjasje përmes intervistave. U zgjodhën intervistat për shkak të një sërë avantazhesh që ato ofrojnë si një metode kërkimore. Nëpërmjet intervistës mund të kuptohen pikëpamje të ndryshme të subjektit dhe të kuptohen ekperiencat e tyre. (Kvale, 1996). Intervistat lejojnë individët që të përçojnë tek të tjerët një situatë nga prespektiva e tyre. Intervista i ka bazat e saj në një bisedim të përditshëm por pyetjet e të cilës janë të kontrollueshme nga kërkuesi.

Kështu intervista luan një rol të rëndësishëm në depërtimin e thellë ndaj fenomeneve në studim si dhe në pasurim e të kuptuarit të fenomenit. (Bryman, 2004)

Pavarësisht se ekzistojnë studime të ndryshme për rolin e femrës në biznes, akoma në Shqipëri një studim i tillë kualitativ, i cili tenton që të identifikojë problematikat në këtë aspekt nuk është realizuar. Në shumicën e rasteve ato janë studime më shumë në formën e raporteve, në formën treguese, numerike të zhvillimit të femrave në biznes. Kështu pyetjet e intervistës u mbështën nga studimi i realizuar prej Mc Kinsey në 2012 dhe në studimin e Stone në 2013, të përshtatura me situatën në Shqipëri.

Ky studim u përqëndrua në pyetje të hapura të cilat i japin mundësi çdo personi të intervistuar të të përshkruajë më mirë situatat, motivet, problemet dhe për të dhënë një opinion të përgjithshëm rreth situatës. Shembuj të pyetjeve që ju drejtuan personave të intervistuar të cilat ishin vetëm femra janë: **“Ekzistojnë të njëjta oportunitete në ngritje në detyrë si për meshkujt edhe për femrat?”**, **“Pse?”**, **“A mendoni se ka pengesë në parandalimin e femrave në nivelin më të lartë në profesion, pavarësisht nga arritjet e tyre dhe meritat (si për shembull**

nje vlerësim i punës jo i barabartë, shpërblime jo të barabarta etj)”. Përveç këtyre, të intervistuarave ju kerkua që të përcaktonin të tjera çështje relevante në mënyrë që asnjë shqetësim i rëndësishëm të mos mbetet i pa identifikuar.

Ky studim u realizua me 32 femra prej të cilave pjesa më e madhe të tyre i përkiste intervalit të moshës 31-40 vjece prej 42% dhe 38% përbënin femrat e moshës 41-50 vjeçe, ndërsa shpërndaja sipas pozicionit pjesën më të madhe e përbënin femrat të cilat ishin në pozicione specialist dhe vetëm 17 femra ishin në pozicione menaxheri. Kohëzgjatja e intervistës varioi nga 20 deri në 40 minuta.

Përpunimi i të dhënave cilësore është realizuar me ndihmën e programit Nvivo. Për shkak të masës së vogël të kampionit rezultatet e këtij studimi nuk mund të përcaktohen si përfaqësuese të të gjithë situatës aktuale për të shpjeguar situatën në të cilat ndodhen femrat në organizata. Megjithatë përmes këtij studimi i cili mund të konsiderohet më tepër me natyrë kërkuese, mund të arrijmë në disa konkluzione të rëndësishme. Hulumtimi i realizuar është cilësor me qëllim për të nxjerrë në pah situatën që paraqitet në organizatat shqiptare e shprehur kjo përmes opinionit të vetë femrave.

4. Rezultatet

Gjatë analizës së të dhënave u vu re që tema e trajtuar përbënte një problem shumë të mprehtë në Shqipëri. Analiza e të dhënave të mbledhura gjatë intervistave nxorri në dukje shumë probleme me të cilat femrat ndeshen sot në ambientin e punës.

Sipas analizës së të dhënave, një ndër sfidat me të cilat femrat përballen në vendin e punës ishte mentaliteti patriarkal që shoqëria shqiptare zotëronte. Kështu njëra prej të intervistuarave shprehej:

“Meshkujt shihen si më të pushtetshëm, më të plotësuar. Ndoshta kjo vjen nga vetë fakti se ata gjithnjë janë parë si më të fortët e shoqërisë” .

Sfida e tjetër për të cilat shumë femra e diskutuan gjatë intervistës ishin edhe dhënia e mundësive për t’u rritur në karrierë. Sipas tyre nivelet e larta

menaxheriale janë pozicione të cilat në vazhdimësi janë zotëruar dhe vazhdojnë të zotërohen nga meshkujt. Kjo vjen si rezultat i perceptimit të këtyre pozicioneve për individë të cilët janë më pak të lidhur me përgjegjësi familjare, janë të gatshëm të levizin dhe të jenë fleksibël me kërkesat e biznesit, dhe këta individë i përkasin gjinisë mashkullore.

“ Për mua ka qënë shumë e vështirë që të fitoja vendin e punës aktuale. Në çdo takim të realizuar më është kërkuar pjesa e fleksibilitetit dhe për mundësitë që unë si femër kisha për t’i realizuar. Pajtohem me faktin që fleksibiliteti është diçka që duhet planifikuar pasi ndikon në jetën tone, por besoj është e njëjta gjë edhe për meshkujt. Shpërndarja e përgjegjësive familjare duhet të jetë e njëjtë dhe te dy gjinive ti jepen të njëjtat mundësi ”.

Problematikë tjetër që shumë prej femrave i pengonte në punën e tyre të përditshme apo e shikonin si faktor pengues për t’u rritur në të ardhmen në karrierën e tyre ishte balancimi i jetës familjare me atë profesionale. Ato tregojnë faktin që një prej shkaktarëve kryesorë në krijimin e problemeve për këtë balancim janë kushtet që shumë kompani në Shqipëri ofrojnë dhe të cilat duhet të ndryshohen.

Pavarësisht këtyre sfidave, gjatë analizës së të dhënave u vu re që edhe pse mendimit të ndryshëm që eprorët kishin në lidhje me pozicionin dhe përfaqësimin e femrave në organizata, ato vazhdonin të mendonin që posedonin aftësitë e nevojshme për një pozicion drejtues. Shumica e tyre aspironin që në një të ardhme të kishin një pozicion me përgjegjësi më të mëdha.

“Do të doja që pas 5 vjetesh të isha pse jo drejtoreshë e sektorit”

“Do të më pelqente të isha menaxhere e përgjithshme në këtë institucion”

Prej të gjithë këtyre problemeve që u parashtruan më lart, femrat e e intervistuarat u shprehën pozitive dhe besonin në aftësitë dhe mundësitë që kishin për t’u promovuar. Gjithashtu janë dhënë sugjerime nga ana e tyre për përmirësimin e situatës, si përsëmbull: krijimi i punëve me orare fleksibël, ndarja e përgjegjësive familjare, specializimet, kualifikimet, ambicia etj.

5. Përfundimet

Në analizën që iu bë të dhënave u arrit në identifikimin e disa problemeve dhe kategorizimin e tyre në dy kategori kryesore; barriera sociale dhe barriera strukturore. Së pari, nga analiza e të dhënave u konstatua si një problem *mentaliteti patriarkal*. Në shumë kompani, sipas këtij studimi, ekzistonin praktika që i konsideronin femrat si të papërshtatshme për të zotëruar pozicione drejtuese. Për më tepër, kishte dhe paragjykime lidhur me aftësitë që ato kishin për një pozicion drejtues. Një tjetër problem i evidentuar ishte edhe *balancimi i kohës*. Përveç përgjegjësi në ambientin e punës, mbi femrat rëndonin edhe përgjegjësitë familjare, kryesisht në aspektin kohor. Për to ishte pothuajse e pamundur që të punonin në orare të zgjatura, jashtë orarit zyrtar dhe kishte një mungesë të theksuar të orareve fleksibël të punës. Ekzistonte një klimë mosbesimi në lidhje me aftësitë që kjo e fundit zotëronte. Së katërti, u evidentua dhe problemi i *mundësive*. Një pjesë e konsiderueshme e të intervistuarave deklaruan se nuk ekzistojnë të njëjtat oportunitete zhvillimi në punë. Ata trajtohen ndryshe nga punëdhënësit tyre vetëm si rrjedhojë e gjinisë së tyre.

Limitet e studimit. Numri i ulët i femrave të marra në intervistë përbën limitin kryesor të këtij studimi. Gjithashtu disa prej femrave të intervistuar nuk kushtuan kohën e duhur për të realizuar një studim efektiv si dhe disa prej tyre jepnin një përgjigje të përgjithësuar dhe në formë teorike më tepërisht se sa dhënia e një përvoje të tyre në punë. Në këtë mënyrë, limitet e këtij studimi nuk lejuan që të paraqitej një pamje e saktë e problemeve dhe barrierave që kanë femrat e punësuar në bizneset në Shqipëri.

5. Referencat

Barsh, J. &. (2012). *Unlocking the full potential of woman at work*. McKinsey.
Browne, M. N. (2003). *Many paths to justice: The glass ceiling, the looking glass and strategies for*, *Hofstra Labor & Employment Law Journal*.

- Bryman, A. (2004). *Social Science Research Methods*. Oxford: Oxford University Press.
- Citizenship, C. (2012). *Women mean Business Empowerment in Developing Markets*. UK: Nottingham University.
- Commision, F. C. (1995). *Good for Business: MAKING FULL USE OF THE*. Washington.
- Eagly, A. (1994). Social role theory of sex difference and similarity. *Harvard Business Review* .
- Ealy, A. &. (2003). *The female leadership atvantage: An evaluation*. *The Leadership Quarterly*.
- Hymowitz, C., & Schellhardt, T. D. (1986). The Glass ceiling. *The wall street journal* .
- Kvale, S. (1996). *Interviews: An Introduction to Qualitative Research Interviewing*. Sage Publications , 1.
- Sealy, R., & Vinnicombe, S. (2012). *The Female FTSE Board Report*. FTSE.
- Sealy, R., & Vinnicombe, S. (2012). *The Female FTSE Board Report2012*. Cranfield International Centre for Women Leaders.
- Stone, P. (2013). Challenging Stereotypes and Creating Real Options for Women in the Professions. *Hunter College and Graduate Center, CUNY* .
- Valle, M. (2004). In search of the 75 cents-on-the-dollar woman. *Equal Opportunities International* .
- Vanderbroeck, P. (2010). The traps that keep women from reaching the top and how to avoid them. *Journal of Management Development* .

6. Shtojca

INTERVISTA Nr. _____

PREZANTIMI: Përshëndetje, quhemi _____ dhe _____ dhe jemi përfshirë në një studim në lidhje me rolin e gruas në botën e biznesit shqiptar. Për këtë qëllim kemi realizuar një pyetësor të shkurtër. Informacioni do të jetë konfidencial dhe anonim. Ju lutem që pergjigjet të jenë sa më të sinqerta në mënyrë që studimi të jetë sa më i vlefshëm.

Data e intervistimit __ / __ / 2016.

Ora e fillimit të intervistës

Ora e mbarimit të

intervistës __

Pozicioni.....

...

Vitet në këtë lloj pune

Mosha 21-30 31-40 41-50 50-60 >60

1. *A mund të na tregoni pak rreth background-it tuaj. Si keni arritur deri këtu ku jeni aktualisht? Sa vite pune keni në këtë pozicion?*
2. *Sa përqind e punonjësve janë në pozicionet drejtuese?*
3. *Pse mendoni se ka kaq pak femra në pozicione drejtuese?(Nqs ka)*
4. *Ekzistojnë të njëjta oportunitete në ngritje në detyrë si për meshkujt edhe për femrat? Pse?*
5. *Mendoni se femrat e kanë të vështirë që të imagjinojnë veten e tyre në të tilla funksione?*
6. *Cilat janë sfidat më të mëdha me të cilat përballen gratë në vendin e punës?*
7. *Mendoni se meshkujt dhe femrat trajtohen në mënyra të ndryshme në punë? Pse?*
8. *Si e balanconi punën me jetën private? Mendoni së përgjegjësia familjare po ndikon në suksesin në punë?*

- 9.** *A mendoni se ka pengesë në parandalimin e grave në nivelin më të lartë në profesion, pavarësisht nga arritjet e tyre dhe meritat (si për shembull një vlerësim i punës jo i barabartë, shpërblime jo të barabarta etj.)*
- 10.** *Ku e shikoni veten pas 5 vjetësh?*

Rendesia e Internet Marketing
(Rasti : Marketingu në internet dhe Shqipëria)

Msc Armira Lazaj

Universiteti “Luarasi”, Tirane, Shqiperi,

Abstrakti:

Marketingu në internet dhe shërbimet elektronike konsiderohen si fushat më të reja të kërkimit të cilat paraqesin një rëndësi strategjike për bizneset që kanë drejtuar përpjekjet e tyre drejt tregut elektronik.

Studimet kanë treguar se sjellja e konsumatorëve online ndryshon (në disa aspekte të rëndësishme) nga sjellja e konsumatorëve në tregun tradicional. Nga ana tjetër manaxherët duket të kenë një kuptim të mirë të nevojave të konsumatorëve për ti përmbushur ato në mënyrë efektive dhe efiçiente në mjedisin elektronik.

Cilësia e shërbimeve elektronike është një koncept mjaft i diskutuar sidomos vitet e fundit.

Ajo është përkufizuar si: “Shkalla në të cilën, një website lehtëson apo ndihmon procesin e blerjes (duke e bërë atë sa më efektiv dhe efiçient) dhe shpërndarjen e produkteve apo shërbimeve”.

Cilësia e shërbimeve elektronike është një tregues i fuqishëm i kënaqësisë konsumatore në website.

Fjalët e rëndësishme: Marketing, Internet, Online, Website, Shërbim, Konsumator

Hyrja

Globalizimi i tregjeve, nevoja për përdorimin e teknologjive të reja në fushen e biznesit, si dhe intensifikimi i konkurrencës po bëhen gjithnjë e më të rëndësishëm. Kjo tendencë pritet të vazhdojë edhe në të ardhmen. Kjo është epoka e informacionit. Çdokush përdor informacionin për të marrë vendime dhe për të reduktuar riskun e perceptuar. Zhvillimet e fundit në fushën e teknologjive të informacionit kanë bërë që interneti dhe komponenti më i ri World Wide Web të jenë në fokusin e marketerëve të cilët kanë kuptuar rëndësinë strategjike dhe fuqinë e tij.

173"Kur ne e lidhim informacionin në internet, e nxisim veten për të zbuluar fakte, të krijojmë ide, të blejmë dhe të shesim gjëra, duke krijuar kështu marrëdhënie të reja me një shpejtësi dhe shkallë që ishte e paimagjinueshme në epokën analoge": Shkruan **Zoti** Berners-Lee.

Kjo ide e thjeshtë e "Lidhjes së informacioneve" që ka transformuar politika dhe ka përmbysur qeveritë çoi në shpikjen e bizneseve të sotme më të njohura globale, dhe në mënyrë të pakthyeshme ka ndryshuar ndërveprimet tona sociale me botën.

Nevoja për marketingun në internet

Marketingu në internet adaptohet sipas nevojave të konsumatorëve, redukton kostot e transaksioneve, lejon zhvendosjen e konsumatorëve nga sjelljet bazuar në kohë dhe lokalizim (dobia e vendit, kohës, zotërimit) tek sjellje jo të përkoshme dhe të palokalizuara.

Studimet e fundit në fushën e marketingut në internet janë ndarë në dy grupe të mëdha ku grupi i parë pajtohet me mendimin se Web-i ka ndryshuar logjikën dominante të marketingut kurse grupi tjetër nuk pajtohet me këtë mendim. Megjithatë duhet të theksojmë se të dy grupet janë të mendimit se përfitimet e marketingut në internet dominojnë problemet që mund të ketë ai.

¹⁷³ <http://webfoundation.org/about/vision/history-of-the-web/>

Në ditët e sotme interneti, përfaqëson platformën më të madhe elektronike për biznesin në sektorin biznes-konsumator, e cila ofron jo vetëm oportunitete të shumta për marketerët por edhe një mënyrë të re dhe dinamike për realizimin e aktiviteteteve marketing.¹⁷⁴“Marketingu në internet konsiderohet si një nga mënyrat më moderne të realizimit të biznesit si dhe një nga zonat më të nxehta që kërkon studime të mëtejshme.”

Kërkimet e fundit në fushën e shërbimeve marketing theksojnë cilësinë e shërbimeve si një nga prioritetet më të rëndësishme për kërkimet aktuale dhe ato në të ardhmen. Fokusi i industrive të ndryshme tek cilësia e shërbimeve lidhet me fuqinë konsumatore në rritje, intensifikimin e konkurrencës dhe saturimin e tregjeve.

Cilësia e shërbimeve elektronike është bërë një nga elementët bazë të diferencimit të ofertës në treg.

Shërbimet elektronike konsiderohen si një mjet për t’iu drejtuar nevojave konsumatorëve dhe iu referohen shërbimeve me vlerë të shtuar të cilat kanë për qëllim të sigurojnë një vlerë specifike për konsumatorët në tregun elektronik. Nga ana tjetër ato konceptualizohen si mjetet kryesore të marketingut në internet, biznes- konsumator. Shërbimet elektronike në këtë punim përcaktohen si tipare të website-it të cilat shtojnë vlerën e proceseve dhe kënaqin më së miri nevojat e konsumatorëve online.¹⁷⁵“Shërbimet elektronike përfshijnë të gjitha shërbimet bashkëvepruese të cilat shpërndahen nëpërmjet internetit duke përdorur telekomunikimin e avancuar, informacionin dhe teknologjitë multimedia.

”Shërbimet elektronike mund të përkufizohen si tërësia e përpjekjeve para, gjatë dhe pas transaksioneve online”.

Marketingu në internet në Shqipëri dhe krijimi Marrdhënia Konsumator,Website,Shërbim.

Në Shqipëri marketingu nëpërmjet internetit është një risi. Ai filloi të aplikohet si një formë për të thirrur në tregun shqiptar të huajt. Analizat e marketingut online tregojnë se ende sot fjlëkërkimet që lidhen me Shqipërinë më së shumti pikëzohen në “Travel Albania” dhe “Acomodation Albania”, pra udhetime per

¹⁷⁴ <http://www.netregistry.com.au/resources/what-is/online-marketing/what-is-online-marketing/>

¹⁷⁵ <http://www.uamd.edu.al/new/wp-content/uploads/2013/12/Dizertacioni-Ervin-Myftaraj.-Maj-2014.pdf>

ne Shqipëri. Këto kërkime janë të orientuara më pak për klimën “Weather Albania”, ndersa kerkimet e tregut janë ende shumë larg. Kjo sepse oferta e tregut Shqiptar, të ngritur kryesisht mbi importe, nuk paraqet ndonjë interes. Shumë pak prodhues kanë përmirësuar imazhin e tyre në rrjetin botëror të informacionit këto vitet e fundit, ndërsa shumica e biznesmenëve shqipëtar edhe kur përdorin postën elektronike, pavarësisht se kanë faqe interneti të kompanive të tyre përdorin adresa që merren falas ne internet, si: hotmail, yahoo etj, duke humbur maksimalisht besueshmërinë.

Në databazat kryesore të shkëmbimeve tregtare në internet , kompanite janë shumë të pakta. Format e marketingut online sot janë aq të sofistikuar sa që profesionistët janë në gjëndje qe, pa bërë asnje shkelje etike, të mësojnë dhe orientimin në treg te vizitorëve të rastësishëm të tyre apo atyre klientëve të piketuar, të cilëve u dërgohet një email I thjeshtë.

Programet e suksesshme të marketingut në internet kalojnë në katër hapa gjatë ndërtimit të marrëdhënieve me konsumatorët por, konsumatorët mund të progresojnë midis këtyre hapave në mënyra të ndryshme.(Figura 1)



fig.1

Në stadin e vetëdijes, konsumatori kupton se agjensia mund të jëtë një partner i mundshëm për shkëmbimin por nuk ka filluar asnjë lloj komunikimi apo blerje të ndonjë prej produkteve/shërbimeve të saj. Në disa rrethana një ekspozim i vetëm në internet mund të krijojë vetëdijen por mund të mos çojë në veprim. Në këtë shtate mund të duhen disa ekspozime. Për të krijuar vetëdijen agjensitë, së pari, duhet të ofrojnë një adresë të thjeshtë website-i e cila të kujtohet lehtësisht nga konsumatorët dhe së dyti, marka në internet duhet të jetë e njëjtë me markën tradicionale (diferenca është vetëm www.com).

Në stadin e eksplorimit, konsumatori sheh mundësinë e shkëmbimit me agjensinë dhe ndoshta mund të nisë të gjykojë për blerjet. Në këtë stad ka një investim minimal tek marrëdhëniet midis dy palëve dhe zgjidhja është më se e lehtë. Qëllimi i këtij stadi është tërheqja, ndërtimi i besimit, normave dhe fuqisë

të marrëdhënieve me konsumatorët. Në stadin e angazhimit, palët pjesëmarrëse në marrëdhënie ndiejnë një sens obligimi dhe përgjegjësie kundrejt njëra-tjetrës. Një sens i fortë obligimi dhe përgjegjësie krijohet kur konsumatorët vazhdojnë të regjistrohen në bazën e të dhënave të agjensisë, pra ata duan të kenë një marrëdhënie dhe të marrin informacion të personalizuar sipas karakteristikave personale.

Zgjidhja ndodh kur njëra ose të dy palët dalin nga marrëdhënia. Shpesh herë problemet teknike mund të behen arsye subjektive që konsumatori të largohet nga website-i agjensisë dhe të mos kthehet më.

Eksperiencia e konsumatorëve në internet

“Eksperiencia konsumatore mund të manaxhohet më mirë në qoftë se website-i siguron bashkëveprim me përdoruesit e tij, pra, këta të fundit nuk kërkojnë vetëm informacion por kërkojnë eksperiencë dhe bashkëveprim në të”.

Ulrike Gretzel (Profesor i Univrsitetit te Queensland, Brisbane).

Eksperiencia mund të përmirësohet vazhdimisht nëpërmjet site-ve që ofrojnë bashkëveprim, mundësojnë fokusim të vëmendjes apo ofrojnë sfida për përdoruesit e tyre.

Një eksperiencë pozitive në website do të rritë kohën e shpenzuar në të. Kjo varet jo vetëm nga përmbajtja e site-it por influencohet edhe nga komunitetet si për shembull, forumet e diskutimit online. Nga ana tjetër vetë përmbajtja e website-it përcakton nivelin e bashkëveprimit duke ofruar oportunitete të shumta për përdoruesit dhe zgjedhje të shumfishta për aktivitetet që dëshirojnë. Website-et më të suksesshëm në ditët e sotme konsiderohen ata që strukturohen rreth çështjeve të mëposhtme: Objektivat e organizatës; Nevojat, dëshirat dhe pritjet e konsumatorëve; Produktet apo shërbimet e ofruara. (Figura

2).




fig.2

Organizatat duhet të mendojnë objektivisht për këto tre dimensione. Ato duhet të njohin mirë tregun e synuar, dëshirat, nevojat, pritjet e konsumatorëve si dhe procesin e vendimmarrjes dhe më pas të diskutojnë me ndërtuesit e website-ve për të përfshirë shërbimet elektronike më të rëndësishme. Lind pyetja: Cili është qëllimi i website-it? Teknika më e përdorur për të vendosur në lidhje me qëllimin dhe objektivat që do të arrihen nëpërmjet website-it tij është, brainstorming me të gjithë personat apo pozicionet në organizatë duke filluar nga niveli më i lartë menaxherial deri tek personat që përmbushin porosinë apo sigurojnë mbështetje për konsumatorët.

- Promovimi i produkteve apo shërbimeve;
- Shitja e produkteve apo shërbimeve ;
- Sigurimi i shërbimeve dhe mbështetje për konsumatorët;
- Sigurimi i informacionit për organizatën dhe produktet ose shërbimet e saj ;
- Krijimi dhe konsolidimi i identitetit të organizatës dhe ose markës;

Website-et duhet të dizajnohet në mënyrë të tillë që të jenë tërheqës për vizitorët; të sigurojnë trafik; të përfshijë elementë të marketingut gojor (të inkurajojë vizitorët të rekomandojnë produktet dhe shërbimet tek të tjerët); të inkurajojnë vizitorët për t'ju dërguar mesazhe nëpërmjet postës elektronike, të reja, njoftime, ofertat speciale mbi baza të rregullta; të stimulojnë besnikërinë konsumatore; të ofrojnë “stickness” për të inkurajuar konsumatorët të qëndrojnë në site dhe të vizitojnë zona të ndryshme dhe të përfshijë elementë bashkëveprimi.

Sot më shumë dhe më shumë përdorues/klient e përdorin internetin për të kërkuar produktet apo shërbimet që ato kanë nevojë. Biznesi juaj I vogël do të ketë rritje të besueshmërisë duke e patur një website. Nëse ju e keni një website dhe është I punuar mesatarisht, atë duhet ta ridizajnoni në mënyrë profesionale sepse do ti siguroj biznesit tuaj një imazh më profesional dhe do të frymëzoj vizitorët/klientet tuaj të kenë besim më të madhë tek kompania juaj. Dizajni I website-t, qëndrueshmëria, optimizimi I website-t, etj të gjithë këto ndikojnë në ndërtimin e një besueshmërie më të fortë tek konsumatorët tuaj.

Website ju kursen paratë - Si pronar I çdo biznesi të vogël ju ndoshta do të mendoni se nuk do ta përballoni financiarisht një website profesional, por në të ardhmen e afërt ju nuk do të përballoheni pa të. Megjithatë edhe pse kostoja e zhvillimit dhe dizajnit të një website ndryshon, gjenerimi I cmimeve për website sillet reth 300€ e deri në 1000 € e sipër, për pagese vjetore, e në disa raste edhe në 150€. Krahaso cmimin e reklames në një gazetë, dhe në krahasim me cmimin e reklamës në një gazetë ju mund të merrni përgjigje më të saktë. Konsideroni tregun tuaj potencial dhe ju mund të arrini më shumë me një website. Kjo është një kosto shumë efektive për të promovuar biznesin tuaj.

Do të mundesojë të mbaj klientet të informuar -Mendoni website-in tuaj sikur të jetë një broshurë online ose një katalog. Është shumë e thjeshtë dhe e shpejtë për t'i freskuar informatat për produktin apo shërbimet tuaja në website se sa në materialet e shtypura,Website-i ju mundëson një mënyrë më të lehtë dhe më efektive që konsumatorët tuaj të njoftohen për ardhjen e produkteve të reja, si psh: ngjarjet e ardhshme, ofertat promovuese , apo për ndonjë shërbim tjetër që ju ofroni. Ndryshe nga reklamat e printuara të cilët shpejt bëhen të vjetruara. Website juaj i biznesit do të mund të siguroj informacione aktuale dhe njoftime të kompanisë tuaj.

Gjithmonë është I hapur- Website është në gjendje gadishmërie 24 orë për çdo konsumator tuajin edhe kur dyqani apo zyra juaj është e mbyllur, duke ju ofruar atyre (konsumatorëve tuaj) me lehtësi t' i shqyrtojnë produktet apo shërbimet tuaja.

Në ditët e sotme kur koha është e kufizuar, website-i është një ndër pikat e më kryesore të shitjes e cila qëndron gjithmonë e hapur dhe ju kursen kohën konsumatorëve tuaj, duke e shqyrtuar produktin apo shërbimet tuaja nga shtëpia, puna, etj dhe të bëjë porosinë brenda 60 sekondave.

Website mundëson targetimin e një tregu të gjërë- Nëse ju i promovoni produktet apo shërbimet tuaja, website-i juaj do të ofrojë pika alternative të shitjes. Sikurse një shitës me pakice, një website eCommerc (shitore online)

është një vend i mirë për të shitur produktet tuaja në një treg të gjërë botëror, madje edhe shërbimet mundë të jenë në dizpozicion global.

Website ofron një vend ku ju mund të prezantoni punët tuaja- Nuk ka rëndësi se në çfarë lloji të biznesit keni ju, website është vendi i duhur për të prezantuar punët tuaja, duke i vendosur në portfolin tuaj ose foto galerinë, dhe në këtë mënyrë ju mund të demonstrioni se çfarë e bënë biznesin tuaj unike nga të tjerët. Reagimet e konsulentëve, gjithashtu do të jene prezente.

Website kursen kohën tuaj- Dhënia e informacioneve për klientët tuaj merr kohë, nëse kjo bisedë bëhet në telefon, ballë për ballë, në broshura, apo në email. Me një kataloge online ju mundë të ofroni informacione të shumta rreth produktit apo shërbimeve. Në momentin që website juaj funksionon, ai është në dizpozicion për konsumatorët tuaj në çdo kohë, dhe ju e kurseni kohën tuaj. Dhe çfarë është koha ? Koha është para.

Përmirson shërbimin për klientët - Ndoshta ju jeni një kontabilist dhe doni t'i keshilloni klientit tuaj se si duhen lehtësuar praktikatat e tyre të kontabilitetit, apo jeni një mjek dhe dëshironi pacientët tuaj t'i mbani të freskët me informacione shëndetësore. Duke përfshirë një faqe NDIHME, duke shtuar artikuj ose duke ngarkuar një artikull për t' ju përgjigjur të gjitha pyetjeve të klientëve apo pacientëve tuaj ju mund t'i mbani ata të "freskët".

Perfundime dhe Rekomandime

Perfundimet dhe rekomandimet vijne ne formen e disa avantazheve dhe disavantazheve ne kete studim.

Një nga të vërtetat absolute e kohëve të sotme është fakti që rrjetet sociale dhe internet ndikojnë në jetën tonë në të gjitha aspektet. Kjo është një çështje se cilës po I kushtohet rëndësi sidomos kohët e fundit. Rrjetet sociale tërheqin vëmëndjen e mijërave përdoruesve me interesa të ndryshme sociale , ekonomike , kulturore dhe politike.

Cfarë është më e rëndësishme për pronarët e bizneseve se sa për ti promovuar produktet dhe shërbimet e tyre në perspektiva më të gjëra në treg?! Me anë të internetit, bizneset të vegjël, mesëm ashtu edhe të mëdhenj, janë të arritshme për miliona përdorues. Biznesi juaj mund të arrijë perspektiva globale. Kjo mund të bëhet duke ndjekur strategjitë e ndryshme të Web Marketing. ¹⁷⁶Duke parë avantazhet e Web Marketing në ditët e sotme duhet marrë në konsideratë prania e tij.

1.Kosto e reduktuar- Kostoja e fillimit është vetëm një fraksion i mijëra eurove që reklamat në Yellow Pages, televizion dhe radio kushtojnë. Përveç kësaj, reklamat tradicionale mund të perdoren vetëm për një kohë të shkurtër. Ndërkohë një fushatë në Web Marketing mund të japë rezultate afatgjata.

2.Lehtësia e matjeve të rezultateve - Marketingu i bërë në gazeta apo revista është shumë i vështirë të tregojë ndikimin e drejtpërdrejtë të shitjeve për biznesin tuaj. Me Web Marketing, çdo gjë mund të gjurmohet dhe të ilustruhet me grafikë të detajuar. Grafikët ilustrojnë trafikun e rritjeve dhe suksesit të marketingut për biznesin tuaj. Duke përdorur një mjet të lirë të analizës të trafikut si Google Analytics, është e lehtë për të llogaritur kthimin tuaj të investimeve. Kështu ju mund të vlerësoni vlerat e shkëlqyera që janë gjeneruar nga Web Marketing. Në internet është më e lehtë për kompanitë të dinë pothuajse menjëherë në qoftë se fushata e tyre është duke punuar apo jo, çfarë kompanie apo përdoruesi është i interesuar në produktet e tyre. Pra, sukseset janë të identifikueshme.

3.Rezultate në kohë reale- Me Web Marketing ju nuk duhet të prisni javë për të parë një rritje të ndjeshme në biznesin tuaj. Me një fushatë të SEO, ju mund të shikoni rezultate në kohë reale. Këto rezultate ju mundesojnë që të bëni rregullime me strategjinë tuaj të marketingut për të arritur efektin e dëshiruar. Nëse strategjia juaj e marketingut nuk është duke punuar në mënyrë efektive, mjetet monitoruese në kohe reale ju lejojnë lehtë të vendosni saktësisht se ku po gaboni.

4.Informacion i lartë për produktet. - Konsumatorët sot duan të krahasojnë kritikën dhe mendimet e miqve, blogjeve të besuara dhe ekspertëve të industrisë

¹⁷⁶ <http://www.uamd.edu.al/new/wp-content/uploads/2013/12/Dizertacioni-Ervin-Myftaraj.-Maj-2014.pdf>

para se të marrin një vendim. Nëse ju mund të siguroni cilesine, informacion të pershtatshem me atë që njerëzit janë në kërkim, atëherë hapi tjetër i konvertimit të përdoruesve në klientë është shumë i lehtë.

5.I pëlqyer nga konsumatorët.- Konsumatorët nuk pëlqejnë metodat ndërhyrëse të marketingut tradicional si reklamat në gazeta dhe reklamat televizive. Kur dikush blen një gazetë apo revistë, ata duan të lexojnë artikuj interesantë jo të bombardohen me reklama të parëndësishme. Në avantazhet e Web Marketing është edhe fakti që ju mund të synoni konsumatorët pikërisht kur ata janë në kërkim për produktet dhe shërbimet që biznesi juaj mund të ofrojë

6.Disponimi i shpejtë i informacionit- Një tjetër nga avantazhet e Web Marketing është disponimi i shpejtë të informacionit nga klientet apo përdoruesit. Duke lundruar në internet, ata mund të marrin informacion shumë lehtë në lidhje me produktet që ata dëshirojnë të blejnë. Përveç kësaj, ata mund ta marrin këtë informacion në çdo kohë të ditës.

Persa i perket Disavantazheve e Web Marketing, i rendisim si Marrja e kënaqësisë me vonesë , si pasojë e shpërndarjes së ngadaltë të porosisë; Gabime në plotësimin e porosive.; Mundësi për mashtrime.; Bashkëveprim ngativ me tregtarin online.; Pamundësi për ta kontrolluar apo provuar produktin para blerjes.; Besnikëri e ulët nga eksperiencat online.; Kosto e të paturit kompjuterin dhe kosto e rrjetit të internetit.; Linjë interneti e ngadaltë dhe koha e gjatë për të hapur faqet e internetit.; Humbje e privatësisë apo informacioneve personale.

Referenca

<http://webfoundation.org/about/vision/history-of-the-web/>

<http://www.netregistry.com.au/resources/what-is/online-marketing/what-is-online-marketing/>

<http://www.uamd.edu.al/new/wp-content/uploads/2013/12/Dizertacioni-Ervin-Myftaraj.-Maj-2014.pdf>

<http://www.uamd.edu.al/new/wp-content/uploads/2013/12/Dizertacioni-Ervin-Myftaraj.-Maj-2014.pdf>

Tregtia dhe zhvillimi ekonomik ndërkombëtarë

Eralda Metaliaj;

University of Tirana, Faculty of Economics

, Tirane, Albania;

Gjat viteve të fundit është zhvilluar një literaturë e konsiderueshme në lidhje me efektet e liberalizimit të tregtisë në performancën e proceseveve makroekonomike dhe mikroekonomike . Mund të themi se ekziston lloj-llojshmëri në literaturën tregtare , liberalizimin e tregtisë , efektet në të ardhurat, punësim dhe balancin e pagesave por nuk ekziston ende ndonjë prove përfundimtare dhe një gjuhë e përbashkët mes kërkuesve rreth efekteve të mardhënieve të tregtisë dhe liberalizimit të tregtisë në ekonomi .Globalizimi ka ndikuar ekonominë në kombe të ndryshme. Për shkak të zhvillimit të shpejtë të veglave efikase të komunikimit dhe rritjes së ngjarjeve të korporatës , ekonominë e gjithë botës janë bërë për t'u vetadaptuar në kushtet e marketit dinamik. Në lidhje me rastin e marketit shqiptarë është e vështirë të imagjinohet funksionimi i një ekonomie të izoluar nga tregu tjetër ndërkombëtarë ,sherbimet dhe faktorët e prodhimit . Rëndësia e komunitetit ndërkombëtar luan një rol më të rëndësishëm në kushtet e ekonomisë në tranzicion ,për shkak të izolimit të thellë në të kaluarën . Si pasojë, qëllimi kryesor I kësaj flete shtrihet në studimin dhe analizën në ndikimin e liberalizimit të tregtisë dhe proceset e integritimit në indikatorët e zhvillimit dhe tregtisë shqiptare me të huaj. E rëndësishme do të jetë gjithashtu : investigimi I ndikimit të liberalizimit të tregtisë në konkurrenca ,duke vazhduar me studimin e rregullave të tregtisë në mënyrë që të rritet konkurrenca.

Fjalët kyce : Liberalizimi I tregtisë , Globalizimi , Konkurrenca , Rritja

1. Prezantimi

Bilanci i çmimeve dhe përfitimeve nga globalizimi për grupe të ndryshme të shteteve dhe ekonomisë botërore është një nga temat më të flakta të debateve të zhvilluara . Përgjatë gjith kursit të studimeve të mia mund të them se Drejtimi Financiar Ndërkombëtarë është fusha ime e preferuar sepse në njëfarë mënyre përmbledhë gjithë njohurinë makro,mikro ekonomike dhe lidh ato me vendimet financiare vendimtare me zhvillimin e kompanive multinacionale , balancin tregtar të shtetit dhe rritjen ose reduktimin e vlerës ekonomike të shtetit në lidhje me vendimet per tregti të hapur ,të drejtat ligjore , sistemin bankar , shkëmbimin e normave dhe stabilitetin gjeneral te shtetit. Integrimi është tema më themelore e cdo mendje per debat ekonomik në kontekstin shumëpalësh, dypalësh, liberalizim të tregtisë regjionale. Kjo letër është bazuar në një rishikim të literatures në tregtinë ndërkombëtare dhe ndikimet e saj në ekonomi , duke u thelluar më tej në kontekstin shqiptarë.

2 Shqyrtimi i literaturës

Tregtia ndërkombëtare është shkëmbimi i kapitalit, mallrave dhe shërbimeve përtej kufijve ndërkombëtarë ose territoreve , të cilat mund të përfshijnë aktivitetet e qeverisë dhe individit. Ndërsa tregtia ndërkombëtare ka qenë e pranishme gjatë gjithë të historisë së ekonomisë , rëndësina e saj ekonomike, sociale dhe politike ka qenë në rritje në shekujt e fundit, është supozim i tregtisë ndërkombëtare se një nivel i mjaftueshëm i paqes dhe stabilitetit gjeopolitik janë mbizotëruese në mënyrë që të lejojnë shkëmbimin paqësor të tregtisë dhe që do të zhvillohet në mes të kombeve. Përfitimet e tregtisë ndërkombëtare i

gëzohen të dy vendet , vendi eksportues , si dhe vendet importuese. Të gjitha teoritë ekonomike të tregtisë ndërkombëtare sugjerojnë se ajo rrit efikasitetin. Në këtë drejtim, tregtisa ndërkombëtare është si një teknologji të re. Ajo shton kapacitetit prodhues të të gjitha vendeve që merren me tregti. Një pjesë e efikasitetit është për shkak të përparësisë krahasuese, si në teoritë e Ricardo dhe Heckscher-Ohlin. Përveç kësaj, disa efikasiteti vjen nga duke përfituar nga kthimit në rritje. Tregtisë në bazë të përparësisë krahasuese duhet të tentojnë të përfitojnë vendet e vogla më shumë se vendet e mëdha. Në qoftë se dallimi është i madh, atëherë një vend fiton një avantazh të madh nga tregtia. Në qoftë se dallimi është i vogël, atëherë ka vetëm një avantazh të vogël nga tregtia. Vendet e vogla kanë më shumë gjasa se sa vende të mëdha për të gjetur se çmimet relative në tregun botëror. Një përfitim tjetër nga tregtia është se ajo nxit dinamizmin dhe përtrirjen brenda një ekonomie. Një ekonomi që është e mbyllur për të tregtisë është ai në të cilin industritë joefikase dhe firmat prapambetur janë të mbrojtur mirë. Në fakt, studimet tregojnë se pengesat për tregtinë janë shkak kryesor i prapambetjes ekstreme. Vendet që janë më të mbyllura për tregti priren të jenë më të varfrit në botë. Vendet që kanë reduktuar pengesat e tregtisë dhe rritjen e peshës së importeve dhe eksporteve në ekonomitë e tyre kanë tendencë të jetë në mesin e më të shpejtë në rritje të kombeve. Rritja e tregtisë ndërkombëtare është vendimtare për vazhdimësinë e globalizimit. Pa tregtinë ndërkombëtare, kombet do të jenë të kufizuara për mallrat dhe shërbimet e prodhuara brenda kufijve të tyre. Tregtia ndërkombëtare është kryesisht e kufizuar në tregtinë për mallra dhe shërbime, dhe vetëm në një masë më të vogël të tregtisë në kryeqytet, punë. Tregtia me mallra dhe shërbime mund të shërbejë si një zëvendësim për tregtinë e faktorëve të prodhimit. Në vend që të importohet një faktor prodhues, një vend mund të importojnë mallra që e bëjnë përdorimin intensiv të këtij faktori të prodhimit dhe në këtë mënyrë mishërojnë atë. Tregtia ndërkombëtare është gjithashtu një degë e ekonomisë, e cila, së bashku me financat ndërkombëtare, formon degën më të madhe të quajtur ekonomia ndërkombëtare. Tregtia është një funksion të vlerës së shtuar: është proces ekonomik me të cilin një produkt gjen tregun e saj, në të cilin rreziqet specifike janë të përballohen nga tregtari.

2.1 Tregtia nderkombetare

Zhvillimi nderkombetar ekonomik injekton konkurrencë globale dhe prandaj njësia e biznesit vendas tenton që të bëhet shumë efikas duke u ekspozuar konkurrimit nderkombetarë. Për shkak të integritit me ekonominë boterore sipërmarrësit mund të kenë lehtësisht kyçje me krijimet teknologjike. Ata mund të përdorin teknologjinë më te fundit për të përmirësuar produktivitetin. Shtetet ne zhvillim kanë vlera me të larta te proteksionizmit në krahasim me shtetet e zhvilluara. Shtetet që kanë pranuar ato njësi matëse janë parë duke korrur të mirat e një regjimi te hapur të tregut. Ekonomia botërore është duke marrë hapa të mëdhenj dhe duke lëvizur në një ritëm të veçantë. Globalizimi ka prekur ekonomitë e kombeve të ndryshme. Tregtia nderkombetare dhe ekonomia botërore janë dy subjekte të pandashme dhe duhet që t'i adresohemi njëherësh. Hence, një sistem nderkombetarë tregtie duhet të dizajnohet, e cila përballet me kërkesat e ekonomisë botërore ne ndryshim. Më shumë dhe më shumë kompani janë duke e bërë prezencën globale të tyre të ndjehet nga nje rrjet i fortë. Kjo ka ngritur shumëllojshmërinë në transaksionet nderkombetare. Mund të perfshijë investimet direkte, tregtinë dhe shërbimet. Ka një ngritje ne aktivitetet ekonomike në të gjitha kombet. Kjo ka berë të nevojshme prezantimin e udhezimeve te caktuara ,te cilat qeverisin transaksionet nderkombetare në mungesë së këtyre udhezimeve ,mund të ketë jo harmoni mes kombeve tregtare.

3 Shqipëria nën liberalizimit e tregtisë

Një ekonomi që është e mbyllur për tregti është ajo tregti në të cilën industritë joefikase dhe firmat prapambetur janë të mbrojtura mirë. Në fakt, studimet tregojnë se pengesat për tregtinë janë shkaku kryesor i prapambetjes ekstreme. Vendet që janë më të mbyllura për tregti priren të jenë më të varfrit në botë. Lidhur me rastin në Shqipëri është e vështirë të imagjinohet funksionimin e një ekonomie të izoluar nga tregu nderkombetar , shërbimeve dhe faktorëve të prodhimit .Rëndësia e komunitetit nderkombetar merr një rëndësi të lartë në kushtet e ekonomive në tranzicion, për shkak të izolimit të thellë në të kaluarën.

Vendet që kanë reduktuar pengesat e tregtisë , dhe kanë rritur sasinë e importeve dhe eksporteve në ekonomitë e tyre kanë tendencë të jenë në mesin e vendeve me rritje më të shpejtë .

3.1 Dinamika e eksporteve dhe importeve

Vëllimi i tregtisë është një tregues i rëndësishëm për progresin e tregtisë, dhe llogaritet si: shuma e importeve dhe eksporteve në vend. Gjatë viteve të tranzicionit në Shqipëri prezantoi një dominim të importit në bilancin tregtar, duke sjellë në këtë mënyrë një deficit të lartë tregtar për të gjitha vitet e përfshira në studim. Bilanci i Tregtisë në Shqipëri është raportuar nga Instituti i Statistikave (INSTAT) ka një vlerë mesatare prej -15,804.76 milionë nga viti 1993 deri në vitin 2015. Mangësia strukturore në Shqipëri janë faktori kryesor që shkakton deficitet . Partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë janë Italia, Greqia, Turqia , Kina, Gjermania, Serbia, Zvicra, Spanja, Franca, Maqedonia dhe Bullgaria. Sipas llogaritjeve në aspektin e vëllimit të tregtimit në radhë të parë është e pushtuar nga vendet e BE-së me një Mesatare 69.17%, e ndjekur nga Italia me 37.44%, dhe Greqia 13.3%. Pavarësisht marrëveshjeve të shumta tregtare, tregtia me vendet e rajonit mbetet shumë e ulët në vlerë, në 1993-2014 llogaritur përafërsisht 0: 07% .lidhur me rastin shqiptar bilanci tregtar ka qenë shpesh në rënie (importet janë rritur në mënyrë të qëndrueshme kundrejt eksporteve).

Vlera më e lartë e arritur në vitin 2011 (347,107 milionë lekë), dhe më të ulët në vitin 1994 (43632000). Megjithatë, në vitin 2013 ka konfirmuar rikthimin e tij, sepse ka 266.133.000 shifra që tregon tabelën e mësipërme. Përmirësimin e bilancit të tregtisë ka filluar në vitin 2011 dhe tregon një përmirësim të vazhdueshëm dhe për shkak të rënies së eksporteve nga importet. Analiza e të dhënave tregon se niveli i eksporteve ka rritur vlerën e saj maksimale prej 20 vjetësh në vitin 2013. Eksportet arritën në mbi 246 miliardë lekë, rikthyer në mënyrë të konsiderueshme dhe duke përmirësuar bilancin tregtar të Shqipërisë.

2009 është një nga vitet ku të dy treguesit rënë në krahasim me vitin e kaluar (importet dhe eksportet). Viti 2010 shënon një rekord me një rritje prej 55%, e cila është ndjekur nga një rritje të vogël në vitet e mëvonshme. Në vitin 2014, eksportet u ulën me 12% më shumë se vitin e kaluar duke arritur një rritje të ulët të eksporteve (me përjashtim të vitit 2009) në 14 vitet e fundit.

3.3 Huaja Direkte e Investimeve

Që nga fillimi i tranzicionit ka qenë një tendencë për rritjen e IHD-ve në Shqipëri. Natyrisht vlera e investimeve të huaja direkte ka qenë më e lartë se vlera e parave të dërguara. Gjatë një periudhe të gjatë prej dhjetë viteve 2002-2012, raporti i këtyre dy vlerave duket të jetë interesante. Në 2002-2006, investimet e huaja direkte u me vlerë të ulët në krahasim me parat e dërguara. Në këtë katër vjet emigrantët sollën në shtëpi 3-4,5 më shumë euro se investitorët e huaj të drejtpërdrejtë kan sjell. 2006 - 2013 është periudha që sjell rritjen progresive të vlerës së investimeve të huaja direkte. Kjo periudhë kohore shënon një moment pozitiv për ekonominë lokale. Duke bërë këtë lloj analize krahasuese tregon se si remitancat janë pozicionuar kundër IHD-ve, duke hetuar me kujdes rolin e secilit tregues dhe dy prej tyre në ekonominë e vendit. Në vitin 2010 regjistroi dallimin më të lartë midis vlerës së dërgesave të emigrantëve dhe vlerës së investimeve të huaja. Sipas Bankës së Shqipërisë, investimet e huaja direkte u rritën me 39% gjatë vitit 2013 në krahasim me vitin 2012, duke arritur nivelin e 923 milionë euro. Në total, bilanci i pagesave është pozitiv dhe si rezultat, rezervat valutore janë rritur, në fund të vitit ishin të mjaftueshme për të mbuluar 4.6 muaj importe të mallrave dhe shërbimeve. Llogaria e shërbimit ka shënuar një bilanc pozitiv në mes të të hyrave dhe shpenzimeve rreth 97 milionë, 4 milionë më shumë se e njëjta periudhë një vit më parë. Kontributi kryesor ishte për shkak të bilancit pozitiv të shërbimeve të udhëtimit që zënë të ardhurat më të madh dhe koston e shërbimeve, me përkatësisht 66% dhe 72% të totalit. Rritja vjetore e të ardhurave gjatë kësaj periudhe ishte kryesisht për shkak të rritjes së numrit të vizitorëve të huaj rreth

29%. Gjithashtu pjesa më e lartë në pagesën e TVSH-së ka pasur sektorin e shërbimeve, e ndjekur nga sektori i prodhimit . Është vurë në dukje rëndësia e reduktimit të ndërtimit dhe të prodhimit të sektorit si një kontribues për TVSH-në dhe rritje të konsiderueshme në pjesën e shërbimeve në total të TVSH-së, në përputhje me aktivitetin ekonomik në vend. Sektorët që rënë pagesa TVSH krahasuar me vitin e kaluar janë: prodhimin e energjisë, prodhimi i naftës, ndërtimin e ndërtesave, tregtinë dhe lëndë djegëse të prodhimit, duke cituar ata me peshë biggest. Sektorët që është paguar TVSH-në më të lartë se një vit më parë dhe janë: Telekomunikacioni dhe shërbimeve.. Telekomunikacioni është një nga aktivitetet më dinamike në sektorin e shërbimeve në Shqipëri. Ajo është zhvilluar kryesisht nëpërmjet privatizimit dhe investimeve pasuese të bëra nga investitorët e huaj dhe në një farë mase nga investimet e brendshme. Si rezultat i investimeve të bëra pas privatizimit, numri i abonentëve të telefonisë mobile në fund të vitit 2011, arriti në 5,2 milionë. Ky nivel i penetrimit të telefonisë së lëvizshme të 187%, është e ngjashme me vendet e zhvilluara si Gjermania.

Prania e kompanive të huaja ka shkaktuar rritjen e konkurrencës në treg, duke ofruar cilësi më të mirë, me kosto të ulët dhe të krahasueshme me rajonin. Një klasifikim i ri në shërbimet është kategori - shërbime për përpunimin e inputeve fizike pronësi të tjerëve . Të ardhurat e kësaj kategorie arritën në 70 milionë euro, të cilat janë shërbimet që janë të ofruara nga rezidentët ndaj jorezidentëve gjatë përpunimit të mallrave në pronësi nga jorezidentët Industria e shërbimeve .Financjal ka bërë ndryshime në sajë të zhvillimit të IHD-ve. Hyrja e bankave të huaja dhe privatizimin e bankave në vend, ka kontribuar në konsolidimin e sistemit bankar. Në përgjithësi, bankat e huaja kanë luajtur një rol pozitiv, në lidhje me efikasitetin dhe stabilitetin e sistemit bankar në ekonomi. Ato kanë forcuar menaxhimin e rrezikut dhe qeverisjes e bankave përmes alokimit efikas të kapitalit dhe rritjen e konkurrencës duke futur shërbime moderne bankare dhe të sofistikuar. Megjithatë, karakteristikat e përgjithshme pozitive të ofruara nga standardet ndërkombëtare për sistemin bankar, nuk i përmbushin ende të gjitha nevojat e ekonomisë. NVM-të kanë një qasje të kufizuar në financimin nga bankat dhe është e nevojshme për të përmirësuar skemat e garantimit të kredive. Është e rëndësishme të theksohet se norma e interesit të ofruara nga bankat e NVM-ve është ende e lartë për tu përballuar.Sektori i shërbimeve është kontribuesi më i madh i tatimit mbi të ardhurat, i pasuar me të njëjtën peshë te

prodhimit dhe transportit. Fitimet e kompanive në pothuajse në të gjithë sektorët e ekonomisë kanë refuzuar një periudhë 12-mujore, krahasuar me një vit më parë. Rënia më e madhe në krahasim me të njëjtën periudhë një vit më parë u shënuar nga sektori i ndërtimit me -24.3%, pasuar nga sektori i prodhimit me -16.7%, sektori i transportit me -13.9% dhe sektori i tregtisë -13.1%. I vetmi sektor në rritje është sektori i shërbimeve +0.4%.

5. Konkluzionet

Globalizimi është rezultat i disa zhvillimeve dhe proceseve, ndërkombëtarizimi i tregjeve financiare, të decentralizimit dhe të liberalizimit të tregtisë, zhvillimi i komunikimit mes vendeve përmes IT etj. Dëshmitë e viteve të fundit të cilat janë gjithnjë e në rritje mbështetin pohimin se tregtia ndërkombëtare nxit produktivitetin përmes rritjes së konkurrencës. Që nga ajo është supozuar që vendet të prodhojnë të njëjtin grup të varieteteve, hapja e tregtisë i bën tregjet më konkurruese duke ulur çmimet dhe rritur masën. Si pasojë, reduktimi i barrierave tregtare stimulon rritjen duke ulur fuqinë e tregut të firmave vendase. Ky ndikim ndryshon nga destinacioni dhe origjina e eksporteve dhe importeve. Shqipëria, mbetet një vend me zhvillim me një luhatshmëri të lartë të çmimeve, të bilancit tregtar udhëhequr nga importi, me burime të kufizuara për përballimin me tregun global, një nivel i pamjaftueshëm i konkurrencës së firmave, një mjedis jo shumë të sigurt për investitorët e huaj. Lidhur me këtë në vendin tonë duhet të bëjnë bilancin e tregut të ekonomisë dhe për të siguruar konvergencën strukturore drejt vendeve të BE-së sa më shpejt që të jetë e mundur. Shqipëria ka arritur një rritje ekonomike pozitive në vitet e fundit, pavarësisht ndikimit të krizës globale financiare. Ndjekja e politikave makroekonomike dhe reformave, të mirë-strukturuara, u përqëndrua në privatizim, integritetet fiskale, liberalizimin e tregtisë, klimës së biznesit, energjisë dhe sektorit financiar, këto kanë bërë të mundur që ekonomia shqiptare të jetë më elastike në ekonomitë e Jug-Lindore.

Referencat

1. International Monetary Fund and World Bank, "Market Access for Developing Countries' Exports", 2001.— World Bank, Globalization, Growth, and Poverty: Facts, Fears, and an Agenda for Action, forthcoming.
2. World Bank Reports, 2008,2009...2012
3. World Bank, Globalization, Growth, and Poverty: Facts, Fears, and an Agenda for Action, forthcoming. IMF, World Economic Outlook, May 1997
4. —TRADE LIBERALISATION: BOOSTING EMPLOYMENT AND GROWTH, OECD Trade Policy Working Paper no. 107, January 2011
5. OECD 2013 Interconnected Economies:Benefiting from Global Value Chains OECD publishing
6. Beckman, F. and Scheiber, T. (2012): “Not So Trustworthy Anymore? The EURO as a Safe Haven Asset in Central, Eastern and Southeastern Europe”, Focus on European Economic Integration, Q2/12 report.
7. Dvorsky, S., Scheiber, T. and Stix, H. (2009): “The 2008 Fall Wave of the OeNB Euro Survey – A First Glimpse of Households’ Reactions to the Global Financial Crisis”, Focus on European Economic Integration Q2 / 0 9

Links:

- 1.http://www.worldbank.org/depweb/beyond/beyondco/beg_12.pdf
- 2.<http://finance.mapsofworld.com/trade/international-world-economy.html>
- 3.<http://www.omicsonline.com/open-access/business-strategies-of-smes-innovation-types-and-factors-influencing-their-innovation-albanian-case-2162-6359-1000319.php?aid=68887>
- 4.[http://www.iob-evaluatie.nl/sites/iob-evaluatie.nl/files/Country%20report%20Ethiopia%20\(final\).pdf](http://www.iob-evaluatie.nl/sites/iob-evaluatie.nl/files/Country%20report%20Ethiopia%20(final).pdf)
- 5.<http://www.instat.gov.al/al/themes/tregtia-e-jashtme.aspx>

6.https://www.bankofalbania.org/web/Raporti_i_Stabilitetit_Financiar_3433_1.php

7.https://www.bankofalbania.org/web/pub/zhvilimet_makroekonomike_7694_1.pdf

8.https://www.bankofalbania.org/web/Marrevshjet_e_tregtise_se_lire_dhe_integrimi_tregtar_midis_vendeve_te_Evropes_Juglindore_Vleresime_te_Modelit_t_e_Gravi_6503_1.php

9.https://www.bankofalbania.org/web/Efekti_i_"kurbes_J_"ne_tregtine_dypaleshe_Ndikimi_i_nencmimit_te_monedhes_ne_bilancin_tregtar_ndermjet_Shqi_6941_1.php

10.<https://www.weforum.org/reports/global-competitiveness-report-2014-2015>

11.<http://www2.deloitte.com/us/en/pages/tax/topics/transfer-pricing.html>

12.https://www.bankofalbania.org/web/Time_series_22_2.php?evn=agregate_detaje&evb=agregate&cregtab_id=689&periudha_id=5

Faktorët që mundësojnë gjetjen e shmangieve të taksave që shkaktohen nga nën-vlerësimi i mallrave

Autori 1: Arta Fazliu

(Studente në Master / Universiteti i Prishtinës)

Autori 2: Mentor Gashi

(PhD Kandidat)

Abstrakt:

Në këtë punim është marrë në shqyrtim një faktor rreziku që mund të shkakton shmangien nga taksat importuese. Faktori i riskut që kemi marr për shqyrtim është vlera doganore e mallit, respektivisht nën-deklarimi i vlerës së mallit në zhdoganim. Prandaj edhe pse gjatë importit të mallit, paraqiten edhe disa faktorë tjerë risku si; origjina e mallit, klasifikimi tarifor, sasia e mallit të deklaruar, kushtet e dërgesës, ku secili prej tyre mund të shkakton shmangie, ne kemi marr këtë faktor i cili edhe nga kërkimet e ndryshme në këtë fushë konsiderohet të jetë njëri ndër faktorët më relevant dhe më me ndikim. Gjatë punës në këtë punim kemi paraqitur ndikimin e vlerës doganore të metodat e vlerësimit dhe nga shqyrtimi i literaturës kemi gjetur dhe paraqitur elemente më fuqishëm që ndikojnë në kontrollin e vlerës së mallit, respektivisht që shfrytëzohen për parandalimin dhe zbulimin e shmangieve të shkaktuara nga faktori nën deklarim i vlerës së mallit.

Fjala kyqe: Evazion dhe shmangie, vlerë doganore, sasinë e mallit, origjinë e mallit, klasifikim tarifor.

1. Hyrja

Gjatë përgaditjes së këtij punimi, kemi marrë në shqyrtim një faktor risku përmes së cilës mund të shkaktohet shmangie nga taksat e importit, i cili faktor risku është mos deklarimi i vlerës së mallit në rastin kur importohet. Pasi që nëse gjatë importit apo në zhdoganim importuesi e deklaron një vlerë më të vogël të mallit, kjo mund të ndikon drejtë për drejtë pagesë më të vogël të taksave të importit. Prandaj dhe është një fenomen i përhapur tek evazuesit fiskal. Për të kryer këtë punim kemi shfrytëzuar referencat specifike për problemin e caktuar që e kemi parashtruar. Ky punim përmbanë konceptin mbi vlerën doganore të mallit, metodat e vlerësimit të mallrave, të cilat janë metoda që përfshihen pothuajse në të gjithë legjislaturën doganore në të gjithë vendet e botës, po ashtu kemi trajtuar edhe ndikimin e vlerës doganore në detyrimet dhe taskat e importit, respektivisht sa më e vogël vlera e mallit rrezulton me pagesë më të vogël të taksave . Pasi kemi trajtuar vlerën doganore, metoda e vlerësimit dhe ndikimin e vlerës së mallit në taksa, kemi identifikuar dhe paraqitur elementet e kontrollit që ndihmojnë në parandalimin dhe gjetjen e shmangieve të taksave nga faktori nën-deklarim i mallit doganor, të cilat përdorimi i këtyre elementeve mundëson më pak shmangie fiskale, dhe më shumë të hyra për arkën e shtetit.

2. Faktorë risku në shmangien e taksave dhe elementet që mundësojnë gjetjen e shmangieve të taksave që shkaktohen nga nën-vlerësimi i mallrave

Pasi që mos deklarimi i saktë i vlerës së mallit, apo nën deklarimi, shkakton evazion fiskal, atëherë gjatë këtij punimi kemi trajtuar vlerën e mallit nga koncepti i tij deri tek vlerësimi i malli që mund të bëhet duke përdorur metodat e vlerësimit. Pastaj kemi paraqitur edhe veprimet apo elemente që duhet ti ndërmerre një auditor për të provuar nëse gjatë importit të mallrave janë deklaruar saktë vlera e tyre. Siç dihet nëndeklarimi i mallit gjatë importit shkakton shmangie nga taksat e importit.

2.1. Vlerësimi doganor i mallrave

Vlerësimi doganor i mallrave përdoret për të përcaktuar vlerën e mallrave, kur ato mallra janë në procedurat e ndryshme doganore, duke përfshirë; procedurën e importit, eksportit , procedurat doganore me ndikim ekonomik, ku përfshinë procedurat e magazinimit doganor, përpunimit të brendshëm, përpunimit nën kontroll doganor, importit të përkohshëm. Bazuar në (Customs Manual Valuation, 2016) përcaktimi i vlerës doganore të mallit është e domosdoshme sepse në bazë të vlerës doganore përcaktohet edhe taksat, respektivisht detyrimet doganore për mallrat e importuara dhe që kanë qëllim zhdoganimin e tyre. Vlerësimi i mallrave përveç evidencave statistikore, rëndësi të veçantë ka atëherë kur për mallrat e caktuara, detyrimeve doganore përcaktohen në bazë të vlerës së mallrave apo “ Ad Valorem” , deri sa ndoshta nuk do të kishte shumë rëndës për ato mallra të cilat përcaktimi i detyrimeve doganore bëhet në formë tjetër, p.sh. në bazë të sasisë dhe jo vlerës.

2.2. Kalkulim i vlerës doganore të mallit

Për të kalkuluar vlerën e mallit doganorë, kemi në funksion gjashtë metoda të vlerësimit të mallrave, të cilat secila prej tyre ka rolin e saj në kalkulimin, respektivisht përcaktimin e vlerës së mallit doganor. Në vijim po paraqesim gjashtë metodat e vlerësimit të mallit, të cilat janë të njohura ndërkombëtarisht dhe po thuhet në të gjitha legjislacionet doganore të vendeve të ndryshme janë të përfshirë këto metoda në legjislaturën e tyre. Prandaj kriter për vlerësimin e mallit apo caktimin e bazës doganore në të gjitha sistemet doganore bashkëkohore janë caktuar sipas marrëveshjes se përgjithshme mbi dogana dhe tregtinë (GATT). Bazuar në (Customs Manual Valuation, 2016), po ashtu procedura dhe mënyra e caktimit të bazës doganore është instrumente i rëndësishëm i politikës doganore në secilin sistem doganor . Edhe në Kosovë në bazë të (Kodit doganor dhe të Akcizave të Kosovës Nr.03-L/109) si dhe Udhëzimit Administrativ 2009/11, janë përfshirë metodat e vlerësimit si instrumente për përcaktimin e vlerës doganore, respektivisht kalkulimin e drejt të detyrimeve doganore. Gjashtë metodat e vlerësimit janë: 1. Metoda e vlerës

së transaksionit , në bazë të çmimit kontraktues; 2. Metoda e vlerës në bazë të çmimit të mallrave identike; 3. Metoda e vlerës në bazë të çmimit të mallrave të ngjashëm 4. Metoda e vlerës në bazë të çmimit për njësi; 5. Metoda e vlerës në bazë të vlerës së përlllogaritur; 6. Metoda e vlerësimit në bazë të të dhënave të disponueshme.

2.2.1. Metoda e parë e vlerësimit – bazohet në çmimin e paguar realisht apo që duhet të paguhet nga blerësi për shitësin e mallrave .Kjo nënkupton pagesën e plotë të bërë apo që duhet bërë nga blerësi në favor të shitësit të mallrat e importuara . Në çmimin e paguar për mallin duhet të shtuar edhe elementet tjera si : shpenzimet e dërgimit , provizioni dhe taksat e tjera që e kanë përcjellë mallin deri të pika hyrëse. Pra në këtë metodë nuk bëhet rritja e bazës doganore , pranohet çmimi fatural .

2.2.2. Metoda e dytë e vlerësimit – Nëse nuk mund të zbatohet metoda e parë atëherë provohet metoda e dytë e vlerësimit. Kjo metodë bazohet në vlerën doganore të mallrave identike të eksportuar për në Kosovë në të njëjtën kohë apo për afërsisht të njëjtën kohë sikur se mallrat që janë duke u vlerësuar. Mallrat identike janë mallra që janë të prodhuar në të njëjtën vend si mallrat që janë duke u vlerësuar , po ashtu duhet të jenë të njëjta në të gjitha aspektet siç janë: karakteristikat fizike , cilësia ,dhe reputacioni, dallimet të vogla në dukje nuk janë të rëndësishme.

2.2.3. Metoda e tretë e vlerësimit – Kur nuk gjene zbatim metoda paraprake (e dyta) atëherë provohet në vlerësim kjo metodë. Metoda e tretë e vlerësimit bazohet në vlerën doganore të mallrave të ngjashme të eksportuar në Kosovë në të njëjtën apo për afërsisht në të njëjtën kohë , me mallrat që kanë për tu vlerësuar. Mallrat e ngjashme mund të dallohen në disa aspekte me mallrat që janë duke u vlerësuar mirëpo të cilat janë prodhuar në të njëjtën vend , mund të kryhen të njëjtat funksione dhe janë të këmbyeshme nga pikëpamja tregtare. Kur mallrat e ngjashme nuk janë prodhuar nga i njëjti prodhues si mallra që kanë për tu vlerësuar personi përkatës mund të shfrytëzon mallrat e ngjashme të prodhuar nga një person tjetër.

2.2.4. Metoda e katër e vlerësimit – Bazohet në çmimin e shitjes së mallrave në Kosovë. Vlera doganore bazohet në çmimin e çdo njësie (cope), në të cilën: mallrat e importuara, mallrat e importuar identike, mallrat e importuara të ngjashme, janë shitur në Kosovë në gjendje siç janë importuara për konsumuesit pa ndonjë lidhje me shitësin. Çmimi i njësie duhet të lidhet me shitjet me shumicë në kohën e importimit të mallrat që duhet të vlerësohen.

2.2.5. Metoda e pestë e vlerësimit – bazohet në shpenzimet e prodhimit të mallit, zakonisht përdoret me rastet kur importuesi dhe shfrytëzuesi janë të lidhur. Vlera doganore në metodën e pestë është vlerë e sendërtuar, bazohet në shumën e pikave të poshtëshënuara:

- shpenzimeve apo vlera e materialeve të fabrikimit apo përpunimit tjetër të përdorur në prodhimin e mallit të importuara
- informat të detalizuara nga eksportuesi, prodhuesi i jashtëm, direkt apo indirekt. SH.D. ka të drejtë të kërkojë informata plotësuese nga eksportuesi i jashtëm, këto informata do të merreshin nga administrata përkatëse doganore e vendit të eksportuesit me pajtimin e saj. Informatat do të nxirreshin nga evidence zyrtare e afarizmit të vet eksportuesit.
- Një shume për profitin prodhuesit me shpenzimet të përgjithshme të tij, plus – shpenzimet e transportit, sigurimeve, ngarkimit të cilat janë të ndërlidhur me mallrat deri në piken hyrëse në Kosovë.

2.2.6. Metoda gjashtë e vlerësimit – kjo është e fundit dhe përdoret atëherë kur vlera doganore e mallit nuk mund të përcaktohet sipas seksioneve 13 dhe 14 të kodit doganor të Kosovës, dhe caktohet në bazë të informatave të cilat i ka në dispozicion shërbimi doganor në Kosovë. Vlera doganore në këtë metodë arrihet duke përdorur mjetet e arsyeshme që janë në pajtueshmëri me parimin e vlerësimit të organizatës botërore të tregtisë. Kjo bënë të mundur metodat prej 1-5 në mënyrë fleksibile që të përshtaten në rrethana jo të zakonshme. Shembull: Metoda 2 apo 3, vlera doganore mund të zbatohet në vlerën e transaksionit të mallrave të importuar identike apo të ngjashme të prodhuar në vendin tjetër si vend i eksportit të mallrave të cilat janë në vlerësim të sipër. Metoda 4 limiti kohor për shitje mund të zgjatet. Vlera doganore mund të zbatohet në çmimin e cili mund të jete i paguar për mallra nëse ato janë blerë ndoshta duke iu referuar në çmimin eksportues për shitje për në Kosovë të

lëshuar prej furnizuesit. Kjo qasje do të ishte në pajtim me parimet e vlerësimit të OBT. Ne mund të cekim edhe për një kategori të vlerësimit të mallrave si: vlerësimi i mallrave pa pagesë; vlerësimi i mallrave zëvendësuese pa pagesë; vlerësimi i mallrave me qira; vlerësimi i mallrave të përdorur; vlerësimi i mallrave të humbur, të dëmtuar apo me defekt.

3. Auditimi i Vlerës doganore

Nëse nuk mund të mund të përcaktohet vlera e mallit në rastin e zhdoganimit të mallit, respektivisht atëher kur zhdoganohet, kjo nuk do të thotë që nuk mund të ketë ndërhyrje të më vonshme tek vlera e mallit nëse kemi informata të reja për një vlerë të mallit e cila nuk është deklaruar saktë me rastin e paraqitjes për zhdoganim. Bazuar në (Post -Clearance Audit (PCA), Volume 1. 2012) pikrisht për këtë doganat e vendeve të ndryshme kanë instaluar në kuadrin e vet edhe sektorë kontrolli apo auditit i cili detyrë kryesore e ka që të hetojë shmangiet e mundshme doganore për periudhën e caktuar retroaktive. Këto mekanizma kontrollojnë jo vetëm shmangiet e taksave nga vlera e mallit, por edhe nga origjina e mallit, klasifikimi tarifor, sasia e pa deklaruar, eksportet fiktive, shkelja e procedurave të tjera. Por qëllimi i këtij punimi është të shqyrtohen dhe të paraqiten vetëm elementet që përdoren për të zbuluar apo gjetur shmangiet e taksave të shkaktuar nga nën-vlerësimi i mallit, apo mos deklarimi i saktë i vlerës reale të mallit të caktuar doganor që është zhdoganuar. Elementet e auditit që përdoren për të provuar verifikimin e vlerës së mallit apo në përpjekje për të gjetur vlerën e saktë të mallrave të zhdoganuar në një periudhë të më vonshme janë:

3.1. Harmonizimi i të dhënave të DUD-it me dokumentet mbështetese

Gjatë auditimit, njëri nga elementet të cilat kontrollohet për të provuar saktësinë e vlerës së deklaruar, auditori bënë harmonizimin e të dhënave në dokumentet përcjellëce të mallit në import si: faturat, kontratat, çertifikatat e caktuara, dokumentet e transportit, i krahason dhe harmonizon me të dhënat e paraqitura në deklaratën doganore (Customs Manual Valuation, 2016).

3.2. Kontrolli i llogarive kryesore apo kontabilitetit

Ky element kontrolli është thelbësore në një auditim, i cili shqyrtojnë llogaritë e operatorit me kujdes, në mënyrë që të konstatojë gjitha blerjet e mallrave nga vendet e tjera nëse është bërë regjistrimi i duhur në libra kontabël. Auditori gjatë kontrolli ushtron aktivitetet në përpjekje për të konstatuar nëse mund të zbulon:

- Faturim të dyfisht
- Nënvlërim të mallit
- Ngarkesat e pa deklaruara
- Pagesat shtesë për dërgesat ose pagesat që duhet ti shtohet çmimit të deklaruar për zhdoganim

Qëllimi i këtij kontrolli është që të sigurohet që të gjitha faturat e pranuar nga vendet tjera janë në dispozicion për të kontrolluar në llogaritë e kompanisë.

3.3. Kontrolli dhe krahasimi i llogarive të përgjithshme

Qëllimi i këtij kontrolli është që të verifikojë në mënyrë të përgjithshme, nëse shumat e deklaruara të llogarive në kontabilitet përputhen saktësisht apo përafërsisht me vlerat doganore të deklaruara në periudhën e audituar. Auditori duhet të shqyrtojë klasifikimin e llogarive operatorit dhe për të identifikuar llogaritë që lidhen me blerjet nga furnizuesit me vendet e tjera me qëllim për të përcaktuar nëse ka ndonjë mospërputhje në mes të këtyre llogarive dhe deklaratat përkatëse. Audituesi duhet të studiojë bilancin dhe llogarinë e fitimit dhe humbjes (d.m.th pasqyrën e të ardhurave) për llogaritë përkatëse, siç janë shpenzimet dhe asetet (p.sh. mallrat e blera, aksione, etj.) në lidhje me blerjet nga vendet e tjera. Përveç kësaj, auditori duhet të verifikojë harmonizimin në mes të kontabilitetit dhe deklaratave doganore.

3.4. Kontrolli i pagesave të mallit

Është e rëndësishme për një auditim që lidhet me vlerën e deklaruar doganore, që të kontrollohen pagesat e bëra të mallrave të importit në mënyrë që të konfirmojnë se vlera doganore është paraqitur si duhet. Për këtë qëllim, përveç verifikimit të pagesave të mallit, analizohen edhe lëvizja e parasë për pagesë të mundshme të mallit me para në dorë (nëse qasja në këtë informacion është në

dispozicion). Në këtë rast kur shumat e parave dërgohen jashtë vendit, dhe si të tilla janë shumë më të larta se sa vlera e importit të deklaruar për atë shumë duhet arsyetuar sepse mund të jenë pagesat të mallit i cili mall ka vlerë më të lartë se sa vlera që është deklaruar për zhdoganim.

3.5. Verifikimi i vlerave në vendin e eksportit

Edhe ky është njëri ndër elementet më të fuqishëm që mundëson verifikimin e vlerës së mallit doganore. Gjatë auditimit për çdo mall për të cilin paraqitet dyshimi se nuk është deklaruar saktë me qëllim të shmangieve të taksave, auditori i rastit mund të përdor mekanizmin e verifikimit të vlerës së mallit tek vendi i eksportuesit për të konstatuar se a është e njëjta vlerë e mallit e cila është eksportuar nga ai vend. Madje nëse nga përgjigjia konfirmohet se e njëjta vlerë është eksportuar për mallin e caktuar, auditori në këtë rast krijon bindshmërinë për vlerë të saktë të mallit, në rastin tjetër nëse vlera e eksportit verifikohet që ishte më e madhe nga ajo vlerë që është deklaruar për zhdoganim atëherë konstatohet shmangie, dhe në këtë rast ndërmerren veprime për të rregulluar gjendjen e deklaruar, respektivisht për të inkasuar taksat shesë që rrejdhin nga shmangiet që janë shkaktuar si rezultat i mos deklarimit të pa saktë të vlerës së mallit.

3.6. Shkëmbimi i të dhënave tregtare me vendet në marrëveshje

Shkëmbimi i të dhënave është njëri ndër mekanizmat relevant i cili mundëson të konstatohen harmonizimi apo diferencat e të dhënave tregtare, respektivisht në ratsin tonë, të konstatohet saktësia e vlerave të mallit doganor, duke krahasuar vlerën e mallit të caktuar në eksport dhe vlerën e atij malli në import. Çdo diferencë apo ndryshim i vlerës të një malli, rezulton të jetë objekti i trajtimit të mëtejshëm, respektivisht nëse edhe në këto rast paraqitet të jetë vlera e mallit nga vendi i eksportit më e lartë se sa vlera e atij mallit gjatë paraqitjes për zhdogaim, konstatohen shmangiet e taksave përmes elementit të riskut nënvlerësim i mallit.

4. Përfundimet

Duke pasur parasysh që problem i evazionit fiskal është prezent në të gjitha vendet e globit, pa përjashtuar edhe vendet më të zhvilluara , por me në nivel të ndryshëm, deri sa vendet në zhvillim me zbatim të ulët të ligjit kanë gjithmon tendencë të kenë evasion fiskal më të lartë se sa vendet e zhvilluara ku zbatim i ligjit është i ashpër. Për tu shkaktuar evazion përdoren mënyra të ndryshme, po ne kemi marrë vetëm evazion nga mos deklarimi i saktë i vlerës së mallit (nëndeklarimi) që është njëra nga mënyrat që mund të shkaktohet evazion fiskal respektivisht mos pagesë të plotë të taksave doganore me rastin e importit. Po njëkohësisht kemi paraqitur edhe elementet që përdoren si mekanizmat për të parandaluar dhe zbuluar evazion që shkaktohen nga ky faktor risku, respektivisht nëndeklarimi i mallit. Gjatë shqyrtimit të elementeve që ndihmoj auditorin për të zbuluar shmangiet nga nëndeklarimi kemi gjetur të jenë: kontrolli i librave tregtare dhe dokumenteve që përcjellin mallin e importit, kontrolli i pasqyrave financiare, kontrolli i pagesave të mallit të importuar, verifikimi i vlerave të mallin në vendet të eksportit, përdorimi i shkëmbimit të të dhënave me vendet në marrëveshje.

Referencat:

1. Customs Manual on Valuation, update May 2016, This Manual provides a guide to the interpretation of the law governing Valuation for Customs Purposes which is set out in Commission Delegated Regulation (EU) No. 2015/2446 and Commission Implementing Regulation No. 2015/2447 laying down the detailed rules and implementing provisions of Regulation (EU) No 952/2013 of the European Parliament and Council establishing the Union Customs Code, and it should be read in conjunction with these regulations.
2. Kodi Doganor dhe i Akcizave të Kosovës, Nr. 03/L-109
3. Ligji Nr. 04/L-099 për ndryshim dhe plotësim të Kodit Doganor dhe të akcizave të Kosovës Nr. 03/L-109
4. Udhëzimi Administrativ Nr. 11/2009 për Implementimin dhe e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës
5. World Customs Organization, Guideline for Post -Clearance Audit (PCA), Volume 1.
6. World Bank, Washington DC, 2011, Post Clearance Audit Reference and Implementation Guide.

Implikimet ekonomike të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit për Kosovën drejt Bashkimit Evropian

Marigonë VRAJOLLI
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Republika e Kosovës

Abstrakt:

Shteti i Kosovës ka kaluar periudhën e rindërtimit të saj duke orientuar veten drejt zhvillimit ekonomik. Zhvillimi dhe rritja e prosperitetit në Kosovë është prioritet i institucioneve vendore. Ky zhvillim në Kosovë ka marrë një kujdes mjaft të veçantë përmes përkrahjes institucionale, kështu duke hartuar qëllime ekonomike për një stabilitet të qëndrueshëm ekonomik, tërheqja e investitorëve vendor e ndërkombëtarë dhe integrimet evropiane. Procesi integrues është bërë i mundur me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit si instrument i Bashkimit Evropian vetëm për vendet e Ballkanit Perëndimor. Ky proces ka adresuar prespektivën evropiane dhe ka inkurajuar bashkëpunim rajonal. Kosova, është vendi i fundit në Ballkanin Perëndimor që ka nënshkruar MSA-në. Kjo marrëveshje është marrëveshja e parë kontraktuale në mes të BE-së dhe Kosovës; një marrëveshje e cila kërkon angazhimin e të dyja palëve në lidhje me rrjedhën e veprimt të detajuar drejt përmbushjes së MSA-së. Marrëveshja me Kosovën është përshtatur me situatën specifike dhe pritet që të mbulojë disa çështje të rëndësishme të bashkëpunimit të ndërsjellët. Fillimisht, duke krijuar një zonë të tregtisë së lirë ndërmjet BE-së dhe Kosovës, në këtë mënyrë për t'u antarësuar duke identifikuar objektiva të përbashkëta socio-ekonomike dhe politike.

Fjalët kyqe: zhvillimi ekonomik, institucionet vendore, Marrëveshja e Stabilizim- Asociimit, Kosova, bashkëpunimi, zona e tregtisë së lirë

1. Hyrje

Ideali dhe rruga e Kosovës për në familjen e Bashkimit Evropian është urë e gjatë e mbushur me sfida dhe përvoja të ndryshme. Gjatë këtij rrugëtimi Kosova duhet të deklaroj më të mirën e mundshme për popullin e saj fillimisht dhe më pas edhe për tërë rajonin, në përgjithësi. Bashkimi Evropian si organizatë supranacionale sot më e madhe në Evropë, konsiderohet synim kyç për vendet e Ballkanit Perëndimor, sidomos për shkak të periudhës në të cilën Ballkani po kalon, e anëtarësimi konsiderohet si 'shpëtim' për zhvillim institucional të këtyre shteteve. Në mesin e këtyre shteteve të Ballkanit Perëndimor, Kosova ende ka disa kufizime. Megjithatë, nënshkrimi i MSA-së konsiderohet si ngjarje më e freskët në aspektin e arritjeve shtetërore është bërë pjesë më diskutabile dhe më rëndësishme për shumë analistë, ekspertë, ekonomistë, politikanë etj. Sfidat të cilat do të sjell MSA do të jenë me përgjegjësi dhe mundësi për Kosovën por që në këtë rast gaditëshmëria e Kosovës për implementimin e detyrave nga marrëveshja është e madhe. Duke e pasur parasysh një ekonomi tranzicionale në Kosovë, një treg i punës i vogël por numri i të papunëve mjaft i madh, një standard jetësor i ulët dhe me dallime të klasave. Thelbësisht, Kosova duhet të punoj akoma më shumë përmes mundësive që ofrohen nga jashtë dhe ndihmesa institucionale për biznese private. Andaj, përmes këtij punimi kam synuar që së paku të paraqes në parim se cilat janë të mirat dhe problematikat e Kosovës në rrugëtimin e saj. Si fillim, kapitulli i parë do të shtjellojë të kuptuarit e emërtimit të vetë termit MSA, synimet dhe aspektet që do të prek më shumë marrëveshja. Marrëveshja është e veshur me petkun ekonomik, prandaj arena më shumë e përfshirë do të jetë aspekti ekonomik. Kosova duhet të ketë prioritet ekonominë e sidomos të zhvillojë një treg me forca më konkurruese dhe të jetë më e begatë në bashkësi. Përmes kësaj, marrëveshja si mundësi e Kosovës për në BE do të afrohet çdoherë e më shumë. Përmes MSA-së, Kosova do të arrijë dukshëm të promovojë vlerat e tregut vendor në arenën ndërkombëtare dhe kështu të rritet ndikimi i saj dukshëm në bashkësinë ndërkombëtare. Në përgjithësi, realizmi i marrëveshjes mbetet prioritet kyç i qeveritarëve dhe popullit. Një perspektivë me përgjegjësi dhe një mundësi e mirë e pret vendin vetëm atëherë nëse drita e

cila del prej saj do të jetë e mbushur me aspekte pozitive dhe rezultatet më të mira të mundshme.

2. Cka nënkupton Marrëveshja e Stabilizim- Asociimit për Kosovën?

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit nënkupton një marrëveshje e cila vendoset mes një shteti (shteti si pjesë e një bashkësie ndërkombëtare) dhe Bashkimit Evropian (si një organizatë supranacionale e shtrirë në territorin evropian). Duke pasur parasysh që nënkupton një marrëdhënie kontraktuale e cila vendoset mes një shteti dhe vetë Bashkimit Evropian, atëherë roli i kësaj marrëveshje do të nënkupton një rol kontribues në aspektin ekonomik (për qka edhe vetë marrëveshja është e specializuar) por edhe në atë politik. Fakti që Kosova është një shtet kandidat potencial, atëherë edhe Marrëveshja për Stabilizim Asociim konsiderohet si hap i një mundësie të mirë në rrugën e ndërtimit institucional dhe në rrugën e Kosovës drejt BE-së. Mekanizmi Përcjellës i Marrëveshjes për Stabilizim –Asociim (MPSA) është baza për dialogun e rregullt mes BE-së dhe autoriteteve kosovare mbi çështjet e BE-së.¹⁷⁷ Negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit kanë filluar në tetor 2013¹⁷⁸ dhe si të tilla kanë marrë kohë derisa është bërë harmonizimi i politikave vendase me ato evropiane dhe reformat ligjore në vend. Duke e vlerësuar natyrën ekonomike të cilën synon të kontribuoj dhe të reformoj MSA-ja, atëherë sfera ekonomike e vendit e cila po përballet me sfidat tranzicionale është ajo e cila më shumë do të përmirësohet dhe të ndihmohet pikërisht prej kësaj marrëveshje. Ndihtes të madhe në hapjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit dha rruga e dialogut e hapur me Serbinë, e cila lë të kuptohet që një prej kriterëve të anëtarësimit, ajo politike¹⁷⁹, ka filluar të implementohet nëpërmjet rrugës së saj të zhvillimit të dialogut politikë me Serbinë e cila kishte sjellë edhe një normalizim të marrëdhënieve mes këtyre dy vendeve. Por kur flasim për MSA, për implementimin e saj është i rëndësishëm edhe kriteri ekonomik; vendi duhet të arrijë të ketë një ekonomi funksionale dhe të konkurrueshme me tregjet evropiane. Në kuadërën e kriterëve ekonomike do të hynin sfidat ekonomike me të cilat duhet të përballet vendi, kësajsoj: ridefinimin e vendit me ekonominë dhe

¹⁷⁷ Hajrullahu, V., "Gjendja aktuale dhe sfidat kryesore për Kosovën drejt rrugës së anëtarësimit në Bashkimit Evropian", FES-Conference Paper, 2008, fq.9

¹⁷⁸ Shehu, B., "Kosova nis zyrtarisht negociatat për MSA", Fokus, 28 Tetor 2013, <http://www.dw.com/sq/kosova-nis-zyrtarisht-negociatat-p%C3%ABr-msa/a-17188357>, (Parë në 21 Shkurt 2016)

¹⁷⁹ Ndër kriteret kyqe gjatë anëtarësimit të shteteve në BE janë: kriteri politik, ekonomik dhe juridik. Më vonë vendoset edhe një kriter tjetër i Madridit më 1995, i ashtuquajtur edhe si 'kriteri administrativ'.

strukturat ekonomike, liberalizimin e tregut, vendosjen e një sistemi të qëndrueshëm legal dhe infrastrukturë institucionale për garantimin e funksionimit të tregut të lirë, stabilitet makroekonomik, etj.¹⁸⁰ Përmes MSA-së vendi do të fitojë jo vetëm në aspektin ekonomik por edhe në rrugëtimin e saj në tërësi për në BE, sepse kjo të mundësonte shtetit të kuptojë që harmonizimi me kriteret e BE-së dhe përparimi i vendit në sektorin ekonomik, do të ndikonte pozitivisht edhe në integrimin e vendit në plotëni për në familjen e madhe të shteteve evropiane. Duke i parë anët negative që kanë shoqëruar ekonominë vendase që nga paslufta, bashkëpunimi në planin ekonomik me vendet e zhvilluara do të ndihmonte Kosovën të hartonte një strategji të qartë në aspektin e veprimit ekonomik dhe përmes bashkëpunimit ekonomik të ketë edhe një mundësi për ndryshime buxhetore në favor pozitiv.

Prandaj, synimet e Asociimit janë:

- Të mbështesë përpjekjet e Kosovës për forcimin e demokracisë dhe shtetin e së drejtës;
- Të kontribuoj në stabilitetin politik, ekonomik dhe institucional në Kosovë si për stabilizimin e rajonit;
- Të sigurojë një strukturë të përshtatshme për dialogun politik, kështu duke lejuar zhvillimin e marrëdhënieve të ngushta politike ndërmjet palëve;
- Të mbështesë përpjekjet e Kosovës për zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik dhe ndërkombëtar, nëse lejojnë rrethanat objektive gjithashtu edhe nëpërmjet përafërimit të legjislacionit të BE-së me atë të Kosovës; dhe
- Të nxisë bashkëpunimin rajonal në të gjitha fushat e trajtuara me këtë Marrëveshje.¹⁸¹

MSA ka fokus të veçantë në spektrin ekonomik duke ndihmuar kësisoj që Kosova të bëhet një vend më i përshtatshëm për të zhvilluar biznese të mirrëfillta por poashtu do të nxiste edhe përkrahjen e investitorëve të huaj në

¹⁸⁰ GAP, "Kriteret ekonomike të Kopenhagës, Cfarë duhet të bëjë Kosova?", Qeshor 2009, fq.06, http://www.institutigap.org/documents/8897_Kriteret_Ekonomike_te_Kopenhages.pdf, (Parë në 21 Shkurt 2016)

¹⁸¹ Ministria e Integritimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të energjisë, në anën tjetër", Kosovë, http://www.mei-ks.net/repository/docs/Kosovo-EU_SAA_Final_SQ.pdf, (Parë në 22 Shkurt 2016).

vend. Një numër i madh i produkteve të Bashkimit Evropian të cilat do hyjnë në Kosovë pas fillimit të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, do të lirohen nga taksat doganore dhe disa prej tyre do të kenë zbritje të tatimit doganor. Nga taksat doganore pritet të lirohen edhe ato produkte të cilat të njëjtat prodhohen edhe në Kosovë.¹⁸² Për më tepër, qëllimi i MSA-së është të ndihmojë në të mirë të kosovarëve për të hyrë më lehtë në tregun evropian, krijimin e vendeve të reja të punës përmes rritjes së konkurrencës, uljen e çmimeve dhe tregje më të konkurrueshme. Por MSA do të rezultoj edhe me disa pasoja negative për vetë vendin, duke pasur parasysh që 2/3 e buxhetit të Kosovës sigurohen përmes taksave/doganave dhe se kjo do të shënonte një regres në të ardhurat shtetërore të vendit në këtë sektor por që do të kontribuonte në sjelljen e më shumë përfitimeve dhe të ardhurave për vend përmes MSA-së. Marrëveshja është hapi i parë i rëndësishëm i Kosovës si shtet që nga pavarësimi i saj dhe si e tillë do të stimulonte edhe shtetet e tjera qofshin ato europiane apo më gjerë në shtrirjen e partneritetit të tyre me një vend të tillë. Mundësi e mirë mbetet fakti se edhe përkundër që Kosova nuk është njohur nga pesë shtetet e BE-së, ka mundësuar që ratifikimi i Marrëveshjes të bëhet edhe duke mos u ratifikuar nga parlamentet kombëtare të shteteve, gjë që do të shmangte mundësinë e përdorimit të pozicionit ‘kundër’ dhe si e tillë të mos kontribuonte në ofrimin e një perspektive të qartë shtetërore ndërkombëtare.

3. Roli i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit në zhvillimin ekonomik të Kosovës

Bashkimi Evropian kishte vendosur marrëdhënie kontraktuale me vendet e Ballkanit Perëndimor që nga viti 1997, siç thuhet në konkluzionet e Këshillit Evropian. Në të njëjtën kohë, ekonomia e Kosovës, në veçanti, përballej me shumë sfida të rëndësishme. Historikisht, ¹⁸³në vitin 1988, prodhimi i përgjithshëm i Kosovës ishte e dominuar nga industria, e cila përbënte rreth 50% të GDP-së, ndërsa bujqësia përbënte vetëm rreth 20% të GDP-së. Gjatë

¹⁸² Kosova Sot, 'MSA-ja liron nga taksa doganore edhe produktet nga Kosova', Janar 2016, <https://www.kosova-sot.info/lajme/70451/msa-ja-liron-nga-taksa-doganore-edhe-produktet-nga-kosova>, (Parë në 22 Shkurt 2016).

¹⁸³ UNDP, Raporti i Zhvillimit Njerëzor, Kosova, 2006, fq.27.

viteve '90, ekonomia e Kosovës kishte shënuar një rënie të konsiderueshme, fillimisht për shkak të mungesës së investimeve të nevojshme dhe së dyti për shkak të shkatërrimit të infrastrukturës së prodhimit dhe kapaciteteve të shkatërruara në vitin 1999. Megjithëse, para vitit 1999 ekonomia e Kosovës ishte e fokusuar në industri, energjetikë e metalurgji, materiale të ndërtimit dhe përpunimin e produkteve bujqësore. Megjithatë, papunësia ishte shumë e lartë dhe sektori privat mbetej për një kohë i dobët. Në këtë mënyrë ishte dashur që të përmisohej mjedisi i të bërit biznes dhe të mbështetej zhvillimi i sektorit privat. Përpjekje të mëdha qenë më se të nevojshme kështu për të synuar zhvillim ekonomik, krijimi i vendeve të reja të punës dhe çështjeve që ndërlidhen me konkurrencën dhe kështu për të arritur rritje më të qëndrueshme dhe afatëgjate. Ndërsa në ditët e sotme, ¹⁸⁴Kosova është anëtare e CEFTA dhe ka një regjim tarifor për të gjitha mallrat industriale dhe produkteve bujqësore, me të gjithë anëtarët e CEFTA-s. Poashtu, Kosova ka një regjim liberal tregtar dhe është një ekonomi e hapur por me disa kufizime në tregti. Kur flasim për tregtinë, duhet pasur parasysh që tregtia është një sektor kyç në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për faktin se u ofron bizneseve të përfitojnë nga MSA me reduktimin e barrierave tregtare dhe krijimin e një tregtie transparente. Në këtë dritë, hapja e tregtisë luan një rol të rëndësishëm në ekonominë e Kosovës në shumë aspekte. Ajo ka qenë e evidentuar se tregtia ndërkombëtare është një nga përbërësit më të rëndësishëm të rritjes ekonomike dhe zhvillimit, duke rezultuar në të ardhura më të larta dhe nivelet e mirëqenies për shoqëritë.¹⁸⁵ Në këtë rrugë, përfitimet e MSA-së për Kosovën përfshijnë një sferë të gjerë zhvillimi. Në fushën ekonomike, marrëveshja e Kosovës me tregjet e BE-së ka kontribuar në një total prej 29.9% të eksporteve që rrjedhin në vendet anëtare të BE-së në gusht të vitit 2015.¹⁸⁶ Por si rezultat i nënshkrimit të MSA-së, Kosova do të përfitoj kushte të volitshme si; blerja e lëndës së parë me çmime mjaft të volitshme, të cilat do të ofrojnë stimuj për reformime të mëtejshme ekonomike në vend. Kjo do të jetë e mirëpritur për bizneset dhe ekonominë kosovare për shkak që gjatë dekadës së fundit Kosova ka një performancë të dobët në

¹⁸⁴ Komisioni Evropian, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në mes të Bashkimi Evropian dhe Kosova, Bruksel, 2012

¹⁸⁵ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë, Dimensionit tregtar i MSA-së me BE-në dhe ekonomia e Kosovës, Prishtinë, 2015, fq.3.

¹⁸⁶ Murati, K., "Shenjat e Kosovës në përputhje me pika - tani çka?", Global Risk Insights, 1 Nëntor 2015 <http://globalriskinsights.com/2015/11/kosovo-signs-on-the-dotted-line-now-what>, (Parë në 15 Shkurt 2015).

treguesit e tregtisë. Në tetë muajt e parë të vitit 2013, Kosova ka shënuar një deficit tregtar prej 1,391,970,000 EURO.¹⁸⁷ Kështu, deficitin vazhdueshëm tregtar reflekton në një bazë të dobët të prodhimit dhe poashtu në mungesën e konkurrencës ndërkombëtare. Për të rritur konkurrencën, investime të mëtejshme janë të nevojshme në kapitalin njerëzor dhe infrastrukturë fizike.¹⁸⁸ Rrjedhimisht, në Kosovë, importet, eksportet mbulojnë nga eksportet —që janë rritur gradualisht gjatë të njëjtës periudhë. Lidhur me eksportin dhe importin e Kosovës, partner kryesor tregtar janë vendet e CEFTA-s të cilat marrin pjesë me (35.4%) për eksport dhe (24.6%) për import, ndërsa vendet e BE-së marrin pjesë me (20.0%) për eksport dhe (43.0%) për import.¹⁸⁹




Figura 1: Totali i Eksportit dhe Importit për Dhjetor 2013-2015 në Kosovë.
Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Tregtisë së Jashtme, 2015

Tregtia e Kosovës me vendet anëtare të BE-së rrit bashkëpunimin e mëtejshëm. Lëvizja e lirë e mallrave, lëvizja e kapitalit dhe të punëtorëve në tregun e Bashkimit Evropian përfaqësojnë themelet e tregut të brendshëm të lirë. Kjo do të thotë se mallrat janë tregtuar në mesin e vendeve anëtare të BE-së dhe trashëgimtarët e MSA-së pa ndonjë pengesë, tani dhe Kosova. Megjithatë, efekti i MSA-së varet më shumë nga aftësia e vendit partner për të zbatuar të gjitha standardet e nevojshme, si: rritja e konkurrencës e saj me produktet të brendshme, stimulimi për eksportet dhe rritja ekonomike. Sipas vlerësimeve të ndikimit të kryera nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë,

¹⁸⁷ Grupi për Studime Juridike dhe Politike, "Ndikimi i tregtisë BE- Kosovë: vlerësimi i rezultateve dhe implikimet", Nr. 03, 2014.

¹⁸⁸ Komisioni Europian, Gjetjet kryesore të raportit 2015 për Kosovën, Bruksel, 2015.

¹⁸⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Tregtisë së Jashtme, Dhjetor 2015, http://ask.rks.gov.net/publikimet/cat_view/14-tregtia-e-jashtme/115-statistikat-e-tregtise-se-jashtme-2015, (Parë në 16 Shkurt 2016).

preferencat e MSA-së do të çojë ¹⁹⁰në një rritje të importeve dhe eksporteve, në afat të shkurtër dhe të mesëm. Në këtë mënyrë, liberalizimi i tregtisë me vendet partnere sjellin rritjen e eksporteve, shumëllojshmëri më të madhe të produkteve, fitimet e mirëqenies, zgjerimin e prodhimit, etj. Prandaj, institucionet e Kosovës duhet të luajë një rol të rëndësishëm unifikues në rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me përparësitë dhe mundësitë e promovimit të produkteve në tregun e BE-së, si dhe përmbushjen e të gjitha kërkesave të nevojshme gjatë periudhave të dhëna kalimtare nga vet BE-ja. Në këtë kontekst, Institucionet e Kosovës duhet të fillojnë të kenë si prioritet mbrojtjen e sektorëve të veçantë të ndjeshëm ekonomik si dhe liberalizimin e të gjitha produkteve, të tilla si makineri, që sjellin kosto më të larta.¹⁹¹

4. Përfundime

Objektivi i parë i studimit ishte për të konstatuar implikimet e MSA-së në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Bazuar në përvojat e zhvillimit ekonomik të vendeve që kanë kaluar nëpër fazën e tranzicionit në vitet e fundit, mund të themi se marrëveshjet e tilla kanë luajtur një rol kyç dhe shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe njëkohësisht të kenë një ndikim multidimensional pozitiv. Këto lloj marrëveshjesh janë shumë të nevojshme për periudhën e tanishme të zhvillimit në të cilën gjendet Kosova, pasi ajo po përballet me një mungesë të burimeve të veta financiare për investime. Edhe pse Kosova ka një regjim liberal tregtar, në përgjithësi ka disa kufizime të tregtisë dhe një nivel shumë i lartë i papunësisë e cila mbetet sfida kryesore ekonomike e shoqërisë kosovare. Prandaj duhet konsideruar që sukcesi në periudhën e vështirë gjatë

¹⁹⁰ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Asistenca teknike për zhvillimin e mëtejshëm të politikave tregtare të Kosovës: përgatitja e Kosovës për aspektet tregtare të negociatave të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me BE-në, 2013

¹⁹¹ Grupi për Studime Juridike dhe Politike, "Ndikimi i tregtisë BE- Kosovë: vlerësimi i rezultateve dhe implikimet", Nr. 03, 2014

krizës do të mund të ndryshohet dhe të kaloj në progres jo vetëm nga angazhimi i qeverisë, por edhe bashkësive transnacionale në përgjithësi, në veçanti, Bashkimi Evropian. Në këtë mënyrë bashkëpunimi EU-Kosovë do të sjell rritjen e eksporteve, kështu duke ardhur edhe deri te një baraspeshë e tregtisë, shumëllojshmëri të produkteve në treg, fitimet e eficiencës, rritje të faktorëve të prodhimit e forma të tjera të bashkëpunimit të ndërsjellët ekonomik me vendet e Bashkimit Evropian, etj.

5. Bibliografia

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Tregtisë së Jashtme, Dhjetor 2015, http://ask.rks-gov.net/publikimet/cat_view/14-tregtia-e-jashtme/115-statistikat-e-tregtise-se-jashtme-2015

² GAP, 'Kriteret ekonomike të Kopenhagës, Cfarë duhet të bëjë Kosova?', Qeshor 2009, http://www.institutigap.org/documents/8897_Kriteret_Ekonomike_te_Kopenha_ges.pdf

³ Grupi për Studime Juridike dhe Politike, 'Ndikimi i tregtisë BE- Kosovë: vlerësimi i rezultateve dhe implikimet', nr. 03, 2014

⁴ Hajrrullahu, V., 'Gjendja aktuale dhe sfidat kryesore për Kosovën drejt rrugës së anëtarësimit në Bashkimit Evropian', FES-Conference Paper, 2008

⁵ Komisioni Evropian, Gjetjet kryesore të raportit 2015 për Kosovën, Bruksel, 2015 Komisioni Evropian, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në mes të Bashkimi Evropian dhe Kosova, Bruksel, 2012

⁶ Kosova Sot, 'MSA-ja liron nga taksa doganore edhe produktet nga Kosova', Janar 2016, <https://www.kosova-sot.info/lajme/70451/msa-ja-liron-nga-taksa-doganore-edhe-produktet-nga-kosova>

⁷ MIE në Kosovë, 'Marrëveshja e Stabilizimi Asociimit –Ndërmjet Kosovës në njërën anë dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të energjisë, në

anën tjetër', http://www.mei-ks.net/repository/docs/Kosovo-EU_SAA_Final_SQ.pdf

⁸ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë, Dimensioni tregtar i MSA-së me BE-në dhe ekonomia e Kosovës, Prishtinë, 2015

⁹ MTI, Asistenca teknike për zhvillimin e mëtejshëm të politikave tregtare të Kosovës: përgatitja e Kosovës për aspektet tregtare të negociatave të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me BE-në, 2013

¹⁰ Murati, K., 'Shenjat e Kosovës në përputhje me pika - tani çka?', Global Risk Insights, 1 Nëntor 2015 <http://globalriskinsights.com/2015/11/kosovo-signs-on-the-dotted-line-now-what>

¹¹ Shehu, B., 'Kosova nis zyrtarisht negociatat për MSA', Fokus, 28 Tetor 2013, <http://www.dw.com/sq/kosova-nis-zyrtarisht-negociatat-p%C3%ABr-msa/a-17188357>

¹² UNDP, Raporti i Zhvillimit Njerëzor, Kosova, 2006

Analiza e strategjive të ndërmarrjeve të vogla

Arian Krasniqi,
Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Republika e Kosovës
ariankrasniqi33@gmail.com

Abstrakti:

Qëllimi i këtij hulumtimi është të vlerësojë dhe të analizojë rëndësinë e strategjive të ndërmarrjeve të vogla në Kosovë, ndërlidhjen e objektivave të ndërmarrjes me strategjitë e saj dhe implementimin e tyre nga këto ndërmarrje. Pse disa biznese kanë sukses dhe pse disa falimentojnë? Burimet e suksesit dhe të dështimit për një biznes mund të jenë të natyrave të ndryshme në të cilin ndikojnë shumë faktorë, mirëpo një pikë shumë e rëndësishme dhe vitale për bizneset është menaxhimi i strategjive biznesore dhe menaxhimi i përparësive konkurruese të cilat i bizneset i posedojnë në raport me rivalët e tyre në treg dhe në industri.

Modeli i hulumtimit përdorë kombinim e metodave cilësore dhe sasiore në mënyrë që të shqyrtohet problemi më thellësisht. Poashtu modeli përfshin teorinë si dhe pjesën praktike e cila është realizuar në sektorin e ndërmarrjeve të vogla. Metodot e shfrytëzuara janë analizat teorike, kombinimin e të dhënave cilësore dhe sasiore si dhe metodat krahasuese.

Nga hulumtimi është vërtetuar se në vendin tonë, strategjitë dhe menaxhimenti strategjik i ndërmarrjeve kanë filluar vonë të aplikohen, madje në shumicën e ndërmarrjeve këto strategji ende nuk kanë filluar të integrohen plotësisht në planifikimet dhe proceset e tyre biznesore. Mirëpo lufta për mbijetësë dhe rritja e ndërmarrjeve në këtë kohë bashkëkohore dhe shumë dinamike, e cila karakterizohet me një konkurrencë shumë të fortë, është e vështirë që të arrihet pa menaxhimin e strategjive.

Fjalët e rëndësishme: strategjia, menaxhimi strategjik, planifikimi, ndërmarrjet e vogla, objektivat strategjike, struktura organizative, operacionet.

1. Hyrja

Qëllimi i këtij punimi është të vlerësojë dhe analizojë rëndësinë e strategjive të ndërmarrjeve të vogla në Kosovë dhe implementimin e strategjive nga këto ndërmarrje.

Zhvillimi i sektorit të NVM-ve në Kosovë duhet të marrë rolin primar në zhvillimin ekonomik të vendit. Por për zhvillimin e këtij sektori nevojiten politika aktive dhe përmirësim i ambientit të biznesit, në përmirësimin e të cilit duhet të ndikoj qeveria me politikat e saj favorizuese dhe stimuluese ndaj biznesëve. Zhvillimi i këtij sektori ka një rol kyç në rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja të punës, i cili si faktorë do të ndikonte në stabilitetin ekonomik dhe mirëqeniqën sociale të qytetarëve.

Në vendin tonë, strategjitë dhe menaxhimet strategjike të ndërmarrjeve kanë filluar më vonë të aplikohen, madje në shumicën e ndërmarrjeve këto strategji ende nuk kanë filluar të integrohen në planifikimet dhe proceset e tyre biznesore, si një ndër faktorë kryesorë mund të jenë kosto e lartë e zhvillimit të strategjive dhe njohuritë e nevojshme për zbatimin apo menaxhimin e tyre.

2. Menaxhimi strategjik në firmat e vogla

Strategjitë dhe menaxhimi i tyre (*menaxhimenti strategjik*) janë faktorë kyç në suksesin e bizneseve, duke i përdorur teknikat, aktivitetet dhe konceptet strategjike. Gjithashtu ndikonë në realizimin e qëllimeve të ndërmarrjes, duke e bërë ndërmarrjen më efektive në alokimin e resurseve të saja dhe më efektive në arritjen e objektivave që i ka. Mirëpo, pa marrë parasysh natyrën e tyre, qëllimi i

cilësdo strategji¹⁹² është të përshkruaj një plan të veprimeve, synimeve dhe rezultateve për një projekt apo ndërmarrje konkrete. Përmes zhvillimit të strategjive të mirëfillta dhe menaxhimit të mirë të tyre mund të krijohet dhe të arrihet avantazhi konkures. Pra ndikojnë drejtpërsëdrejti në rritjen e performancës së ndërmarrjes, çka është edhe karakteristikë e strategjive dhe menaxhimit strategjik.

Sipas Kume (2010) menaxhimi strategjik është po aq jetik për bizneset e vogla sa edhe për të mëdhatë . Nga themelimi i tyre, të gjitha organizatat kanë një strategji, edhe në qoftë se strategjia e tyre zhvillohet nga operacionet e përditshme. Edhe nëse kryhet në mënyrë joformale ose nga një pronar/sipërmarrës i vetëm, procesi i MS mund të rrisë në mënyrë të konsiderueshme zhvillimin dhe prosperitetin e firmave të vogla. Gjithshtu është e rëndësishme të theksohet se strategjitë e marketingut duhet të jenë në pajtueshmëri me drejtimin, synimet dhe strategjitë e përgjithshme të organizatës¹⁹³. Kërkime të rëndësishme gjithashtu përmbledhin që kompanitë e mëdha i kushtojnë më shumë vëmendje menaxhmentit strategjik dhe kanë shumë më shumë strategji detale të përgaditura se sa bizneset e vogla¹⁹⁴.

2.1Ndikimi i strategjisë dhe strukturës në vendimmarrjen operationale të organizatës

Duke ditur së operacionet shërbejnë për realizimin e strategjisë së organizatës, për realizimin e objektivave strategjike, është e kuptueshme së varësisht nga lloji i strategjisë që zhvillohet në një organizatë duhet të zhvillohen edhe operacionet përkatëse të cilat përputhen më strategjinë dhe janë në funksion të strategjisë. Gjithashtu këto së bashku duhet t'i përshtaten edhe strukturës së ndërmarrjes.

¹⁹² Barritt, Ch. & Alderman, F. Lee, 2004. *Creating a Reusable Learning Objects Strategy*. San Francisco, USA: Pfeiffer, fq. 9

¹⁹³ Wood, B. Marian, *The Marketing Plan Handbook*. 2nd ed. New Jersey, USA: Pearson Prentice Hall, 2005

¹⁹⁴ Skokan Karel, Pawliczek Adam, Piszczur Radomír, *Strategic Planning and Business Performance of Micro, Small and Medium-Sized Enterprises*, Vol. 5, Journal of Competitiveness , Issue 4, pp. 57-72, December 2013, fq. 70

Tabela 1: Lokacioni operacional i bizneseve në Kosovë

Lokacioni operacional i bizneseve	%
Në një vend në Kosovë	83.7
Dy e më shumë vende në Kosovë	15.5
Në Kosovë dhe jashtë vendit	0.8
Totali	100.00

Burimi: BSCK Survey¹⁹⁵, 2010.

Nga tabela mund të vërehet se bizneset kosovare operacionet e tyre më së shumti i kanë të lokalizuar në vendin në të cilin veprojnë, do të thotë aty ku operojnë, dhe nuk vërehen shumë shtrirje në vende të tjera (fshatra, qytete, rajone), gjëgjësisht duke përfshirë shtrirjet edhe jashtë vendit në shtete tjera. Pra qëllimet e tyre për zgjerim të tregut dhe aspiratat globaliste nuk shprehen shumë

3. Rasti studimorë

3.1 Metodologjia e hulumtimit

Ky hulumtim përbehet nga dy pjesë, i cili përfshin pjesën teorike dhe atë praktike. Pjesa teorike e hulumtimit përfshin literaturën, artikujt nga revistat shkencore dhe informatat e shfrytëzuara nga webi, ndërsa pjesa praktike e hulumtimit përfshin intervistat e realizuara me ndërmarrjet e vogla. Punimi është mbështetur duke i shfrytëzuar të dhëna primare dhe të dhëna sekondare, duke shfrytëzuar literaturë bashkëkohore nga fusha e

¹⁹⁵ Entrepreneurship and Small Business Development in Kosovo, Research report, Prishtinë, Mars 2011

menaxhmentit strategjik si dhe hulumtimeve e punimeve të cilat janë realizuar rreth kësaj fushe. Hulumtimi është realizuar përmes pesë intervistave, ku si mostër janë marrë biznese të vogla të cilat i takojnë fushave të ndryshme të veprimtarive biznesore. Katër prej intervistave janë realizuar në Gjakovë dhe rrethinë të saj, ndërsa njëra është realizuar në parkun e biznesit në Drenas. Intervista është e tipit të strukturuar me gjithsej 11 pyetje, e cila përmban pyetje të hapura, të mbyllura dhe me alternativa. Intervistat kanë zgjatur nga 40 minuta për secilën.

3.2 Prezantimi dhe analiza e rezultateve

Pyetjet gjatë Intervistes	Agro-AF	NPT Garden	NPN Alping	Niki-M	Jakova Inovation Center	Përqindja	
						PO	JO
A keni pasur biznes plan para së të hapëni firmen	Po	Jo	Po	Po	Po	0,8	0,2
Gjatë planifikimit të strategjive, a i përdorni teknikat e analizave dhe matricave	Po	Po	Jo	Jo	Jo	0,4	0,6
Pjesëmarrja e departamenteve dhe punëtorëve në planifikim strategjik	Jo	Po	Po	Jo	Po	0,5	0,5
A keni njohuri të mfajtueshme mbi klientët dhe target grupin tuaj	Po	Po	Jo	Jo	/	0,5	0,5
A keni informacione mbi konkurrencën dhe aksionet e tyre	Po	Po	Po	Po	/		

A perdorni softver kompjuterik ne planifikimin dhe ne kontrollin strategjik	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo		1
Periudhat e rishikimit te implementimit te strategjive	Vjetore	6 Mujore	3 Vjeqare	Vjetore	Vjetore		
Cfare prisni ne vitin 2017	Me i mire	Me i mire	Me i keq	Njejte	Me i mire		
Profiti i ndermarrjes tuaj eshte	Rritur	Rënie	I njejte	Renie	/		
A keni marre kredi nga banka	Subvencion	Jo	Jo	Jo	Donacione	0,4	0,6

Burimi: Autori

Tabela 2: Rezultatet e pyetjeve të mbyllura

Nga tabela mund të vërehet se 80% e bizneseve të intervistuar kishin biznes plan kur e kanë filluar biznesin, ndërsa 20% prej tyre nuk kishin. Përveç këtyre pyetjeve, në intervistë janë trajtuar dhe analizuar të dhënat cilësore të bizneseve që kanë të bëjnë me çështjet:

Strukture organizative e ndërmarrjeve: Përgjithësisht këto biznese shfrytëzonin strukturën Piramidë apo hierarkike, dmth përdorin një strukturë të thjeshtë organizative, që fillontë me pronarin në krye të biznesit, duke pasuar më menaxherët dhe drejtorët dhe në fund të piramidës janë punëtorët.

Përdorimi i teknikave analitike dhe matricave gjatë planifikimit strategjik: 40 % të bizneseve të intervistuar kanë përdorur matricat, matrica e përdorur nga të dy bizneset ka qenë SWOT analiza, ndërsa Matricën e vlerësimit të faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm e ka shfrytëzuar një biznes. Ndërsa tri bizneset e tjera nuk i përdornin matricat dhe teknikat tjera për planifikim të strategjive dhe biznesit, duke konsideruar që nuk kanë njohuri në aplikimin e këtyre matricave dhe analizave biznesore.

Pritjet për vitin 2017: Sa i përket pritjeve të bizneseve, 60% prej tyre janë më optimiste duke parashikuar që ky vit do të jetë më i mirë sesa viti paraprak, ndërsa 40% prej tyre kanë shënuar rënie duke theksuar që ambienti i paqëndrueshëm biznesorë dhe faktori politik ka ndikuar në kërkesë. Ndërsa 20% tjera kanë deklaruar që fitimi i tyre ishte i pandryshueshëm.

Përdorimi i softuereve për planifikim strategjik: Vërehet qartë nga tabela se intergrimi i softuereve për planifikim strategjik ende nuk ka filluar. Bizneset vlerësohen të jenë faktorët kyç dhe kryesorë të cilat shtynë zhvillimin e teknologjive të reja për të arritur përparësi strategjike në zhvillimet e suksesshme fitimprurëse¹⁹⁶.

Kreditë nga Banka: Nga tabela mund të konstatojmë se kredi nga banka nuk kanë marrë 60% prej tyre, mirëpo 40% e bizneseve tjera kanë marrë subvencione nga ministria dhe donacione të ndryshme, që do të thotë se kredi nuk kanë shfrytëzuar asnjë nga bizneset për shkak të interesit të lartë që është edhe një kufizim për veprimtarinë biznesore.

Strategjitë që kanë prioritet me të lartë nga ndërmarrjet: Nga kjo tabelë mund të vërejmë qartë se ndër strategjitë më të rëndësishme të bizneseve kanë të bëjnë me:

¹⁹⁶ Mustafi, Skender. Matures and still emerging: The Changing Position of The Internet in Business Strategies of Companies Since the DotCom Hype, FHNW, Olten, 2011

	Agro-AF	NPT Gard en	NPN Alpi ng	Nik i-M	%
1.Përmirësimi i cilësisë së produkteve/shërbimeve		+		+	50 %
2.Diferncimi i produkteve/shërbimeve		+		+	50 %
3.Marketingu dhe aktivitetet reklamuese	+	+	+		75 %
4.Investimi në teknologji				+	25 %
5.Trajnimi i të punësuarve (strafit)	-	-	-	-	0.0 0
6.Kostot më të ulëta	+		+	+	75 %

Tabela 3: Strategjitë më të rëndësishme të ndërmarrjes

Burimi: Autori

1. Arritjen e kostove më të ulëta, e cila ka ndikim direkt në arritjen e fitimeve të bizneseve, dhe që këto fitime mund të shfrytëzohen për aktivitete tjera apo të investohet në diçka të re. Kjo strategji synohet nga 75% e bizneseve të intervistuar

2. Marketingu dhe aktivitetet reklamuese, definimi dhe implementimi i një strategjie të fortë të marketingut është pothuajse faktori i vetëm më i rëndësishëm që kontribuon në drejtim të suksesit të qëndrueshëm afatgjatë të çfarëdo biznesi¹⁹⁷. Sipas të dhënave të marra nga këto biznese theks të veçantë është duke u dhënë aktiviteteve reklamuese të cilat i informojnë konsumatorët më ofertat e reja të këtyre bizneseve, dhe format që shfrytëzohen më së shumti nga këto biznese janë reklamat në vet objektin e biznesit dhe mediumet. P. Drucker ka theksuar qartë rolin e marketingut¹⁹⁸ për suksesin e ndërmarrjes dhe qëndrueshmërinë e saj i cili është i pakontestueshëm.

3. Përmirësimi i cilësisë së produkteve/shërbimeve, rreth 50% e këtyre bizneseve deklarojnë që kjo është njëra ndër strategjitë më të rëndësishme dhe vazhdimisht shihet tendenca e realizimit të kësaj strategjie për arsye të tërheqjes së konsumtarëve të rinjë dhe mbajtjen e atyre ekzistues.

4. Diferencimi i produkteve/shërbimeve, po ashtu rezultojë si strategji e rëndësishme e bizneseve, ku 50% prej tyre theksuan që një diferencim i mirë i produkteve do të rritë fitimin e biznesit dhe do të sjellë klient të ri. Nga diferencimi mund të krijohen përparësitë konkurruese¹⁹⁹, të cilat janë thelbësore për suksesin afatgjatë të ndërmarrjes.

¹⁹⁷ A & C Black Publishers Ltd: *Choosing Your Marketing Strategy*, UK, 2006

¹⁹⁸ Drucker, P.: *The Practice of Management*, Harper & Row, New York, 1954, citat në faqën 37 të librit Evans, J.R. & Berman, B.: *Marketing*, New York, 1987

¹⁹⁹ Fred R. David, „Menaxhimi Strategjik – Koncepte dhe rastet studimore“, Botimi i 13-të, Prishtinë, Janar 2014, (Përkthimi Shqip), fq. 10

5. *Trajnimi i të punësuarve (stafit)*, nga intervistat me këto biznese, kjo strategji ende mbetet e parëndësishme dhe nga to nuk është duke u bërë diçka në ndryshimin e kësaj çasje. Ende vazhdon qasja tradicionale për mos trajnimin e stafit dhe duke mos e konsideruar RH si faktorin kryesorë. Gjithashtu nga një hulumtim i zhvilluar në lidhje me programet edukuese të bizneseve të vogla²⁰⁰, ka evidentuar që këto programe për trajnimin dhe edukimin e stafit kanë hasur në rezistence nga pronari-menaxheri i biznesit të vogël.

6. *Kostot më të ulëta*, si një strategji shumë e rëndësishme, 75% deklaruan që kjo është njëra nga strategjitë që përpjekjen të arrijnë vazhdimisht që ndikon direkt në profitin e ndërmarrjeve. Përveç kësaj, arritja e kësaj strategjie mund të sigurojë edhe përparësi konkurruese në krahasim më bizneset e tjera.

3.3 Hipotezat

H1: *Vështirësitë në financim janë pengesë për realizimin e strategjive.* Është esenciale për bizneset e vogla që të kenë qasje në financim nga jashtë si psh nga: bankat, subvencionet dhe mbështetjet qeveritare, investitorët etj, për arsye të operimit, implementimit të strategjive dhe rritjes së tyre.

H2: *Jostabiliteti politik dhe ambienti i paqëndrueshëm biznesorë janë faktorë destabilizues i zhvillimit të bizneseve.* Jostabiliteti politik në vend dhe ambienti i paqëndrueshëm biznesorë, kanë ndikuar në performancën e bizneseve duke qenë faktorë destabilizues në implementimin e strategjive dhe duke ndikuar në uljen e fitimeve dhe gjithashtu me mos përkrahjen e bizneseve me subvencione dhe forma të tjera nga ana e qeverisë.

H3: *Probabiliteti për sukses i bizneseve që kanë plane strategjike është më i madh tek ato që posedojnë këto plane, se sa të ato të cilat nuk kanë plane dhe strategji.* Rezultatet e hulumtimit tregojnë që organizatat që i përdorin konceptet e menaxhimit strategjik janë më profitabile dhe më të suksesshme se ato që nuk i përdorin. Bizneset që i përdorin konceptet e menaxhimit

²⁰⁰Gary Gorman, Dennis Hanlon, Wayne King, *Some research perspectives on entrepreneurship education, enterprise education and education for small business management: a ten-year literature review.* International Small Business Journal, April-June 1997 v15 n3 p56(22), fq. 13

strategjik tregojnë përmirësim të dukshëm në shitje, profitabilitet dhe produktivitet krahasuar me firmat pa planifikim sistematik.

4. Përfundime

Nga ky hulumtim mund të vijmë në përfundim se strategjitë dhe menaxhimit strategjik i ndërmarrjeve të vogla në vendin tonë është shumë pak i aplikuar dhe vendimet mbi udhëheqjen e biznesit nuk bazohen në strategji dhe analiza përmes teknikave dhe metodave të planifikimit strategjik, mirëpo më shumë janë të bazuara mbi intuiten dhe vendimet e pronarëve të biznesit. Hulumtime të ndryshme kanë ardh në përfundim se menaxhmenti strategjik ka efekt në performancën e bizneseve të vogla, gjithashtu implementimi i menaxhmentit strategjik ka një lidhje pozitive me pjesën e tregut të kompanisë. Për me tepër, faktorët infrastrukturorë, mjedisorë dhe socio-kulturorë në mënyrë signifikantë kanë impakt në menaxhimin strategjik të bizneseve të vogla²⁰¹. Përfundimet e nxjerrura nga hulumtimi janë:

- Në mungesë të strategjive dhe planeve, mekanizmi i kontrollit nuk mund të realizohet në mënyrë adekuate dhe që të gjitha këto së bashku ndikojnë së drejt mbi performancën e bizneseve.
- Zhvillimi i strategjive adaptive dhe i strategjive participative janë të lidhura direkt me performancën e biznesit të vogël. Modeli mbështet kërkimin që firmat të cilat shfrytëzojnë kombinime të proceseve për zhvillim të strategjive në vend të fokusimit tek një proces ekskluzivisht, janë më premtuese që të kenë sukses²⁰².
- Posedimi me një strategji të mirëfilltë nga biznesi i vogël, implementimi dhe kontrolli saj do të ishin kryesore për suksesin e biznesit dhe ngritjen e performancës së tij, gjithashtu udhëheqja efektive dhe arritja e qëllimeve do të ishte më e realizueshme për këto biznese se sa ato të cilat nuk posedojnë fare strategji.
- Ndërmarrjet të cilat i lidhin objektivat e tyre me planifikimin dhe menaxhimin strategjik në tërësi, kanë probabilitet shumë më të lartë që ti arrijnë ato, në krahasim më ndërmarrjet të cilat nuk kanë objektiva të qarta dhe të cilat nuk i menaxhojnë strategjitë e tyre.

²⁰¹ Ben, Etim Udoh and Agu. O. Agu, *The impact of strategic management on corporate performance of selected small business enterprises in cross river state*, International Journal of Current Research Vol. 4, Issue, 11, pp.152-158, November, 2012, fq. 158

²⁰² Martie-Louise Verreynne & Denny Meyer, *Small business strategy and the industry life cycle*, Springer Science+Business Media, LLC. 2008, Small Bus Econ (2010) 35:399–416, fq. 412

5. Referencat

1. Barritt, Ch. & Alderman, F. Lee, *Creating a Reusable Learning Objects Strategy*. San Francisco, USA: Pfeiffer, 2004.
2. Ben, Etim Udoh and Agu. O. *The impact of strategic management on corporate performance of selected small business enterprises in cross river state*, International Journal of Current Research Vol. 4, Issue, 11, pp.152-158, November, 2012.
3. Burnes, Bernard, *Managing Change*. 4th ed. London, UK: Pearson Educated Limited, 2004, fq. 207
4. Drucker, P.: *The Practice of Management*, Harper & Row, New York, 1954.
5. Entrepreneurship and Small Business Development in Kosovo, Research report, Prishtinë, Mars 2011
6. Enver A. Kutllovci, *Menaxhimi i resurseve njerëzore (Qasja strategjike)*, Prishtinë, Qershor 2014.
7. Fred R. David, „Menaxhimi Strategjik – Koncepte dhe rastet studimore“, Botimi i 13-të, Prishtinë, Janar 2014, (Përkthimi Shqip)
8. Gary Gorman, Dennis Hanlon, Wayne King, *Some research perspectives on entrepreneurship education, enterprise education and education for small business management: a ten-year literature review*. International Small Business Journal, April-June 1997 v15 n3 p56(22), fq. 13
9. Government programme for prevention of informal economy in Kosovo 2010 – 2012.
10. Graham Beaver & Caroline Ross, *Strategic Change*, (1999), 251-261
11. Martie-Louise Verreynne & Denny Meyer, *Small business strategy and the industry life cycle*, Springer Science+Business Media, LLC. 2008, Small Bus Econ (2010) 35:399–416, fq. 412
12. Peter M. Ginter, W. Jack Duncan, Linda E. Swayne. *Strategic Management of Health Care Organizations*. 4th ed. New Jersey, USA: Blackwell Publishing, 2002.
13. Porter, E. Michael: *What is Strategy*, Harvard Business Review, Boston, USA, 2001
14. Robert A. Blackburn, Mark Hart, Thomas Wainwright, "Small business performance: business, strategy and owner-manager characteristics", Journal of Small Business and Enterprise Development, Vol. 20 Iss: 1, pp.8 – 27

15. Skokan Karel, Pawliczek Adam, Piszczur Radomír, *Strategic Planning and Business Performance of Micro, Small and Medium-Sized Enterprises*, Journal of Competitiveness, Vol. 5, Issue 4, pp. 57-72, December 2013.
16. Vasilika Kume, *“Manaxhimi strategjik”*, Pegi, Tiranë , 2010.
17. Wood, B. Marian, 2005. *The Marketing Plan Handbook*. 2nd ed. New Jersey, USA: Pearson Prentice Hall 20 Iss 1 pp. 8 – 27.

Privatizimi dhe korrupsioni

PhD.Cand Erisa MUSABELLI

Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës, Shqipëri erisamusabellu@hotmail.it

PhD.Cand Eldisa CIROGU

Universita di "La Sapienza", Roma, Italia, eldisa.cirogu@albacall.eu

Abstrakt

Ky punim analizon lidhjen ndërmjet korrupsionit dhe privatizimit. Në veçanti, do të studiojmë se si korrupsioni ndikon në çmimin e blerjes dhe strukturën e tregut të post-privatizimit. Modeli parashikon se privatizimi në vendet me qeveri me nivel të lartë të korrupsionit rezulton në një shkallë më të lartë përqendrimit të tregut se sa në vendet ku qeveritë janë më pak të korruptuara. Çmimi blerjes gjithashtu ka të ngjarë të jetë më i lartë, kur një qeveri është shumë e korruptuar se sa kur zyrtarët e qeverisë janë të ndershëm apo në mënyrë të moderuar të korruptuar. Së fundmi, dhe ndoshta çuditërisht, tregojmë se një angazhim më i fortë për të përvetësuar të ardhurat e shtetit mund të zvogëlojë përfitimet e zyrtarëve qeveritarë nga korrupsioni. Arsyeja është se sa më shumë të etur të jenë zyrtarët e qeverisë për të marrë ryshfet, aq më pak do të perfitojnë

Fjalë kyçe: korrupsioni, privatizimi, strukture tregu.

Hyrje

Procesi i reformës ekonomike në Shqipëri filloi në korrik të vitit 1992, kur programi i qeverisë u mbështet nga marrëveshja "Stand By" me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Objektivat kryesorë ishin: 1. Stabiliteti makroekonomik, i cili synonte reduktimin e deficitit buxhetor, kontrollin e inflacionit dhe liberalizimin e çmimeve. 2. Ristrukturimi i sektorit shtetëror nëpërmjet eliminimit të subvencioneve prej shtetit, nxitja dhe zhvillimi i konkurrencës së lirë dhe riorganizimi i sektorit publik, përfshirë sistemin bankar. 3. Privatizimi i ekonomisë, që u konceptua si një transferim i të drejtave nga sektori shtetëror në sektorin joshetëror, duke synuar rritjen e standardit të jetesës nëpërmjet

eliminimit të joefikasitetit të shtetit. Në fillim të viteve '90, njësitë ekonomike që vepronin në të gjithë sektorët e ekonomisë ishin në gjendje mjaft të vështirë. Ndërhyrjet për rikapitalizim kërkonin investime në vlera të mëdha të papërballueshme, të cilat kërkonin tërheqjen e kapitaleve të huaja apo vendase private për të riaktivizuar dhe përdorur me efektivitet burimet natyrore dhe njerëzore të këtyre sektorëve.. Ndërmjet faktorëve të tjerë, kostot e larta të lëndëve të para të importuara, joefikasiteti në drejtimin e ndërmarrjeve shtetërore dhe rregullat e reja të tregut, bënë që produkti i prodhuar në vend të ishte më i shtrenjtë se produkti i importuar. Megjithë koston e ulët të fuqisë punëtore në krahasim me vendet e tjera, shumica e ndërmarrjeve shtetërore dështuan.

Procesi i privatizimit në Shqipëri

Në procesin e transformimit ekonomik, që po pëson vendi ynë, privatizimi është konceptuar jo vetëm si ndryshim pronësie, por si një alternativë e re që do të sigurojë funksionimin efektiv të veprimeve të " lojtarëve të tregut ", privatë apo shtetërorë, dhe të garantojë konkurrencë legale midis tyre. Ky proces shoqërohet me një kompleks problemesh, ndryshimesh dhe interesash politikë, socialë, makro dhe mikroekonomikë dhe ligjorë. Synimi përfundimtar i qeverisë, nëpërmjet procesit të privatizimit, është realizimi i transferimit të të drejtave shtetërore tek privatët në të gjitha format e saj dhe nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm dhe eficient. Në këtë kontekst, privatizimi është përkufizuar si transferim i tre lloje të drejtash nga shteti tek sektori privat: · të drejtës së pronësisë; · të drejtës së përdorimit; · të drejtës së zhvillimit; Nëpërmjet transferimit të të drejtës së pronësisë (shitjes), shteti çlirohet nga të gjitha llojet e rrezikut që lidhen me administrimin e ndërmarrjes apo të shoqërisë, ndërsa nëpërmjet transferimit të të drejtës së përdorimit (kontratat e administrimit, shërbimit etj.) shteti, përgjithësisht, mbetet i përfshirë në monitorimin e kushteve kontratore dhe të rrezikut financiar nëse njësia ekonomike del me humbje. Kontratat e koncensionit, të skemave BOT; BOOT; ROT dhe dhënia me qira apo enfiteozë janë ndër mënyrat e përdorura gjatë privatizimit për transferimin njëkohësisht të të drejtës së përdorimit dhe asaj të zhvillimit, të cilat përfshijnë ose jo shtetin në rrezikun financiar, në varësi të kontratave

specifike. Në Shqipëri transferimi i të drejtës së pronësisë është përdorur gjerësisht në procesin e privatizimit gjatë periudhës 1991-2000.

Objektet e privatizimit

Shqipëria ka qenë një nga ekonomitë më të shtetëzuara, ku pothuajse e gjithë prona private ishte e çrrënjosur. Për këtë arsye, privatizimi nuk është konsideruar thjesht si një transferim të drejtash, por kryesisht si një mënyrë e rikthimit për njerëzit, e të drejtave të mohuara për një gjysmë shekulli. Ky proces privatizimi ka përfshirë çdo gjë që shteti e konsideronte si pronë të tij, domethënë, tokën, shtëpitë, ndërmarrjet dhe shoqëritë.

Probleme administrative të pasprivatizimit

Metoda e privatizimit masiv, që u përdor në Shqipëri, u bazua kryesisht në blerjet nga brenda (punëtor dhe drejtues) të ndërmarrjeve dhe rezultoi në një strukturë mjaft të shpërndarë pronësie. Punëtorët dhe ish-punëtorët janë prezent në më shumë se 80 për qind të ndërmarrjeve të privatizuara, ndërkohë që mungoi plotësisht angazhimi i institucioneve financiare në këtë proces. Mungesa e fondeve të investimit në këtë proces, që mund të angazhoheshin në emër të individëve të veçantë për monitorimin e drejtimit dhe për të influencuar në procesin e vendimmarrjes, i privoi këta individë nga ky shërbim i specializuar, një situatë kjo e Shqipërisë krejt ndryshe nga ç'ndodhi në Republikat Çeke e Sllovake dhe në Poloni. Struktura e shpërndarë e pronësisë, që rezultoi nga kjo metodë, solli si rezultat një sjellje pasive dhe mungesë motivimi nga ana e drejtuesve për të ristrukturuar ndërmarrjet e tyre në periudhën e pasprivatizimit. Kështu, për 45 ndërmarrjet e marra në shqyrtim, indeksi i ristrukturimit rezultoi më i vogël se 2.5 (në një shkallë nga 1-minimumi deri në 5-maksimumi), duke demonstruar për përpjekje të pamjaftueshme nga ana e administratorëve për të transformuar ndërmarrjet. Ky indeks tregon se si mesatare masa e ristrukturimit të këtyre ndërmarrjeve pas privatizimit ka qenë e ulët, krahasuar me vendet e tjera në tranzicion. Për më tepër, kjo ndikon edhe mekanizimin e qeverisjes së ndërmarrjes, që nuk mund të funksionojë siç duhet: drejtuesit e ndërmarrjeve nuk kanë një motivim të madh për t'u angazhuar në ristrukturim të thellë, si rrjedhim, situata e pafavorshme vështirëson mjaft tërheqjen e kapitaleve të reja aq të nevojshme për këto

ndërmarrje të privatizuara. Dhe rezultati final do të jetë: efekte negative në performancë. Në këtë kuadër, vërehet një tendencë për të lëvizur drejt një strukture më të përqendruar pronësie në këto ndërmarrje. Nga studimi ynë rezulton se në vitet e pasprivatizimit ka ndodhur një përqendrim i pronësisë midis ndërmarrjeve me një numër të madh aksionmbajtësish, megjithëse numri i ndërmarrjeve me më shumë se 100 aksionerë është akoma i madh (46.7%) gjë që reflekton një strukturë akoma të shpërndarë. Ky përqendrim mund të shihet jo vetëm në numrin e aksionerëve, por edhe përsa i përket paketave të tyre të aksioneve. Kështu, paketa kontrolluese e aksioneve është përqendruar në duart e shumë pak pronarëve. Për më tepër, drejtuesit rezultojnë të jenë më të motivuar në ndërmarrjet me struktura të tilla të përqendruara të pronësisë. Është e rëndësishme të përmendim se për secilin nga aspektet e ristrukturimit (ristrukturimin e mjeteve, ristrukturimin e përdorimit të burimeve, ristrukturimin e strukturës drejtuese, riskstrukturimin e produktit dhe tregut të synuar dhe riskstrukturimin financiar) për struktura me pronësinë më të shpërndarë kemi edhe indekset më të vogla të ristrukturimit.

Privatizim vs korrupsion

Prej më shumë se 2 dekadash, privatizimi është konsideruar si një nga ilaçet themelore kundër korrupsionit. Logjika ishte e thjeshtë. Nëse korrupsioni përkufizohet si përdorim i postit publik për përfitime personale, reduktimi i postit publik nënkupton edhe reduktimin e korrupsionit. Meqenëse korrupsioni buron nga sektori publik, (dmth. nga abuzimi me postin publik apo shtetëror), reduktimi i këtij sektori automatikisht do të reduktonte edhe korrupsionin. Sa më pak të ndërhyjë shteti në treg, sa më pak kompetenca dhe rol të ketë ai në ekonomi, aq më pak korrupsion do të ketë. Në ekstremin e tij logjik ky arsytim thotë se pa shtet nuk ka korrupsion. Pra, në një rast hipotetik ku shteti apo hapësira publike zhduket, zhduket edhe korrupsioni, pasi në këto kushte nuk ka poste publike dhe për pasojë nuk mund të ketë abuzim të postit publik për interesa personale. Kemi të bëjmë pra, me një filozofi që identifikon shtetin me korrupsionin dhe tregun e lirë me mungesën e tij. Për pasojë, procesi i privatizimit, që reduktonte sektorin publik (shtetëror) dhe zgjeronte sektorin privat, pritej që përveç se të rriste efikasitetin e operatorëve ekonomikë në treg, të eliminonte edhe korrupsionin. Sot, pas pothuajse njëzet vjetësh privatizim të vazhdueshëm, mund të themi pa frikë se diçka e tillë nuk ka ndodhur. Për të qenë të saktë, duhet thënë se dukshëm ka një rënie të lehtë të korrupsionit administrativ, sikurse parashikohet nga teoria neoliberal. Megjithatë, duket se

ka një rritje të korrupsionit të nivelit të lartë apo asaj që shpesh quhet kapja e shtetit. Është ajo që shpesh në debatin publik quhet privatizimi i pushtetit publik. Ky pushtet nuk përdoret më për të mirën e publikut, por për të maksimizuar fitimet dhe pasurimin e atyre që janë në pushtet. Nga kjo pikëpamje mund të themi pa frikë se, sa më shumë ka avancuar procesi i privatizimit, aq më shumë është rritur edhe fenomeni i korrupsionit si kapje e shtetit. Në këtë aspekt, teoria e antikorrupsionit ka prodhuar efektin e kundërt të asaj që parashikohej, Pse ndodh diçka e tillë ?

Së pari, procesi i privatizimit rrit pafundësisht pikat e kontaktit mes sektorit publik dhe atij privat. Është pikërisht në këtë pikë-takim, mes funksionarit publik dhe aktorit privat, ku ndodh ajo që ne e quajmë shpesh korrupsion. Privatizimi nuk është thjesht procesi i transferimit të pronës publike në duar private. Ai nuk është një proces i fundmë, por nënkupton zgjerimin e vazhdueshëm të hapësirës së tregut privat. Privatizim do të thotë krijim i vazhdueshëm i tregjeve të reja, jo vetëm në hapësirat që më parë ishin shtetërore (p.sh. telefonia celulare apo Albtelekomi), por edhe në hapësira që vazhdojnë të jenë publike (si arsimi apo shëndetësia). Por, krijimi i tregjeve të reja kërkon më shumë dhe jo më pak ndërhyrje nga shteti. Tregu nuk ekziston vetem apriori, ai krijohet me rregullim, legalizim, arbitrim, et j. Kjo do të thotë se më shumë privatizim nënkupton edhe më shumë rregullim dhe ndërhyrje ligjore nga ana e shtetit, në mënyrë që të garantohet mirëfunksionimi i tregjeve të reja, sidomos kur këto hapen në pika delikate si arsimi, energjia elektrike apo shëndetësia, dhe sa më shumë shteti bie në kontakt me sektorin privat që zgjerohet vazhdimisht.

Arsyeja e dytë:

Rritja e pikë-takimit mes sektorit publik dhe atij privat shoqërohet me një diferencim gjithnjë e më të madh të pagave në nivele drejtuese mes sektorit publik dhe atij privat.

Dy janë arsyet

Së pari, sektori publik është gjithnjë e më i neglizhuar nga ana e shtetit dhe theksin e vë tek sektori privat.

Së dyti, sektori privat në Shqipëri, shpesh si pasojë e mungesës së burimeve njerëzore dhe si pasojë e konkurrencës së ashpër në treg, ofron paga jashtëzakonisht të larta për nivelet drejtuese. Rezultat i është një varfërim relativ i sektorit publik, pavarësisht rritjes së vazhdueshme të pagave aty, sidomos në nivelet drejtuese. Sot, çdo menaxher banke, pa folur për nivel drejtorit të përgjithshëm, ka të ardhura vjetore shumë më të larta se vetë kryeministri apo çdo ministër në qeveri. Kjo prodhon një mospërputhje midis rolit social dhe

përfitimit financiar. Është një mospërputhje problematike në ekonominë e tregut, ku vlera e rolit social përcaktohet gjithnjë e më tepër financiarisht. Pra, nuk mjafton të jesh ministër për të qenë pjesë e elitës sociale, duhet të kesh edhe financat e duhura që të bësh jetën e elitës, çka nuk përballohet dot me pagat e shtetit. Kjo shpjegon pjesërisht edhe paradoksin e denoncimit të korrupsionit të zyrtarëve apo politikanëve të lartë. Nga njëra anë, pothuajse të gjithë e denoncojnë korrupsionin e tyre. Nga ana tjetër, një politikan apo funksionar i lartë me stil të ulët jetese shikohet shpesh me përbuzje.

Arsyeja pse tundimi për tu korrumpuar kthehet në realitet na sjell tek *arsyeja e tretë*, që shpjegon rritjen e korrupsionit si pasojë e procesit të privatizimit. Interesi personal, si përcaktuesi themelor i sjelljes së funksionarit publik. Sot funksionari publik, sidomos në nivelet e larta, gjithnjë e më shpesh motivohet tërësisht nga interesi personal, që në shumicën e rasteve do të thotë maksimizimi i të ardhurave financiare. Që interesi personal ka qenë faktor i rëndësishëm edhe gjatë komunizmit nuk ka dyshim, pavarësisht se publikisht ai denoncohej shpesh. Të ndjekësh interesin tënd personal jo vetëm që nuk është gabim, jo vetëm që është pjesë e natyrës njerëzore, por është mirë edhe për shoqërinë në përgjithësi. Kështu, modeli i sjelljes që dominon tregun, maksimizimi i fitimit apo i interesit personal, iu vesh edhe sektorit publik. Për pasojë, zyrtari publik sillet si biznesmeni në treg. Ai e trajton postin publik si pronë private, nëpërmjet të cilës ai ose ajo synon maksimizimin e fitimit personal dhe jo realizimin e interesit përgjithshëm.

Arsyeja e katërt dhe e fundit. Humbja e interesit të përgjithshëm si objektivi orientues i politikëbërjes. Arsyeja se përse funksionari publik e ka të lehtë të korrumpohet nuk është vetëm shtytja për përfitim personal, por edhe sepse interesi i përgjithshëm është pothuajse inekzistent në politikëbërje. Filozofia aktuale qeverisëse bazohet në idenë se nuk ka një interes të përgjithshëm publik, por një mori interesash, që në përplasje me njëri-tjetrin, prodhojnë një rezultante që duhet ndjekur nga qeveria

Përfundimet

1. Problemi i strategjisë së re të privatizimit qëndron në mënyrën e hartimit, por më tepër në mënyrën e zbatimit.
2. Privatizimi përbën vetëm një nga elementet e procesit të reformimit të ekonomisë dhe të gjithë shoqërisë.

3. Në shumë raste papunësia është rezultat i privatizimit dhe i ristrukturimit të ndërmarrjes pas privatizimit.
4. Monopolizim dhe mungesë konkurrence. Ndërmarjet shtetërore mbrohen nga konkurenca me anë të ligjeve dhe vendimeve shtetërore që u japin atyre monopol në sektorë të veçantë ose mbrojtje përmes tarifave të larta dhe barrierave për të eliminuar konkurrencën e huaj.
5. Mungesë të motivit të fitimit.
6. Nivel artificial të çmimeve. Në ekonominë e planifikuar shteti vendos çmimet, pa i lejuar tregun të vendosë për to.
7. Mundësia e korrupsionit e cila shoqëron privatizimin

Referencat

1. Mema F. “Post privatization in Albania: Success or Failure”, Konferenca Ndërkombëtare “Integration and transformation in Albania, Hungary and Macedonia” Bamberg, Gjermani, 5-7 July 2001.
2. Mema, F “Privatizimi në Shqipëri: arritje, të meta, e ardhmja” Monografi, Tiranë, Korik 1997
3. Privatizimi dhe efikasiteti itij ne Shqiperi,
https://www.bankofalbania.org/web/pub/fatmirmema_134_1.pdf
4. Privatizimi dhe efikasiteti I tij ne Shqiperi ,
https://www.bankofalbania.org/web/pub/vasipano_164_1.pdf
5. Effects of privatization and ownership in transition economy. <http://elibrary.worldbank.org/doi/abs/10.1596/1813-9450-4811>
6. Adnan Filipovic, Furman University “Impact of Privatization on Economic Growth “Issues in Political Economy, Vol. 14, August 2005

ROLI I ARSIMIT NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË NJË VËNDI

Egzon S. Zariqi
Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Republika e Kosovës
egzonszariqi@gmail.com

Abstrakti:

Kjo është temë e cila është e ndarë në dy pjesë, qëllimi kryesor i pjesës së parë është trajtimi i rolit të arsimit që ka në zhvillimin ekonomik dhe efektin e edukimit në produktivitet të punës, përdorim të teknologjisë, efektin mbi shëndetin, do të mundohemi të tregojmë ndërlidhjen në mes arsimit dhe zhvillimit ekonomik në vende të ndryshme si ato të zhvilluara ashtu edhe në ato në zhvillim, disa arsye pse vendet investojnë shuma të mëdha në arsim. Më shumë do të ndalemi së cilat janë mekanizmat përmes të cilave arsimit ndikon në zhvillimin ekonomik të një vendi, trajtohet shumë rëndësia e arsimit të lartë, jepet një vështrim shumë specifik për debatet e vendeve me demokraci të lartë sa i përket arsimit që fokusohen në: qasje të barabartë për arsim dhe sa duhet të financohet arsimit nga fondet publike në vende të ndryshme.

Në pjesën e dytë është pjesë krejt tjetër e cila trajton sistemin e arsimit Kosovës dhe zhvillimin ekonomik, jepet një kënd vështrim për reformat në sistemin e arsimit, zhvillimet aktuale në arsim, treguesit sasiorë që kryesisht kanë të bëjnë me qasjen dhe përfshirjen në arsim, nivelin e arsimit të fuqisë punëtore; indikatorët financiarë të arsimit; dhe krejtë në fund do të trajtohen përmes Lakores së Heckman-it do të japim përkufizime se në cilin nivel të

shkollimit duhet të investohet dhe cilat janë kostot e opertune dhe norma e kthimit nga këto investime.

Fjalët e rëndësishme: *Arsimi, Cilësia, Zhvillimi Ekonomik, Investimet në arsim*

HYRJE

Më arsim do të kuptojmë njoftimin me fenomene të reja për të cilat nuk dimë shumë dhe kemi për qëllim zgjerimin e dijes sonë, pra arsimi është procesi i lehtësimit të të mësuarit. Njohuritë, aftësitë, vlerat, besimet dhe zakonet e një grupi të njerëzve janë transferuar në njerëz të tjerë, me anë të tregimit, diskutimit, mësimdhënies, trajnimeve etj. Arsimimi shpesh zhvillohet nën drejtimin e edukatorëve, por nxënësit mund t'a edukojnë vetën në një proces të quajtur të mësuarit autodidaktik²⁰³. Arsimi ka qenë dhe do të mbetet padyshim shtylla më e fortë që ka mbajtur dhe mbanë çatinë e shoqërisë.

Arsimi bënë pjesë në grupin e qëllimeve kryesore në zhvillimin ekonomik, ai është i domosdoshëm për t'a përmirësuar cilësinë e jetës. Arsimimi ka rol qënësor, sepse mundëson kuptimin dhe absorbimin e teknologjive moderne dhe gjithashtu e ndihmon aftësinë shtetërore për zhvillim vetanak²⁰⁴.

²⁰³ John Dewey - *Democracy and Education*. The Free Press. pp. 1–4 ISBN 0-684-83631-9.

²⁰⁴ But Dedaj - *Ekonomiksi i Sektorit Publik (Tema të zgjedhura)* – Prishtinë 2013, faqe 18.

Arsimi dhe zhvillimi ekonomik

Kapitali njerëzor është një element bazë për rritjen ekonomike të qëndrueshme dhe të shpejtë. Posaqërisht kapitali njerëzor është i rëndësishëm për vendët në tranzicion pasi këto vende janë duke reformuar ekonomitë e tyre drejtë ekonomive të tregut. Ndërsa progresi drejt ekonomisë së tregut në fazat e para të tranzicionit varej nga vullneti dhe vendosmëria e qeverisë për zbatimin e reformave, zhvillimet në fazat e mëvonshme të këtyre ekonomive varen kryesisht nga aftësia e kapitalit njerëzor për të përfituar dhe përdorur njohuritë e nëvojshme për ndërtimin e aftësisë konkurruese të ekonomisë²⁰⁵.

Pa dyshim arsimi është çelës për rritjen e efikasitetit ekonomik dhe qëndrueshmërisë sociale, ai është faktori kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të çdo vendi, por ndërlidhja në mes arsimit dhe rritjes ekonomike, është mjaft komplekse. Qytetarët e vendeve të zhvilluara kërkojnë më shumë arsimim dhe jo vetëm për arsye ekonomike, ndërsa për vendët në zhvillim sipas studiuësve të ndryshëm me anë të të metodave ekonometrike kanë argumentuar se ekziston një lidhje e vogël apo mungesë e lidhjes mes rezultateve të arsimit dhe rritjes ekonomike. Kjo është pasojë e korrupsionit dhe infrastrukturës së varfër ligjore që e bënë të vështirë shndërrimin e produktivitetit të shumicës së njerëzve të arsimuar në të mira për shoqërinë si tërësi. Sipas *Mark Rogers* nga Universiteti i Oksfordit²⁰⁶, vjen më një përfundim që rezultatet e arsimit të lartë gjenerojnë rritje më të shpejtë ekonomike vetëm në vendët me shkallë të ulët të korrupsionit, ekonomi të vogël informale dhe nivel të ulët të emigracionit mes shtresave më të arsimuara.

²⁰⁵ A. Hoti & N.Adnett - *Schooling in a High Unemployment Economy: The case of Kosova*, Staffordshire University Business School, Economics Division Working Paper - 2004

²⁰⁶ Mark Rogers (2003) *Directly Unproductive Schooling: How country characteristics affect the impact of schooling*, Harris Manchester College, University of Oxford.

Viteve të fundit shumë shtete (qeveri) janë duke e trajtuar arsimin, dhe veçanërisht arsimin e lartë, si një përcaktues shumë të rëndësishëm të performancave ekonomike të vendëve të tyre. Ndër arsytet për këtë vëmendje të shtuar kah arsimi janë të shumta, por në vijim janë të cekura vetëm disa më bazë të fortë:

1. OECD ka vlerësuar se një vit shkolle shtesë ndikon ta rrisë BPV afatgjatë për 6%, dhe kjo arrihet nëse niveli më i lartë i arsimimit ndikon në produktivitetin shumë më të lartë në punë, inovacione dhe shfrytëzim më të shpejtë të teknologjive të reja²⁰⁷.
2. Edhe Trendi Matematikor Ndërkombëtar dhe Studimit të Shkencës (TIMSS) dhe Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studenteve (PISA) kanë krahasuar nivelët e arritjeve arsimore në mes të vendeve dhe kanë ...
3. Vendët që kanë rritur pjesëmarrjen e GDP-së për arsim, kanë pasur edhe tendenca në rritjen e cilësisë, cilësinë e kanë rritur duke rregulluar infrastrukturën, duke ngritur numrin e profesorave në 100 student (*kanë ndikuar edhe në rritjen e çmimit për studime*).
4. Globalizimi, ekonomia e re dhe rritja e mobilitetit gjeografik të puntorëve me produktivitet të lartë të punës kanë bërë që vëmendja e qeverisë të drejtohet në rritjen e konkurrencës në nivel global dhe të bazuar në dije.

Vendët e Bashkimit Evropian (BE) i ndërmoren këta hapa pas nënshkrimit të Strategjisë së Lisbonës në vitin 2000, ku kjo strategji ka përfshirë tre (3) qëllime që të arrihen deri në vitin 2010, sistemët e arsimit dhe trajnimit duhet të

²⁰⁷ OECD (2003a) *Reviews of National Policies for Education: South Eastern Europe Volume I*, Paris: OECD.

organizohen rreth *cilësisë, qasjes dhe hapjes ndaj botës*²⁰⁸, pra një *ekonomi të bazuar në dije*.

Mekanizmat e arsimit mbi rritjen ekonomike

Nga pikëvështrimi teorik, janë të paktën tre mekanizma përmes të cilëve arsimi mund të ndikojë në rritje ekonomike. *Së pari*, arsimi rrit kapitalin njerëzor të qënësishëm në fuqinë punëtore, e cila rrit produktivitetin e punës me aplikimin e modeleve të reja të punës që kanë të bëjnë uljen e kostove dhe ngritjen e kualitetit, dhe kështu do të ketë rritje ekonomike në mënyrë të vazhdueshme drejt një niveli më të lartë të ekuilibrit të prodhimit, produktiviteti në punë këtë aspekt arrihet duke u japur bonuse dhe insentiva financiare për rezultatet pozitive në punë. *Së dyti*, arsimi mund të rrisë kapacitetin inovativ të ekonomisë, si dhe njohuritë e reja për teknologjinë, produktet dhe proceset e reja që nxisin rritje. Arsimi i lartë luan një rol qendror në forcimin e përfshirjes së punonjësve në proceset inovative. Për të kontribuar në proceset inovative duhet kontribut i vazhdueshëm i njohurive apo i të mësuarit, këto njohuri ata mund t'i përmirësojnë më anë të programeve të arsimit të zakonshëm dhe të mësuarit në vendin e punës por edhe aplikimin e teknologjive të reja, që në vendët e pazhvilluara ata këto teknologji mund t'i eksportojnë nga vendët që më herët i kanë kaluar këto faza. *Së treti*, arsimi mund të lehtësojë përhapjen dhe transmetimin e njohurive të nevojshme për të kuptuar dhe përpunuar informacionet e reja dhe për të zbatuar me sukses teknologjinë e re të hartuar nga të tjerët, të cilat përsëri promovojnë rritje ekonomike²⁰⁹ pra më integrimin e teknologjive të reja dhe bashkëpunimit globale në sferën e arsimit pa dyshim që është bërë transformimi i të mësuarit në arsimin e lartë nga klasa

²⁰⁸ The Lisbon Strategy 2000-2010, Economic and Scientific Policy - Employment and Social Affairs www.europarl.europa.eu/document/activities/cont/201107/20110718ATT24270/20110718ATT24270EN.pdf

²⁰⁹ Eric A. Hanushek & Ludger Woßmann - The role of education in economic growth, Feb. 2007

tradicionale, programet akademike të vendëve të zhvilluara janë “kopjuar” apo më mirë të themi janë marrur si model për vendët e varfëra por që kanë pasur disa karakteristika të njëjta, dhe produktet arsimore të cilat janë vënë në dispozicion të nxënësve, si librat në mënyrë elektronike, video të ligjëratave të universitetëve më prestigjioze në botë etj.

Mënyra më e mirë për të matur nëse një ekonomi po ecë përpara është për të parë nëse të ardhurat mesatare të njerëzve janë duke u rritur. Për të arritur deri të rritja e të ardhurave mesatare për njerëzit, duhet të ndodhin dy gjëra: produktiviteti ka nevojë për t’u rritur, dhe të ardhurat e krijuara nga produktiviteti i rritur, duhet të kthehet për punëtorët në formën e pagave më të larta.

Rëndësia e arsimit të lartë

Shumica e vendëve i kushtojnë rëndësi të madhe arsimit në përgjithësi dhe arsimit të lartë në veçanti për një afat të gjatë kohor. Arsimi i lartë ka të bëjë me proceset e të studjuarit në universitete dhe kolegje, ku përfshijnë personat mbi moshën 17-18 vjeçar/e , universitetët dhe kolegjet janë ato institucione që e bëjnë përgaditjen e personave për t’u ballafaquar më jetën në aspektet profesionale. Pothuajse të gjitha universitetët apo kolegjet në botë punën që e bëjnë në teori arrijnë t’a zbatojnë edhe në praktikë, gjë që do të thotë se ata janë të gatshëm për të dalur në tregun e punës si persona të aftë për atë punë.

Në gjithë literaturën e shfletuar për këtë temë vendët më demokraci të zhvilluar debatet sa i përket arsimit i fokusojnë në: qasje të barabartë për arsim, sa duhet të financohet arsimi nga fondet publike dhe se a kemi cilësi apo kualitet të arsimit për t’u krahasuar me vendët tjera.

Qasje të barabartë për arsim: Arsimi është një element kyç në strategjitë kombëtare të reduktimit të varfërisë dhe luan një rol qendror në këtë aspekt. Pa arsim varfëria shpesh transformohet në brezin tjetër, prandaj promovimi i arsimit është së gjithmonë duhet të investojmë në çdo individ²¹⁰. Të gjithë studentët anë e mbanë botës meritojnë qasje të barabartë në resurset arsimore si programet akademike, kurrikulare, mësimdhënies, objektet, teknologji, dhe materialeve mësimore, pa marrë parasysh gjininë, racën, ngjyrën, apo origjinën e tyre kombëtare.

Pavarësisht progresit të jashtëzakonshëm në drejtim të arritjes së barazisë gjinore në arsim, pabarazitë gjinore mbetën në shumë vende. 31 milionë vajza janë ende jashtë shkollës në mbarë botën. Ka shumë pengesa që i pengojnë vajzat për t'u arsimuar janë: varfëria, izolimi gjeografik, martesat e hërshme, vlerat kulturore dhe dhuna me bazë gjinore. Edukimi i vajzave është thelbësore për mirëqënien sociale dhe ekonomike të një vendi si ajo promovon shëndetin dhe mirëqënien e brezit të ardhshëm²¹¹.

Financimi i arsimit nga fondet publike: Nëse nisemi nga Uganda një shtet që ka rreth 38 milion banor, më të ardhura për kokë banori 657 dollar amerikan për vitin 2014²¹², presidenti i tyre ***Y. Museveni*** theksojë së për të pasur zhvillim ekonomik duhet transformim i shoqërisë, ku tek transformimi i shoqërisë ka përfshirë reformim (radikal) të arsimit fillor dhe atë të përgjithshëm duke larguar çfarëdo pagesë për shkollim dhe rezultatet kanë qenë së regjistrimet në shkolla u shumëfishuan²¹³.

²¹⁰ Draft - Zehn Ziele für Bildung BMZ Bildungsstrategie 2010-2013

²¹¹ Report - The Millennium Development Goals – 2010

²¹² World Bank – *GDP per Capita* <http://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.CD> (Vizituar më 21.06.2015)

²¹³ Joseph E. Stiglitz “*Globalizimi dhe pakënaqësitë e shkaktuara prej tij*” - faqe 103-104.

Në Shqipëri, prej vitit 1992, me pak përjashtime, buxheti për arsimin në përgjithësi nuk ka qenë më i lartë se 3% e PBB-së, ose më mirë të themi 10-15% të gjithë shpenzimeve të buxhetit. Duhet theksuar se këto shifra i referohen arsimit në përgjithësi, jo vetëm atijë universitar. Vendët e zhvilluara përëndimore në kuadrin e OECD-së e financojnë arsimin e tyre në nivelët 5 - 8% të PBB-së, nga i cili 1 - 3% e PBB-së shkon drejtpërdrejtë për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. Shqipëria, aktualisht, shpenzon 0.4 – 0.6% të PBB-së. Kjo shifër duhet të rritet në vitet në vazhdim si premisë e suksesit të vendit në arsimimin e lartë të popullsisë²¹⁴.

Një shembull i mirë është në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku personat që ndjekin studime pas shkollës së mesme, të tilla studimet e bachelorit, studimet 4 vjeçare, masterit, të doktorates por edhe programe për formim profesional, nëse do të kenë nevojë për mjete financiare, financohen nga ana e qeverisë më kredi mjaft të ulta, këto kredi janë të ndara në dy pjesë dhe janë pjesë e Programit Federal të Kreditit të Drejtpërdrejtë për Studentët (FDSLSP) dhe të familjës së tyre (FFELP), njerën pjesë e jep Departamenti Amerikan i Arsimit dhe pjesa tjetër jepet nga subjektet tregtare të tilla si bankat, unionet e kreditit dhe firmat që merrën më shërbime financiare.

Ndërsa për shtetin e Kosovës, arsimi fillor dhe ai i mesëm financohen tërësisht nga buxheti shtetëror, dhe nga disa analiza nga plani strategjik i Arsimit të Kosovë 2011-2016, parashihet që arsimi i lartë do të financohet nga buxheti shtetëror rreth 96 milionë euro, ku pothuajse 95% nga ky financim shkojnë për infrastrukturë dhe pjesëmarrje dhe vetëm 0.28% për kërkimet shkencore, inovacione dhe transfer të teknologjisë.

²¹⁴ MASSH - Raporti përfundimtar për reformimin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor – Tiranë 2014

Cilësia arsimore dhe zhvillimit ekonomik: Arsimi përveç që është e drejtë njerëzore themëlore, arsimi poashtu është motor për zhvillimin ekonomik. Gjëndja e përgjithshme arsimore e popullsisë së një shteti pjesërisht përcakton nivelin e arsimit të fuqisë punëtore të atij shteti. Disa shtete i theksojnë komponentët e ndryshëm të arsimit. Për shembull, një shtet që nuk ka program arsimor profesional në shkollat e mësme nuk do të ketë fuqi punëtore ‘të shkathtë’²¹⁵.

Cilësia është rezultat i shumë faktorëve që janë të ndërvarur dhe e ndikojnë njëri tjetrin në mënyrë reciproke. Kontribuesit e përgjithshëm në përmirësimin e cilësisë së arsimit përfshijnë: trajnimin efektiv të mësimitdhënësve, të mbështetur me një sistem efektiv të certifikimit të mësimitdhënësve, praktikat efektive të mësimitdhënies, lidërsipin dhe mënaxhimin efektiv.

Pasi që edukimi cilësor ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi zhvillimin ekonomik të një shteti, ai është më shumë në qendër të raportimit, ku sasia nuk vëhet në fokus. Për të ngritur nivelin e arsimit, nuk është e mjaftueshme të zgjatet koha për arsimim, apo thjeshtë vitet e shkollimit. Mirëqënia ekonomike nuk mund të promovohet përmes zgjatjes së thjeshtë të viteve të arsimit tëdetyrueshëm apo rritjes së numrit të studentëve që përfundojnë arsimin e lartë²¹⁶.

Sistemi arsimor dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës

Zhvillimi i arsimit në Kosovë ka kaluar në disa periudha kohore duke marrë për bazë zhvillimin e ngjarjëve që në ato periudha padyshim janë reflektuar në zhvillimin e arsimit.

²¹⁵ Eric A. Hanushek & Ludger Woßmann "*The role of cognitive skills in economic development*" - (2007)

²¹⁶ ZBE, MASHT dhe GIZ, *Edukimi Cilësorë - Pikëpamja e përgjithshme*
<http://www.giz.de/expertise/downloads/giz2013-alb-seminari-1.pdf> - (Vizituar më 23.06.2015)

Sistemi i arsimit Kosovar ishte i lidhur me sistemin e arsimit të ish-Jugosllavisë, qe deri në vitet 1990, okupuesi përherë përcaktojë politikat e veta për arsim. Në mbështetje të materialëve burimore kam vlerësuar së pothuajse në përgjithësi para vitëve 1941-44 sistemi i arsimit karakterizohej me mbajtjen e mësimit në gjuhën serbe dhe atë me një numër të vogël të paraleleve të nxënësve. Hapi i parë për mësimin legal, ishte periudha e viteve 1941/45, ku mësimi kryesisht mbahej në objekte private. Mirëpo, tempoja e zhvillimit të arsimit në gjuhën shqipe ishte në rritje dhe zhvillim të rëndësishëm në vitet e '70-ta, mirëpo arsim të mirëfillt kombëtar kemi tek në vitet '90-ta.

Sistemi i pavarur i arsimit të Kosovës e mbijetojë më sukses të plotë luftën e fundit dhe menjëherë pas çlirimit, filloi procesin e reformimit të plotë në bashkëpunim me administratën ndërkombëtare të udhëhequr nga misioni i Kombeve të Bashkuara i quajtur UNMIK.

Kthesa e madhe historike e sistemit të arsimit ishte ajo e vitit 1999/2000, duke filluar përgaditjet e gjithëmbarshme për transferimin e një *sistemi të komanduar* në një *sistem të hapur* dhe të orientuar në ekonominë e tregut.

Një shtet i pazhvilluar ekonomikisht siç është Kosova karakterizohet me arsimim të ulët dhe duke e ditur rëndësinë e arsimimit në rritjen ekonomike, do të jetë e nevojshme të praktikojmë reforma të cilat kanë synim përmirësimin e cilësisë që në mënyrë indirekte të ndikojnë edhe në sferat ekonomiko-sociale. Hyrja në reformimin e plotë të sistemit të arsimit, u bë në vitin 2002 kur u themelua Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT), ku kjo ministri erdhi me politika të qarta dhe me një program shumë dinamik për zhvillim dhe zbatim të reformave në arsim²¹⁷.

²¹⁷ Nexhmie Osmani - Reforma e Sistemit të Arsimit në Kosovë 2000 – 2010, <http://www.germ-a.com/?p=1861>

Zbatimi i reformave për arsimin e mesëm të lartë dhe synimi për arsim

cilësor: Reforma e sistemit të arsimit të mesëm të lartë të Kosovës përfshinte:

1. ***Kornizën ligjore***, nëse bëjmë krahasim në kohët e mëhershme, korniza ligjore apo më mirë të themi e drejta për t'u arsimuar është shumë më e madhe, asnjëherë askush nuk ka të drejtë të ja ndalojë dikujtë tjetër arsimimin. Sot çdo shkollë ka udhëheqësinë e vetë, ka këshillin-bordin e nxënësve të cilët mbledhën çdo fund muaj dhe i paraqesin kërkesat e tyre për problemët që ballafaqohen çdo ditë dhe kërkojnë ndryshime të vazhdueshme²¹⁸.
2. ***Zhvillimin e planprogrameve të reja dhe tekstet shkollore:*** planprogramet dhe tekstet mësimore disa vite më herët kanë qenë një problem mjaft i madh, për arsye që pothuajse popullsia totale e Kosovës ishin të nacionalitetit shqipëtar dhe atyre ju imponohej që mësimin ta vijonin në gjuhën serbe, jo që nuk ka pasur tekste mësimore adekuate shqipe, por vetë politikat e hartuara nga Ish-Jugosllavia kanë pasur për qëllim mos ngritjen e cilësisë të arsimit në shtetin e Kosovës.
3. ***Aftësimin e mësimdhënësve dhe rikualifikimin e tyre:*** titulli akademik i mësimdhënësit paraqet edhe cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në mënyra indirekte, pra sa më i lartë titulli akademik aq më e lartë edhe signifikanca e orës mësimore.
4. ***Sistemin e ri të vlerësimit dhe të mësimdhënies:*** sistemi i mësimdhënies disa vite më herët ka qenë “*Qasje transmetuese*” pra është fokusuar në transmetimin e dijes nga mësimdhënësi tek nxënësi. Pra, fokusi kryesor i kësaj qasje janë vetëm “njohuritë” që fiton nxënësi dhe jo “bërja,

²¹⁸ KEC – Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e Arsimit – Raporti 1 – 2009/10

sjellja”²¹⁹. Tani për tani mësimdhënia është duke shkuar drejt mësimdhënies bashkohore ndërkombëtare, atë së çfarë e përgaditë mësimdhënësi në orën mësimore e aplikojnë në praktikë në kabinete të informatikës dhe laboratore të ndryshme.

Arsimi i lartë në Kosovë

Kosova ka popullsinë më të re në Evropë. Rreth 70% e popullsisë janë nën moshën 30 vjeçare dhe rreth 50% e popullsisë janë nën moshën 25 vjeçare. Duket qartë se edhe nëse Kosova arrin nivelin rajonal të rritjes ekonomike, do të jetë vështirë që tregu kosovar të absorbojë të gjithë të rinjtë e aftë për punë. Është e qartë që Kosova ka nevojë për investime të huaja direkte dhe më qëllim që të arrijë këtë, Kosova ka nevojë për fillimin e reformave në sektorë të ndryshëm, të identifikojë mundësitë dhe avantazhet konkurruese²²⁰.

Ndonëse, shikuar në aspektin afatshkurtër, popullsia e Kosovës shihet si pengesë, në aspektin afatmesëm dhe afatgjatë, popullsia e re e Kosovës përbën potencial të cilin askush në rajon nuk e posedon. Kosova ka fuqi punëtore të cilën nuk e ka askush. Me qëllim që kjo pengesë të mund të kthehet në pasuri ose vlerë për Kosovën, duhet të synojmë që të përmirësojmë mënyrën e aftësisë të fuqisë punëtore. Politikat arsimore janë instrument kyç në përmbushjen e këtij synimi. Politikat arsimore mund të përdoren për pasurimin e popullatës së re me aftësi që tregu i sotëm i kërkon. Në anën tjetër vendët e

²¹⁹ ZBE, MASHT dhe GIZ, Moduli 3 – “Mësimdhënia dhe të Nxënit” faqe 16.

²²⁰ GAP – *Analizë, Pasqyra e Arsimit të Lartë Privat në Kosovë* – Prishtinë

Bashkimit Evropian përballen me sfidën e mptakjes së popullsisë, dhe kjo është një ndër problemet që reflektohen edhe në aspektin ekonomik. Pra, Kosova më aftësimin e fuqisë punëtore, në të ardhmën mund të arrijë që të t'i përmbush disa kërkesa për vende pune në vendët e Bashkimit Evropian.

Arsimi i Lartë për pjesën më të madhe të studiuesve dhe politikë-bërësve është konsideruar si një nga shtytësit kyç të konsolidimit demokratik dhe prosperitetit ekonomik. Aftësimi profesional dhe dituria e fituar përmes arsimit të lartë janë faktorë të rëndësishëm në gjënërimin e vendëve të punës dhe krijimin e mirëqënies së një shteti dhe një shoqërie. Në këtë kuptim, universitetët luajnë një rol qendror në krijimin e stabilitetit politik dhe social si dhe në konsolidimin e një shoqërie demokratike²²¹.

Problemet e Arsimit të Lartë në Kosovë: Problemi thelbësor me nivelin e cilësisë së arsimit të lartë si në sektorin publik edhe në atë privat, është në fakt një problem i gjithë sistemit arsimor në Kosovë. Kjo nënkupton që pa një reformim radikal (gjithëpërfshirës) të sistemit arsimor, nuk do të arrijmë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik por as edhe zhvillim të mirë të kapitalit human.

Reforma të veçanta duhet t'i kushtohen ngritjes së cilësisë, Agjensioni i Akreditimit të Kosovës (AAK) duhet të zbatojë masa të rrepta për ngritjen e cilësisë dhe duhet të jetë më dorë-shtrënguar sa i përketë licencimit të universitetëve, kolegjeve e njësive akademike të arsimit të lartë në Kosovë. Shteti i Kosovës duhet t'i kushtojë më shumë rëndësi arsimit të lartë dhe në vazhdimësi duhet të këtë reformim të sistemit në ngritjen e cilësisë arsimore,

²²¹ W. Benedek, B. Baliqi, A. Hoti, J. Baćević, I. Damjanovski – *Impact of Higher Education and Human Capital on the Economics and Political Development of Kosovo* - 2010

dhe nëse analizojmë Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016 do të shohim së Financimi për Arsimin e Lartë në cakun e Sigurimit të cilësisë i kushton rëndësi shumë pak, rreth 0.15% të totalit. Problem pothuajse i njejtë është edhe me cakun për kërkimet shkencore, inovacionet dhe transferin e teknologjisë që i kushtohet rëndësi vetëm 0.28% të totalit, po ashtu edhe më analizimin e tregut të punës që i kushtohet edhe më pak rëndësi. Kërkimeve shkencore duhet t'i kushtohet rëndësi të madhe për arsye se kërkimi apo hulumtimi shkencor mund t'i sigurojë përgjigjet kryesore që hartuesit e politikave do të kenë nevojë t'i dinë për vendimet e tyre strategjike për strukturën e ardhshme ekonomike, strategjinë e arsimit, kornizën ligjore dhe institucionet e sigurisë që të sigurohet një mjedis për zhvillim të suksesshëm ekonomik dhe shoqëror.

Kthimi nga investimet në arsim


Arsimi në vendet në zhvillim ka një kthim më të lartë të investimit sesa në ato industriale, pasi që kapitali njerëzor është më i rrallë në këta të parë dhe në këtë mënyrë më i vlefshëm. Femrat e arsimuara shoqërohen me një shkallë më të lartë të kthimit të investimit sesa meshkujt e arsimuar. Është konstatuar se arsimi i përgjithshëm (kundrejtë atijë profesional) siguron fitime më të larta.

Norma e kthimit të investimit në kapitalin njerëzor- Lakorja e Heckman-it:

Për më tepër, për shkak të formimit të veçantë të sinapseve të trurit, është e nevojshme që të investohen më shumë burime në arsimin parashkollor; norma e

kthimit të investimit në kapitalin njerëzor është më e lartë kur programet synojnë moshë sa më të hershme të jetës²²².

Figura 1: **Normat e kthimit nga investimi në kapitalin human**



Burim: Heckman (2008)

Evidencat empirike tregojnë gjithashtu se investimi në kapitalin njerëzor në moshë të hershme është më fitimprurës, kryesisht për shkak të dy faktorëve: së pari së të rinjtë kanë një horizont kohor më të gjatë dhe për këtë arsye mund të fitojnë më shumë gjatë ciklit jetësor nga arsimimi i hershëm dhe së dyti arsimi është

një proces dinamik, ku shkathtësitë e hershme njohëse dhe jo-njohëse e bëjnë më të lehtë të mësuarit më vonë në jetë²²³.

Në kontekst të Kosovës nuk ka studime të efektit të arsimimit në rritjet ekonomike të vendit, ose rezultatet 'shoqërore' (dhe jo-monetare), p.sh. në formë të përmirësimit të shëndetit, uljes së krimit, ngritjes së pjesëmarrjes qytetare, planifikimit familjar etj. Mirëpo ka dëshmi empirike se individët përfitojnë në formë të pagës më të lartë, posaçërisht femrat: Për çdo vit shkolle

²²² James J. Heckman (2007)- The Case for Investing in Disadvantaged Young Children

²²³ MEI & GIZ - Material diskutimi për të arriturat, sfidat dhe rekomandimet në fushën e Arsimit dhe Shkencës në Kosovë – Tetor 2012

shtesë, paga e femrave ngritet për mesatarisht 7.5%, ndërsa ajo e meshkujve për 3.3%. Një pjesë e kthimit në investim në arsimim për individin vjen edhe në formë të gjasave për punësim . Edhe efekti në gjasat për punësim është më i lartë tek femrat²²⁴. Por beneficionet kryesore ekonomike të arsimit të lartë kapen kryesisht nga të diplomuarit individualë në formë të pagës më të lartë.

Si përfundim për temën

Si përfundim mund të themi së asnjë vend nuk mund të arrijë zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik pa investime të konsiderueshme në kapitalin njerëzor. Arsimi sjell produktivitet dhe kreativitet tek njerëzit dhe promovon sipërmarrjen dhe teknologjitë përparimtare. Në vazhdimësi ka tendenca për t'a promovuar arsimin dhe vazhdimisht është duke u mbështetur e drejta për arsim dhe si stimulim për t'u regjistruar në shkolla apo fakultete kostoja për arsim është minimale ose raste të veçanta largohet krejtësisht.

Është cekur së ndikimi i arsimit të lartë në rritjen ekonomike dallon nga vendi në vend, përshembull në vendët më korupsion të ulët, ekonomi të vogël informale mund të ketë ndikim më të madh por edhe më të shpejtë, kështu që për shtetin e Kosovës duhet një infrastrukturë e gjatë për t'u rregulluar.

Pothuajse të gjitha vendet që kanë arritur të aplikojnë reforma në arsim qëllimet kryesore kanë qenë në ngritjen e cilësisë, sepse cilësia ndikon drejtëpërdrejtë në produktivitet, dhe më rritjen e produktivitetit në një mënyrë apo tjetrën vjen zhvillimi social dhe ai ekonomik.

Kohëve të fundit Bashkimi Evropian ka paralajmëruar për vlerësimin (*jo të mirë që është bërë*) e skemës së bursave të BE-së, dhe konsiderohet se institucionet lokale të Kosovës pas kthimit të kandidatëve nuk ju kanë ofruar

²²⁴Avdullah Hoti (2004) Human Capital and Unemployment in Transition Economies: The Case of Kosova

punë. Dhe nëse vendoset për ndalimin e kësaj skeme ose granti për shkollim, pasojat do të jenë negative për trendët zhvillimore në Kosovë respektivisht për gjeneratat e reja të studentëve.

Pa ngritjen e resurseve njerëzore dhe përgaditjen për tregun e punës nuk ka rritje ekonomike. Më rëndësi është sistemi i arsimit, prandaj konsiderohet se nevojitet një reformim i vazhdueshëm i sistemit të arsimit në Kosovë. Përveq arsimit universitar rëndësi të veçantë kanë edhe ngritja e kapaciteteve njerëzore përmes trajnimeve, ndërlihdja e arsimit me komunitetin e biznesit, krijimin e qendrave të aftësisimit profesional si dhe forma të tjera institucionale të veprimit të cilat do ta rrisin cilësinë e arsimit dhe përgadisin kuadro të afta për tregun e punës.

Rekomandime

- 1.** Reforma në arsim duhet bërë dalëngadalë, më përkushtim e më përkujdesjen më të madhe, por nëse ato nuk dimë t'i bëjmë vetë, duhet t'i përfaqesojmë të arriturat e të tjerëve. Pra, duhet t'a shikojmë ndonjë shtet i cili ka pasur infrastrukturën dhe disa karakteristika të njejta më shtetin tonë.
- 2.** Nëse reformimin e nisim pa planprogram, pa pajisje dhe mjete adekuate për mësim dhe buxhet të bollshëm është më shumë së një dështim. Pse dështim? Sepse nxënësit apo studentët nuk janë eksperiment, dhe së për t'a ditur a po funksion një reformë duhet të kalojnë disa vite.
- 3.** Të gjitha nivelet e sistemit të arsimit duhet të forcojnë lidhjet me tregun e punës dhe të inkurajojnë rritjen e vetë-punësimit, shembull shkollat e mesme profesionale (zanatit) dhe universitetët duhet të vëjnë kontakte të rregullat me punëdhënës si dhe të kujdesën për mundësitë për punësim të atyre që mbarojnë arsimin. Duhet të bëhen një vlerësim i rregullt sesa u mësohen

nxënësve dhe studentëve shkathtësitë e përgjithshme që janë kyçe dhe që kërkohen në tregun e punës.

4. Duhet të zhvillohet një sistem i këshillimit për karrierë në kuadër të shkollave dhe të institucioneve të arsimit të lartë. Universiteti i Prishtinës duhet të zhvillojë module ku do mësohej planifikimi i karrierës dhe zhvillimi profesional, të cilat module do u ofroheshin të gjithë studentëve.
5. Programet e studimit të institucioneve publike e private të arsimit të lartë duhet të pasqyrojnë nevojat e tregut të punës dhe duhet të përmirësojnë punësueshmërinë e të diplomuarve duke promovuar transferin e teknologjisë, inovacionin dhe ndërmarrësinë. Një mënyrë për të arritur këtë mund të jetë nëpërmjet një dialogu të vazhdueshëm me punëdhënësit, mirëpo mund të jetë e dobishme edhe përshtatja e programeve studimore me përparësitë zhvillimore dhe strategjitë e punësimit në vend.
6. Rëndësi të veçantë duhet t'i kushtohet kërkimeve shkencore sepse ato sigurojnë përgjigje për hartuesit e politikave që ata të marrin vendimet e tyre strategjike për strukturën e ardhshme ekonomike, strategjinë e arsimit, kornizën ligjore dhe institucionet e sigurisë që të sigurohet një mjedis për zhvillim të suksesshëm ekonomik dhe shoqëror.

Referencat

1. A. Hoti & N.Adnett - *Schooling in a High Unemployment Economy: The case of Kosova*, Staffordshire University Business School, Economics Division Working Paper – 2004
2. A. Hoti - *Human Capital and Unemployment in Transition Economies: The Case of Kosova* - 2004
3. But Dedaj - *Ekonomiksi i Sektorit Publik (Tema të zgjedhura)* – Prishtinë 2013, faqe 18.
4. Draft - *Zehn Ziele für Bildung BMZ Bildungsstrategie 2010-2013*
5. Eric A. Hanushek & Ludger Woßmann - *The role of education in economic growth*, Feb. 2007
6. Eric A. Hanushek & Ludger Woßmann - *"The role of cognitive skills in economic development"* - (2007)
7. GAP – *Analizë, Pasqyra e Arsimit të Lartë Privat në Kosovë* – Prishtinë
8. James J. Heckman - *The Case for Investing in Disadvantaged Young Children* - 2007
9. John Dewey - *Democracy and Education*. The Free Press. pp. 1–4 [ISBN 0-684-83631-9](#).
10. Joseph E. Stiglitz “*Globalizimi dhe pakënaqësitë e shkaktuara prej tij*” - faqe 103-104.
11. KEC – *Promovimi i të drejtave të femijës në fushën e Arsimit – Raporti 1* – 2009/10
12. Mark Rogers (2003) *Directly Unproductive Schooling: How country characteristics affect the impact of schooling*, Harris Manchester College, University of Oxford.
13. MASSH - *Raporti përfundimtar për reformimin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor* – Tiranë 2014
14. MEI & GIZ - *Material diskutimi për të arriturat, sfidat dhe rekomandimet në fushën e Arsimit dhe Shkencës në Kosovë* – Tetor 2012
15. Nexhmie Osmani - *Reforma e Sistemit të Arsimit në Kosovë 2000 – 2010*
16. OECD (2003a) *Reviews of National Policies for Education: South Eastern Europe Volume 1*, Paris: OECD.
17. Report - *The Millennium Development Goals* – 2010
18. The Lisbon Strategy 2000-2010, *Economic and Scientific Policy - Employment and Social Affairs*

19. World Bank – *GDP per Capita*
<http://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.CD> (Vizituar më 19.10.2016)
20. W. Benedek, B. Baliqi, A. Hoti, J. Baćević, I. Damjanovski – *Impact of Higher Education and Human Capital on the Economics and Political Development of Kosovo* - 2010
21. ZBE, MASHT dhe GIZ, Moduli 3 – “*Mësimdhënia dhe të Nxënit*” faqe 16
22. ZBE, MASHT dhe GIZ, *Edukimi Cilësorë - Pikëpamja e përgjithshme*
<http://www.giz.de/expertise/downloads/giz2013-alb-seminari-1.pdf> - (Vizituar më 19.10.2016)

Narkomania dhe Kriminaliteti

Hanife Hoxhaj

Fakulteti Juridik Master, Suharekë, Kosovë, hanife-hoxhaj@hotmail.com

Fluturë Avdiu

Fakulteti Juridik Master, Glllogoc,
Kosovë, flutura.avdiu@hotmail.com

Ky punim synon të shtjellojë narkomaninë si faktor sociopatologjik, ndikimin e saj në shoqëri dhe një numër të statistikave që pasqyrojnë praninë e kësaj dukurie të dëmshme në shoqëri. Trajtim në këtë punim jemi munduar të i japim edhe raportit të narkomanisë me kriminalitetin, se sa ndikon narkomania në përhapje të kriminalitetit dhe se çfarë vepra penale mund të kryhen nga përdorimi i narkotikëve dhe se çka mund të shkaktojë përdorimi i tyre.

Pasi që kjo dukuri e dëmshme është mjaftë e përhapur në shoqëri është gjithnjë e nevojshme që të bëhen përpjekje që nëpërmjet masave preventive të parandalohet dhe të mbrohet shoqëria nga kriminaliteti. Po ashtu, jemi munduar që sado pak nëpërmjet këtij punimi të paraqesim disa nga faktorët që ndikojnë në paraqitjen e saj, se kush janë përdoruesit më të shpeshtë të drogave narkotike si cilat veprat penale janë më të shpeshta si pasojë e përdorimit të drogave dehëse duke ndikuar kështu paraqitjen e kriminaliteti në një shoqëri.

Fjalët e rëndësishme: Substanca psikotrope, Kriminalitet, Trafikim, Viktimë, Fëmijë, i rritur.

Faktorët socio-patologjik

Quhen socio-patologjik për arsye se kanë të bëjnë me një sëmundje shoqërore e cila kaplon raportet e caktuara në një rrafsh më të gjerë. Këto dukuri kanë të bëjnë me atakimet dhe cënimet e disa vlerave morale, njerëzore, sociale, të cilat kontibuojnë në paraqitjen e sjelljeve delikumente dhe kriminale në një vend. Si faktorë sociopatologjik përmenden prostitucioni, patologjia seksuale, alkoolizmi, narkomania, bixhozi, bredhja, lëmosha, dukuria e AID-sit, dukuritë e vetëvrasjeve, hakmarrja dhe gjakmarrja. Këto lloje të faktorëve ndikojnë në jetën e njeriut që mund tëshpie deri të kryerja e ndonjë vepre penale. Janë disa shkaqe tek të cilat vie deri tek disa nga këto lloje të faktorëve si papunësia, problemet familjare, lakmia, e shumë shkaqe të tjera.

Si një ndër faktorë e cila duhet të përmendet është përdorimi i substancave narkotike e cila është e ndaluar me dispozita ligjore. Në vendin tonë kjo çështje është e rregulluar me Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike përbëjnë vepër penale.

Narkomania

Termi narkomani rrjedh nga fjala greke “narko”-dehem dhe “mania”-tërbim me të cilën shprehen epshet për kënaqje, dëfrim me mjete narkotike (drogë).

Me narkomani kuptojmë dëshirën jonormale dhe të zgjatur që manifestohet nga disa individ për lëndë (substance) toksike ose drogë, të cilat i kanë njohur aksidentalisht ose të cilat i përdorin vullnetarisht duke kërkuar prej tyre efekte: qetësuese, euforizante ose dinamike dëshirë kjo që bëhet shumë shpejtë një

zakon tiranik dhe që ushtron në formë të padiskutueshme rritjen e progreseve të dozave²²⁵.

Narkomania paraqet dukurinë negative shoqërore e cila manifestohet në përdorimin e drogave dehëse dhe pijeve të tjera narkotike, kjo dukuri është shumë e përhapur në botën bashkëkohore dhe paraqet një problem shqetësues ngase konsumimi i tyre prek edhe të miturit, ndërsa të rriturit disa e përdorin për përfitimet e tyre ekonomike duke shitur në mënyra të ndryshme kundërligjore.

Të gjitha drogat dehëse mund të jenë natyrore dhe sintetike. Natyrore janë ato droga dehëse dhe pije narkotike që gjenden në natyrë, që merren drejtperdrejt nga natyra, ndërsa droga dehëse apo pijet narkotike sintetike janë ato të cilat prodhohen në mënyrë artificiale.

Llojet e drogave dehëse dhe subsancave psikotrope

Ekzistojnë disa lloje të drogave si marihuana, hashashi, kokaina, heroina, amfetaminat, halucionjënët, solvantet, opiumi.

Drogat merren në mënyra të ndryshme dhe varet nga lloji i drogës dhe ndikimi i saj psh. heroina, kokaina merren përmes të thithurit nga hunda si dhe me injektim në venë, kurse drogat tjerë si marihuana, hashashi, opiumi merren me anë të thithjes së tyre në formë cigareje ose në formë çaji apo gjethet e përtypura.

Personat të cilët mund të ndikohen janë të ndryshëm sidomos në ato vende ku zhvillimi ekonomik është i lartë më së shumti është e prekur pjesa e shtresës së lartë sidomos fëmijët e tyre si shkuarja nëpër klube të ndryshme, shoqëria me persona të ndryshëm. Shtresa e ulët gjithashtu përfshihen nga mërziya e kësaj jete nga problemet e shumta ekonomike tek të cilët mund të arrijn të kryejnë vepra penale të ndryshme si psh. vjedhje të hollash, sendesh që të ketë një dozë. Në vendin tonë në Kosovë kjo dukuri më herët nuk ka qenë shumë e përhapur mirëpo tani këtij problemi është duke iu rritur numri, institucionet si policia e RKS-së gjithashtu edhe organizata Labyrinth kanë arritur të nxjerrin disa statistika lidhur me këtë dukuri, si psh. Policia e RKS-së në vitin 2011, policia e Kosovës ka realizuar 186 operacione dhe ka arrestuar 547 persona të dyshuar për trafikim të drogës ndërsa më bazë të raportit vjetor 2014 ka nxjerr disa statistika si:

²²⁵ www.lirenti.com/threads/1308-Narkomania

Vepra Penale	2013	2014	Krahasimi %
Kultivim nartotikeve	31	58	+87
Posedim I narkotikeve	428	588	+37.4

Burimi: Raporti vjetor 2014 I Policis së Kosovës

Sipas statistikave këtu vërejmë një ndryshim tek veprat penale nga viti paraprak ai 2013 në këtë 2014 numri i këtyre veprave është duke u rritur si ajo e Kultivimit të narkotikëve 87%, ndërsa Posedim i narkotikëve 37.4%.²²⁶ Ndërsa konfiskimet të cilat i kanë bërë gjatë vitit 2014 dhe 2015 sipas raportit 2015 të policisë së Kosovës biem në përfundim se ka një ulje të konfiskimeve.²²⁷

KONFISKIME	2014	2015	Krahasimi %
Substancënarkotike(HEROINE)	9kg606.34gr	9kg585.85gr	00%
Substancë narkotike(KOKAIN)	21kg104.6gr	54.5gr	-100%
Substancënarkotike(MARIHUANA)	734kg913.3gr	461kg721.09gr	-37%
Substancë narkotike(Bimë Kanabis)	6930	2557	-63%

Burimi: Raporti vjetor 2015 I Policis së Kosovës

²²⁶Raporti vjetor 2014 I Policisë së Kosovës.


²²⁷ Raporti vjetor 2015 I Policisë së Kosovës

Organizata joqeveritare Labyrinth është organizatë e cila merret me problemet e narkomanëve gjithashtu e cila ka nxjerr disa statistika prej vitit 2002 deri më 05.06.2015 në bazë ajo të moshës, statusit, përdorimin e drogave të para, edukimi, në bazë të nacionaliteteve, vendbanimeve në territorin e Kosovës.

Sipas disa të dhënave nga OJQ-së Labyrinth i cili ka ndarë përdorimin e këtyre substancave si psh, sipas vendbanimeve Prishtinë 353 ka shkuar numri, mandej me numër të madh vie Gjilani me 122, Gjakova me 70, Prizreni me 127, Mitrovica me 84, Burim me 4, Hani i Elezit me 0, Lipjan me 6²²⁸.

Sipas gjinisë më së shumti janë meshkujt me 92.62% ndërsa femrat me 7.38%. Moshë mesatare është 28, të papunësuat janë 66.13% ndërsa të punësuar 33.30% këtu ne e vërejmë se personat e papunësuar janë më së shumti pjesë e kësaj dukurie.


Shembull:



Shembulli 1: Raporti I OJQ Labyrinth lidhur me gjinin dhe gjendjen sociale lidhur me përdorimin e drogave dehëse

Gjithashtu sipas OJQ-së Labyrinth ka qenë si studim edhe gjendja martesore sipas se cilave del ne perfudim se të pamartuarit janë përdoruesit më të shpeshtë.

Shembull:



Shembulli 2:Raporti OJQ lidhur per perdorimin e drogave dehësesipas statusit martesor

Në bazë të edukimit në shkolla fillore numri 288 me 27.25%, Fakultet numri 46 me 4.35%, shkolla fillore e pambaruar 13 me 1.23%, shkolla e mesme 677 , e 64.05%, analfabet 9 e 0.85% dhe shkollë të lartë 6 me 0.57%. Sipas këtyre statistikave e vërejmë se më së shumti janë përdorues të shkollave të mesme mandej shkollat fillore të cilat duhet të vetëdijesohen të tjerët që ky fenomen

ndikon si në gjendje psikike ashtu edhe fizike dhe vetëm me anë të seminarëve dhe trajtimi i tyre si dhe ndonjë lëndë e posaçme të mësohet dhe t'i kushtohet një rëndësi më e madhe. Edhe psikologët e ndryshëm kanë dhënë mendimet e tyre lidhur me këtë faktor si Psikologia Dafina Muçaj, thotë se janë shumë faktorë që po ndikojnë në përhapjen e fenomenit të përdorimit të drogës tek të rinjtë, sidomos tek moshat e mitura. “Studimet e nivelit botëror thonë se, ajo çka ndikon në përdorimin e drogave, më së shumti është kureshtja. Madje, ndikimi i bashkëmoshatarëve, është një prej faktorëve të rëndësishëm që ndikon tek një i ri për ta nisur drogën. Pra, ka faktorë të ndryshëm, por në vendin tonë, mendoj

Shembulli 3: Raporti I OJQ lidhur me konsumimin e drogave dehëse në edukim

Edukimi	Numri	Përqindja
Shkolla Fillore	288	27.25%
Fakulteti	46	4.35%
Shkolla fillore e pambaruar	13	1.23%
Shkolla e mesme e pambaruar	16	1.51%
Shkolla e mesme	677	64.05%
Analfabet	9	0.85%
Shkolla e Lartë	6	0.57%

se njëri prej faktorëve është qasja e lehtë tek drogat dhe çmimi shumë i ulët i substancave narkotike”, shprehet psikologja Muça

Raporti i narkomanisë me kriminalitetin dhe parandalimi

Duke pasur parasysh rrethanat narkomania trajtohet si faktor kriminogjen ngase një numër i personave, të cilët konsumojnë drogën dehëse dhe pijet e tjera narkotike, jepen pas kryerjes së një varg sjelljeve delikuede dhe kriminale. Shumë narkoman mirren me veprime të ndaluara dhe kriminale. Posaçërisht ata mirren me shitblerjen dhe shpërndarjen e drogave dehëse dhe me nxitjen e të rinjëve dhe të miturve për konsumimin e drogave dehëse, po ashtu individët narkomanë jepen edhe pas kryerjes së krimeve të vjedhjes, tregtisë me armë, organizimit të prostitucionit, plackitjes, thyerjes së dyqaneve dhe objekteve të tjera, me qëllim të sigurimit të mjeteve financiare për blerjen dhe sigurimin e drogave dehëse. Personat narkoman janë të kyqur edhe në krimet e dhunës, e sidomos me organizimin e prostitucionit, reketizmit, kindnapimit të fëmijëve e shantazheve të ndryshme dhe shpesh marrin pjesë edhe në shkelje të rendit publik²²⁹.

Për këtë arsye, në shumë vende janë bërë përpjekje për pengimin dhe evitimin e dukurisë së narkomanisë. Këto përpjekje kanë konsistuar në ndërmarrjen e masave për rregullimin juridik të prodhimit, shitjes dhe përdorimit të llojeve të ndryshme të drogave dehëse dhe pijeve narkotike. Mirëpo pa marrë parasysh të gjitha këto masa represive dhe dënime rigoroze e drakonike, prodhimi, qarkullimi dhe shpërndarja ilegale dhe trafikimi i drogave dehëse dhe substancave psikotrope në botën bashkëkohore është në ekspansion, të dhënat më të reja të statistikave kriminale tregojnë për rritjen e numrit të trafikantëve të zbuluar dhe sasinë e madhe të drogave dhe të konfiskuar nëpër vise të ndryshme të botës.

Gjithashtu janë miratuar konventa si ajo e Gjenevës e viteve 1925, 1931, 1946 dhe 1953. Konventa më e gjithanshme, konsiderohet Konventa e Vjenës e vitit 1971, dhe kjo quhet “Konventa unike mbi substancat psikotrope”. Në këtë konventë janë caktuar se cilat substanca konsiderohen si pije narkotike si dhe është rregulluar në mënyrë të hollësishme çështja e prodhimit, vënies në qarkullim si dhe ndalimi i keqpërdorimit dhe për përdorimin për nevoja

²²⁹Halili Ragip, Kriminologjia, Prishtinë, 2011, fq. 314

medicinale²³⁰. Në këtë konventë janë paraparë edhe masat preventive dhe represive për ndalimin e keqpërdorimit të drogave dehëse. Sikur në të gjitha vendet e botës edhe në vendin tonë në Kosovë kjo dukuri është e rregulluar me dispozita ligjore të cilat janë të parapara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013, të cilat hynë në kuadër të një kapitulli XXIII të cilat emërtohen si veprat penale të narkotikëve²³¹. Me anë të cilave mundohet parandalimi dhe luftimi i këtyre veprave në shoqërinë tonë.

Përfundimet

Duke pasur parasysh që narkomania është një dukuri negative në shoqëri kjo duhet të arrihet të bëhet parandalimi i saj. Duke parë statistikat sidomos kohët e fundit është në një rritje e cila po prek gjeneratat e reja sidomos të miturit. Sikur ne që jemi një vend në tranzicion ballafaqohemi me këtë problem të cilat duhet arritur mënjanimi i tyre sidomos tek të miturit të cilët vijojnë mësimin, kontributi i familjes, interesimi i prindërve për fëmijet e tyre se me kë shoqërohen luan rol që mund të arrihet që fëmija e tyre mos të bëhet një narkoman. Ndryshimi i sjelljeve mund të arrihet të kuptohet tek një narkoman si ajo zbehje në fytyrë, i dobët me peshë, i nervozuar në mungesë të dozës e disa veti tjera. Me anë të trajnimeve mund të arrihet që një narkoman të arrijë të shërohet si dhe organeve tjera, kujdesin ndaj tyre, kontrollin e tyre etj. Ka pasur raste kur një narkoman për shkak të dozëz së caktuar ka kryer një vepër penale si ajo e vjedhjes, vrasjeve e vepra tjera të ndryshme vetëm që të arrijë të ketë një shumë të hollash që të arrijë të ketë dozën e caktuar. Mund të arrihet të luftohet kjo dukuri negative në shoqëri me bashkëpunimin e organeve dhe vetëdijesimin e qytetarëve për efektet negative që ndikojnë në shëndetin e tyre, familjen, në mjedisin dhe shoqërinë.

²³⁰ Vepra e cituar, fq. 315

²³¹ Kodi penal I RKS 1 janar 2013

Bibliografia;

Halili, Ragip, Kriminologjia, Prishtinë, 2011

Kodi Penal I Republikës së Kosovës 1Janar 2013

Raporti vjetor i Policisë së Kosovës 2014

Raporti vjetor I Policisë së Kosovës 2015

Raporti i OJQ-së, Labyrinth, Prishtinë, 2010

www.lirenti.com/threads/1308-Narkomania

<http://koha.net/?id=8&arkiva=1&l=86282>

PUNIM HULUMTUES

TEMA:

“Dixhitalizimi i si faktorë nxitës në hapjen dhe menaxhimin e bizneseve”

Punuan: 1.Admir Krasniqi

**Republika e Kosovës, Fakulteti Ekonomik Prishtinë
(admir.krasniq@hotmail.com)**


2.Aldi Zogaj

**Republika e Kosovës, Fakulteti Ekonomik Prishtinë
(aldi.zogaj@hotmail.com)**

Abstrakti:

Globalizimi dhe efekti i ti janë shumë dimensionësh. Ai mund të llogaritet edhe si një variabël(përparsi,dobësi) varësisht nga këndvështrimi i natyrës së biznesit dhe analizave që i bëjnë.Për disa lloje organizatash kjo është një avantazh kryesor dhe arsye e ekzistencës së tyre.Këtë hulumtim e kemi realizuar që të mbulojmë një boshllëk teorik,praktik që mund ti qasen studentet ata të cilët merren me biznese dhe ata që dëshirojnë ti futen kësaj fushe.jemi munduar ti thjeshtëzojmë dhe ti rendisim në mënyrën më logjike të mundshme. I kemi sjellur disa fakte si si janë të varura bizneset në kohën tone ndërmjet vete,si e shfrytëzojnë konkurrencën si arsye të ekzistimit dhe zhvillimit të afarizmit.Si u qasën në botën teknologjike dhe si ndryshoj mjedisi operues i bizneseve,si ju lehtësua puna e tyre menaxherike,si po shkojnë bizneset tek një menaxhim dixhital të tërsishëm,dhe si funksionon sistemi (SAP).

Do ta kemi edhe rezultatet e hulumtimit nëpërmjet pyetsorit. Ne përdorëm një system on-line të intervistimit të disa mostrave në nivel vendi. Mostrat kanë përfaqesues të popullimit se kemi të bëjmë me dy lloje të respondentëve. Të dhënat e mbledhura i kemi koduar dhe rezultatet mund ti shohim në pjesën e fundit të punimit. Aty mund ta shohim se sa përdorin, besojnë menaxhimit dixhital dhe çka mendojnë për një të ardhme të afërt lidhur me biznesin e tyre. Dhe a ju ka lehtësuar punën dixhitalizimi?!



Fjalët kyqe:

informatik, menaxhim, ndërvarësi, internet, biznes, telekomunikim, varësi, komunikim, zhvillim, SAP, etj.

Hyrje

Në një seri artikujsh kam studiuar dhe trajtuar disa aspekte të rëndësishme të internetit dhe ndërmarrjeve. Ndër elementet më të rëndësishme që janë vënë në pah janë zhvillimi i internetit, zhvillimi i biznesit, ndikimi i biznesit në zhvillimin e internetit, ndikimi i internetit në zhvillimin e biznesit si dhe varësia e biznesit nga interneti. Ky është një artikull i cili mund të ndërlidhet me atë seri artikujsh meqë varësia e bizneseve në këtë rast nuk ka të bëjë jo vetëm me nënshkrimin e kontratave të ndryshme, por edhe me vetë zhvillimet teknologjike, e posaçërisht me zhvillimet e teknologjisë informative.

1. Ndërlidhja dhe varësia mes të bizneseve

Fig:1. Bashkëveprimi mes organizatave (Tubaro, P.2010)

Shumë strategji të reja dhe modele të biznesit janë vazhdimisht në ndikim nga mënyrat e ndryshme të strukturimit, ndërlidhjes dhe koordinimit të aktiviteteve

të niveleve të ndryshme nëpër organizata. Këto ndryshime janë duke ndodhur jo vetëm në brendi të

organizatave, por edhe në të gjitha aktivitetet e tyre që kanë të bëjnë me ndërveprimin e tyre me partnerët, konsumatorët dhe palët tjera të treta, madje ndonjëherë edhe në tërë zinxhirin furnizues²³².

Kjo është duke shfaqur një ndërveprim mes organizatave i cili po shndërrohet në një sistem i cili nga Barnes (2007) është definuar si “zhvillim i infrastrukturës mes telekomunikimit dhe kompjuterit, i udhëhequr ose/dhe shfrytëzuar nga dy ose më shumë organizata me qëllim të shkëmbimit të informatave për të mbështetur aplikacionet ose proceset e biznesit”. Nga zhvillimet në tregun botërorë mund të vërehet se mundësitë e reja të ndërlidhjes së automatizuar mes organizatave kanë detyruar kompanitë të ndryshojnë strategjitë e tyre të bashkëveprimit dhe të menaxhimit të rrezeve për shkak të nivelit të lartë të varësisë mes veti. Përkundër këtij fakti, shfrytëzimi i tregtisë elektronike (njohur edhe si e-komerc) për të përmirësuar efikasitetin e zinxhirit të furnizimit është promovuar me të madhe si tek shitësit me të vogël gjithashtu edhe tek tregtuesit e njohur në përgjithësi. Mënyra tradicionale e partneritetit mes organizatave është ndryshuar nën ndikim nga teknologjitë e reja të cilat kanë bërë që ndërlidhja të mos ndërpritet në nivelin e nënshkrimit të marrëveshjeve, por të vazhdojë më tej deri në nivelin e ndërtimit të një infrastrukture të përbashkët teknologjike mes partnerëve. Ky lloj i partneriteti, është fjala për partneritetin B2B, shfrytëzon karakteristika të ndryshme të bashkëveprimit përmes realizimit të veprimeve dhe marrëveshjeve të ndryshme siç është përcaktim i standardit të përbashkët për numërimin e produkteve, themelimin e teknologjive të përbashkëta të identifikimit të produkteve ose/dhe shërbimeve, përcaktim të standardeve të përbashkëta të shkëmbimit të të dhënave, ngritja e tregjeve të përbashkëta elektronike, themelimi i qendrave të përbashkëta për sinkronizimin e të dhënave²³³. Për më tepër, mjedisi i kompjuterizimit në re (nga anglishtja cloud computing) shfrytëzohet si mjet i cili mundëson bashkëveprim më efikas në rrjetet e sistemeve ku kanë qasje shumë kompani të profileve të ndryshme.

²³² Li, F. (2007). What is e-business how the Internet transforms organizations.

²³³ – Barnes, S. (2007). E-commerce and v-business: digital enterprise in the twenty-first century


Mënyra e re e realizimit të partneriteteve është më e organizuar, shumë e sofistikuar dhe më e suksesshme në rrjedhën e informacioneve të bizneseve. Për më tepër, kjo mënyrë po i sjell kompanitë më afër njëra tjetrës, që nuk është element i bashkëveprimit tradicional, por në anën tjetër po krijojnë varësi mes kompanive meqë investimet në projektet e bashkëveprimit janë gjithnjë në rritje e sipër.

Ky bashkëpunim i thellë përcaktohet nga investimet e bëra nga partnerët në një projekt të përbashkët. Natyrisht, lloji i partneritetit, intensiteti i investimeve, rëndësia në realizimin urgjent të këtyre investimeve, marrja e barrëve të menaxhimit dhe bashkë-koordinimit ndryshojnë nga industria në industri, nga vendi në vend, si dhe nga struktura e tregjeve elektronike si dhe në shumë raste edhe të atyre tradicionale.

2.Ndikimi i Internetit në ndryshimet dhe zhvillimin e biznesit

Interneti dhe teknologjitë informatike jo vetë që kanë çrregulluar sinjalet e tregut, por gjithashtu kanë ndryshuar edhe rëndësinë e shumë faktorëve kyç të biznesit tradicional. Interneti ofron mundësi të reja marketingu, duke ndryshuar ndërlidhjen dhe ndërveprimin në mes funksioneve të marketingut, duke shtuar mjete të reja marketingu, instrumente të reja, e të tjera.

Në këtë mënyrë, përfshirja në biznesin elektronik, për shkak të këtyre ndryshimeve, relativisht është lehtësuar. Interneti ka mundësuar rikonfigurimin e



industrive ekzistuese të cilat kanë qenë të ndërlidhura ngushtë me shpenzime të larta komunikimi, shpenzime të larta për mbledhjen e informacioneve, dhe shpenzime të larta për transaksione.²³⁴Për më

tepër, tregjet e suksesshme në Internet siç janë Amazon.com, eBay.com e të

²³⁴ Porter, Michael E. (2008). On competition (2nd ed.). Harvard Business Press.

tjera, kanë lehtësuar depërtimin e kompanive në biznesin elektronik përmes ofrimit të mundësive të cilat ndërli dhin mundësi e rëndësishme biznesi – është një teknologji e patjetërsueshme. Suksesi i vepruesve të parë (anglisht: first-movers) në biznesin elektronik, siç janë Yahoo, Galileo, Amazon.com, eBay.com, Google.com e të tjerë, ka ndryshuar tërësisht mënyrën tradicionale të të bërit biznes. Këto kompani u bënë udhëheqëse të tregut për një kohë të shkurtë duke shitur produkte dhe/ose shërbime virtuale, duke vepruar si ndërmjetësues në shitje, duke shitur hapësirë për reklamim në Internet, duke ofruar “gjithçka falas”, duke qenë vend në të cilin të tjerët mund të realizojnë aktivitetet e tyre dhe shumë veprime tjera; shumica e aktiviteteve të tyre nuk kishin asgjë të përbashkët me aktivitetet në tregjet tradicionale.

Meqë tregu elektronik është rrjeti depërtimi dhe veprimi i kompanive arrin kufijtë e vetë rrjetit të Internetit.

Deri ku ka Internet, deri në atë vend është i gjerë tregu i kompanisë. Kështu, faktor kyç në tregjet elektronike është shpërndarja e cila ndërlidhë mes veti porosinë dhe konsumimin. Për këtë, faktorët si vendi në të cilin kompania është themeluar (që nënkupton serverët), si dhe vendi në të cilin produkti është deponuar nuk janë të rëndësishëm. Është informata ajo e cila qëndron në ballë dhe e cila “përmëshë” nevojat dhe dëshirat e konsumatorëve. Për më tepër, të ndryshuarit e kuptimit të koncepteve siç është “vendi në Internet”, ka ndikuar në ndryshimin e kuptimit të koncepteve tjera siç është planifikimi i produktit, planifikimi i shpërndarjes, planifikimi i kapacitetit e të tjerë. Ky ndryshim ka ngritur lirinë e të bërit biznes dhe planifikimin e aktiviteteve të kompanive, pa ndikuar negativisht kënaqjen e konsumatorëve. Nga pikëpamja e biznesit, ka ndryshuar konceptin e konkurrimit pasi që një kompani elektronike është konkurrencte e të gjitha kompanive tjera qofshin ato elektronike apo tradicionale edhe atë në tërë botën²³⁵. Interneti u ka mundësuar dhe lehtësuar kompanive depërtimin dhe lëvizjen nëpër tregje të llojeve të ndryshme. Kështu që, rritja dhe segmentet e tyre të tregut ndryshojnë relativisht lehtë dhe relativisht shpejtë. Gama dhe trajta e ofrimit të produkteve dhe shërbimeve nga ana e kompanive ndryshon thuajse çdo ditë. Është normale për biznesin elektronik, sepse për biznes të suksesshëm, që kompanitë të kenë model të biznesit që


²³⁵ – England, E., & Finney, A. (2007). Managing interactive media: project management for Web and digital media (4th ed.)

vazhdimisht evoluon duke ofruar produkte ose/dhe shërbime të reja (p.sh. karakteristika e Facebook “kyçja përmes Facebook”), largimin e produkteve/shërbimeve ekzistuese (p.sh. Google Inc. mbylli *Google Buzz*), blerja e kompanive me produkte/shërbime të cilat plotësojnë produktet/shërbimet ekzistuese të kompanisë (p.sh. Google Inc. bleu Youtube.com), dhe shumë veprime të tjera.

Për shkak të teknologjive të Internetit, dinamizmi i ndryshimeve si në tregun elektronik ashtu edhe në atë tradicional është i lartë.

Trilogjia e zhvillimit është fundamenti mbi të cilin krijohet baza e zhvillimit të përgjithshëm të biznesit në ditët e sodit, duke përfshirë biznesin tradicional dhe atë në Internet. Kjo trilogji mund të perceptohet vetëm në

pikëpamjen e përgjithshme, ndërsa në pikëpamjen e zhvillimit të biznesit është një proces që zhvillohet në prapavijë. Është një proces shtytës që ndikon drejtpërdrejtë ose tërthorazi në zhvillimin e strategjive të reja të biznesit. Të kuptuarit të drejtë të këtij zhvillimi bëhet përmes analizës së çështjeve si zhvillimi i teknologjive të Internetit dhe hapat e përmirësimit të biznesit



elektronik, të kuptuarit e depërtimit të bizneseve në ambientin elektronik, ndikimi i Internetit mbi modelet tradicionale të biznesit, ndikimi i Internetit mbi ndryshimet në treg, lëvizja e bizneseve tradicionale drejt zhvillimit të strategjive të biznesit elektronik, ndikimi i internetit në zhvillimin e strategjive inovative të bizneseve tradicionale e të tjera.

Në njërin anë, konkurrentët e drejtpërdrejtë shtynë njëri tjetrin për pjesë më të madhe të tregut dhe në anën

tjetër ata lëvizin drejt një tregu tjetër për të ndikuar ndaj bizneseve tjera (shih figurën).

Nga figura mund të vërejmë se treguesit sipas tregjeve të tyre mund të ndahen në tre lloje: tregues tradicional, tregues në Internet dhe tregues me treg të përzier. Kështu, treguesit tradicional të ndikuar nga zhvillimet në Internet gjithnjë e më shumë

lëvizin drejtë zgjerimit të tregut të përgjithshëm përmes pjesëmarrjes në Internet, pra kalojnë nga tregtues tradicional në tregtues me treg të përzier. Përfundimisht, zhvillimet e teknologjive të Internetit kanë krijuar mundësi shumë të mira për të themeluar biznese të reja ose/dhe për të përshtatur bizneset ekzistuese në ambientin e ri tregtues. Interneti ka “krijuar” kompani të reja, tregtuesit në Internet, me modele tërësisht të reja të biznesit, por me synim të njëjtë si bizneset tradicionale: të fituarit përmes kënaqjes së konsumatorit.

3. Interneti dhe strategjitë e biznesit

Shumë kompani kanë pasur ide të mrekullueshme për t’i implementuar në internet. Për më tepër, ato madje kanë zhvilluar modelet e biznesit për këto ide. Më në fund, për shkak të mungesës së strategjisë ose duke implementuar strategji të gabuar, pas investimit të milionave nga kapitali i tyre, ato kanë dështuar drejt implementimit të modeleve të zhvilluara të biznesit. Pra, mahnitja nuk është pjesë e biznesit dhe zhvillimeve të tij, por strategjia është elementi kyç për biznes të suksesshëm. Pa dyshim Porter (2011) ka të drejtë kur thekson se të pasurit strategji është disiplinë, meqë ajo kërkon përqendrim të fortë mbi rentabilitetin dhe jo vetëm mbi rritjen. Gjithashtu, strategjia, është vullnet për të zhvilluar tregtime të mëdha duke përzgjedhur çfarë të bëhet dhe çfarë jo. Në këtë mënyrë, mjeti bazë për të kuptuar ndikimin e teknologjisë informative mbi kompanitë është modeli i zinxhirit të vlerave. Sepse çdo aktivitet përfshinë krijimin, përpunimin dhe komunikimin e informacioneve, dhe teknologjia informative ka ndikim të madh mbi zinxhirin e vlerave.

Edhe pse interneti u mundëson kompanive depërtim të lehtë në tregun në internet, ato duhet zhvilluar strategji të cilat sigurojnë depërtim të suksesshëm dhe rritje stabile si në biznesin tradicional – nëse kompanitë janë tradicionale dhe përpilojnë strategji për depërtim në tregun në internet – ashtu edhe në tregun në internet. Për këtë çështje, Porter (2001) vlerëson se zinxhiri i vlerave duhet të jetë shumë i harmonizuar, ku aktivitetet e kompanisë përputhen si një sistem i cili vetë-fuqizohet. Në këtë mënyrë, cilido konkurrent që tenton të imitojë strategjinë duhet zëvendësuar sistemin e tërë ekzistues në vend të kopjimit të një ose disa karakteristikave të produktit ose të kopjimit të një ose dy mënyrave të realizimit të aktiviteteve të caktuara.



Figura:
II.Lakorja e miratimit
(Waser, 2011)

Në fazat e para të implementimit të teknologjisë,

sinjalet e tregut mund të jenë të pa sigurta meqë teknologjitë e reja shtynë eksperimentime të papërmbytura, si nga kompanitë ashtu edhe nga konsumatorët, dhe këto eksperimentime shpesh janë ekonomikisht të pa qëndrueshëm. Prandaj, si pasojë, sjellja e tregut deformohet dhe duhet interpretuar me kujdes (Porter, 2008).

Për këtë, strategjia e implementimit duhet bazuar në strukturën e fuqive të kompanisë për të realizuar biznes elektronik e cila analizon në një anë kombinimin mes dimensioneve të teknologjisë, kompanisë, dhe njerëzve, dhe në anën tjetër strategjinë e biznesit, adoptimin e biznesit elektronik dhe menaxhimin e zinxhirit të furnizimit. Duke u mbështetur në pozicionimin strategjik në një anë, dhe në informacionet e përmbledhura nga studimi i strukturës së aftësive të kompanisë për të realizuar biznes elektronik në anën tjetër, mund të implementohen dy strategji implementimi: strategjia e implementimit të përnjëhershëm dhe strategjia e implementimit hap-pas-hapi (shih figurën 2, respektivisht figurën 3).




Figura:III. Implementimi i përnjëhershëm


Depërtimi drejt një modeli të caktuar të biznesit në internet, nga ana e kompanive të themeluara në baza tradicionale, shkatërron

të implementuar me sukses.

dy strategjive është menaxhim i rreziku meqë hapat e ndryshimit të modelit të biznesit kanë madhësi dhe hendeqe të ndryshme.

Pra, dallimi mes këtyre

Figura:IV.
Implementimin hap-pas-hapi



Për në fund, meqë interneti shkatërron modelin e biznesit të zhvilluar paraprakisht, madje edhe modelet e implementuar me sukses, secila kompani

duhet zhvilluar strategji të cilat mundësojnë implementimin e suksesshëm e modeleve të biznesit elektronik. Madje, interneti dhe ambienti në të është duke u bërë çdo ditë më tërheqës për zhvillimin e aktiviteteve të biznesit, madje edhe për personat privat, prandaj ka nevojë për strategji të cilat 1) plotësojnë, në vend të kanibalizojnë, strategjitë ekzistuese të biznesit të kompanisë dhe 2) krijojnë përparësi konkurruese – këto përparësi konkurruese duhet bërë nga efektiviteti operativ dhe pozicionimi strategjik – të cilat konkurrentët nuk mund t'i kopjojnë. ²³⁶

4. Menaxhimi dixhital

Niveli i ndikimit, gjithashtu, është i lartë edhe në industrinë e shërbimeve siç janë bizneset që kanë të bëjnë me hoteleri, udhëtim dhe turizëm, bankat, shërbimet shëndetësore e të tjera. Rezultate të arritura nga studime të shumta tregojnë se teknikat e reja të të mësuarit përmes mjeteve elektronike siç janë rrjetet neurologjike artificiale (*anglisht: artificial neural networks*) ose makinat vektoriale mbështetëse (*anglisht: support vector machines*), janë në gjendje të ofrojnë parashikime shumë të sakta lidhur me shumë probleme të bizneseve të ndryshme (Baesens et al., 2003). Për shembull, duke u bazuar në ndonjë grup të

Porter, Michael E. (2008). On competition (2nd ed.). Harvard Business Press.

caktuar të të dhënave nga aplikimet e mëparshme për mbështetje financiare, institucionet financiare konstruktivë modele financiare për të parashikuar nëse një aplikues i caktuar do të jetë në gjendje ose jo të paguaj borxhin financiar për të cilin aplikon. Kurdo që kërkohet tek shumë sipërmarrës të NME-ve si ata menaxhojnë biznesin, me vendime të çfarë llojeve të problemeve, përgjigja e tyre është shpesh: "rregull e pranoj, intuitë, duke iu referuar ndërmarrjeve të tjera të suksesshme të biznesit Mode "Në të vërtetë, këto gjëra kanë një rol të caktuar për marrjen e vendimeve të biznesit ndërmarrje, por vendimet e vërtetë e duhura të ndikojë drejtpërdrejt në funksionimin e të dhënave duhet të jetë, vetëm të dhënat në mënyrë që të reflektojë gjendjen e vërtetë të biznesit. Prandaj, në mënyrë që të përmirësohet rrënjësisht nivelin e menaxhimit të ndërmarrjeve, të menaxhimit të bëhet menaxhimin e turbullt racional, ajo duhet të menaxhohen në bazë të të dhënave që MBF (Menaxhimi nga figurat), përmirësojnë vendimmarrjen e menaxhimit më shkencore. Faza fokus menaxhimin, atëherë, kur operatorët e marrjes së vendimeve të biznesit, të cilat duhet të veprojnë një bazë dixhitale! Kështu, operatori duhet të përqëndrohet në rritjen e shitjes dhe pjesë të tregut. Në këtë fazë, menaxhimi duhet të përqëndrohet në të ardhurat, fitimin bruto, diferencë kontributit, fitimi pikë arrijnë shumën në shitje, pjesën e tregut dhe rritjen e shitjeve, shkalla e produkteve të kualifikuar, kënaqësinë e konsumatorit dhe figura të tjera të biznesit.

5. Çka është SAP(Sistemet Aplikacionet Produktet-Shërbimet)?

Shkurtesa SAP rrjedh nga gjermanishtja, "Systeme, Anwendungen, Produkte" e që në shqip ka kuptimin Sistemet Aplikacionet dhe Produktet. Për herë të parë SAP u përdor në vitin 1972 nga pesë ish punëtorë të IBM në filialin Meinheim, Gjermani. Meqë, terminologjia informative dhe ajo e biznesit elektronik shumë shpesh referohet në anglisht, po përmendim se kuptimi i SAP në anglisht është "Systems Applications and Products.". Idea origjinale e SAP ishte që tu ofrohet konsumatorëve mundësia për të ndërvepruar me bazën e përbashkët të të dhënave të kompanisë për një gamë të caktuar të aplikacioneve.

Së fundi SAP ka përmbledhur produktet në një faqe të vetme interneti emëruar mySAP.com, gjithashtu ka shtuar aplikacione të reja të biznesit elektronik duke përfshirë CRM (Menaxhimi i Marrëdhënieve me Konsumatorët nga anglishtja Customer Relationship Management) si dhe SCM (Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizuesve nga anglishtja Supply Chain Management).

Nga modulet të cilat përfshihen tek SAP shërbimet për të realizuar shërbimet kryesore të biznesit janë:

- **FI** – Kontabiliteti Financiar (**anglisht: Financial Accounting**)
- **FSCM** – Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit Financiar (**Financial Supply Chain Management**)
- **CO** – Kontrolli (**anglisht: Controlling**)
- **MM** – Menaxhimi i Materialeve (**anglisht: Materials Management**)
- **SD** – Shitjet dhe Shpërndarjet (**anglisht: Sales and Distribution**)
- **LE** – Zbatimi i Logjistikës (**anglisht: Logistics Execution**)
- **PP** – Planifikimi i Prodhimit (**anglisht: Production Planning**)
- **QM** – Menaxhimi i Kualitetit (**anglisht: Quality Management**)
- **PM** – Mirëmbajtja e Depove (**anglisht: Plant Maintenance**)
- **PS** – Sistemi i Projekteve (**anglisht: Project System**)
- **HR** – Burimet Njerëzore (**anglisht: Human Resources**) ²³⁷

Metodologjia e Implementimit të SAP

Implementimi i SAP sistemit në një kompani është projekt i madh i cili kërkon muaj ose një vit angazhim. Sidoqoftë, për implementimin e një metodologjie të një SAP projekti përdoret një qasje e përgjithshme që zakonisht përputhet me 5 fazat:

Faza 1: Planifikimi i projektit.

Faza 2: Skematizimi i projectit.

Faza 3: Realizimi.

Faza 4: Përgatitja përfundimtar.

Faza 5: Futja në veprim.

Për më tepër, secila fazë e realizimit duhet të realizohet bazuar në synimet specifike dhe në planin specifik të realizimit. Për realizimin e SAP projekteve tanimë ekzistojnë lëmi veprimi si “Menaxhimi i SAP Projekteve” (anglisht: SAP Project Management) dhe ” Menaxhimi i SAP Ndryshimeve në Organizatë” (anglisht: SAP Organizational Change Management).

6.Hulumtimi

a.Vështrim mbi Hulumtimin- Hulumtimi na tregon qartazi se si mendojnë veprojnë dhe supozojnë ata të cilët merren dhe do të merren me biznes kundrejtë

1 ²³⁷ www.globalguideline.com(Systems, Applications, and Products (SAP) Guides)

dixhitalizimit të ekonomisë (ekonomia). Janë disa attribute të cilat na japin I informacione të qarta lidhur me të ardhmen e dixhitalizimit total.

b. Puna në të ardhmen në këtë temë - Lidhur me dixhitalizimin mbahen konferenca dhe shumë korporata apo biznese duke u bazuar në globalizmin (tregjet e largta gjeografikisht) e kanë si metod të imponuar. Ne e pamë se dixhitalizimi krijonë lehtësi, besueshmëri, siguri, saktësi dhe mbanë një imixh sa i përket "good willit" të organizatës.

c. Metodologjia e hulumtimit ka qenë pyetsori i cili ka përmbajtur:

1. dhjetë (10) pyetje,
2. 60 respondent,
3. on-line,
4. Distanca kohore Krijuar (03.03.2016).
5. SPSS - të dhënat e përpunuar

<p>1. A është njëra ndër arsyet (TIK) dhe dixhitalizimi i ekonomisë se ju dëshironi ta zgjeroni biznesin (apo hapni një biznes të ri)?</p>	<p>a. Po (plotësisht). (43.48%)</p> <p>b. JO (nuk i/do përdori për biznes). (4.35%)</p> <p>c. Njëra nga arsyet. (39.13%)</p> <p>d. 70% e arsyes është kjo. (13.04%)</p>
--	---

<p>2.A do/i përdorni(TIK) dhe data bazat elektronike për ruajtjen e të dhënave dhe komunikimin në lidhje me biznesin(afarizmin)?</p>	<p>a.Po i/do i përdori (90.91%) b.Jo nuk i/do i përdori sepse nuk kam njohuri. (0.00%) d.Jo në të gjitha aspektet. (4.55%) c.Jo nuk i besoj virtualitetit(aspak). (4.55%)</p>
<p>3.Virtualiteti dhe memorizimi elektronik është afarizmi i të ardhmes ,konkurrenca do të ju a imponojë në një formë?</p>	<p>a.Do ta përdori. (27.27%) b.Ndoshta(mundë të ndodhë). (63.64%) c.Nuk pëlqej të mendoj diçka të tillë. (4.55%) d.Jo(kam metoden time). (4.55%)</p>
<p>4.A i/do përdorni metodat elektronike për reklamimi të produktit apo biznesit tuaj?</p>	<p>a.Po(i pashmangshëm). (82.61%) b.Jo(aty nuk i përshtatet). (4.35%) c.Metoda t'jera përdori. (8.70%) d.Është i kotë. (4.35%)</p>
<p>5.A ju ka lehtësuar punën dixhitalizimi në mbajtjen e shënimeve (kuantitative, kualitative)? "kliko dy opcione".</p>	<p>a.Ka lehtësuar punën. (83.33%) b.Ka rritur saktësinë. (44.44%) c.Ka rritur shpejtësinë. (38.89%) d.Ka zvogluar sigurinë. (16.67%) e.Ka rritur sigurinë. (33.33%)</p>
<p>6.Dixhitalizimi a ka ndikuar në reduktimin e puntorëve?</p>	<p>a.Po (83.33%) b.Jo (16.67%)</p>

<p>7.Dixhitalizimi(robotika) a ka/do ndikuar në produktivitetin e biznesit tuaj?</p>	<p>a.Po. (61.11%) b.Jo. (16.67%) c.Nuk varet vetëm nga makineria moderne. (11.11%) d.Varet nga konkurrenca se qka përdor. (11.11%)</p>
<p>8.Shkalla e dixhitalizimit ka arritur në një kulm që ka reduktuar punën e mundishme a e ka rritur monotonin e punës së njëjtë?</p>	<p>a.Jo(shumë më mirë). (16.67%) b.Po(qëndrimi para kompjuterit). (44.44%) c.Për disa punë e ka rritur. (33.33%) d.Ende nuk i përdori metodat e reja. (5.56%)</p>
<p>9.Aspektet e komunikimit dhe japjes së detyrave(virtuale) ju pëlqejnë?</p>	<p>a.Po sepse s'ka humbje kohe. (38.89%) b.Jo më pëlqen takimi fizik me nën/mbivartës. (11.11%) c.Disa situata(punë)e preferoj. (50.00%)</p>
<p>10.Rreth deklarimeve dhe pagesave (tatimit,furnitorët) a e ka lehtësuar punën dixhitalizimi?</p>	<p>a.Po(e mira më e madhe). (94.44%) b.Jo(vetëm se mu ka imponuar). (5.56%)</p>

Referencat:

1. Barnes, S. E-commerce and v-business: digital enterprise in the twenty-first century, Butterworth Heinemann. (2007).
2. Li, F. What is e-business: How the Internet transforms organizations. Wiley Blackwell.(2007).
3. Porter&Michael E. On competition (2nd ed.). Harvard Business Press. (2008).
4. Mustafi, S., Jost, L., & Nguyen, T. The Relationship between Online and Offline Marketing. Integration The Vlsi Journal. (2011). FHNW, Olten.
5. Takimi Ministral i Mesdheut për Ekonomi Dixhitale 30,Shtator,Bruksel(Deklarata e përbashkët) .
www.globalguideline.com (marrur më 10.03.2016)
6. 7.Ligjeratat(UP-Ekonomik,N.Skenderi”Hyrje në Biznes”,M.Berisha-Namani”Informatika e Biznesit)2013-2015,Prishtinë

Prishtinë,Kosovë Nëntor 2016

Bashkimi i Kërkesëpadive në Procedurën Civile – Kontestimore

Egzon Doli

Universiteti i Prishtinës, Prishtinë-Kosovë,

egzon_d8@hotmail.com

Abstrakti:

Bashkimi i Kërkesëpadive si institut i procedurës kontestimore ka rëndësi të posaçme për faktin se janë shumë të shpeshta rastet kur pala paditëse në një procedurë kontestimore nuk ka vetëm një kërkesë ndaj palës së paditur, por në padinë e tij parashtron disa kërkesa, si të tilla p.sh. “...kthimin e sendit siç ka qenë në momentin e nënshkrimit të kontratës, shpërblimin e dëmit për shfrytëzimin e sendit si dhe fitimin e humbur për shkak të pamundësisë së disponimit të sendit nga pronari...”. Menagjimi i situatës së tillë, kur kemi të bëjmë me bashkim të kërkesëpadive, nga ana e gjyqtarit që e gjykon lëndën, kërkon një profesionalizëm më të lartë se në rastin kur kemi të bëjmë me një kërkesë të vetme të palës paditëse.

Fjalët e rëndësishme: Bashkimi i Kërkesëpadive, Procedura Kontestimore, Bashkimi eventual i Kërkesëpadive, Bashkimi komulativ i Kërkesëpadive, Bashkimi Alternativ i kërkesëpadive.

1.Hyrja

Në këtë punim do të trajtohet një institut procedural që i përket procedurës kontestimore dhe që si i tillë kanë rol të rëndësishëm sepse mardhëniet

juridiko-civile në plot raste nuk janë thjesht vetëm me nga një kërkesë të vetme, por ato shpesh mund të jenë mes disa palëve ose personave dhe me disa kërkesa të ndryshme.

Më bashkimi e kërkesëpadive, si institut procedural kuptojmë kur pala paditëse në procesin kontestimorë, ndaj palës së paditur parashtron dy apo më shumë kërkesa në një padi të vetme dhe që për ato kërkesa zhvillohet e njejta procedurë.

Në rastin kur kemi të bëjmë me bashkim të kërkesëpadive, procedura civile, përkatësisht kontestimore për gjykatën dhe palët është më e komplikuar se në rastin kur kemi të bëjmë me një kërkesë të vetme ose vetëm me një palë paditëse dhe një të paditur.

Ky konstatim bëhet për faktin se kur procedura civile zhvillohet duke zbatuar këtë institut procedural mund të jetë më e gjatë se normalisht, sepse duhen trajtuar shumë prova, duhen dëgjuar më shumë dëshmitarë, ekspert etj, andaj gjykata në raste të tilla duhet të shpreh një profesionalizëm më të madh

2. Teksti Kryesor

Parimi i Ekonomizimit, si për palët në procesin kontestimorë ashtu edhe për gjykatën, është shkaku kryesorë se pse një palë vendos që të disa kërkesa e tij ti përfshijë në një padi të vetme. Poashtu shkak tjetër i rëndësishëm se pse një apo më shumë palë paditëse i përfshijnë dy apo më tepër kërkesa në padinë e tij/tyre, është ekzistimi i bazës së njejtë juridike prej nga e kanë burimin ato kërkesa ndaj palës së paditur. Në kuadër të bashkimit të kërkespadive kemi tri lloje të bashkimit:

1. Bashkimi komulativ i kërkesëpadive
2. Bashkimi eventual i kërkesëpadive, si dhe
3. Bashkimi alternativ i kërkesëpadive

Bashkimi komulativ i kërkesëpadive

Fillimisht duhet cekur se padia është veprimi disponibil i personit fizik ose juridik dhe veprimi i parë procedural, me paraqitjen e së cilës fillon procesi kontestimorë për çka edhe prodhohen efektet e para juridike si për palën paditëse ashtu edhe për të paditurin.

Në parim, pala paditëse paraqet një padi dhe një kërkesë kundër palës së paditur, mirëpo janë të shumta rastet në praktikë kur pala paditëse në një padi paraqet dy a më shumë kërkesa ndaj palës së paditur dhe që kjo ndryshe në shkencën juridiko-civile njihet si bashkim i kërkesëpadive. Për bashkimin e kërkesëpadive në një padi flet edhe neni 255 i LPK-së. Në rastin kur paditësi në padinë e tij përfshinë disa kërkesa ndaj palës së paditur dhe kërkon nga gjykata që për të gjitha ato kërkesa të vendosë përnjëherë me një vendim, atëher kjo njihet si bashkimi komulativ i kërkesëpadive. Pra në rastin e tillë paditësi kërkon nga gjykata që me vendimin e saj ta detyroj të paditurin që ti përmbushë të gjitha kërkesat në mënyrë komulative ndaj tij, mirëpo kjo kërkesë e palës paditëse nuk e pengon gjykatën që të nxjerrë aktgjykim të pjesshëm duke i aporvuar vetëm disa nga kërkesat e paditësit (Neni 147 i LPK-së). Si rast tipik i bashkimit komulativ të kërkesëpadive mund të jenë në rastet e shkaktimit të dëmit si rezultat i fatkeqësisë në komunikacion, kështu P.SH personi B në cilësinë e taksitit është goditur në veturën e tij nga personi A, pa fajin e tij, me çka i është dëmtuar makina dhe si rezultat i kësaj ai nuk mund ta ushtroj për disa ditë profesionin e taksistit dhe në këtë rast personi B në padinë e tij mund të parashtrij disa kërkesa ndaj personit A, siç janë: Kërkesa për dëmshpërblim: për shkak të shpenzimeve në rregullimin e makinës, Kërkesa për fitimin e humbur për shkak se ai nuk ka mundur për disa ditë ta shfrytëzoj makinën e tij taksi si dhe Kërkesën për shpërblimin e dhimbjeve shpirtërore (frikws) të pësuar me rastin e aksidentit.

Për të ekzistuar bashkimi komulativ i kërkesëpadive duhet që paraprakisht të plotësohen disa kushte. Si kusht elementarë është ekzistimi i bazës së njejtë faktike ose juridike për të gjitha ato kërkesa, të njejtën bazë faktike ose juridike e kanë të gjitha ato kërkesa të cilat mund të subsumohen në

të njejtën normë juridike, si psh. disa autorë kërkojnë shpërblimin e dëmit nga një librari për shkak të shkeljes së të drejtës së autorit.²³⁸ Nëse kërkesat e palës paditëse nuk janë të lidhura për të njejtën bazë faktike ose juridike, atëher ato kërkesa mund të përfshihen në një padi vetëm nëse për të gjitha ato kërkesa ekziston kompetenca lëndore dhe territoriale e të njejtës gjykatë, pastaj për të gjitha ato kërkesa është përcaktuar lloji i njejtë i procedurës (pra nëse për njërin nga kërkesat e palës paditëse kompetente është gjykata që zhvillon procedurën jokontestimore, ndërsa për kërkesën tjetër gjykata që zhvillon procedurën kontestimore, atëher s'kemi të bëjmë me bashkim komulativ të kërkesëpadive) dhe që gjykata pas vlerësimit të këtyre rrethanave vjen në përfundim se përfshirja e këtyre kërkesave në një padi i kontribuon ekonomizimit të gjykimit, e nëse gjykata vlerëson se kjo nuk i kontribuon ekonomizimit të gjykimit atëher më së voni në seancën pregaditore ose seancën për shqyrtimin kryesorë, gjykata me aktvendim e ndanë procedurën, ndaj të cilit aktvendim lejohet ankimi (Neni 206 parag.1 i LPK-së).

Me legjislacionin e më hershëm ishte paraparë që nëse nëse për njërin nga kërkesat e palës paditëse është kompetent trupi gjykues ndërsa për kërkesën tjetër gjyqtari i vetëm, atëher në lidhje me padinë vendosë trupi gjykues sepse konsiderohet që një çështje vendoset në mënyrë më profesionale nga trupi gjykues se sa nga gjyqtari vetëm, ndërsa me legjislacionin e ri të procedurës kontestimore neni 15 parag.1 parashihet se në procedurën pranë gjykatës së shkallës së parë vendos vetëm gjyqtari individual. Si edhe tek rasti i bashkëndërgjyqësisë, edhe tek bashkimi komulativ i kërkesëpadive mund të ekzistoj bashkimi komulativ i njëkohshëm ose fillesar i kërkesëpadive dhe bashkimi komulativ i mëvonshëm ose suksesiv i kërkesëpadive. Tek bashkimi komulativ fillestarë i kërkesëpadive pala paditëse në momentin e paraqitjes së padisë në gjykatë parashtron të gjitha kërkesat përnjehëre që ka ndaj palës së paditur, ndërsa tek bashkimi komulativ i mëvonshëm i kërkesëpadive, pala paditëse pas paraqitjes së padisë por jo më vonë se seanca për shqyrtimin kryesorë të çështjes mund të paraqes edhe kërkesa të reja që ka ndaj palës së njejtë, të cilat kërkesa nuk i ka përfshirë më herët në momentin e dorëzimit të

padisë në gjykatë dhe kjo mund të ndodhë me kusht që kërkesat e reja të kenë të njejtën bazë faktike ose juridike me kërkesa e mëhershme të paraqitura në padi.

Bashkimi eventual i kërkesëpadive

Në rastët kur pala paditëse përfshinë në padinë e tij dy apo më shumë kërkesa të cilat janë të ndërlidhura mes tyre dhe që kërkon nga gjykata që nëse e refuzon kërkesën e parë, ta aprovoj kërkesën e dytë me rradhë, atëher kemi të bëjmë me bashkimin eventual të kërkesëpadive. Kjo radhitje e kërkesave, duhet të jetë e caktuar në padi nga paditësi²³⁹. Bashkimi eventual i kërkesëpadive ndodhë zakonisht kur paditësi shpreh pasigurinë e tij në lidhje me atë se a do të ketë sukses me kërkesën e parë ndaj palës së paditur. Për të ekszituar bashkimi eventual i kërkesëpadive duhet parapraktisht të ekzsitoj baza e njejtë faktike ose juridike, pastaj të ekzsitoj komeptenca lëndore dhe territoriale e gjykatës së njejtë për të dyja kërkesat e palës paditëse, si dhe që për ato kërkesa të jetë paraparë lloji i njejtë i procedurës, pra procedura kontestimore.

Një tjetër çështje e rëndësishme, kur është fjala e bashkimit eventual të kërkesëpadive, është edhe vlera e objektit të kontestit, normalisht kjo vjen në shprehje në kontestet pasuroro-juridike. Dispozita e nenit 30 të LPK-së në lidhje me vlerën e objektit të kontestit përcakton se te vlera e objektit të kontestit merret parasyshë vetëm kërkesa kryesore, mirëpo në rastin e bashkimit eventual të kërkesëpadive, pala paditëse ka dy kërkesa: njëra kryesore e tjetra eventuale, andaj këtu mund të themi se vlera e objektit të kontestit në rastin e bashkimit eventual të kërkesëpadive do të mund të caktohet sipas vlerës së kërkesës së parë (kryesore) të palës paditëse, e nëse kërkesa e parë i është refuzuar, atëher vlera e kërkesës së dytë (eventuale) do të ishte vendimtare në përcaktimin e vlerës së objektit të kontesit.

Neni 255 i cili edhe flet për këtë institut procedural, nuk e pengon palën paditëse të paraqes më shumë kërkesa në mënyrë eventuale, pra jo vetëm dy por edhe 3 apo 4 kërkesa ndaj palës së paditur, të cilat kërkesa do të vijnë në shprehje vetëm nëse secila nga kërkesat paraprake i refuzohen paditësit nga gjykata. Poashtu i njejti nen ka përcaktuar shprehimisht se me aprovimin e kërkesës së parë të palës paditëse, nga gjykata, shuhet gjyqëvarësia e krijuar me kërkesën numër dy. Si shembull tipik i bashkimit eventual të kërkesëpadive është kur pala paditëse në cilësinë e kreditorit, në padinë e tij kërkon nga gjykata, që ta zgjidhë kontratën me të paditurin e nëse gjykata e refuzon kërkesën për zgjidhjen e kontratës, atëher ta detyroj të paditurin që të përmbushë detyrimin, përkatësisht çmimin kontraktues brenda afatit të caktuar ndaj paditësi si kreditorë.

Pala e paditur nga paditësi i cili ka parashtruar dy kërkesa eventuale ndaj tij, ka të drejtën dhe detyrën e tij që brenda afatit ligjorë prej 15 ditësh të parashtrroj përgjigje në padi nga momenti i dorëzimit të padisë nga gjykata. Nëse i padituri nuk parashtron përgjigje në padi atëher gjykata mund të nxjerrë aktgjykim për shkak të pandëgjueshmërisë ose mosbindjes për duke e aprovuar një të një nga kërkesat e palës paditëse varësisht se për cilën ekziston themelësia e kërkesës, e në rastin tjetër kur pala e paditur ka parashtruar përgjigje në padi, duke e pohuar kërkesën e parë ose të dytë të paditësit, atëher gjykata mund të nxjerrë aktgjykim në bazë të pohimit dhe në këtë rast nuk lëshohet në themelësinë e kërkesës së pohuar nga i padituri, për shkak se kjo konsiderohet si veprim disponibil i tij.

Bashkimi Alternativ i Kërkesëpadive

Gjithashtu edhe tek bashkimi alternativ i kërkesëpadive kemi të bëjmë më një mardhënje detyrimore mes kreditorit i cili paraqitet si paditës dhe debitorit që paraqitet si i paditur. Ky bashkim ekziston atëher kur paditësi në padinë e tij parashtron disa kërkesa ndaj të paditurit dhe që i padituri në këtë rast ka të drejtë

të zgjedh mes disa alternativave për përmbushjen e detyrimit ndaj paditësit dhe me përmbushjen e njëres nga kërkesat e paditësit konsiderohet se është përmbushur në tërësi detyrimi ndaj tij. Si shembull i një detyrimi alternativ do të mund të ishte rasti kur kreditori kërkon nga debitori që në emër të borxhit prej 35`000 Euro, t'ia dorëzoj atij makinën e markës mercedez ose t'ia dorëzoj në pronësi banesën e tij dhe në rastin e tillë me dorëzimin e makinës ose të banesës nga debitori, përmbushet në tërësi detyrimi i tij ndaj kreditorit. Pra tek bashkimi alternativ i kërkesëpadive paditësi parashtron dy ose më shumë kërkesa, ndërsa i padituri ka të drejtën e zgjedhjes së cilën nga këto kërkesa do të përmbushë ndaj paditësit, në atë mënyrë që të fshihet në tërësi detyrimi ndaj tij, që do të thotë se kemi të bëjmë me një ofertë që paditësi i bën të paditurit. Kur është fjala për zgjedhjen e njëres prej alternativave për përmbushjen e detyrimit, këtë të drejtë e kanë: Kreditori, Debitori dhe Personat e tretë.²⁴⁰ Bashkimi alternativ i kërkesëpadive nuk rregullohet shprehimisht me dispozitat procedurale të ligjit mbi procedurën kontestimore, por për rregullimin e këtij instituti procedural mund të shërbehemi me dispozitat e së drejtës materiale, përkatësisht me ligjin mbi mardhënjet detyrimore(LMD) nga neni 387 deri 392. Dispozitat e LMD-së parashohin edhe disa rregulla speciale në lidhje me zgjedhjen e debitori (të paditurit) ose kreditorit (paditësit) mes alternativave për të përmbushur detyrimin. Kështu neni 388 i LMD-së parasheh: Zgjedhja quhet e bërë kur pala të cilës i takon e drejta e zgjedhjes e njofton palën tjetër për atë që e ka zgjedhur dhe nga ky moment zgjedhja nuk mund të ndryshohet apo revokohet. Poashtu me këtë ligj është kufizuar e drejta e debitorit (të paditurit) që zgjedhjen e tij për përmbushjen e detyrimit mes disa alternativave ndaj kreditorit (paditësit) ta bëj brenda një periudhe të caktuar kohore, e cila peridhë është paraprë deri sa të mos jetë bërë përmbarimi i dhunshëm në sendet e debitorit. Ndërkaq ka gjithashtu raste kur e drejta e zgjedhjes mes alternativave për përmbushjen e detyrimit i takon kreditorit, kjo sepse kështu janë pajtuar ai dhe debitori ose këtë të drejtë ja ka njohur ligji, andaj në raste të tilla nëse debitori në peridhën e caktuar kohore nuk e shfrytëzon të drejtën e tij, pra nuk deklarohe lidhur me përmbushjen e detyrimit

ndaj tij, atëher kjo e drejtë mund ti kaloj debitorit. Përpos këtyre dy subjekteve, e drejta e zgjedhjes se alternativave për përmbushjen e detyrimit, në raste të caktuara i takon edhe personave të tretë të cilët në mardhënjen midis kreditorit dhe debitorit e përcaktojnë se cili send do të dorëzohet në emër të përmbushjes së detyrimit, e nëse këta persona të tretë nuk e bëjnë një gjë të tillë brenda afatit të caktuar, atëher lënden e përmbushjes së detyrimit e cakton gjykata.

Përgjegjësia për demtimin e sendit i cili është lëndë e detyrimit: Kur objekti i detyrimit është shkatrruar tërësisht ose pjesërisht dhe për këtë përgjegjësinë e mban debitori, atëher detyrimi kufizohet në objektin e mbetur nëse të drejtën e zgjedhjes e ka pasur debitori, e nëse të drejtën e zgjedhjes e ka kreditori dhe sendi është shkatrruar për fajin e debitorit, atëher kreditori ka të drejtë të kërkoj objektin mbetur ose shpërblimin e dëmit. Ndërkaq kur objekti i detyrimit është shkatrruar tërësisht ose pjesërisht dhe për këtë përgjegjësinë e mban kreditori, atëher detyrimi i debitorit ndaj tij shuhet, por nëse e drejta e zgjedhjes i ka takuar debitorit atëher ky mund të kërkoj nga kreditori shpërblimin e dëmit dhe ta kryerj detyrimin e vet nga objekti i mbetur, përkatësisht objekti i pa shkatrruar.

3.Rastet e Studimit

Si raste të studimit kanë shërbyer lëndët e inicuar pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në të cilat lëndët pala ose palët paditëse ndaj palës apo palëve të paditur/paditurve ka parashtruar dy apo më shumë kërkesa në një padi të vetme, për të cilat është zhvilluar procedura e njëjtë dhe është nxjerrë aktyrim i njëjtë për të gjitha kërkesat.

4.Përfundimet

Bashkimi i kërkesave si institut i paraparë me Ligjin mbi Procedurën Kontestimore në Republikën e Kosovës, është në funksion të realizimit të

një parimi mjaft të rëndësishëm në procedurë kontestimore, siç ai i ekonomizimit të gjykimit. Me zbatimin e kwtij instituti procedural, arrihet ekonomizimi i gjykimit për faktin se veprimet procedurale siç janë psh. padia, përgjigja në padi, ankesa etj, kryhen vetëm njëherë, poashtu në raste të tilla gjykata cakton vetëm një seancë pregaditore dhe një seancë për shqyrtimin kryesorë të çështjes juridike etj. Me bashkimin e kërkesëpadive, përpos ekonomizimit të gjykimit arrihet edhe siguria juridike kjo sepse në raste të tilla kemi të bëjmë me të njejtat fakte që paraqiten nga paditësit apo të paditurit, me çka mundësohet gjykimi i njëllojtë i çështjes juridiko-kontestimore nga gjykata.

5.Referencat

1. Brestovci, Faik, E Drejta Procedurale Civile I (ribotimi i IV-të), Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2006.
2. Dauti, Nerxhivane, E Drejta e Detyrimeve-Pjesa e Përgjithshme, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2013. Ligji për Procedurën Kontestimore Nr.03/L-006, neni 255
3. Kodi Civil i Shqipërise, kreu III neni 438.
4. Ligji për Procedurën Kontestimore Nr.03/L-006, neni 394 parag.1.
5. Ligji për Procedurën Kontestimore Nr.03/L-006, neni 394 parag.1.
6. Morina, Iset dhe Nikçi, Selim, Komentari i Ligjit për Procedurën Kontestimore, GIZ, 2012.
7. <http://www.uamd.edu.al/neë/ëp-content/uploads/2013/01/PALET-NDERGJYQESE-NE-PROCESIN-GJYQESOR-CIVIL-.pdf> (marrë me dt. 09.04.2015).

**NDIKIMI I BURIMEVE TE RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË NË
ZHVILLIMIN E EKONOMISË SË KOSOVËS**

RAST STUDIMI: PARKU I ENERGJISË ME ERË NË SHTIME

Autoret:

Fatlind Morina, Master i Shkencave Ekonomike ne Menaxhment dhe
Informatikë, Asistent ne Universitetin “Kadri Zeka”.

Shqipdon Abazi, Master i Shkencave Ekonomike në Menaxhment dhe
Informatike

Prishtinë, 2016

Abstrakti

Në këtë punim shkencor, kemi hulumtuar gjendjen e energjisë elektrike në Kosovë, se si po ndikon në mënyrë negative energjia elektrike në bizneset të cilat operojnë në Kosovë. Kemi shqyrtuar të gjitha kapacitetet për prodhim të energjisë elektrike që ka Kosova, për të plotësuar kërkesat të cilat për momentin janë të papërbalueshme dhe të cilat janë cdo ditë në rritje. Kemi theksuar që, nga zgjidhja që do të bëjë Qeveria e Kosovës për plotësimin e kërkesave për energji elektrike, do të caktojë edhe ndikimet që do të ketë sektori energjetik në: shëndetin e komunitetit ku do të instalohen këto kapacitete gjeneruese, rëndësi të theksuar do të ketë në aspektin ekonomik, si në punësim, rritjen e të ardhurave për Qeverinë Qendrore dhe ato Lokale, dhe shumë ndikime tjera në aspektin ekonomik.

Në këtë punim shkencor kemi marr si rast studimi Parkun Energjetik me Erë në Komunën e Shtimes, se çfarë kapaciteti do të ketë ky Park Energjetik, si do të ndikojë në ekonominë e Kosovës, si dhe në ekonomin e Komunës së Shtimes.

Fjalët e Rëndësishme:

- Energjitë e ripërtëritshme,
- Ekonomia e Kosovës,
- Energjia Elektrike,
- Parku i energjisë elektrike në Shtime.

Hyrja

Energjia dhe burimet e mjaftueshme të energjisë përbëjnë një nga sfidat më të mëdha të civilizimit njerëzor, e sidomos të vendeve në zhvillim. Mungesa e

burimeve të mjaftueshme të energjisë dhe kapitalit për t'i shfrytëzuar ato burime, ka ngritur nevojën për shfrytëzim sa më eficient të sasisë ekzistuese të energjisë.

Sot, Kosova përballlet me zgjedhje kritike energjetike dhe zhvillimore që do të ndikojnë në furnizimin me energjinë në dispozicion për të plotësuar nevojat themelore, dhe për të siguruar rritjen e ekonomisë. Këto zgjedhje do të ndikojnë po ashtu në shëndetin e popullatës, do të përcaktojnë potencialin e krijimit të vendeve të punës në sektorin energjetik, nga ana tjetër integrimi evropian është një tjetër sfidë e madhe.

Qëllimi i temës është identifikimi i sfidave dhe propozimi i mundësive për ristrukturimin e sektorit energjetik të vendit ashtu që ai të shndërrohet nga harxhues i buxhetit të Kosovës në financues të tij, nga pengues i zhvillimit ekonomik në nxitës dhe mbështetës të tij.

1. Sektori energjetik në Kosovë

Furnizuesi dhe prodhuesi kryesor i energjisë elektrike në Kosovë është operatori vendor KEK. Të dy termocentralet me linjit të KEK-ut prodhojnë 97% të energjisë elektrike të përdorur në vend me një kapacitet total të instaluar të energjisë prej 1478 MW. Është paraparë që këto dy termocentrale të shkyçen nga rrjeti në vitin 2024, dhe të zëvendësohen me një termocentral të ri. Shqetësimi kryesor në sektorin e energjisë është mungesa e furnizimit që shpie në ndërprerje të rregullt të energjisë, së bashku me degradimin mjedisor lidhur me operacionin. Për të plotësuar kërkesën në rritje për energji (një rritje prej 25% në konsumin vjetor është parashikuar deri në vitin 2020), burime të reja të prodhimit të energjisë duhet të zhvillohen.

Tabela.1. Kapacitetet e instaluara prodhuese të energjisë elektrike

Njësitë prodhuese	Kapaciteti i njërive (MW)			Futja në operim
	Instaluar	Neto	Min/max	
Termocentralet				
A1	65	Nuk operon		1962
A2	125	Nuk operon		1964
A3	200	182	100-130	1970
A4	200	182	100-130	1971
A5	210	187	135	1975
TC Kososva	800	551		
B1	339	310	180-260	1983
B2	339	310	180-260	1984
TC Kososva B	678	620		
Total TC	1478	1171		
Hidrocentralet				
HC Ujmani	35	32		1983
HC Lumbardhi	8.80	8.00		1957 (2006)
HC Dikanci I	1.00	0.94		1957 (2010)
HC Radavci	0.90	0.84		1934 (2010)
HC Burimi	0.86	0.80		1948 (2011)
Total HC	46.56	42.58		
Energjia nga	1.35			2010
Total	1,525.91	1,213.58		

Burimi: Strategjia e energjisë së Republikës së Kosovës 2013 - 2022

Energjitë e ripërtëritshme dhe potenciali i Kosovës për energji të ripërtëritshme

Prognozat e dala nga studimet e deritanishme, për potencialin energjetik ekonomikisht të shfrytëzueshëm të vendit nga burimet e ripërtëritshme faktojnë se Kosova mund të gjenerojë energji nga këto burime:

- **Potencialet e Ujit**

Uji konsiderohet si një burim i rëndësishëm prej të cilit Kosova mund të përfitoi sa i përket prodhimit të energjisë elektrike. Sipas disa studimeve të bëra nga ekspertë të Shqipërisë, në Kosovë²⁴¹, janë identifikuar rreth 77 vende potenciale për të ndërtuar hidroelektrana të vogla. Kapaciteti i instaluar i tyre pritet të jetë rreth 130 MW, pa përfshirë elektranat më të mëdha si ajo e Zhurit.

- **Potenciali i diellit**

Me afërsisht 278 ditë me diell, Kosova mund të konsiderohet si një vend që ka predispozita të qarta për shfrytëzimin të këtij burimi.

- **Potenciali i Erës**

Studime të bëra²⁴² tregojnë një potencial të madh të energjisë së erës në Kosovë duke u bazuar në matje të sakta dhe profesionale sipas kërkesave standarde për investitorë. Potenciali i përgjithshëm i energjisë së erës në Kosovë është përafërsisht 328 MW.

²⁴¹ Mjedisi, Energjia, Transporti dhe Zhvillimi Rajonal, Task Forca për integrim Evropian, Dhjetor 2012.

²⁴² Energjia e ripërtëritshme si një shans i zhvillimit ekonomik në Kosovë, Evroenergie L.L.C., Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit – GIZ, 2013.

Tabela 2. Potenciali i Kosovë për energji të ripërtëritshme

Nr.	Projekti	Kapaciteti në MW
1	Shtime 1	100
2	Shtime 2	27
3	Kitka,	30
4	Golesh(Windpower)	1.36
5	Nek Zatriq	30
6	Bajgore	50 (Matjet vazhdojnë)
7	Skenderaj	50 (Matjet vazhdojnë)
8	Budakova	40
Total		328.36

2. Ndikimi i investimeve në Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë në Ekonominë e Kosovës

Përmes shfrytëzimit të drejtë të burimeve të ripërtëritshme të energjive dhe mbrojtjes së tyre mund të arrihen këto qëllime:

1. Mbështetja e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik


Përvoja e zhvillimit ekonomik në dekadat e fundit e sidomos kur është fjala për vendet në zhvillim²⁴³, ka vënë në pah se investimet në energji të ripërtëritshme,

²⁴³ INVESTIMET E JASHTME DIREKTE NË KOSOVË, RIINVEST, SHTATOR 2002, FAQE 12.

konsiderohen të rëndësishme për shkak të efekteve të tyre të shumanshme pozitive e sidomos për shkak se:

- Investimet e huaja direkte, ku hynë edhe investimet në energji të ripërtëritshme, ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillim ekonomik në ato vende të cilat janë në tranzicion, pra në këtë kategori hynë edhe Kosova.
- Investimet në energji të ripërtëritshme do të ndikonin në ndaljen e reduktimeve të rrymës elektrike, e cila është një prej faktorëve kryesor që ndikon në bizneset të cilat operojnë në Kosovë.
- Me investim në energji të ripërtëritshme do të krijohet një ambient më i përshtatshëm për investimet e huaja direkte në Kosovë,

Figura 1: Pjesëmarrja e sektorëve në zhvillimin dhe ndërtimin e energjisë së erës



Burimi: (EWEA - The European Wind Energy Association, 2012).

2. Krijimi i vendeve të reja të punës

Krijimi i vendeve të punës është një çështje veçanërisht e ngutshme për Kosovën si vendi cili po përballet me normë papunësie prej dy-shifrash me një normë të shpejtë të rritjes së të rinjëve që hyjnë në fuqinë punëtore. Me një normë papunësie prej 46 përqind dhe një normë të ulët punësimi (29 përqind), Kosova ka ritmin më të dobët të punësimit në Evropë.

Zhvillimi i energjive të ripërtëritshme vlen që një kohë të gjatë si motor për krijimin e vendeve të reja të punës

Figura e mëposhtme tregon zinxhirin e vlerave të krijuar në sektorët në të cilët mund të krijohen vende të reja pune.

Figura 2. Zinxhiri i vlerave të shtuara



Burimi: Energjia e ripërtëritshme si shancë i zhvillimit ekonomik në Kosovë, Studimi GIZ, Prishtinë 2012, faqe 57.

3. Rritja e sigurisë së furnizimit me energji elektrike

Parakusht themelor për zhvillim ekonomik është sigurimi i energjisë elektrike. Si pasojë e mungesës së sigurisë të energjisë elektrike, sektori privat po pëson shume dëme, pra siguria e furnizimit me energji elektrike në Kosovë është kushti kryesor për tërheqjen e investimeve të huaja, por edhe stabilitetit për bizneset në Kosovë. Jostabiliteti me furnizim me energji elektrike, bizneseve kosovare i kushton në mbi 300 milionë euro humbje në vit.

4. Parku i energjisë me erë në Komunën e Shtimes

4.1 Qëllimi dhe objektivat

Objektiva kryesore e Parkut të energjisë me erë në Shtime është ngritja e parkut më të madh të energjisë me erë në Kosovë, në periferi të qytezës së Shtimes, me një kapacitet prodhues total prej 100MW. Duke qenë se aktualisht Kosova përballet me probleme të mëdha sa i përket furnizimit me energji elektrike dhe përmbushjes së nevojave në vend me energji, projekti në fjalë do të jetë një mbështetje e madhe në veçanti për zhvillimin e sektorit prodhues, me implikime në gjenerimin e punësimit në Kosovë, ku papunësia mendohet të ketë arritur shkallën prej mbi 40% të papunë.

Ky park do të ketë rreth 10% të kapacitetit total të bruto prodhimit të energjisë të instaluar në Kosovë, ndërsa prodhimi i energjisë do të zëvendësoj rreth 5% të konsumit total, sipas parashikimeve të ZRrE-së. Për më tepër energjia e prodhuar nga era do të reduktojë në masë të madhe ndotjen e ajrit i cili përndryshe do të shkaktohej nga termoelektranat ekzistuese kosovare.

Kosto e projektit kap shumën prej rreth 100 milion €, mjete te cilat janë të siguruara nga investitorët e huaj.

4.2 . Pozita gjeografike

Komuna e Shtimes gjendet në pjesën qendrore të Kosovës. Territori i komunës së Shtimes ka një sipërfaqe prej 134 km² (13,450.8 hektarë), gjegjësisht, 1,2 për qind të territorit të Kosovës. Afër 48,4 % e territorit të komunës është tokë bujqësore dhe bujqësia është një nga prioritetet zhvillimore të komunës. Kryqëzimi i akseve rrugore të rëndësishme në relacionet Prizren - Prishtinë dhe Prizren-Ferizaj-Shkup janë segmente me rëndësi për zhvillimin e mëtutjeshëm të komunës.

4.3. Kapaciteti prodhues

Fillimisht, në fazën e parë të projektit, do të ngritën 20 njësi prodhuese (turbina me erë) me një kapacitet prej 2.5MW për njësi. Deri në përfundim të projektit do të ngritën 40 turbina me kapacitet të gjithmbarshëm prej 100MW.

Duke u bazuar në matjet dhe nga përlllogaritjet e bëra parashikohet se çdo turbinë do të prodhojë rreth 8GWh në vit ndërsa prodhimi total për një vit do të sillet nga 150GWh deri në 170GWh.

4.4. Financimi

Mjetet për përfundimin e projektit janë të siguruara dhe garantuara nga investitorë të huaja. Me marrëveshjen e partneritetit është garantuar se me krijimin e kushteve të parapara sipas marrëveshjes, investitori do të investojë shumën 100% të projektit. Nga momenti i sigurimit të dokumentacionit të nevojshëm për investime (licenca nga ZRrE), partnerët me marrëveshjen e

partneritetit janë zotuar se do të fillojnë me investime në afatit më të shkurtë të mundshëm.

4.5. Përfituesit

Projekti i energjisë me erë “KL-Energy” do të ndikoj në mënyrë të drejtpërdrejtë në stabilitetin energjetik të Kosovës.

Pamjaftueshmëria e energjisë elektrike dhe reduktimet e shumta të saj do të lehtësoheshin në masë të madhe nga realizimi i projektit, për më tepër i gjithë projekti do të ndikoj edhe në shfrytëzimin e burimeve të rinovueshme të cilat nuk e ndotin ambientin.

Kosova ka një shkallë të papunësisë afër 45% dhe njëra nga arsyet kryesore llogaritet të jetë mungesa e energjisë elektrike e cila krijon vështirësi në funksionimin e bizneseve dhe fabrikave prodhuese.

Realizimi i projektit ndikon në stabilitetin afatgjatë të vendit dhe po ashtu në përmbushjen e objektivave afatgjata, sigurimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme sipas EU-së 20% deri në vitin 2020.

Përveç ndikimit në aspektin nacional, projekti do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë edhe në komunën e Shtimes. Realizimi i projektit pritet të kushtoj afërsisht 150 milion EUR, përfitues të të cilit do të jenë firmat vendore të cilat do të jenë të inkuorporuara në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin e projektit.

3. Përfundimet

Më poshtë kemi paraqitur disa përfundime pas konsultimit me literaturë të ndryshme:

- Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm me energji përbën objektiv strategjik kryesor. Të gjitha kategoritë e konsumatorëve të energjisë duhet të jenë në gjendje të gëzojnë furnizim eficientë dhe të pandërprerë të energjisë, dhe të cilësisë adekuate. Për këtë kërkohen investime për rehabilitim të sistemeve energjetike ekzistuese dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- Kërkesa për energji deri tani është rritur në mënyrë të pakontrolluar. Ajo do të jetë e lartë në vitet e ardhshme, kjo kryesisht edhe për arsye së
- parashikohet një rritje relativisht e shpejtë e zhvillimit ekonomik të vendit. Kjo kërkesë duhet të përballohet, por kërkohet edhe të merren masa që ajo të mbahet nën kontroll.
- Integrimi i Kosovës në BE kërkon edhe zbatimin e objektivave 20-20-20 të planit të BE-së për fushën e energjisë që kërkon nga shtetet anëtare që deri në vitin 2020 të: (i) reduktojnë me 20% emetimin e gazrave që krijojnë efektin “serë”, (ii) Rritjen në 20% pjesëmarrjen e burimeve të ripërtëritshme në konsumin e energjisë, dhe (iii) Përmirësimin me 20% të efikasitetit të energjisë.
- Kosova ka një potencial të kënaqshëm të burimeve të ripërtëritshme për prodhimin e energjisë që e bën tregun Kosovar treg të mirë për investime të fushës së energjisë së pastër. Ekzistojnë studime të cilat e vlerësojnë potencialin e Kosovës në fushën e energjisë së pastër si konkurrense me vendet e rajonit. Përmes shfrytëzimit të drejtë të burimeve të ripërtëritshme të energjive dhe mbrojtjes së tyre mund të arrihen këto qëllime:
 1. zhvillimi ekonomik,
 2. mbrojtja e ambientit,
 3. krijimi i vendeve të reja të punës,

4. decentralizimi i prodhimit të energjisë,
5. nxitja e konkurrencës në treg,
6. përshpejtimi i zhvillimit të inovacioneve.

4. Referencat

1. *Renewable and Alternative Energy*. New York: Britannica Educational Publishing. Robert, C. (2012).
2. *Renewable Energy Sources*. Rajendranagar, India: Acharya N.G. Ranga Agricultural University. A. Mani, K. Sada Siva Rao dhe C. Gopala Rao (2012).
3. *Doracaku për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë*. Prishtinë: UNDP. Naser, S., Maliq, P. dhe Besim, V. (2013).
4. *Opsionet për Energji të Qëndrueshme për Kosovën*. Berkeley: Universiteti i Kalifornisë. Daniel, M., Maryam, M. dhe Daniel. (2012).
5. *Deklaratë mbi Sigurinë e Furnizimit në Kosovë (energji elektrike, gaz natyror dhe naftë)*, Zyra e Rregullatorit për Energji. Prishtinë, 2013.
6. *Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2013 – 2022*. MZHE. Prishtinë 2013.
7. *Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë 2011 – 2020*. MZHE, Prishtinë 2013.
8. *Balanca Afatgjate e Energjisë 2013-2022*, KOSST & ZRrE, Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Prishtinë 2013.

9. *Tarifat nxitëse dhe rëndësia e tyre për investime në Kosovë*, Dardan Abazi dhe Rinora Gojani, Botuar nga INDEP në kuadër të KOSID. Prishtine 2014.
10. *Eficiency për Zhvillim: Ekonomiksi i Eficiency së Energjisë në Kosovë*. Konsorciumi Kosovar i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID). Maj 2014.

BALLAFAQIMI SHOQËRISË KOSOVARE ME REALITETIN E RAPORTIMIT TË INTEGRUAR TATIMOR

Nuhi Çerkini
Kandidat në studimet master drejtimi,

Financa, Kontabilitet dhe Banka, Universiteti Prishtinës -Kosova,

nuhi.cerkini@gmail.com .

Abstrakti

:

Në këtë punim shtjellohet rëndësia e raportimit të integruar tatimor si një funksion elementar dhe shtytës i zhvillimit të qëndrueshëm të shtetit dhe mënyra e integritit të raportimit tatimor nga legjislacioni vendor tek ne. Pastaj mundohet të prezantohet një strukturë e selektuar ,përmes së cilës bëhen analiza të ndryshme mbi baza teorike dhe praktike për drejtuesit e subjekteve ekonomike ,kontabilistët ,auditorët ,financierët dhe brezat e pasues tjerë të tyre .Sic jemi në dijeni për nevojën që ka informacioni kontabël i besueshëm dhe transparent ,gjykojmë ky element sa është i nevojshëm aq i rëndësishëm të rritjes se efikasitetit në lidhje me vendimarrjet e subjekteve ekonomike dhe zhfrytëzuesve të informacionit kontabël , poashtu si një prej plotësimit për raportim financiar korrekt për integrimin e Kosovës drejt Bashkimit European. Ky punim është një “kurorzim” pas një pune të lodhshme hulumtuese dhe shkencore në fushën e raportimit tatimor , produkt ky shumë i nevojshëm për të gjithë zhfrytëzuesit e informacionit kontabël dhe pasqyrave financiare të pregatitura nga subjektet ekonomike të ndryshme në vend. Një fenomen tjetër i rëndësishëm i konstatuar gjatë studimit të këtij punimi është edhe efekti i çështjes së trajnimit të profesionistëve, kontrollimit te vazhdueshem dhe menyres se zbatimit te legjislacionit vendor gjatë përpilimit të informacionit kontabël dhe ndikimi të këtyre elementeve në saktesine e hartimin të pasqyrave financiare .Poashtu është shtjelluar relacioni në mes raportimit kontabël dhe raportimit fiskal.Rezultatet e arritura në lidhja midis raportimit kontabël dhe raportimit tatimor është sa komplekse aq edhe dinamike, ndaj ky studimin edhe pse në Kosovë është ndër të parët në këtë fushë, ka kufizimet e veta dhe lë

mundësi për studime dhe hulumtme të mëtejme. Ky hulumtim duke marrë parasysh nevojën e raportimit të drejtë dhe zbatimit të legjislacionit fiskal është i bazuar në “ Teorinë e politikës së ligjeve ”, duke përdorur qasjen induktive të mbledhjes së të dhënave për përpilimin e studimit.

Fjalët e rëndësishme : Legjislacioni fiskal, Integrimi, Informacioni kontabël, SNRF-të, Raportimi tatimor.

1. Hyrje

Sic e dijmë cdo vend i zhvilluar, i pa zhvilluar apo në zhvillim e sipër ashtu si jemi ne në këto dy decediet e fundit, është i varuar nga shumë faktorë të brendshëm apo të jashtëm të cilët ndikojnë në stabilizimin e ekonomisë si: papunësia, inflacioni, mosfunksionimi i derregullimit, korrupsioni dhe ineglizhenca e respektimit të obligimeve fiskale në vend .Prandaj në këtë punim është munduar që të selektohet njëri prej këtyre faktorëve dhe të shtjellohet më tej. Ndër problemet kyçe që kanë kërkuar zgjidhje drejtuesit e njësive ekonomike ka qenë zhvillimi i vazhdueshëm dhe përmirësimi i kuadrit ligjor për kontabilitetin dhe raportimin financiar , element ky që do të çonte në dhënien e një informacioni të besueshëm dhe relevante për të gjitha palët e interesuara për të (si investitorët e huaj ashtu edhe ata vendas) në uljen e informalitetit në vend si dhe eliminimin e korrupsionit në administratën publike. Problemi me rezultatin e këtij lloji është se, në pikën e divergjencave, nuk mund të jetë konfuzion konceptual dhe vështirësitë në integrimin dhe menaxhimin e dy sistemve konceptualisht shumë të ndryshme rregull.²⁴⁴

2. Integrimi Raportimit Tatimor

Si pjesë e rëndësishme e sistemit të legjislacionit të vendit, raportimi tatimor nuk është e lehtë që të kuptohet dhe analizohet në aspektin praktik prandaj ky element është i rëndësishëm si pjesë e realitetit të shoqërive në tranzicion. Pas përfundimit të luftës, shoqëria kosovare ndodhet përballë integritit të raportimit financiar nga pjesa dërrmuese e biznesit, kjo për vetë faktin sepse jemi duke jetuar akoma në kushtet e një ekonomie “të pasigurtë”. Raportimi tatimor është bërë pjesë e këtyre ndryshimeve të vazhdueshme ,të cilat jo pak kanë ndikuar në raportimin e njësive të ndryshme ekonomike. Shtrohet pyetja “Në çfarë niveli pasqyrat financiare në shoqërinë kosovare sigurojnë se janë transparente dhe të besueshme dhe përmbushin objektivitetin

²⁴⁴ Judith Freedman 2008, Oxford University Centre for Business Taxation

dhe realitetin tatimor ? “(Fejzo E. 2011).Relacioni mes dy fushave, ajo e kontabilitetit dhe ajo tatimore , është një lidhje që ka egzistuar, egziston dhe do të egzistojë në drejtim të analizës dhe zgjedhjes së problemeve mjaftë brengosëse , në aspektin që subjektet e ndryshme ekonomike të respektojnë llogaritjen dhe përmbushjen të obligimeve të tyre , si dhe faktin që të dhënat dhe informacionet kontabël të jenë relevante dhe të besueshme.Evoluimi i sistemit kapitalist në vendin tonë ka bërë që interesi parësor i zhfrytezuesve të informacionit kontabel dhe pasqyrave financiare në lidhje me politikën e tatimeve mund të çojë në situata të maksimizimit të profitabilitetit dhe vlerës së njësisë ekonomike që është qëllimi kryesor i pronarëve të subjekteve ekonomike . 245

3. Rasti studimi – anketimi

Pyetjet janë formuluar ne përputhje me qëllimin e studimit.Pyetëtori është shpërndarë për t’u plotësuar nëpërmjet dy mënyrave kryesore atë të ballafaqimit drejtpërdrejt me të anketuarin dhe nëpërmjet plotësimit të tij në mënyrë elektronike (me e-mail). Disavantazhi i saj është pamundësia e marrjes së opinioneve të drejtpërdrejta lidhur me sugjerimet apo mundësitë e përmirësimit të këtyre raportimeve.Ne kete studim pytsori është shpërndarë ne 115 kopje material dhe elektronike, por në këtë mostër të rendomtë kanë marrë pjesë vetëm 40 të anketuar (pra 34.78% e tyre), të cilët kanë qenë përfaqësues të kompanive që operojnë në fusha të ndryshme të biznesit por edhe persona të angazhuar brenda tyre si dhe në profesionistë që ushtrojnë aktivitet në mënyrë të pavarur të tillë si teknik kontabilisti, kontabilits i certifikuar,auditor, duke u bazuar në këto moster dhe rezultate nuk mund të paraqesim një pasqyrim të saktë. Pytesori është realizuar gjatë periudhës Janar/Shkurt 2015 dhe statistikat janë nxjerrur përmes programit ‘SPSS’.

Anketa e të punësuarve dhe kompanive ekonomike

1.1.1 Karakteristikat themelore të anketuarve

Nga të dhënat e marra nga vrojtimi në terren rezulton se peshën më të madhe të njësisive ekonomike dhe të anketuarve të tjerë e zë Ferizaj me 37.5% pastaj Prishtina vije me 30%, më pas vjen gjilani, me 7.5 % dhe t fundit renditen Shtimja dhe Lipjani me nga 12.5 % .Duke u bazuar ne ankete: 42.5% jane femra kurse 57.5% meshkuj.

²⁴⁵ Trade economy -<http://www.econlib.org/library/Enc/FreeTrade.html>

Tabela 1. Përmbledhja e të dhënave

Komuna	Frekuen	Përqindja
Shtime	5	12.5
Ferizaj	1	37.5
Gjilan	3	7.5
Prishtinë	1	30
Lipjan	5	12.5
Total	4	100.0 %

Burimi: Të dhënat nga anketa




Figura 1. Nga cila komunë jeni ?
juaj ?

Figura 2. Gjina

Duke u bazuar ne figuren 1, mbizotron grup-mosha deri ne 20 vjet vjet me 40 % nga totali e ndjekur me 23.33 % mosha 41-50 vite .Kjo na bënë që të kuptojmë se në fushën e kontabilitetit pjesa më e madhe e profesionisteve janë të rinjë dhe me një pervojë të ulët në krahasim me vendet në rajon , por kjo mund të arsyetohet përmes argumenteve të paraqitura më lartë në kapitujt e mëhershëm në aspektin kontabël jemi duke u ballafaquar me standartet , rregullat e integruara në shoqërinë kosovare mbas lufte .

Tabela 2. Çfarë moshe jeni ?

Grup-mosha	Frekuen	Përqindia
Nën 25 vjeç	12	30.00%
25-30 vjeç	1	25.00%
31-35 vjeç	5	12.50%
36-40 vjeç	3	7.50%
41-45 vjeç	6	15.00%
46-50 vjeç	0	0.00%
51-55 vjeç	4	10.00%
56-60 vjeç	0	0.00%
66-70 vjeç	0	0.00%
Total	4	100.00%

Burimi: Të dhënat nga anketa

Kurse lidhur me parashtrimin e pyetjes ndaj të anketuarve se në çfarë niveli arsimor posedojnë, vërejm se 92.5 %, kanë përfunduar studimet beqelor dhe atë në drejtimin Banka dhe financa me rreth 7.5 % , kundrejt kontabilitetit me 6.4 % dhe drejtimet tjera ne nivel me te vogel. Duhet cekur se nje pjese e kenaqeshme kan perfunduar studimet master kurse ne nivel me te larte nuk kemi hasur gjate anketimit . Mund të konkludojmë se të gjithë të anketuarit vijnë nga pjesa e profesionit të kontabilitetit. Pra pjesa më e madhe është ajo e financave e cila udhëheqë duke mos anashkaluar edhe MBA .

Tabela 3. A keni përfunduar studimet beqelor ?

Diplomë në beqelor	Frekuenca	Përqindia
Po	37	92.5 %
Jo	3	7.5 %
Total	40	100.0 %

Burimi: Të dhënat nga

anketa




Figura 3. Në cilin drejtim keni përfunduar studimet beqelor?

Duke patur parasysh faktin që realiteti social–ekonomik në Kosovë pas luftës ka ndryshuar me hapa të shpejtë e pasqyruar kjo edhe në ndryshimet e shumta të legjislacionit veçanërisht në fushën fiskale ka sjellë si domosdoshmëri përshtatjen e burimeve njerëzore të punësuar jo vetëm në administratën publike por edhe tek kompanitë dhe bizneset private. Kjo ka bërë që një pjesë e konsiderueshme e specialistëve të punësuar në kompani të mëdha, të trajnohen dhe të çertifikohen nga administrata shtetërore për t’iu përshtatur këtij realiteti.

Tabela 3. Sa vite përvojë pune keni bërë ?

Eksperiencia në	Frekuenc	Përqindja
0-5 vjet	3	77.5
6-10 vjet	4	10.0
11-15 vjet	1	2.5%
16-20 vjet	2	5.0
21-25 vjet	0	0.0
26-30 vjet	2	5.0
31-35 vjet	0	0.0
Total	4	100.0%

Burimi: Të dhënat nga anketa

Nga të dhënat e mësipërme mund të japim një opinion se peshën më të madhe të anketuarve e përbëjnë pjesa me më pak se 5 vite përvojë pune , të ndjekur me ata që kanë 6-10 vite , eksperience për dallim prej pasardhësve tjerë të cilët janë më të reduktuar.Si mund t’a shpjegojme kete informatë të përpunuar nga të dhënat ? Në opinion logjik mund të themi se jemi nje popull dukshem i ri dhe ne

tranzicion ku përfshihet edhe fusha e kontabilitetit dhe fusha tatimore dy fusha të rëndësishme për zhvillimin e vendit tonë.




Figura 4. Sa here keni bere trajnime brenda nje viti ?

Duke u bazuar ne figuren 4, lidhur me trajnimet, 74% jane pergjigjur pozitivisht ndersa 26 % negativisht. Kurse saj perket periudhes brenda nje viti pjesa me e madhe me 43.33% jane pergjigjur se cdo 9 muaj bejne trajnime dhe pjesa prej 36.67% cdo 3 muaj, dhe cdo 12 muaj 16.67%.

Karakteristikat e kompanive ekonomike

Nga të dhënat e vrojtuar të pasqyruara në Tabelën 8, u vu re se njësitë ekonomike të cilat kanë edhe peshën më të madhe janë ato që aktivitetin e tyre e kryejnë që prej 11-15 vitesh me 41.67%, të ndjekura nga ato me jetëgjatësi 6-10 vjet, dhe 0-5 vjet respektivisht me 19.4% dhe 18.3%. Me këtë jepet një përgjigje që u deduktua nga rezultatet mbi vjetërsinë e ushtrimit të profesionit më sipër. Pra, eksperiencia në profesion ka lidhje me “moshën” e ndërmarrjeve ku punojnë.




Figura 5. Sa është koha e egzistencës së kompanisë suaj ?

Shohim se profesionistët e ndryshëm të cilët punojnë në ndërmarrje të degëve të ndryshme, për nga vjetërsia kompanisë, kanë moshë më të lartë prej 41.67 %, 11-15 vite që e verteton faktin se mbasë lufte janë themeluar numri më i madhë i subjekteve ekonomike kurse më vjetërsi më të ulët janë te subjektet tjera .




Figura 6. Cili është aktiviteti primar i kompanisë suaj ?

Koncentrimi kyqë në anketimin dhe përpilimin e këtij punimi ka qenë në ndërmarrjet që mirren me shërbime të kontabilitetit dhe kjo kryesisht në qytetet si Ferizaj dhe Prishtinë , por duke mos anashkaluar edhe sektorët tjerë ku me 25 % ka pjesëmarrje fusha e financave dhe të tjera.

1.1.1.1.4. Konkluzionet dhe rekomandimet

1.1.1.1.2

Të krijohet rritja e përfaqësimit të grupeve të interesit gjatë hartimit/ndryshimit të ligjeve dhe rregullave tatimore.. Kjo mund të realizohet me një bashkëveprim më të afërt mes institucioneve shtetërore dhe organeve rregullatore sic është KKRF-ja në vend. II. Nevoja në nivel edhe me të lartë midis rregullave të kontabilitetit dhe rregullave tatimore, gjë e cila do të krijonte integritet edhe më të shpejtë në vendin tonë. Edhe pse mjaft studiues janë të mendimit se këto dy raportime nuk mund të jenë kurrë të pavarura nga njëra – tjetra. Mendoj se kjo mund të realizohet nëpërmjet bashkëpunimit të KKRF, dhe Ministrisë së Financave, evidentimit faktoreve të cilët kanë impakt në krijimin e dallimeve midis raportimit financiar dhe tatimor.

- Anashkalimi i raportimit të integruar të subjekteve ekonomike gjatë përpilimit të pasqyrave financiare. Kjo mund të realizohet nëpërmjet reduktimit së ndryshimeve të shpeshta të ligjeve, akteve normative dhe rregullave fiskale nga ana e institucioneve shtetërore dhe organeve rregullatore.
- Nga organet rregullatore dhe institucionet shtetërore të rritet mundësia dhe format e ushtrimit të kontrollit fiskal, pasi ato janë në sens të kundërt me interesin e drejtuesve për të zvogëluar barrën e taksave, pavarësisht interesit të tyre për maksimizimin e vlerës ekonomike të njësisë ekonomike.

5. Referencat

2 Research methodology & Methods and techniques - C. R. Kothari

Jelçiq, Bozhidar Shkenca mbi financat dhe drejta financiare, Prishtinë, 1985

Asllanaj, Rrustem “ Kontabiliteti financiar “, Prishtinë, 2010 faqe. 12-345

Komoni, Sabahudin: Financat, Prishtinë, 1985, 2012

Aliu, Muhamet “Raportimi financiar – ligjerata “, Prishtinë , 2014 faqe. 20-

Desai, M.A., Foley, C.F. and Hines Jr., J.R. (2004) The costs of shared

ownership: evidence from international joint ventures, *Journal of Financial Economics*, vol. 73, faqe. 323–374

Brgsthaler, D., Elliott, W.B. and Hanlon, M. (2002), How Firms Avoid Losses: Evidence of Use of the et Deferred Tax Asset Account. *Working Paper*, available on: http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=355780 (consulted at 15.07.2011).

Cuzdriorean, D. (2010), *The relationship between accounting and taxation: A brief international literature review*, *Analele Universității din Oradea*, faqe. 496-502, gjindet në [:http://anale.steconomieuoradea.ro/volume/2010/n1/077.pdf](http://anale.steconomieuoradea.ro/volume/2010/n1/077.pdf) .

TRAJNIMI SI PROCES I RËNDESISHËM NË ZHVILLIMIN E NDËRRMARRJES

Ramë Hajraj (c) M.sc
Universiteti i Gjilani “Kadri Zeka”, Republika e Kosovës
ramehajraj@yahoo.com

Abstrakti

Në ekonominë e sotme çështjet rreth zhvillimit të resurseve humane janë themelore. Për këtë secila ndërmarrje bënë përpjekje maksimale që të rekrutojë në radhët e veta njerëz që kanë dije. Arritjen e këtyre objektivave menaxherët e resurseve humane e realizojnë nëpërmjet trajnimit dhe zhvillimit. Kur menaxherët apo punëdhënësit e vërejnë se për të qenë më kooperativ në treg, duhet të bëhet rritja e produktivitetit të punonjësve, atëherë investojnë në trajnime të punonjësve ekzistues. Njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë trajnimeve u ndihmojnë punonjësve të rrisin suksesin në ndërmarrje. Ndërsa në të kaluarën trajnimi konsistonte para së gjithash në organizimin thjesht të kurseve të trajnimit, sot gjithnjë e më tepër flitet për një proces trajnimi i cili duhet të programohet mirë.

Fjalët kyçe: investimet në trajnim; nevojat për trajnim; njohuritë, aftësitë dhe zotësitë; resurset humane; stafi i shërbimit doganor.

JEL kualifikimi: Z, Z0, Z19.

1. Hyrje

“Të trajnosh (formosh) do të thotë të ndihmosh personat, grupet dhe organizatat të mësojnë për të ndryshuar: për të arritur më mirë objektivat personale dhe ato të organizatës të cilat propozohen në raport me ambientin”

(Quaglino)

Sot ambienti i biznesit konsiderohet mjaft kompleks dhe që ndryshon shpejt. Zhvillimet e shpejta teknologjike dhe ndryshimet e vazhdueshme strukturore, që synojnë një fleksibilitet të madh dhe mundësi më të madhe përshtatjeje me ambientin, janë faktorët kryesorë të cilët bëjnë që trajnimi i resurseve humane të konsiderohet shumë i domosdoshëm për mbijetesën e ndërmarrjeve.

Të fitosh një njohuri, të zhvillosh një zotësi, të modifikosh një qëndrim është gjithmonë një proces ndryshimi nga një gjendje në një tjetër.

Funksionet e rekrutimit dhe të seleksionimit janë vetëm stadet e para të sigurimit të një stafi efektiv në punë. Drejtuesit, përgjegjësit, dhe punonjësit duhet të trajnohen vazhdimisht në qoftë se do të duan të përdorin me efektivitet potencialin e tyre.

2. Ç'është trajnimi

“Procesi i trajnimit është procesi i përvetëmit sistematik të sjelljeve, koncepteve, njohurive, roleve apo aftësive që sjellin në një performancë më të mirë në punë”

Goldstein, 1991

Trainimi është një proces ku individët përvetësojnë njohuri për të ndihmuar në arritjen e objektivave të organizatës.

Trajnimi i punonjësve është përpjekje e ndërmarrjes për të përmirësuar performancën aktuale dhe të ardhshme të punonjësve.

Në qoftëse menaxherët apo punonjësit duan që të pasurohen me aftësi të reja, ata duhet të trajnohen vazhdimisht.

2.1. Pse lind nevoja për trajnim

Ndërmarrjet e suksesshme nëpërmjet trajnimit dëshirojnë që ta qartësojnë vizionin e tyre tek të punësuarit. Për ta përkrahur dhe zhvilluar atë vizion, të punësuarit duhet të kenë njohuri të mjaftuara të cilat mesiguri se ndryshojnë nga ato që janë mësuar në shkollimin formal, njohuri të cilat plotësohen nëpërmjet edukimit joformal - trajnimeve.

Nevoja për trajnim mund të lind për shumë arsye:

✓ Kur fillojnë punën, të gjithë punonjësit duhet të mësojnë si bëhen punët në ambientin e ri, duke përfshirë këtu edhe gjërat që nuk janë të shkruara në ndonjë manual politikash apo procedurash,

✓ Punonjësit e rinjë, edhe kur janë zgjedhur me ndihmën e programeve të mira të rekrutimit dhe seleksionimit, mund të kenë zotësi të pamjaftueshme,

✓ Ndryshimet teknologjike mund të diktojnë nevojën për zotësi të reja pune,

✓ Riorganizimi i punës mund të kërkojë nga punonjësit të përvetësojnë më shumë zotësi,

✓ Punonjësit që transferohen apo që promovohen mund të kenë nevojë për më shumë zotësi,

✓ Ndryshimi në strategjitë e ndërmarrjes/institucionit mund të kërkojë që drejtuesit të adaptojnë sjellje të reja lidheshme dhe të fitojnë njohuri në fusha të reja të tilla si manaxhimi strategjik.

2.2. Metodatat më të përdorshme të trajnimit

Që të jetë i suksesshëm trajnimi duhet të ketë qëllime të qarta dhe reale. Për këtë për trajnimin e stafit përdoren metoda të ndryshme. Disa nga metodatat më të përdorshme në trajnimin e stafit janë:

1. Trajnimi gjatë punës,
2. Trajnimi jashtë punës,
3. Trajnimi në klasë,
4. Trajnimi në ambiente të ngjajshme me kushtet e punës,
5. Trajnimi nëpërmjet televizionit.

2.3. A është trajnimi investim i mirë për ndërmarrjen

Trajnimet mund të jenë të shtrenjta, dhe përveq kostos që nevojitet për ta realizuar trajnimin, janë poashtu edhe kostot të cilat nevojiten për analizën dhe vlerësimin e efikasitetit të programit.

Ka shumë lloje dhe tipe të trajnimeve. Disa nga trajnimet janë më të suksesshme dhe më efektive se të tjerët, varësisht nga qëllimi dhe situata. Por, asnjë lloj i trajnimit nuk mund të klasifikohet si më i suksesshmi në të gjitha situatat.

2.4. Trajnimi ka rëndësi të madhe në kohët e sotme

Sot ambienti i biznesit konsiderohet mjaft kompleks dhe që ndryshon shpejt. Zhvillimet e shpejta teknologjike dhe ndryshimet e vazhdueshme strukturore, që synojnë një fleksibilitet të madh dhe mundësi më të madhe përshtatjeje me ambientin, janë faktorët kryesorë të cilët bëjnë që trajnimi i resurseve humane të konsiderohet shumë i domosdoshëm për mbijetesën e ndërmarrjeve të biznesit dhe për rritjen e efijencës.

Eksperiencia e vendeve OECD (Organisation for Economic Co-operation and Development) tregon se nevoja për trajnim gjatë punës për punonjësit publik ka qenë e neglizhuar për një kohë të gjatë. Vetëm në fund të viteve 60, qeveritë filluan të zbulojnë nevojën për këtë lloj trajnimi.

Kjo qe koha kur reforma e administratës publike ishte në axhendat e tyre dhe filluan të zbatoheshin teknika të reja të manaxhimit në shërbimin publik, si sistemet e buxhetit, metodat e planifikimit dhe ato të organizimit.

Duke konsideruar rolin vendimtar të trajnimit në realizimin e reformave administrative publike në shumicën e vendeve të OCED, e drejta dhe detyrimi i nëpunësve civil për tu trajnuar është përcaktuar në kushtetutë dhe trajnimi është rregulluar ose nëpërmjet ligjit të shërbimit civil ose nëpërmjet akteve nënligjore.

Trajnimi në shërbimin publik në këto vende ka synuar dy objektiva të përgjithshme:

- ✓ Mbështetjen e zbatimit të reformës në shërbimin civil dhe administratën publike
- ✓ Përmirësimin e aftësive dhe kualifikimit profesional të stafit për të rritur efijencën e shërbimit publik.

2.5. Kush është përgjegjës për trajnimin

Trajnimi ashtu si dhe të gjitha aktivitetet e tjera të personelit është përgjegjësi jo vetëm e specialistëve të menaxhimit të resurseve humane por edhe e drejtuesve dhe e vetëpunonjësve. Pa mbështetjen dhe angazhimin e menaxhimit (drejtuesve) të nivelit të lartë, ndërmarrjet mund të mos u kushtojnë vëmendjen e duhur aktiviteve të trajnimit. Kjo është e vërtetë, sidomos në rastet kur ndërmarrjet kanë objektiva afatshkurta dhe dëshirojnë rezultate të menjëhershme. Në këto raste ato nuk kanë shumë kohë për të pritur përfitimet nga trajnimi.

Shumë varet nga drejtuesit dhe eprorët e drejtpërdrejtë të punonjësit që do të trajnohet, përderisa janë ata të cilët vlerësojnë edhe kërkesat për periudhën aktuale edhe ato për një periudhë të mëvonshme për stafin që ata manaxhojnë. Lidhja e trajnimit me performancën e kërkuar të njësisë të institucionit apo të projektit për të cilën ata janë përgjegjës është padyshim një avantazh.

Efektiviteti i një sistemi trajnimi kërkon gjithashtu edhe mbështetjen dhe kooperimin e të gjithë punonjësve. Vetëm mbështetja e menaxhimit nuk është e mjaftueshme.

Individi (nëpunësi) është i pozicionuar mirë në identifikimin e pikave të forta dhe të dobta të tij, dhe të nevojave të tij për zhvillim në lidhje me realitetin dhe kërkesat e punës. Në disa rethana individi mundet edhe të investojë për procesin e trajnimit. Kur ndërmarrja fillon të përqafojë një filozofi të mësimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm, është e domosdoshme një pjesëmarrje më aktive e të gjithë personave të interesuar në projektimin dhe zbatimin e sistemit të trajnimit në ndërmarrje.

2.6. Llojet e trajnimit të vazhdueshëm

Trajnim profesional fillestar (kontratë mësimi apo kualifikimi) - Kjo ka të bëjë me zhvillimin e tranimit në formën e një stazhi mësimor në institucion. Praktika e vendeve të tjera tregon që ky lloj trajnimi ka filluar të interesojë dhe kuadrot e ardhshëm.

Trajnim adoptimi (në periudhën e provës) - Ky mund të jetë trajnim plotësues për të rinjtë që nuk kanë ekperiencë profesionale. Ky gjithashtu mund tu shërbejë edhe punonjësve të rinj pavarsisht nga ekperiencia e tyre e mëparshme, me një objektiv orientimi.

Rifreskim i njohurive për njohuritë që nuk përdoren dhe janë vjetëruar.

Aktualizim i njohurive - Trajnim për zhvillimin e njohurive profesionale

Trajnim plotësues - Në fushat e afërta për të lehtësuar aftësinë për të marrë përsipër aktivitete të cilat deri tani i realizonte një specialist i një fushe tjetër.

Trajnim evoluimi - Trajnim për zhvilimin e karrierës, për të autorizuar apo shoqëruar një promovim. Një promovim do të thotë një ndryshim i pozicionit të punës; detyrat që duhet të kryen nga punonjësi nuk do të jenë më po ato, pra edhe njohuritë, aftësitë dhe zotësitë nuk janë më po ato.

2.7. Procesi i trajnimit

Puna për hartimin e programeve të trajnimit kërkon përgjigjen e pyetjeve të tilla si:

- Si do të evidentohen nevojat për trajnim,
- Çfarë mundësish paraqiten lidhur me nevojat për trajnim,
- Si të harmonizohet trajnimi me dimensionet e tjera të menaxhimit të burimeve njerëzore për institucionin,
- Cilët janë faktorët të cilët pengojnë dhe lehtësojnë investimet në trajnim që të plotësojnë objektivat e dëshiruara.

Në përputhje me hapat e procesit të trajnimit ka një konsensus që menaxhimi i programeve të trajnimit përfshin disa etapa, të cilat mund të dallohen si më poshtë:

- Përcaktimi i nevojave për trajnim,
- Hartimi i programit të trajnimit,
- Planifikim i aktiviteteve të trajnimit,
- Realizimi,
- Vlerësimi i trajnimit.

- Fillohet me analizën e nevojave për trajnim nëpërmjet të cilës bëhet mbledhja dhe organizimi i të dhënave, në bazë të të cilave vendoset nëse është i nevojshëm apo jo përpunimi i një programi formimi,

✓ Në bazë të të dhënave të mbledhura nga faza e parë konceptohet programi i formimit: përcaktohen objektivat dhe përmbajtja e tij,

✓ Më pas bëhet planifikimi i programit të formimit: parashikimi i resurseve humane dhe materialeve të nevojshme për realizimin e aktiviteteve që u korrespondojnë objektiveve të aprovuar të formimit,

✓ Pas realizimit të aktivitetit të trajnimit duhet të bëhet vlerësimi i programit të formimit, Ky realizohet nëpërmjet një tërësie aktivitetsh që lejojnë t'i caktohet një vlerë programit të trajnimit ose një apo shumë përbërësve të tij. Përcaktimi i kësaj vlere ndihmon drejtuesit, formuesit, klientët të marrin një vendim kundrejt programit të trajnimit: të modifikohet apo të pezullohet ai.

“Një vlerësim i duhur i nevojave për trajnim duhet të konvergjojë me drejtimin e ndryshimit organizativ, karrierën që ndjekin ose mundt të ndjekin punonjësit dhe ndryshimet teknologjike që ndodhin”.

“Analiza e nevojave për trainim duhet të jetë pjesë e analizës së problemit, që është e rëndësishme për menaxhimin e cilësisë, dhe që përcakton nëse trainimi do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë, apo duhen kërkuar zgjidhje të tjera më pas”.

2.7.1. Përcaktimi i nevojave për trajnim

Në këtë etapë të parë bëhet mbledhja dhe organizimi i të dhënave, në bazë të të cilave vendoset nëse është i nevojshëm apo jo përpunimi i një programi trajnimi pra ky është hapi që siguron bazimin në parimin themelor që: trajnimi duhet të bazohet mbi atë çfarë kërkon institucioni dhe çfarë kërkojnë punonjësit dhe jo çfarë ofron një projekt apo një institucion i vaçantë i nteresar.

Eksperiencat e deritanishme të trajnimit kanë treguar se nganjëherë punonjësit marrin trajnim jo se u nevojitet, por për arsye të tjera. Për shembull, në disa ndërmarrje, një program trajnimi shërben si një shpërblim për performancën e kaluar të punonjësit.

Trajnimi duhet të ofrohet në bazë të nevojave. Pa përcaktuar nevojat për trajnim, një ndërmarrje nuk mund të jetë e garantuar që do të hartohet një program i përshtatshëm trajnimi për njerëzit të cilët kanë me të vërtetë nevojë për të.

Nevojat për trajnim mund të përcaktohen si kërkesa specifike të lidhura me përgatitjen profesionale të individëve që kanë të bëjnë jo vetëm atë që individët bëjnë (aktivitetin e tyre), por edhe atë që mendohet të bëjnë (planet dhe projektet e tyre) dhe si do ta bëjnë (modeli i tyre kulturor), duke iu referuar gjendjes së veçantë të marrdhënies së tyre me ndërmarrjen.

Në rastin tonë nevoja për trajnimin e stafit të shërbimeve doganore është e obliguar, si për punonjësit e rinjë ashtu edhe për të gjithë punonjësit tjerë gjatë tërë kohës, sa herë të paraqitet nevoja për njohuri të reja.

Përfundim

Trajnimi dhe zhvillimi ashtu si dhe të gjitha aktivitetet e tjera të personelit janë përgjegjësi jo vetëm e specialistëve të Menaxhimit të resurseve humane por edhe e drejtuesve dhe e vetë punonjësve. Pa mbështetjen dhe angazhimin e

menaxhimit (drejtuesve) të nivelit të lartë, ndërmarrjet mund të mos u kushtojnë vëmendjen e duhur aktiviteteve të trajnimit.

Për të treguar vlerën e trajnimit dhe zhvillimit ka vështirësi. Janë bërë përpjekje për të vlerësuar kosto-përfitime të aktiviteteve të trajnimit, por analizat lidhur me këtë proces janë shumë të sofistikuar. Prandaj dhe aktivitetet e vlerësimit të trajnimit janë shpesh të neglizhuara.

Trajnimi duhet të ofrohet në bazë të nevojave. Pa përcaktuar nevojat për trajnim, një ndërmarrje nuk mund të jetë e garantuar që do të hartohet një program i përshtatshëm trajnimit për njerëzit të cilët kanë me të vërtetë nevojë për të.

Referencat

1. Dr. Sc. Enver A. Kutllovci “Menaxhimi i resurseve humane”, Prishtinë 2004.
2. Dr. Ymer Havolli “Menaxhmenti i resurseve njerëzore”, Riinvest: Prishtinë, 2003.
3. Mr. Sc. Theranda Beqiri “Menaxhimi i burimeve njerëzore”, Prishtinë, 2005.
4. Enno Bozdo “Menaxhimi i burimeve njerëzore”, Instituti i trajnimit të administratës publike. VITI I BOTIMIT??
5. Sjellja organizative, Toena.
6. Shërbimi Doganor – Pejë.

Globalizimi financiar në vendet në zhvillim (çështja e valutës) – rasti i Kosovës

Zijad Krasniqi
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Republika e Kosovës;
zjadkrasniqi@gmail.com

Abstrakt

Ky studim analizon përfitimet dhe sfidat me të cilat është përballur ekonomia e Kosovës. Në përgjithësi studimi vlerësoi se valuta e re e përdorur në Kosovë ishte e dobishme në sjelljen e stabilitetit makroekonomik dhe financiar dhe zgjidhjen e problemit të besimit në monedhën.

Termi globalizim financiar i referohet procesit ku tregjet financiare në vendet e ndryshme të botës janë të integruara si një. Globalizimi financiar kërkon futjen e një monedhe të vetme në gjithë botën, të menaxhuar dhe të rregulluar nga një autoritet i vetëm monetar ndërkombëtar.

Kosova ka një sistem financiar në rritje. Procesi i liberalizimit dhe derregullimit filloi në vitin 1999. Që nga fundi i vitit 1999 Kosova është një ekonomi e hapur financiarisht me një monedhë të konvertueshme të plotë. Në kushtet e flukseve të kapitalit, ajo është shumë më e hapur se sa shumë vende evropiane.

Monedha ishte projektuar edhe për të siguruar një mbështetje kritike për një strategji të jashtme të orientuar drejtë zhvillimit, e cila ishte një domosdoshmëri, më shumë se një zgjedhje, duke pasur parasysh madhësinë e tregut të brendshëm. Ky punim shqyrton një dimension të rëndësishëm të globalizimit financiar në Kosovë: të monedhës (konvertimit nga DEM në EURO).

Fjalët kyqe: Globalizimi, Monedha, Banka Qendrore e Kosovës, Derregullimi

Hyrje

Miratimi i një monedhe të huaj të qëndrueshme ka qenë i nxitur nga gatishmëria e vendeve të cilat janë të destinuara për arritjen e stabilitetit makroekonomik nëpërmjet inflacionit të ulët dhe besueshmërisë së lartë.²⁴⁶

Marka Gjermane u adoptua në mënyrë të njëanshme, si një monedhë e ligjshme de facto në Kosovë, dhe nuk pati ndonjë negociatë me Bundesbankën Gjermane apo Bankën Qendrore

Evropiane në atë kohë. Adoptimi i markës gjermane dhe më pas adoptimi i euros, nuk ishte i rastësishëm. Ajo pasonte dy dekada të paqëndrueshmërisë ekstreme monetare, shoqëruar me një shkallë të lartë të përdorimit jozyrtar të markës gjermane si një rezervë vlerashdhe mjet shkëmbimi. Në periudhën e parakonfliktit, marka gjermane ishte valuta më e përdorur; kishte shuma të konsiderueshme të parave të gatshme në qarkullim. Popullsia ishte e familjarizuar me këtë monedhë. Në kohën kur Kombet e Bashkuara morën administrimin e

Kosovës, adoptimi i strukturës monetare bazuar në përdorimin e markës gjermane u paraqit si një zgjedhje e natyrshme. Përdorimi i një monedhe të qëndrueshme ishte i rëndësishëm në mirëmbajtjen e një stabiliteti makroekonomik dhe luante një rol vendimtar në rindërtimin e besimit të njerëzve në sektorin financiar.

Mbështetja për zhvillimin e sektorit financiar

Eurozimi mbështeti zhvillimin e sektorit financiar të Kosovës, i cili duhej të krijohet nga fillimi pas konfliktit. Në fillim, në Kosovë nuk kishte banka dhe praktikisht të gjitha transaksionet bëheshin në para të gatshme. Në fakt, për gati dy vite, në Kosovë nuk kishte sektor financiar dhe entiteti i vetëm financiar, Micro Enterprise Bank (MEB), ishte i specializuar në mikrokredi. Megjithatë, dy vitet e ardhshme dëshmuar një zhvillim të vrullshëm të ndërmjetësisimit financiar në Kosovë, veçanërisht atë të sektorit bankar. Midis marsit

²⁴⁶ Backé, P. and Wójcik, C., “Unilateral Euroisation: A Suitable Road Towards Joining the Euro Area For Central and Eastern European EU Accession Countries?”, 03 Sep 2015, Research Gate network for scientists and researchers, (accessed 01 April 2016)

dhe nëntorit 2001, u themeluan gjashtë banka, të cilat sollën një konkurrencë aq të nevojshme në këtë sektor.

Në vitet 2002 dhe 2003, shtatë bankat tregtare të Kosovës u zgjeruan në mënyrë domethënëse. Duke pasur parasysh përmasat e vogla të ekonomisë dhe popullsisë së Kosovës, dhe përvojat negative me bankat në të kaluarën, sistemi financiar i Kosovës karakterizohet nga një pjesëmarrje e fuqishme e entiteteve të huaja. Bankat evropiane tregtare, së bashku me agjencitë e zhvillimit dhe institucione të tjera financiare, janë bërë aksionerët kryesorë të dy bankave më të mëdha të Kosovës. Banka Amerikane e Kosovës u krijua me pjesëmarrje kapitali nga USAID në nëntor 2001, dhe iu shit në fillim të vitit 2003 të bankës “Raiffeisen”. MEB u emërtua ProCredit Bank në gusht të vitit 2003. Pesë bankat e tjera kanë sipërmarrës vendas si aksionerët e tyre kryesorë.

Eurozimi

Hedhja në qarkullim e euros përfundoi me sukses më 28 shkurt 2002. Kështu, nga ky moment, ekonomia e Kosovës është “euroizuar” tërësisht dhe në mënyrë të efektshme. Eurozimi shpesh përkufizohet si adoptimi i Euros si monedhë ligjore dhe monedhë zyrtare nga autoritetet e një vendi jashtë Zonës Euro²⁴⁷. Ky përkufizim nënkupton gjithashtu, që autoritetet vendosën që të refuzonin instrumentet e politikave të tyre monetare dhe të braktisnin monedhën e tyre kombëtare. Duhet të theksoj sërish se rrethanat e Kosovës paskonfliktit ishin, dhe ende janë, disi specifike, politikisht dhe ekonomikisht. Duke marrë parasysh përdorimin e gjerë jozyrtar të markës gjermane dhe rolin e saj, i cili është shumë i madh, sa ndryshe mund të quhet thjesht një monedhë paralele, UNMIK-u e pranoi këtë zgjedhje si një “fait accompli” (fakt i kryer).

Stabiliteti monetar si pasojë e globalizimit

²⁴⁷ <https://www.ecb.europa.eu/mopo/eaec/html/index.en.html>

Në kohën kur Kosova zgjodhi eurozimin, inflacioni vjetor ishte mbi 40 për qind. Monedha e saj zyrtare (dinari) u zhvlerësua tërësisht dhe përdorimi i saj ishte pothuajse joekzistues. UNMIK-u nuk po zëvendësonte thjesht një monedhë kombëtare të zhvlerësuar, por gjithashtu po vendoste në Kosovë një themel monetar të shëndoshë të nevojshëm për rindërtimin ekonomik, shoqëror dhe politik në vitet që do të pasonin.

Adoptimi i euros si një monedhë kombëtare solli gjithashtu, stabilitet monetar në Kosovë. Rreziku i zhvlerësimit të monedhës kombëtare u zhduk. BPK-ja, e cila vepron si një agjent fiskal për administratën lokale, nuk ndërmerr rrezik këmbimi, ndërsa administron rezervat zyrtare. Këto rezerva investohen kryesisht brenda vendeve të Zonës Euro, në banka qendrore dhe në institucione financiare me norma të larta. Ekonomia e Kosovës nuk përballon rreziqe këmbimi

domethënëse. Në të njëjtën mënyrë, euroizimi ka penguar që në Kosovë të ketë normë të dyfishtë këmbimi të monedhës, ligjore dhe informale²⁴⁸. Kjo në fakt duhet të çojë në një kosto më të ulët të huamarrjeve dhe në rritjen e investimeve, në nxitjen e rritjes ekonomike dhe të mirëqenies²⁴⁹.

Stabiliteti makroekonomik

Euroizimi në Kosovë kishte gjithashtu disa objektiva politike afatgjatë. Nga shumë kjo konsiderohet si “i pakthyeshem”. Euroizimi në Kosovë pritet që të kujdeset për stabilitetin ekonomik, të zgjidhë problemin e besueshmërisë, por kryesisht të rrisë disiplinën fiskale duke eliminuar mundësinë e riprodhimit të parave për të mbuluar deficitet fiskale. Pas një periudhe më të gjatë kohore, kur të plotësohen kushtet e tjera gjithashtu, kjo duhet të çojë në rritjen e investimeve të huaja direkte.

Në përfundim, nëse euroizimi nuk i ka zgjidhur të gjitha problemet financiare në Kosovë, dhe nëse euroizimi ka sjellë kufizime në drejtimin e një politike të

²⁴⁸ Kadrijaj Dushu, A. and Merovci, S., “The Effects of Exchange Rate Market in the Economy of Kosova”, Acta Universitatis Danubius. (Economica, Vol 10, No 4, 2014, pp. 5-18

²⁴⁹ http://bqk-kos.org/repository/docs/2010/CBK_WP_no.2.pdf

pavarur monetare, përparësitë e tij pa dyshim janë pozitive, kryesisht sepse përdorimi i euros ka ndikuar në stabilitetin e sektorit financiar.

Përfundime

Miratimi i euros në Kosovë ka qenë shumë i dobishëm në sjelljen e stabilitetit makroekonomik, duke pasur parasysh fazën në zhvillim në të cilën Kosova ishte. Përvojat inflacioniste shoqëruar me rënien e sistemi financiar në ish-Jugosllavi gjatë viteve të 90-ta kanë shkatërruar besimin në monedhën vendase dhe si rezultat, çoi në shkallë të lartë të zëvendësimit të monedhës në Kosovë.

Euro ka sjellë një stabilitet shumë të nevojshëm monetar për uljen e inflacionit, duke eliminuar rrezikun e kursit të këmbimit, ndikoi në uljen e kostove të transaksionit dhe promovimin e tregtisë ndërkombëtare dhe investimeve të huaja direkte. Kosova është në një situatë të avancuar në krahasim me ekonomitë e vogla të hapura të cilat përballën me efektet përçarëse të qarkullimit të monedhës së dyfishtë, dhe konkurrencës së pabalancuar midis një monedhe kombëtare dhe një monedhe fortë të huaj.

Referencat

1. Backé, P. and Wójcik, C., “Unilateral Euroisation: A Suitable Road Towards Joining the Euro Area For Central and Eastern European EU Accession Countries?”, 03 Sep 2015, ResearchGate network for scientists and researchers, (accessed 01 April 2016)
2. http://bqk-kos.org/repository/docs/2010/CBK_WP_no.2.pdf, (accessed 03 April 2016)
3. Kadrijaj Dushu, A. and Merovci, S., “The Effects of Exchange Rate Market in the Economy of Kosova”, Acta Universitatis Danubius. (Economica, Vol 10, No 4, 2014, pp. 5-18)
4. <http://news.bbc.co.uk/2/hi/business/437844.stm> , 03 Sep 1999, (accessed 10 April 2016)
5. Stiglitz, J., ‘Globalization and growth in emerging markets’, Journal of Policy Modeling, Vol 26, 2004, pp 465-484
- 6.

7. Czinkota, M., Ronkainen,I., Moffet,M., ‘Biznesi ndërkombëtar’, Tiranë, 2010
8. <https://www.ecb.europa.eu/mopo/eaec/html/index.en.html> , (accesed 10 Aprill 2016)

Misioni i EULEX-it në Kosovë

Ardit Berisha ,

Universiteti “Haxhi Zeka “ , Pejë- Kosovë,ardit_gervalla@outlook.com

Abstrakt

Kosova e pasluftës është përballur më një sistem të brishtë të sundimit të ligjit , më një kaos në vete më doganat poashtu edhe policinë, pastaj duke vazhduar më korrupsion të lartë, krim të organizuar ,krime të luftës e edhe më ndërhyrje politike në sistemet gjyqësore . Ky mision i bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë u vendos në vitin 2008 dhe që përfaqëson misionin më të madh të politikës së përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes të bashkimit evropian . Synimi Eulexit ishte që të luftonte problemet ekzistuese në fushën e ligjit në Kosovë ,duke përfshirë këtu mungesën e kapacitetëve ,ndikimin politik ,korrupsion ,krimin e organizuar ,krimet e luftës dhe në vecanti mungesën e sundimit të ligjit në veriun e shtetit të ri. Ky mision ka qenë dhe është një nga misionet më të kritikuar . Kritikata kanë ardhur nga ish-punonjësit e EULEX-it ,Parlamenti Evropian dhe nga Gjykata Evropiane e Auditorëve , si dhe nga organizatat tjera ndërkombëtare në Kosovë sikurse KFOR-i . Metodatat shkencore, që janë aplikuar gjatë hartimit të këtij punimi janë të përcaktuara nga vetë qëllimi i hulumtimit . Gjatë hartimit të këtij punimi është shfrytëzuar literatura shkencore e një spektri të gjerë që ka të bëjë më fushën e këtij punimi. Po ashtu, janë shfrytëzuar edhe studimet e instituteve kërkimore-shkencore, raportet vjetore të institucioneve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare si dhe të dhënat e publikuara në internet.Misioni i EULEX-it gjithashtu ka rolin edhe të monitorimit,mentorimit dhe këshillimit ,ndërsa ruan edhe disa përgjësi ekzekutive . EULEX-i përkrahet nga 28 shtete anëtare të bashkimit Evropian dhe pesë vende tjera kontribuuese (Kanada,Norvegji ,Zvicra ,Turqia,dhe SHBA), mandati i saj në Kosovë është deri më 14 qërshor 2018 .

Fjalët kyqe:Kosova ,Eulexi ,Misioni ,Mandati .

Hyrje

Ky mision i bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë u vendos në vitin 2008 dhe që përfaqëson misionin më të madh të politikës së përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes të bashkimit evropian . Synimi Eulexit ishte që të luftonte problemet ekzistuese në fushën e ligjit në Kosovë ,duke përfshirë këtu mungesën e kapacitetëve ,ndikimin politik ,korrupsion ,krimin e organizuar ,krimet e luftës dhe në vecanti mungesën e sundimit të ligjit në veriun e shtetit të ri. Ky mision ka qenë dhe është një nga misionet më të kritikuar . Kritikant kanë ardhur nga ish-punonjësit e EULEX-it ,Parlamenti Evropian dhe nga Gjykata Evropiane e Auditorëve , si dhe nga organizatat tjera ndërkombëtare në Kosovë sikurse KFOR-i. Misioni i EULEX-it gjithashtu ka rolin edhe të monitorimit,mentorimit dhe këshillimit ,ndërsa ruan edhe disa përgjësi ekzekutive . EULEX-i përkrahet nga 28 shtete anëtare të bashkimit Evropian dhe pesë vende tjera kontribuese (Kanada,Norvegji ,Zvicra ,Turqia,dhe SHBA), mandati i saj në Kosovë është deri më 14 qërshor 2018.

Qëllimet dhe objektivat e studimit tonë

- Të japim një studim të mirëfilltë rreth punës së këtij misioni që studiuesit e rinjë të marrin si referencë në punimet e ardhshme të tyre
- Pjesëmarrësit të njoftohen me shumë me sfidat që ka kaluar ky mision dhe punën që ka berë në fuqizimin e sundimin e ligjit në Kosovë
- Të sjellim para pjesëmarrëseve një analizë rreth impaktit që ka pasur ky mision në përmisimin e jetës dhe sigurisë së qytetarëve të Kosovës .
- Të japim rekomandimet e nevojshme për përmisimin e çasjes së ketij misioni ndaj strategjive për siguri publike dhe në forcimin e sistemit doganor .

Metodologjia e punimit shkencore

Në këtë punim shkencore ne kemi aplikuar të dhenat primare dhe sekondare , më të dhenat primare ne kemi aplikuar raporte të nxjerra nga organet ndërkombëtare për monitorimin e punës së EULEX-it dhe raportet e raportuesve për ballkanin përendimor , tek të dhenat sekondare ne kemi aplikuar forma të

ngjajshme të studimeve që kanë të njëjtën tematike më studimin tonë të nxjerra nga revistat shkencore ndërkombëtare dhe kombëtare . Ne kemi aplikuar edhe literaturë që ka të bëjë me vetë qëllimin e punimit tonë që vjen nga studiuesit e këtij misioni.

1.0 VENDOSJA E SUNDIMIT TË LIGJIT NË KOSOVË

1.1

Kosova përballet me sfida të jashtëzakonshme në fushën e sundimit të ligjit, dhe duke e bërë këtë të lirë nga ndikimi politik. Institucionet e saj të sundimit të ligjit u shuan plotësisht në luftën e viteve 1998-1999. Në përgjithësi, zyrtarët e sundimit të ligjit duhet të jenë të lirë nga ndikimi politik në një shoqëri të thurur ngushtë dhe me konflikte të shpeshta të interesit. Zyrtarët kosovarë shpesh perceptohen si të korruptuar duke ushqyer kështu pritjet e ulëta të popullatës vendore. Institucionet e dobëta lejojnë që të lulëzojë krimi i organizuar. Krimet e luftës shkaktojnë probleme politike, por duhet të adresohen për t'i dhënë fund mosndëshkimit dhe paqartësisë. Në fund, Prishtina nuk mund të rregullojë komunitetet serbe të pabindura në veri, duke krijuar një hapësirë të pasiguruar. Ky kapitull do të mbulojë se si këto vështirësi dëmtojnë sundimin e ligjit në Kosovë.

1.1 Kapacitetet

Rënia e institucioneve të sundimit të ligjit në Kosovë ishte e pashmangshme. Regjimi i Milosheviçit i mbante shqiptarët e Kosovës jashtë policisë dhe gjyqësorit. Shumica e zyrtarëve të sundimit të ligjit vinin nga grupet minoritare dhe ikën nga Kosova gjatë luftës, duke lënë pak policë, prokurorë apo gjykatës. Misioni i OKB-së në Kosovë (UNMIK) nuk e zgjidhi problemin. Gjersa UNMIK-u tentoi të integronte shqiptarët e Kosovës në gjyqësor duke përdorur panele hibride ndërkombëtare-vendore me shqiptarët e Kosovës si shumicë, sistemi degradoi pasi që shqiptarët e Kosovës i mbivotonin homologët e tyre ndërkombëtarë, duke marrë shpesh vendime të dyshimta në rastet kur përfshiheshin minoritetet etnike. UNMIK-u reagoi duke i ndryshuar panelet hibride, ku shumica përbëhej nga ndërkombëtarët dhe duke ju lejuar vendorëve që të apelonin tek UNMIK-u për të caktuar gjykatës ndërkombëtarë dhe prokurorë ndërkombëtarë për një rast. Zyrtarët vendorë i kalonin rastet e rrezikshme tek gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë. Zyrtarët e UNMIK-ut, kështu, kalonin pak kohë me homologët e tyre kosovare dhe edhe më pak kohë për trajnimin dhe këshillimin e tyre. Aftësitë në polici stagnuan nën UNMIK-un. Pasi arritën një nivel bazik të sigurisë, trajnimet për Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK) u bënë sporadike. Matjet e llogaridhënies u përdorën rrallë në institucionet e sundimit të ligjit dhe kur ato bëheshin, vlerësimet që rezultojnë

nuk përdoreshin për të përmirësuar efikasitetin. Doganat ishin e vetmja gjë e ndritur ku UNMIK-u vendosi autoritetin e vet dhe ishte në gjendje që të ndërtojë ca kapacitete vendore. Pavarësia dhe gjashtë vitet pasuese kristalizuan këto dështime. Aftësitë ekzistuese në gjyqësor u bënë të pavlefshme me një sistem të ri që zhvendoste institucionet e Kosovës nga një sistem organizimi në tjetrin. Ndryshimi detyroi gjykatësit dhe juristët të ri-trajnohen. Dispozitat ligjore të Kosovës, që kanë pësuar disa herë ndryshime madhore, e ka bërë trajnimin më të vështirë pasi që prokurorët dhe gjykatësit duhet të përcjellin një sistem ligjor që vazhdimisht pëson ndryshime fundamentale. Sa i përket policisë, SHPK nuk ishte e përgatitur për të trajtuar krimet serioze dhe vazhdon të ketë vështirësi. Kjo mungesë e trajnimit la një gjyqësor me një besim të ulët dhe një forcë policore pa trajnimin dhe resurset për të sulmuar diçka më të vështirë se krimi i nivelit të ulët. Qeveria e Kosovës e përkeqësoi problemin duke mos i plotësuar pozitat në gjyqësor, duke ju dhënë gjykatësve dhe prokurorëve pak të trajnuar një sasi shumë të madhe të punëve. Gjersa në institucionet gjegjëse shpesh ka mungesë të kandidatëve të kualifikuar, shpeshherë refuzohen të kualifikuarit për arsye politike. Gjyqësori dhe policia nuk kanë personel të mjaftueshëm apo të trajnuar për të trajtuar çështjet tjera të sundimit të ligjit në Kosovë.

1.2 Ndikimi politik

Përtej kapaciteteve, institucionet për sundimin e ligjit të Kosovës vuajnë nga ndikimi politik i spikatur. Avokatët mbrojtës rregullisht rrjedhin materiale gjyqësore tek media për t'i bërë presion gjyqësorit. Gjykatësve dhe prokurorëve u mungon sigurimi adekuat, duke i bërë të cenueshëm ndaj frikësimit. Gjykatësit ofrojnë qasje pa kufizim palëve gjatë orarit të punës, duke ju lejuar individëve të bëjnë apele emocionale apo politike që ndikojnë në procedurën gjyqësore të tyre. Zyrtarët qeveritarë vënë në dyshim paanshmërinë e gjykatave në media, nuk zbatojnë vendimet dhe debatojnë vendimet gjyqësore duke vënë në siklet gjykatësit. Mungesa e fshehtësisë, kërcënimet, apelet personale dhe kritikrat publike shkaktojnë që gjykatësit dhe prokurorët të veprojnë në bazë të shqetësimeve politike, dhe jo atyre ligjore. Nxitjet për t'i rezistuar presionit janë të ulëta. Gjykatësit dhe prokurorët nuk u përballen me standardet etike dhe nuk u lejuan që të marrin pronësinë e sundimit të ligjit në Kosovë në kohën e UNMIK-ut, duke mos lënë motiv për të vendosur pavarësinë e gjyqësorit. Institucionet pas pavarësisë bënë pak për t'i liruar gjykatësit dhe prokurorët nga ndikimi politik. Rregullat për caktimin e rasteve nuk ekzistojnë dhe nuk ka sistem për të caktuar automatikisht rastet tek prokurorët dhe gjykatësit. Konflikti i interesit vazhdon i pavërejtur. Zbrazëtirat procedurale parandalojnë

zgjidhjet e rasteve të ndjeshme. Prokurorët nuk parashtrojnë aktakuza ndaj të pandehurve me ndikim; gjykatësit shpeshherë vonojnë seancat dëgjimore me muaj; poashtu ka raste kur gjykatësit dhe avokatët deklarohen të sëmurë për periudha të gjata. Prokurorët dhe gjykatësit që kanë kryer shkelje etike rrallë disiplinohen dhe pothuajse asnjëherë nuk shkarkohen. Kur presioni politik është kaq i lartë dhe kosto e dorëzimit kaq e ulët, ndikimi politik deformon sundimin e ligjit.

1.3 Korrupsioni

Duke u vendosur në vendin 33 nga 100 sish, Kosova është më afër Uzbekistanit (17) despotik të korruptuar se modelit të Estonisë (68) në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International. Shpërdorimi i pozitës zyrtare është forma më e zakonshme e korrupsionit, edhe pse ryshfeti dhe përvetësimi ndodh gjithashtu. Besim që qeveria apo gjyqësori do të luftojnë korrupsionin është i ulët. Institucionet vërtetojnë këtë cinizëm me pak hetime pavarësisht indikacioneve për korrupsion të gjerë sikurse profesionet e shumta të deputetëve të Kuvendit dhe mospërputhjes në mes të hyrave të raportuara të politikanëve dhe pasurive të tyre të shtrenjta. Presioni politik pengon gjykatësit dhe prokurorët vendorë për të vepruar mbi rastet e korrupsionit, të cilat, në vend të kësaj, përcillen tek prokurorët dhe gjykatësit ndërkombëtarë, qofshin ata të UNMIK-ut para pavarësisë apo EULEX-it pas saj. Përtej hezitimit të institucioneve për të luftuar korrupsionin, përpjekjet kundër korrupsionit në Kosovë luftojnë dy forca sistematike që inkurajojnë korrupsionin. Së pari, pritjet e ulëta nga institucionet mundësojnë mungesën e llogaridhënies. Pasi që qytetarët pranojnë shpesh ekzistimin e korrupsionit zyrtar, ata nuk i besojnë zyrtarëve qeveritarë që të luftojnë atë në mënyrë të besueshme. Kur programet kundër korrupsionit arrijnë pritje të ulëta, qytetarët pranojnë rezultatet. Së dyti, korrupsioni i përhapur krijon më shumë korrupsion. Zyrtarët arsyetojnë korrupsionin pasi që homologët përfshihen në të dhe vuajnë pak pasoja. Kultura e korrupsionit riprodhon veten.

1.4 Krimi i organizuar

Ndërmarrjet e krimit të organizuar janë shume aktive në Kosovë. Me rënien e sundimit të ligjit pas luftës gjatë viteve 1998-1999, mungesa e zbatimit të ligjit, dominimi i ekonomisë joformale dhe mungesa e mallrave nxiti konkurrencën në mes „organizatave“ kriminale për pjesë të tregut. Ato u ngulitën në Kosovë dhe UNMIK-u nuk ishte i suksesshëm në çrënjosjen e tyre. Pas pavarësisë, krimi i organizuar vazhdoi me ndërhyrje të pakta. Mungesa e sigurisë për dëshmitarët i bën ata caqe të lehta për frikësim. Të frikësuar për sigurinë e tyre, ekzistojnë

raste kur prokurorët dhe gjykatësit përfshihen në të njëjtat sjellje që shkaktohen nga ndikimi i padrejtë politik: pranimi i preferencave të jashtme, vonimi i rasteve dhe mosdeklarimi i konfliktit të interesit. Ata shpesh nuk ndjekin penalisht rastet e krimit të organizuar, ose duke i injoruar ato apo duke ju përcjellë gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë. Policia ka mungesa të dukshme për t'i koncentruar burimet për të luftuar krimin e organizuar. Ata gjithashtu shmangin hetimin e krimeve financiare dhe konfiskimin e pasurisë, gjë e cila është veçanërisht problematik pasi që mënyra më e lehtë e parandalimit të krimit të organizuar është të rritet rreziku u humbjeve financiare. Duke pasur parasysh pozitën e rrënjosur nga lufta, grupe të krimit të organizuar ende vazhdojnë të mbesin aktive në Kosovë, duke marrë parasysh institucionet „e frikësuar“ të sundimit të ligjit që i lejojnë ato të vazhdojnë. Mosmarrëveshjet brenda dhe jashtë Kosovës e bëjnë problemin e krimit të organizuar më akut. Jashtë Kosovës, mosmarrëveshjet rreth statusit pengojnë shkëmbimin e informacionit me institucionet e Kosovës. Kosova duhet të luftojë një problem e vetmuar, për të cilin shumë shtete i bashkojnë resurset. Brenda Kosovës, institucionet rrallë bashkëpunojnë, duke penguar zyrtarët të cilët luftojnë krimin e organizuar. Për shembull, gjersa prokurorët dhe zyrtarët epolicisë duhet të bashkëpunojnë për të hetuar krimin e organizuar, ata nuk përdorin një sistem të përbashkët për numrin e referencës së rastit, që do të thotë se ata ka të ngjarë që nuk kanë njohuri për aktivitetet e njëri-tjetrit, duke parandaluar bashkërendimin.

1.5 Krimet e luftës

Krimet e luftës janë një problem veçanërisht i ndërlikuar në Kosovë. Lufta dhe mungesa e sundimit të ligjit lejoi një shfaqje të dhunës ndëretnike dhe brenda etnike. Gjatë kësaj kohe mijëra civilë u zhdukën apo u vranë. Për të parandaluar mosndëshkimin e kriminelëve të luftës, është e nevojshme të gjinden dhe të dënohen ata. Ndjenjat popullore, megjithatë, zmbrafsen nga hetimet. Ka pak mundësi për të hetuar dhe akuzuar ish forcat ushtarake dhe paraushtarake serbe të cilat kryen krime kundër njerëzimit gjatë dhe para vitit 1999, kurse ende shumica i reziston pohimeve individuale kundër ish-anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). UNMIK-u rriti vështirësinë e hetimeve duke hetuar shumë pak raste, shumica e të cilave ishin serb. Hendeku nëntë vjeçar në mbledhjen e provave e uli numrin e rasteve që mund të hetohen dhe gjykohen. Hetimet janë të nevojshme në këtë mënyrë për të parandaluar mosndëshkimin për krimet e luftës, por do të kenë pak rezultate për shkak të rezistencës popullore dhe provave të pakta.

1,6 Kontrolli i territorit

Ligji i Kosovës mungon gjerësisht në veri të vendit. Serbët vendorë të cilët jetojnë në tri komuna veriore të Kosovës vazhdojnë t'i rezistojnë integritet të sistemit ligjor të Kosovës. Me përjashtim të KFOR-it, forcat ndërkombëtare kanë pasur pak ndikim dhe sundimi i ligjit është në masë të madhe inekzistent. Sjellja jo-bashkëpunuese nga serbët e veriut të Kosovës dhe insinuatat e institucioneve të Serbisë në veri e mbanin UNMIK-un jashtë, por UNMIK-u pothuajse nuk protestonte këto veprime. Raportet e OKB-së pranojnë përfshirjen e Serbisë në veri, por duken komfore që të lejojnë autoritetin e Serbisë të përhapet. Ka gjasa që UNMIK-u ishte i kujdesshëm që të mos acaronte qeverinë e Serbisë, edhe pse rezistenca lokale dhe mungesa e përgjithshme e sigurisë në veri ishin gjithashtu faktorë. Në çdo rast, periudha e UNMIK-ut rezultoi që këto komuna veriore të ndaheshin nga Prishtina dhe lidhen më afër me Beogradin.

Këto lidhje nuk e kanë përmirësuar sundimin e ligjit në veri të Kosovës. Gjersa reputacioni i veriut si qendër e "mungesës së ligjit dhe konfliktit" është i ekzagjeruar, aty nuk ka institucione të besueshme të sundimit të ligjit. Popullata nuk i beson policisë; gjykatat penale praktikisht nuk ekzistojnë; dhe gjykatat civile janë fushëbeteja etnike. Krimi i organizuar ka kaluar nëpër një ngritje të vazhdueshme në veri pasi që kjo shihet si një zonë e parregulluar ku popullata nuk i pranon tarifën e vendosur nga Prishtina dhe gëzon trajtim preferencial nga Beogradi. Ndërmarrjet kriminale kështu veprojnë pa frikë nga ndjekja për evazion fiskal, trafikim apo aktivitete tjetër kriminale. Kontrabanda është e shfrenuar. Bandat kriminale bëjnë çmos për të frikësuar popullatën lokale, sidomos në veri të Mitrovicës, ku vetëm pak kanë guximin të dalin natën apo të bashkëpunojnë me Prishtinën. Serbët e Kosovës në veri kështu vuajnë nga mosbesimi dhe pasiguria e thellë, duke refuzuar institucionet e jashtme të sundimit të ligjit gjersa kanë pak burime të veta.

PËRFUNDIMI DHE REKOMANDIMET

Në këtë studim të tonë arritëm të konkludojmë se misioni i bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë u vendos në vitin 2008 dhe që përfaqëson misionin më të madh të politikës së përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes të bashkimit evropian. Synimi Eulexit ishte që të luftonte problemet ekzistuese në fushën e ligjit në Kosovë, duke përfshirë këtu mungesën e kapacitetëve, ndikimin politik, korrupsionin, krimin e organizuar, krimet e luftës dhe në

vecanti mungesën e sundimit të ligjit në veriun e shtetit të ri. Kosova përballet me sfida të jashtëzakonshme në fushën e sundimit të ligjit, dhe duke e bërë këtë të lirë nga ndikimi politik. Institucionet e saj të sundimit të ligjit u shuan plotësisht në luftën e viteve 1998-1999. Në përgjithësi, zyrtarët e sundimit të ligjit duhet të jenë të lirë nga ndikimi politik në një shoqëri të thurur ngushtë dhe me konflikte të shpeshta të interesit. Rënia e institucioneve të sundimit të ligjit në Kosovë ishte e pashmangshme. Regjimi i Milosheviçit i mbante shqiptarët e Kosovës jashtë policisë dhe gjyqësorit. Përtej kapaciteteve, institucionet për sundimin e ligjit të Kosovës vuajnë nga ndikimi politik i spikatur. Avokatët mbrojtës rregullisht rrjedhin materiale gjyqësore tek media për t'i bërë presion gjyqësorit. Gjykatësve dhe prokurorëve u mungon sigurimi adekuat, duke i bërë të cenueshëm ndaj frikësimit. Gjykatësit ofrojnë qasje pa kufizim palëve gjatë orarit të punës, duke ju lejuar individëve të bëjnë apele emocionale apo politike që ndikojnë në procedurën gjyqësore të tyre. Duke u vendosur në vendin 33 nga 100 sish, Kosova është më afër Uzbekistanit (17) despotik të korrumpuar se modelit të Estonisë (68) në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International. Shpërdorimi i pozitës zyrtare është forma më e zakonshme e korrupsionit, edhe pse ryshfeti dhe përvetësimi ndodh gjithashtu. Ndërmarrjet e krimit të organizuar janë shume aktive në Kosovë. Me rënien e sundimit të ligjit pas luftës gjatë viteve 1998-1999, mungesa e zbatimit të ligjit, dominimi i ekonomisë joformale dhe mungesa e mallrave nxiti konkurrencën në mes „organizatave“ kriminale për pjesë të tregut. Ato u ngulitën në Kosovë dhe UNMIK-u nuk ishte i suksesshëm në çrrënjosjen e tyre. Pas pavarësisë, krimi i organizuar vazhdoi me ndërhyrje të pakta. Ligji i Kosovës mungon gjerësisht në veri të vendit. Serbët vendorë të cilët jetojnë në tri komuna veriore të Kosovës vazhdojnë t'i rezistojnë integritet në sistemin ligjor të Kosovës. Me përjashtim të KFOR-it, forcat ndërkombëtare kanë pasur pak ndikim dhe sundim të ligjit është në masë të madhe inekzistent.

- Rirja e efikënqes së institucioneve të misionit të Bashkimit Evropian në raport me institucionet e Republikës së Kosovës .
- Reduktimin e ndikimit politik dhe krijimin e një mekanizmi brenda prokurorisë që do e kontrollonte rastet e përfshirjes në ndikime politike .
- Rritjen e efikasitetit në Agjensionin Kundërkorrupsion dhe fuqizimin e mekanizmave të tjerë indirekt që do të luftojnë korrupsionin në nivel qendror dhe atë lokal .

- Bashkëpunimi më efikasë në mes Misionit të Bashkimit European dhe autoriteteve Kosovare në luftimin e krimit të organizuar .
- Bashkëpunimi më efikasë në mes Misionit të Bashkimit European dhe Gjykatës Speciale në zbardhjen e rasteve nga krimet e luftës .
- Bashkëpunim më efikasë në mes Misionit të Bashkimit European dhe Autoriteteve Vendore në shtrirjen e sorvanitetit dhe kontrollin administrativ të Kufive , fuqizimin e sistemit doganor në gjithë territorin e Kosovës .

Referencat

- I. Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, "Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Administratën e Përkohshme në Kosovë," (12 korrik 1999), UN Doc S/1999/779, në dispozicion në:
<http://www.unmikonline.org/SGReports/S-1999-779.pdf>.
- II. Grupi Ndërkombëtar i Krizave, "Gjetja e barazisë: Nivelet e drejtësisë në Kosovë," (12 shtator 2002), Raporti për Ballkan nr. 134, në dispozicion në:
[http://www.crisisgroup.org/~media/2032.pdf](http://www.crisisgroup.org/~/media/2032.pdf)
Files/europe/Kosovë%2032.pdf.
- III. Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, "Rregullorja nr. 2000/64 mbi caktimin e gjykatësve / prokurorëve dhe / ose ndryshimin e vendit të gjykimit", (15 dhjetor 2000), UN Doc UNMIK/REG/2000/64, në dispozicion në: <http://www.unmikonline.org/regulations/2000/reg64-00.htm>.
- IV. Tom Perriello dhe Marieke Wierda, "Lessons from the deployment of international judges and prosecutors in Kosovo," Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale, (Mars 2006), f. 19, në dispozicion në:
http://ictj.org/sites/default/files/ICTJ-FormerYugoslavia-Courts-Study-2006-English_0.pdf.
- V. Eric Scheye, "UNMIK and the significance of effective program management: the case of Kosovo," në Security Sector Reform and UN Integrated Missions, editorë. H. Hänggi & V. Scherrer, (Gjenevë, Zvicër: DCAF, 2008), p. 181-182

Roli i NVM-ve në Zhvillimin e Ekonomisë Lokale në Kosovë

Msc. Blerim Morina (PhD Candidate)

Iniciativa për Ndërmarrësi dhe Zhvillim Ekonomik Lokal,

Prishtine – Kosovë,

Abstrakti:

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-t) janë duke u bërë gjithnjë e më të rëndësishme për krijimin dhe zhvillimin e një ekonomie moderne, dinamike dhe të bazuar në dije. Kjo është për shkak të kapacitetit të tyre për nxitjen e ndermarresisë dhe për shkak të aftësisë së tyre për të qenë fleksibël dhe të përshtaten shpejt në një treg që ndryshon, dhe për të gjeneruar vende të reja pune.

Spektori i NVM është shtylla kurrizore e ekonomisë në vendet me të ardhura më të larta, ndërsa ajo është më pak e zhvilluar në vendet me të ardhura të ulëta. Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) raporton se më shumë se 95% e ndërmarrjeve në zonën e OECD-së janë NVM.

Këto ndërmarrje punësojnë rreth 60% e punëtorëve të sektorit privat, të japë një kontribut të madh në fushën e inovacionit dhe të mbështesë zhvillimin rajonal dhe kohezionin social. Gjithashtu, NVM-të në shumicën e vendeve me të ardhura të ulëta kanë kontribut të rëndësishëm në rritjen e PBB-së dhe krijimin e vende të reja pune.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-t) janë firmat e pavarura të cilat punësojnë një numër të caktuar, deri 250 të punësuarve në Bashkimin Evropian, ndërsa SHBA firmat me më pak se 500 punonjës.

Fjalët e rëndësishme: NVM-t, Zhvillimi ekonomik, Programet mbështetëse etj.

1. Hyrja

Ky hulumtim është një rast studimi që tregon dinamikën e zhvillimit të NVM-ve në Kosovë. Të dhënat primare janë mbledhur me anë të të dhënave cilësore të raporteve kërkimore dhe literaturës shkencore në këtë fushë.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të) në Kosovë janë shumë të rëndësishme për rritjen ekonomike. Përqindja e NVM-ve llogaritet rreth 99% në ekonominë e Kosovës dhe rreth 70% e të punësuarve në Kosovë janë të punësuar nga NVM-të, për këtë arsye ato kanë një efekt të rëndësishëm në punësimin e forces punëtore të vendit. Struktura e ndërmarrjeve është e dominuar kryesisht nga ndërmarrjet mikro (1-9 punonjës) dhe niveli i rritjes është i qëndrueshëm, por ende në nivel të ulët.

Prandaj ky është një studim cilësor për të ilustruar dinamikën dhe rolin e NVM-ve në Kosovë. Ka një numër të pengesave që ndikojnë në rritjen e tyre, faktorëve të tillë si: aksesit në financa, konkurrencës, korrupsionit dhe pengesave të tjera të tregtisë, kompetencat e menaxhimit, mungesës së kualifikuar të punëtorve, strategjitë e marketingut, nivelin e inovacionit dhe investimet në teknologji, etj.

Nisur nga rrjedhat historike të ekonomisë Kosovare e cila e pësoj fatin e shpërbërjes në vitet e 90-ta dhe tranzicionit të vonshëm dhe të ngadalshëm, ku si pasojë roli i ndërmarrësit u mishërua me nevojën e egzistences ekonomike të shoqërisë sonë, duke pasur parasysh kulturen ndërmarrëse në Kosovë dhe statet e zhvillimit, komponente me rëndësi në promovimin dhe avancimin e sajë paraqiten shoqatat e biznesit të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në orientimin e potencialit biznesor përmes anëtarësimit dhe dhënjes së shërbimeve profesionale mbështetëse (organizimit të trajnimeve për biznese, hartimit të

planeve të biznesit, hulumtimeve të tregut, krijimit të identitetit, rrjetizimin, etj.).

Industria e shërbimeve konsulente në Kosovë është relativisht e re dhe në etapat e sajë fillestare, ku një rolë të rëndësishëm në zhvillimin e sajë e kanë organizatat donatore si: EBRD përmes programit TAM-BAS (Turn Around Management and Business Advisory Services); USAID përmes KPEP (Kosovo Private Enterprise Programme); Programi KOSME si dhe organizatat vendore si: Agjencia për Ndermarrje të Vogla dhe të MeNVM (skema e vouchereve); BSC Kosova (trajtime për ndërmarrësi dhe zhvillim të bizneseve), dhe së fundmi Krijimi i Këshillit të Konsulentëve të Biznesit BCC (CMC, diagnostifikimi i biznesit, etj.)

2. Kategorizimi i NVM-ve dhe faktorët përcaktues

Kategoria e mikro, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të) është i përbërë nga ndërmarrjet që punësojnë më pak se 250 persona dhe kanë një xhiro vjetore që nuk kalon 50 milion euro, dhe / ose një bilanc total vjetor jo më shumë se 43.000.000 € .

Faktorët kryesorë që përcaktojnë nëse një kompani është një NVM-ve janë:

1. Numri i të punësuarve dhe
2. Qarkullimi ose bilanci total.

Tabela 1. Kategorizimi i NVM-ve

Lloji i Bizneseve	Punësuarit	Të ardhurat	Bilanci i gjendjes
MeNVM	< 250	≤ € 50 m	≤ € 43 m
Vogla	< 50	≤ € 10 m	≤ € 10 m
Mikro	< 10	≤ € 2 m	≤ € 2 m

Burimi: Komisioni Evropian

Një nga përkufizimet e biznesit të vogël është dhënë nga “Committee for Economic Development” sipas të cilit duhet të plotsohen dy ose më shumë nga karakteristikat vijuese²⁵⁰:

- Menaxhimi i firmës është i pavarur ku zakonisht pronarët janë edhe menaxher,
- Kapitali është në pronësi të një individi ose grupi të vogël,
- Shtrirja dhe të punësuarit janë kryesisht lokal,

Ndërmarrjet e vogla dhe të meNVM (NVM) janë një grup shumë heterogjene. Firmat operojnë në tregje shumë të ndryshme (urbane, rurale, lokale, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare); mishërojnë nivele të ndryshme të aftësive, kapitalit, sofistikimit dhe orientimin e rritjes, dhe mund të jetë në formal apo ekonomisë informale.

3. **Format legale te NVM-ve**

Përmirësimi i mjedisit të biznesit, duke siguruar që i gjithë legjislacioni i ri është efikas dhe transparent me anë të konsultimeve të zgjeruara publik-privat dhe disa forma të analizave të ndikimit rregullator.

Zhvillimi i mëtejshëm i institucioneve dhe kapacitetin e tyre për të zbatuar dhe monitoruar programet mbështetëse të biznesit, në mënyrë progresive duke marrë fonde mbi aktivitetet që donatorët janë aktualisht, rindërtimin e partneriteteve të biznesit, për promovimin e mësimin sipërmarrës.

Sondazhi Intervista e bërë për këtë studim njofton për një numër të karakteristika të tjera kryesore të sektorit të NVM-ve në Kosovë.²⁵¹ Figura tregon se "Biznes Individual (BI)" është forma dominuese ligjore sidomos në mesin e solo-sipërmarrësit dhe bizneset e tjera mikro me më pak se 10 persona të punësuar.

²⁵⁰ Riinvest (2005). Mustafa .M, Kutllovci.E, Gashi.P, Krasniqi, B Biznesi i vogël dhe i mesëm.


²⁵¹ KOSME Raport Studimi i NVM-ve 2014

Në këto kategori të madhësisë 92% dhe 77% e bizneseve respektivisht janë duke përdorur formularin e BI.

Ndërmarrjet e vogla dhe të meNVM (10-249 persona të punësuar), janë më shpesh të organizuar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SH.PK). Në këtë kategori, 43% janë duke përdorur formularin SH.P.K.

Rreth 10% e atyre të organizuara si një "Biznes Individual (BI)" janë aktualisht duke planifikuar të ndryshojnë formën e tyre ligjore në një Kompani me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.PK). Kjo ka të bëjë kryesisht biznese në kategorinë e madhësisë prej 2 deri në 9 personave të punësuar në sektorë të ndryshëm.

Figura 1. Frekuenca (%) e formave ligjore midis NVM-ve, sipas madhësisë



4. Dinamika e Zhvillimit të NVM-ve ne Kosove 2007-2011

Roli i sektorit privat, e posaçërisht i NVM-ve ka qenë relativisht i dobët. Pavarësisht kësaj, Kosova është ende në fazën e tranzicionit ku ndërmarrësia dhe krijimi i bizneseve të vogla pritet të luaj rol thelbësor në rrugën drejt një

ekonomie moderne të tregut të lire dhe si rrjedhim edhe drejt zhvillimit dhe rritjes ekonomike²⁵².

NVM-të përbëjnë shtyllën kurrizore të ekonomisë së Kosovës. Sipas të dhënave të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), në fund të 2011, NVM-të (përfshirë ndërmarrjet mikro) përbënin rreth 99,97% të të gjitha bizneseve që veprojnë në vend (për më shumë detaje, shih tabelën nr. 2 më poshtë).

	2007		2008		2009		2010		2011	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Mikro ndërmarrjet	6,744	96.79	8,242	97.50	9,798	97.48	9,420	98.00	9,919	98.40
Ndërmarrjet e vogla	178	2.55	160	1.89	215	2.14	165	1.72	139	1.38
Ndërmarrjet e mesme	40	0.57	43	0.51	31	0.31	21	0.22	19	0.19
Gjithsej NVM	6,962	99.91	8,445	99.91	10,044	99.93	9,606	99.94	10,077	99.97
Ndërmarrjet e mëdha	6	0.09	8	0.09	7	0.07	6	0.06	3	0.03
GJITHSEJ	6,968	100%	8,453	100%	10,051	100%	9,612	100%	10,080	100%

Burimi: Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë

Tabela nr. 2 Statistikat e ndërmarrjeve sipas madhësis 2007-2011

4.1. NVM-t sipas formës së menaxhimit

Si duket statuti ligjor i ndërmarrjeve dhe madhësia e tyre, ka ndikim edhe në formën e menaxhimit. Rezultatet nga anketa dëshmojnë se tek NVM-të, në Kosovë ende nuk kemi ndarje të funksionit të pronës dhe menaxhimentit. Në fakt, nga të gjitha ndërmarrjet e anketuara mund të vërejmë se 86.46 % e tyre menaxhohen nga pronarët dhe vetëm 13.54 % menaxhohen nga menaxherët e caktuar.

²⁵² Strategjia e Zhvillimit të NVM-ve 2012-2016 me vision 2020

Menaxhimi	Gjithsej Ndërmarrje	%	Prishtinë	%	Gjilan	%	Pejë	%	Prizren	%	Mitrovicë	%
Pronari	677	86.46	226	88.28	151	86.29	121	87.68	109	78.99	70	92.11
Menaxheri	106	13.54	30	11.72	24	13.71	17	12.32	29	21.01	6	7.89
Totali	783	100	256	100	175	100	138	100	138	100	76	100

Tabela 3. Ndërmarrjet sipas formës së menaxhimit

Burimi: Agjencia e NVM-ve

4.2. *Struktura gjinore dhe mosha e themeluesve të NVM-ve*

Struktura gjinore e pronarëve të ndërmarrjeve është element i rëndësishëm në analizën dhe përcjelljen e aktiviteteve të ndërmarrjeve. Edhe pse në vendin tone pjesëmarrja e femrave në udhëheqjen e ndërmarrjeve është e vogël, viteve të fundit shihet një ngritje e pjesëmarrjes së femrave në regjistrimin e ndërmarrjeve²⁵³.


Tabela 4. Struktura gjinore e NVM-ve

Gjinia	Gjithsej Ndërmarrje	%	Prishtinë	%	Gjilan	%	Pejë	%	Prizren	%	Mitrovicë	%
Femër	54	6.90	20	7.81	5	2.87	11	7.97	12	8.63	6	7.90
Mashkull	729	93.10	236	92.19	169	97.13	127	92.03	127	91.37	70	92.10
Totali	783	100	256	100	174	100	138	100	139	100	76	100

Burimi: Agjencia e NVM-ve


²⁵³ Agjencia e NVM-ve Raport – Hulumtimi i 800 Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme

Figura 2. Struktura gjinore e themeluesve




Burimi: Agjencia e NVM-ve

Figura 3. Struktura moshore e pronarëve të biznesit



Burimi: Agjencia e NVM-ve

Figura 4. Niveli i edukimit të pronarëve të biznesit



Burimi: Agjencia e NVM-ve

5. Struktura sektoriale e NVM-ve

Ekzistojnë indikacione se struktura sektoriale e NVM-ve në Kosovë po përmirësohet në dobi të prodhimit në krahasim me dy anketimet e mëparëshme²⁵⁴. Ndryshimet konsistojnë në zvoglimin e pjesëmarrjes së ndërmarrjeve tregtare dhe rritjen e pjesëmarrjes së ndërmarrjeve prodhuese dhe shërbyese në numrin e përgjithshëm të ndërmarrjeve. Megjithatë veprimtaria kryesore e ndërmarrjeve të anketuara është e koncentruar në tregti (55.3%), prodhimi (30.3%), ndërkaj pjesa tjetër (13.3%) përfshin të gjitha veprimtaritë shërbyese.

Sektori	Mikro	Të vogla	Të mesme	Gjithsej
Prodhimi	15.9	51.3	66.7	32.0
Tregtia	65.9	43.5	26.7	55.3
Shërbimet	18.2	5.2	6.7	12.7
Shuma	100.0	100.0	100.0	100.0


Burimi: Të dhënat nga anketa e Riinvestit

Tabela 8. Krahasimi i madhësisë së ndërmarrjeve sipas sektorëve (%)

²⁵⁴ Profili Rrethina institucionale dhe konkurrese e NVM-ve ne Kosove RIINVEST 2001

Struktura e veprimtarive ekonomike është e ndarë në sektorë të ndryshëm ku tregtia (me shumicë dhe pakicë) e ndërmarrjeve dominon aktivitetin ekonomik²⁵⁵

Figura 5: Struktura e ndërmarrjeve sipas aktivitetit ekonomik (2003-2010)



Burimi: Sfidat dhe Perspektiva e NVM-ve në Kosovë Shiroka-Pula Justina

6. Anëtarësimi i NVM-ve në asociacione të biznesit

Pjesëmarrja në asociacione, klube apo forume të cilat kanë funksion të shkëmbimit të përvojave, kontakteve, avancimit të klimës ekonomike, përcjelljes së trendëve të zhvillimit të bizneseve është faktor shumë i rëndësishëm për afirmimin e ndërmarrjeve. Nga përgjigjet e të anketuarve mund të vërehet se ekziston një vakum i komunikimit apo prezencës së ndërmarrjeve në institucionet e lartshënuara. Nga ndërmarrjet e anketuara 83.91% e tyre kanë deklaruar se nuk janë pjesëmarrës në asociacione të ndryshme, përderisa vetëm 16.09% e tyre janë pjesë e organizimeve të cekura më lartë.

²⁵⁵ Sfidat dhe Perspektiva e NVM-ve në Kosovë Shiroka-Pula Justina




Figura 6. Anëtarësimi në asociacione të biznesit

Burimi: AMNVM Raport – Hulumtimi i 800 Ndërmarrjeve të Vogla dhe të MeNVM





Figura 7. Niveli i mbështetjes nga organizatat e shërbimeve të biznesit

Burimi: AMNVM Raport – Hulumtimi i 800 Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme

7. Masat qe duhet ndërmarr qeveria në mbështetje të krijimit dhe zhvillimit të NVM-ve

Me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për zhvillimin e bizneseve në fokus të këtij hulumtimi kanë qenë edhe masat që duhen marrë në favor mbështetjes, krijimit dhe zhvillimit të NVM-ve. Rrjedhimisht është tentuar që të analizohet opinioni i përfaqësueseve të ndërmarrjeve për masat të cilat do të ndikonin pozitivisht për përmirësimin e ambientit afaristë për bërje të biznesit. Rezultatet nga hulumtimi na bëjnë me dije qe ulja e taksave dhe thjeshtimi i sistemit fiskal është prioriteti kryesorë i ndërmarrjeve që duhet të adresohet nga institucionet shtetërorë. Në fakt 82% prej tyre kanë theksuar këtë si prioritet i madh. Tre prioritet tjera me radhë që janë theksuar nga mbi 2/3 e ndërmarrjeve të anketuara janë zvogëlimi i taksave për eksport dhe promovimi i produkteve vendore, krijimi i fondit për NVM, dhe rritja e mbështetjes perms agjencive për mbështetje të NVM-ve.

Figura 8. Masat qe duhet ndërmarr qeveria në mbështetje të krijimit dhe zhvillimit të NVM-ve



Burimi: ANVM – Raport – Hulumtimi i 800 Ndërmarrjeve të Vogla dhe të MeNVM

Përfundime (Rekomandime)

Si rekomandime për akterët relevant të cilët janë të implikuar në zhvillimin dhe promovimin e NVM-ve rekomandohet të ndërmerret disa hapa:

- 1.** Organizimi dhe mbajtja e trajnimeve për rëndësinë e planifikimit operativ dhe strategjik të aktivitetit ekonomik për periudha më të gjata kohore, që do të rezultojnë me zgjerimin e afarizmit dhe plotësimin e tij me aktivitete të reja.
- 2.** Krijimin e politikave për stimulime financiare ata të cilët kanë ambicie për të zhvilluar biznes.
- 3.** Aplikimin e masave stimuluese për eksportet nga ana e qeveris, si thjeshtësimin e procedurave burokratike, zvogëlimin e tarifave doganore, etj.
- 4.** Përforsimi i marrëdhënieve ekonomike me vendet tjera të rajonit, me qëllim që të krijohen kushte të favorshme për depërtimin e produkteve vendore në tregjet rajonale dhe ato të Bashkimit Evropian.
- 5.** Krijimi i masave lehtësuese për investitorët e huaj, përfshirë thjeshtësimin e procedurave administrative të licencimit të kompanive ndërkombëtare të cilat shprehin interes për të investuar në vendin tonë.
- 6.** Përgatitja e legjislativës bankare nga BQK, me qëllim të lehtësimit dhe zbutjes së kriterëve kreditore për kompanitë që dëshirojnë të shfrytëzojnë format e ndryshme kreditore për zhvillim të biznesit.
- 7.** Afatet kohore për kthimin e kredisë duhet të zgjatën (të aplikohet grejs perioda), dhe njëkohësisht duhet të zbatohen politika kamatore më të arsyeshme, në mënyrë që kreditë bankare ndihmojnë zhvillimin e biznesit e jo të bëhen pengesë e zhvillimit të tij.
- 9.** Duhet të stimulohet anëtarësimi i NVM në asociacione të biznesit, sepse kjo përbënë një faktor me rëndësi për zhvillimin e aktivitetit të tyre.

Literatura

- Mustafa .M, Kutllovci.E, Gashi.P, Krasniqi, B (2005). Biznesi i vogël dhe i mesëm. Riinvest
- Shiroka-Pula J. Sfidat dhe Perspektiva e NVM-ve në Kosovë Analizë Krahasuese dhe Empirike 2013
KOSME Raport Studimi i NVM-ve 2014
- AMNVM 2011, Hulumtimi i 800 NVM-ve në Kosovë
- Agjencia e NVM-ve 2011, Strategjia e zhvillimit të NVM-ve (2012-2016) me vision 2020
- MTI mars 2013 Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017
- Profili Rrethina institucionale dhe konkuresse e NVM-ve ne Kosove RIINVEST 2001
ASK 2013, Rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve 2008-2012

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

34(496.51)“2016”(063)

33(496.51)“2016”(063)

Qasje / Qendra për Avancimin e Studimeve Juridike dhe
Ekonomike. – Prishtinë : Universiteti i Prishtinës : Qendra
për Avancimin e Studimeve Juridike dhe Ekonomike, 2016.

- libra : ilustr. ; 21 cm. – (Libri i Punimeve)

[Libri] I : Kongresi i Parë Ndërkombëtar i Shkencave
Juridike dhe

Ekonomike Prishtinë, 29-30 tetor 2016. – 290 f.

Literatura pas çdo punimi.

ISBN-978-9951-00-181-6

ISBN-978-9951-00-182-3



QASJE

Qendra për Avancimin e Studimeve Juridike dhe Ekonomike



**Universiteti i Prishtinës
“Hasan Prishtina”**



**Republika e Kosovës
Ministria e Arsimit Shkencës
dhe Teknologjisë**

Mbështetur nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

ISBN 978-9951-00-182-3



9 789951 001823

www.qasje.org